

**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP**

**STUDIME
ALBANOLOGJIKE**

11

Shkup, 2015

*Kryeredaktor
Prof. Dr. Qemal Murati*

*Redaksia
Prof. Dr. Qemal Murati
Dr. Bukurije Mustafa
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Naim Halimi
Dr. Besnik Emini*

*Sekretar i redaksisë
Dr. Besnik Emini*

*Adresa e redaksisë:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
Kutia Postare nr. 171
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë*

*Adresa elektronike:
studimealbanologjike@yahoo.com
studimealbanologjike@itsh.edu.mk*

ISSN 1857-6958
UDK 930.85
COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA

<i>Alfred UÇI</i> BARIU I POPULLIT DHE LIGJËRIMET E TIJ.....	7
FJALIMI I RRALLË I FAN NOLIT NË ASAMBLENË E LIDHJES SË KOMBEVE.....	15
<i>Ardian VEHBUI</i> IDENTITETE SHQIPTARE E ARBËRESHE - sprovë për një përkufizim.....	19
<i>Qemal MURATI</i> “ENCIKLOPEDIA E JUGOSLLAVISË”: SHQIPTARËT ME PREJARDHJE ILIRE.....	29
<i>Dorian KOÇI</i> SPROVA IDENTITARE E KONGRESIT TË MANASTIRIT.....	33
<i>Vincent W. J. VAN GERVEN OEI</i> ÇFARË MUND TË BËJË SHTETI ME GJUHËN?.....	35
<i>Haredin XHAFERI</i> KLASIFIKIMI I LOKUCIONEVE PARAFJALORE SIPAS STRUKTURËS DHE VLERËS SË TYRE SEMANTIKE.....	41
<i>Memli KRASNIQI</i> KRIJIMI I SHTETIT SERB DHE LINDJA E PROJEKTIT “CZARTORYSKI”.....	55
<i>Naim HALIMI</i> SYLË HOTLA NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE.....	61
<i>Nexhmedin Z. BARDHI</i> KOLONIZIMI DHE SHPËRNGULJA NË FSHATRAT E MORAVËS SË EPËRME 1912-1915.....	65
<i>Shpend AVDIU</i> SHTYPI EVROPIAN MBI ZGJEDHJEN E PRINCIT TË SHQIPËRISË VILHELM VIDI (1913-1914).....	75

Marisa KËRBIZI

PARADIGMA E DASHURISË SË ËNDËRRIT NË ROMANIN “VERA PA KTHIM” TË BESNIK MUSTAJ.....91

Jolanda LILA

EUFONIA, TIPAR MBIZOTËRUES NË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT.....99

Danillo KISH

DISA KËSHILLA PËR TË GJITHË SHKRIMTARËT E RINJ.....101

Izaim MURTEZANI

RRETH RITIT TË RRAHJES SIMBOLIKE TË DHËNDRIT.....107

Ermal MEHMETI

KËNDIMI POLIFONIK TE POPUJT E BALLKANIT.....115

Gjovalin SHKURTAJ

EPOSI I KRESHNIKËVE DHE MBLEDHËSIT E SHQUAR TË PERLAVE.....123

Rini USEINI

ZANAT NË MITOLOGJINË SHQIPTARE – ASPEKTI DIAKRONIK DHE SIMBOLIK I TYRE.....127

Bernard LEWIS

ISLAMIZMI DHE PERËNDIMI.....135

Jovan NIKOLAIDIS

NE BALLKANASIT DIMË MIRË VETËM SI TË ZIHEMI.....141

Raymond DETREZ

MOS U BESONI ATYRE QË THONË SE KUJDESEN PËR INDENTITETIN TUAJ!.....147

Agim RUSHITI

ABETARES (SË PËR)BASHKË(T) TË GJITHË T’I GËZOHEMI.....149

Angjelina HAMZA

GLOBALIZIMI DHE TRADITA E USHQIMIT NË KULTURËN SHQIPTARE.....157

Bukurie MUSTAFA

FJALË DHE SHPREHJE FRAZELOGJIKE TË SË FOLMES SË PATISHKA REKËS.....167

Bajram MEHMETAJ

MBI DISA TOPONIME PERIFRASTIKE TË TREVËS SË DEÇANIT.....175

Hajrip KOÇINAJ

TOPONIMIA E FSHTATIT BLAÇ TË OPOJËS.....181

RECENSIONE

NJË STUDIM AKTUAL PËR PROBLEME TË SHQIPES STANDARDE (Prof.dr. Qemal Murati, Gjuha shqipe në komunikimet publike, IAP, Prishtinë, 2013, f. 1-549) (Bajram MEHMETAJ).....197

NOMADËT E FUNDIT (Sipas romanit të shkrimtarit Thanas Medi) (Miho GJINI).....201

SIMON VIZENTAL - LUFTËTAR I MBAJTJES GJALLË TË KUJTESËS SË GJENOCIDIT NAZIST (Ilir HASHORVA).....205

KRONIKA SHKENCORE

OLIVERA JASHAR-NASTEVA - NJË INSTITUT MË VETE BALLKANOLOGJIE (në 15-vjetorin e vdekjes) (Qemal MURATI).....211

AKTIVITETET DHE BOTIMET SHKENCORE TË ITSHKSH NË VITIN 2014 (Sefer TAHIRI).....215

MANIFEST PËR MBROJTJEN E SHQIPES (Preng Cub Lleshi, Mos e vritni fjalën shqipe, Tiranë, 2014) (Dhurata HAMZAI).....221

IN MEMORIAM: *Aleksandar Stipçeviq (1930-2015)*

IKJA E ILIROLOGUT QË DINTE MË SË SHUMTI PËR ILIRËT (Naser FERRI).....225

ALFRED UÇI

BARIU I POPULLIT DHE LIGJËRIMET E TIJ

ESE Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes të Fan S. Nolit (1882-1965) mbi jetën dhe veprën madhore, kulturore, atdhetare dhe historike të rilindësit gjenial

Fan S. Noli është një figurë e shumanshme letrare e poetike, burrë i madh shteti e politikan i shquar atdhetar, dijetar dhe historian, përkthyes e poliglot, prijës popullor e kreu i Kishës Autoqefale të Kombit shqiptar, që ka lënë pas një kontribut të jashtëzakonshëm në trashëgiminë kulturore kombëtare, që mban emrin e tij të Fanolizmës dhe që rron e gjallë, duke ushqyer përparimin e të ardhmen e ndritur të Shqipërisë, edhe të shqiptarëve kudo ku jetojnë e nderojnë Atdheun e shtrenjtë. Pjesë e pandarë e organike e Fanolizmës janë Fjala e tij shqipe dhe ligjërimet e tij të famshme, të paharrueshme, që kanë pushtuar dhe pushtojnë mendjen e zemrat e dëgjuesve shqiptarë me ide të larta përparimtare, që kanë bukurinë e hijet e Bariut të gjithë popullit. Fan Noli ka futur në to një përmbajtje tejet interesante me figura, motive, shakara e anekdota groteske, gjithë lezet, por edhe me finesë, ironi e humor, satirë e sarkazma të shkëlqyera. Ligjërimet e tij, me çfarëdolloj teme, janë në nivelin e ligjëratave klasike të Antikitetit greko-romak, përmbushin plotësisht kërkesat normative, që i theksonte në kohën e vet, Ciceroni, mjeshtri i shquar i gojëtarisë romake: “Mëria, delikatesa, urrejtja, mëshira, tmerri, shpresa, neveria, gëzimi, hidhërimi, entuziazmi, revolta, të gjitha këto duhet të jenë nën pushtetin e oratorit.

Ai duhet të dijë të prekë e të ngjallë secilin prej këtyre ndjenjave”. Në këtë mes mjeti i sprovuar i ligjërimeve të Nolit është edhe grotesku, ndonëse i përfshirë në një mënyrë të re në mendimin e tij modern; s’ka në to aroma të skaduara e anakronike, të ezauruara e të bëra bajat. Tek ligjëratat mbizotërojnë shqetësimet për fatet e vendit, për të ardhmen e tij, urrejtja e përqeshja e kundërshtarëve të lirisë e përparimit të Atdheut. Gjuha shqipe e mrekullueshme, stili i thjeshtë në parashtrimin e problemeve më të thella që shqetësojnë opinionin e masave, me imazhe e ngarkesë poetike origjinale ekspresive, me patos dhe erudicion, ligjëratat e tij kanë qenë e do të mbeten gjithmonë frymëzuese për çdo atdhetar. Që në ligjëratën e parë, të mbajtur para shoqërisë “Malli i Mëmëdheut” në Amerikë, shkëlqejnë figurat groteske, që përçojnë frymën kombëtare: ”Qamë, lebetitëm, ulëritëm ndër kisha e xhami, por kurrën e kurrës na u përgjigjën muret e thatë, atje vetëm korbat, galat dhe kukumjaçkat dinë t’ia thonë. Kujt i luteshim atje? I luteshim atij që kurrë do mos na e kthente fjalën. Po krahëve tona, vetes sonë, trimërisë sonë, shpatës dhe kordhës sonë, kurrë s’iu lutëm... Shqipërinë e lamë në varr të harrimit, thika e palla na u mykën ndër myllet e huaja”.

Në përputhje me veçoritë tematike Fan Noli sajoi figura krejt origjinale, të përshtatshme e të kuptueshme: “Të mos e bëjmë rrojtjen tonë gur varri, por ta bëjmë statujë përmbi të cilën të vihet kurorë e vdekjes”. Situatat që kalon demokracia e brishtë parlamentare e ditëve të sotme, duket sikur përsërit vetveten në ligjërimet e Fan Nolit të viteve të para të dekadës së dytë të shek.XX, të cilat i përqueshte me stilin e tij të mprehtë ironik: “Shpresat tona sa venë e fishken, se mali i mbarsur i kabineteve tona të forta, ndofta i influencuar nga syri i lig i pakicës kundërshtarë heterodokse dhe heretike të papenguar, dështoi me një buçitje dhe refuzoi të na japë të paktën miun proverbial”. Dhe më tej, në frymën popullore, në ligjëratat e tij në Parlament, Noli jep cilësimin e Kabinetit, duke i vënë nofkën, që s’harrohet tashmë kurrë, të “kabinetit të pykave”: “Se ca janë pyka nga dituria e ca janë pyka nga vlerat civile. Dhe është në natyrë të pykave të jenë të rrethuar me pyka e dallkukë. Ideali i tyre nuk është të organizojnë shtetin, se as vetë s’dinë të organizojnë, as organizatorët nuk do t’i lënë të lirë. Ideali i tyre është të mbajnë kolltukët me çfarëdo çmim. Mjetet e tyre për të arrirë këtë ideal janë druri e ryshfeti”. Në majën e oratorisë mjeshtërore të Fan Nolit qëndron, pa dyshim, fjalimi i tij historik në Asambleshën e Lidhjes së Kombeve. Ndonjë keqdashës, që s’nguron t’i kthejë përmbys ngjarjet historike, ka guxuar ta quajë “të gabuar” e “të dëmshme” për interesat kombëtare këtë ligjëratë të Nolit, se kinse paska penguar Lidhjen e Kombeve, të atyre që e kullandrisnin atë në dobi të interesave imperialiste (të na falë lexuesi për epitetin e vjetër, që s’është i vjetruar vetëm për atë kohë), paska penguar dëshirën e padurimin e saj për ta ndihmuar Shqipërinë. Por edhe vlera politike e ligjëratës së Fan Nolit në këtë “mexhilis” nuk do të kuptohej, po të mos harrojmë se ajo ka qenë një paralajmërim i mençëm i një burri të urtë e largpamës, (i bindur jo vetëm se ata që kullandrisnin Lidhjen e kishin copëtuar Shqipërinë), për fundin e palavdishëm të Lidhjes së Kombeve.

Lidhja e Kombeve

Këtë fund kishte parasysh Noli kur u drejtohej delegatëve në stil grotesk me përqeshje për fjalët “paqedashëse”, që përcillnin përgatitjet e luftës. Pyetjes se ç’kishte bërë Lidhja e Kombeve për paqen gjatë pesë vjetëve të ekzistencës së saj, Noli i përgjigjej me shprehjen e famshme groteske të Shekspir: “Fjalë! Fjalë! Fjalë!”, “domethënë erë e asgjë më tepër”, së cilës Noli i shton nga shqipja: “Flluskë sapuni!”. Në një prerje groteske e vendos veprimtarinë e Lidhjes Dhespoti shqiptar: “Këto çështje për çarmatim e paqe iu dhanë për shqyrtim një Komisioni, i cili do t’ia kalojë një nënkomisioni, i cili do t’ia parashtrijë konkluzionet e tij një konferencë, që do të mbledhet së shpejti, dhe kjo konferencë do t’ia dërgojë përsëri këto çështje një komisioni, pastaj një nënkomisioni, i cili do t’ia referojë komisionit, i cili do t’i dërgojë një raport konferencës. Konferenca do të votojë njëzëri një rezolutë dhe kjo e fundit do t’i jepet për shqyrtim Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Këshilli, nga ana e tij, do t’ia kalojë këtë rezolutë Asambleshës së ardhshme të Lidhjes, e cila do t’i drejtojë njëzëri një lutje Zotit të plotfuqishëm, atje lart në qiell. Dhe kur këto çështje të kenë bërë këtë cikël poetik zvarritjesh e kundërzvarritjesh, raportesh e kundëraportesh dhe mendimesh konsultative, atëherë

ato do t'i dërgohen së fundi, sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do t'i mbyllë me kyç mirë e mirë dhe do t'i varrosë në dosjet e vdekura të Sekretariatit, ku do të mbahen brez pas brezi...Kjo histori do të mbarojë siç mbarojnë flluskat e sapunit!”. Flluska sapuni quan me të drejtë Noli edhe premtimet e Lidhjes së Kombeve për t'i dhënë Shqipërisë një hua sado të vogël qoftë. Në gjithë historinë e publicistikës shqiptare vlerat më të shquara e më të qëndrueshme kanë qenë krijuar kryesisht, kur është përdorur brenda saj stili letrar grotesk. Kjo prirje nuk duhet të ketë qenë e rastit. Ne duam ta hamendësojmë për shkaqe të rëndësishme, që kanë përcaktuar këtë dukuri. Mendojmë se rrjedhat e jetës shoqërore e sidomos politike të Shqipërisë në gjysmën e parë të shek. XX kanë përfshirë probleme e procese tejet dramatike, kriza e kthesa të rënda, që patën prekur themelet e ekzistencës e të jetës kombëtare, kundërthënie për të qarë e për të qeshur, mbushur me onçobonço shqipo, si edhe ca të tillë spanjollë që i paraqit Servantesi në romanin e tij, të përkthyer nga Fan Noli.

Noli paraqet panoramën e lezetshme të Ministrisë së Jashtme

“Rroftë Ahmet Zogu, rroftë, Shakaxhiu i përparimit, Brez pas brezi u kujtoftë, Si stërnipi i Nastradinit”. Në ligjëratën e famshme “Shakaxhiu i përparimit” në stil grotesk F. Noli nxjerr në pah plagët e rënda sociale të regjimit zogollian, të cilin e karakterizon si regjimin e pesë anarkive: anarkisë fetare, anarkisë sociale, anarkisë morale, anarkisë patriotike dhe anarkisë së idealeve: “Këtu idealet e errëta, të shtrembra e të mumifikuara të Fanarit e të Buharasë përfytyren e përleshën në një luftë për vdekje me idealet e gjalla, elegante e të ndritshme të Perëndimit; na mungojnë vetëm idealet e antropofagëve, po për të zënë vendin e këtyre kemi kolltukofagët, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten me plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpushë, që mund t'i copëtosh, po jo t'i shqitësh nga trupi që kafshojnë e thëthijnë”. Se s'i mjaftonin këto pesë, po “shakaxhiu i përparimit” shtoi edhe dy të tjera, thotë Noli: Anarkinë shtetërore dhe anarkinë ekonomiko-financiare, duke e ruajtur arkën e zbratur të shtetit se mos bie ndonjë mi në të e thyhen kokën. Dhe për ta plotësuar pasqyrën e shtetit zogollian, Noli e quan edhe “shtet” të “ministrive të gafave”. Në një stil, që bashkon Servantesin me Rablenë, Noli paraqet për konkretizim panoramën e lezetshme të Ministrisë së Jashtme: “Pashë që kopshti i Ministrisë së Punëve të Jashtme është tharë krejt.

Atje më parë lulëzonin qepë, kastravecë dhe kunguj, atje pulkat dhe zogat klluçitnin dhe bënë vezë taze, të cilat depozitoheshin me kujdes në dollapët e Ministrisë, ku ruhen arkivat e shtetit. Tani vura re me hidhërim që qepët e kastravecët ishin tharë, dhe ahime! Ishin ç'dukur dhe kungujt që na kujtonin kokët simpatike të ministrave tanë”. Për ta mbyllur me një kulm figuracionin grotesk, Noli kujton historinë që ka rrëfyer Herodoti për atë athiniotin që kapi një anije perse me dorën e djathtë dhe s'e lëshonte gjersa ia prenë, atëherë e kapi me dorën e mëngjër, ia prenë dhe këtë; ahëre e kapi me dhëmbë dhe s'e lëshoi gjersa ia prenë kokën. “Sikur të ngjallej Herodoti”,-shton Noli, “Përsëri do të shikonte që kolltukofagët tanë janë më të fortë se trimi legjendar i lashtësisë greke. Që t'i

shqitësh këta tanët nga kolltuku, duhet t'u presësh jo vetëm duart e kokën, por edhe këmbët e trupin". Karakterizimi satirik i përsosur artistikisht, të tmerron kur kujton atë përbindësh që e pat zënë për fyti shoqërinë shqiptare dhe ia mbyti të ardhmen: "Mydiri i Pashiçit, Zogolli sygjarpër, zemërvrer, gjakkalbur, shpirtshitur, Esati i dytë, që çjerr, copëton e thëthim kufomën e Shqipërisë me egërsinë e një mostre të përrënjeve të Afrikës, së bashku me shtetarët dallkawkë, rajenj, laro dhe zaptie. Kështu ka zënë rrënjë shteti me kusarët në zyrat më të larta: Kusarë lart, kusarë poshtë, kusarë kudo. Dhe puna do të vazhdojë kështu, sa kohë qëndron në fuqi Ahmet Zogu, i cili nuk mund të çlirohet nga bashibozukët... Tani, a mund të rronjë Shqipëria si çiflig ministrash kusarë dhe si fushë plaçkitjeje hajdutësh të maleve?". Kaq bukur i realizon këta tipa, sa që kjo të kujton mjeshtërinë e autorit të lashtësisë greke të veprës "Karakteret", por Noli e nxjerr nga një realitet social e politik tjetër, nga realiteti konkret shqiptar, ndonëse shumë gjëra përsëriten në historinë e njerëzimit.

Noli ka krijuar vlera të shquara në publicistikë

Shqyrtimi e diskutimi i tyre kërkonte një stil të fuqishëm ekspresiv, që të prekte e të zgjonte nga gjumi letargjik gjithë atë masë pasive, të përgjumur, indiferente, interesat e së cilës ishin në lojë, ndonëse për këtë ajo s'ishte plotësisht e vetëdijshme. Prandaj, letrarët shqiptarë si Konica e Fishta, Fan Noli, Nonda Bulka dhe Migjeni etj., i kushtuan një vend të gjerë në krijimtarinë e tyre letrare publicistike dhe përdorën si të parapëlqyer një stil ekspresiv, zgjues ndërgjegjeje shoqërore e kombëtare. Nga ana tjetër, letërsia e mirëfilltë artistike te ne nuk kish arritur një shtrirje aq të gjerë, nuk binte nën ndikimin e saj një masë shumë e madhe lexuesish (qoftë edhe për shkak të analfabetizmit) dhe nuk zotëronte vlera aq të shquara sa të mund të trajtoheshin mjeshtërisht e artistikisht problemet, krizat e kontradiktat e bashkëkohësisë kombëtare, prandaj, ndoshta, brenda saj zuri një vend të rëndësishëm, e armatosur me një stil të groteskut ekspresiv. Kjo prirej spikat edhe në krijimtarinë letrare të Fan Nolit. Ashtu si Konica e Fishta, edhe Fan Noli ka krijuar vlera të shquara në publicistikën e tij të gjerë. Në radhë të parë spikatin ata artikuj publicistikë të Nolit, që trajtonin realitetin e atëhershëm shoqëror të Shqipërisë. Fan Noli vinte re shumë dukuri të mirëfillta groteske në të, duke filluar nga maja e piramidës shtetërore, për të cilat shkruante se përbëheshin nga "një çetë e hurit dhe e litarit", prej tradhtarësh, kusarësh, kriminelësh, tiranësh e bashibozukësh, domethënë qeniesh të tmerrshme groteske. Noli i klasifikon sipas llojit në kategori të ndryshme, duke nxjerrë në pah tiparet e tyre të shëmtuara. Në qendër të goditjeve demaskuese satirike Noli vendos kreun e regjimit, vetë Presidentin, që vetshpallet "Mbret i shqiptarëve". Ndryshe nga Konica, që e vendos atë nën goditjet e satirës groteske vetëm kur "Naltmadhëria e tij" braktisi Mbretërinë, duke e lënë në duart e pushtuesve të huaj fashistë, Noli e damkos në çdo hap të karrierës së tij dhe zbulon me kohë se ç'fatkeqësi kolosale përbënte Zogu për vendin e të ardhmen e këtij.

Ai stigmatizon atë skort servilësh e kusarësh, që i hapnin rrugën një Salepboze (nofka groteske e sajuar nga Konica), "Napoleonit të gjirizeve", të

ngjitej drejt fronit mbretëror; le të fillojmë së pari me anën qesharake:”Një pronar kabareje në Bukuresht, që ishte në krye të një turme njerëzish famëkëqij, banditë të vjetër, spiunësh, vrasësish me pagë, intrigantësh me pagë, e cila quhej Asamble Kushtetuese, i ofron kurorën mbretërore një hajduti të quajtur Ahmet Zogu, i cili ka shkruar përpara me vrasje, është pasuruar me vjedhje dhe është ngritur në pushtet me anë të tradhtisë. Ky hajdut emëron si Kryeministër të tij një bataçqi e një kriminel, Koço Kotën”. Noli e quan gjithë këtë një farsë e një operetë monarkike, që luhet në Europë m’u në shek.XX dhe që fshihte tragjedinë tonë kombëtare. Forca ekspresive e fjalës noliiane spikat sidomos kur përdoret për ta portretizuar Salep Sulltanin:”Historia s’ka parë një mbret aq të madh sa Salepboza, i kurorëzuar me hudhra e sa Napoleoni i gjirizeve. Pra, të gjithë janë të shtrënguar t’i falen statujës së tij prej hallve”. Për ta nxjerrë në pah fytyrën e vërtetë të Zogut, Noli kujton anekdotën për Tir Ulenshpigelin, që e quan “Nastradin Gjerman”. Dhe rrëfen, si shumë rrëfime të këndshme nga “Don Kishoti”: “Ky morri përsipër të zografiste muret e kështjellës së një konti, por duke mos qenë mjeshtër në këtë punë, sajoi një lodër groteske, paralajmëroi soditësit e pikturave të përfunduara se veç ata që s’do të ishin doçër, do të mund t’i shikonin e t’i pëlqenin veprat e tij. Kështu, miqtë e Kontit, kur hynë në kështjellë, filluan të lëvdonin pikurat nga frika se mos quheshin doçër dhe vetëm një shërbëtore, që më kot u përpoq të shijonte pikurat, bërtiti: “Ndjesë pastë nëna ime, më ka bërë doçe se unë nuk shoh asgjë”. Kështu, vazhdon Noli, e mori përsipër Zogu ta zbukurojë Shqipërinë, duke i mbushur mendjen Parlamentit me profkat e tij, por pak kohë u deshën për të kuptuar se puna doli fyçkë dhe “shakaja” u kuptua nga të gjithë. Dhe ngaqë Zogun Noli e akuzon për një “shaka” kolosale e groteske, që bën mbi kurriz të Shqipërisë, i thurë vargjet satirike në stil të parodisë groteske, që s’harrohen kurrë.

Prerjet groteske noliiane janë të dobishme edhe në ditët tona

Kundërvënia midis idealistëve dhe frikacakëve nga Noli realizohet në një prerje stilistike groteske, për të qeshur e për të qarë: “Të mençurit baresën dhe mejtohen me të rendur bashkë me çape të rregulluara pas algjebërës së ftohtë për mbi fushën e shtruar. A sikur lindë ata që të martohen me rehatinë dhe të vdesin në plaf të butë?! Unë i quaj frikacakë ata njerëz, që nuk kanë mjeshtërinë e madhe të lozin valle majë tërkuzës, i quaj njerëz, të cilët lindën me këmbë ariu dhe me mendje viçi, mentë të cilat nuk janë elastike që të përhapen e të përmblihen pas kohës. Të marrët rendin breg për bregu, shkëmb për shkëmbi. Mund të thyejnë kokën herë-herë.” Nga shpifarakët e gojëndyrët Noli krijon zanatin e “ndyrologjisë”, sepse vetëm nga dy artikuj të një gazete, thotë ai, “zumë: 3 spurdhjakë, një sharlatan, një të turpshëm, tre lëpushka, katër tradhtarë, 3 shaj, gjashtë të ndyrë, dy levere, pesë të poshtër, një shpirtzi, 15 gjarpërinj, 3 gjarpërinj helmues të ndyrë, tre këlyshë të ndyrë, një nepërkë, një përçollak, 2 gjarpërinj të helmuar, tre gjuhëza me helm, 24 kuçedra, një i pështymë të kuçedrës, gjithë këlyshët e kuçedrës, gjithë mostrat e Apokalipsit dhe, më në fund, një çomage në kokë dhe një të shtypur të kokës... Në këtë katalog duhen shtuar dhe Juda që tradhtoi Tënzot, Azefi, Artingu dhe vera e Ajadros... Neve e goditim me histori

dhe ai na përgjigjet me mitologji dhe gjarpologji... Duhet ta provoni me argumente dhe jo me sharje dhe gël'baza, o çomagjia xhonturke". Do të i kishte patur zili Servantesi rrëfimet e Peshkopit dhe do ta kishte shkruar edhe një vëllim për shtegtimet e "donkishotizmit" drejt Mbretërisë së shqiponjave. Por kjo prerje groteske noliene do t'ishte e dobishme edhe për ditët tona, kur mjaft politikanë e publicistë kanë vetëm një arsenal nga marrin armët, nga "ndyrologjia" e re, nga gjarpërologjia. Aktuale tingëllojnë dhe goditjet satirike të Nolit kundër grindjeve e hakmarrjes shqiptare: "Shumë herë në ca shtëpira, shëkon të servirin sofrën pa thikë, pa pirua e pa pjata, se këto vegla kaq të padëmshme bëhen armë të rrezikshme ndër duart e shqiptarëve të egërsuar për t'i nxjerrë sytë njëri tjetrit", na thotë shkrimtari.

Po përse zgjatemi me shkrimet e Fan Nolit? Jo vetëm se janë modele të mrekullueshme rrëfimi të po atij niveli si ato që na rrëfen edhe Servantesi, por edhe se më mirë do të kuptohet edhe platforma politiko-sociale e "fanolizmës", për të cilën do të kujtohem në kapitullin tjetër më thellë e më seriozisht, për të qeshur e për të qarë. Ashtu si Konica, edhe Fan Noli herë pas here bën klasifikime të atyre qenieve njerëzore, që ai i konceptonte si qenie groteske për nga veset e tyre të shëmtuara, të këqija, qesharake e komike, të tmerrshme e të llahtarshme. Kështu, në artikullin "Gurakuqi, Vinjau dhe Unë" (1925) brenda vathës së politikanëve pseudonacionalistë Noli zbulon katër tipa groteskë: 1) Proteikët, stërnipër të kulluar të Proteut mitologjik, që ndërrojnë fytyrën sipas kohës e nevojës dhe që hyjnë në çdo kallëp; 2) Emigrantikët, që s'kanë fytyrë të shkoqur e që s'hyjnë në asnjë kallëp; 3) Divinët, që s'dalin dot nga kallëpi i fesë së tyre, ashtu siç e kanë kuptuar denbabaden; 4) Konstruktivët liberalë e konservatorët... Të parët janë komikë; të dytët tragjikomikë; të tretët patetikë; të fundmit tragjikë". Të gjithë këta Noli i quan "Sizifë modernë" të Ferrit shqiptar, që nisën të ngjitin në majë të malit gurin e rrokullisur të Independencës me një tenacitet titanësh dhe pastaj po aty zihen e përçahen dhe venë në krye antikombëtarin Ahmet Zogun, ashtu siç patën vepruar kur zgjodhën edhe Esat Toptanin. Dhe Peshkopi ynë konkludon në mënyrë paradoksale, por ironike: "Jam në një mendje me ata që besojnë se Ahmet Zogolli është i vetmi njeri që mund ta shpëtojë Shqipërinë nga gjithë belatë. Ai do ta shpëtojë vërtet, duke e copëtuar e duke e kallur në varr njëherë e mirë". Një specie tjetër groteske Noli pat quajtur edhe ata që luajnë lojën e "paanësisë", ndonëse fshehin lojën e anësisë. Po në këtë kategori fut asi edhe ithtarët e pajtimit midis ujkut e bariut, duke i quajtur ironikisht "shenjtorë të pajtimit". Pas tyre vijnë edhe ata që dinë ta dredhin e shkojnë nga fryn era: "Nga fryn era? Nuk bën nga fryn era, po nga është udha e vërtetë; nuk nga është udha e hapur, po nga duhet hapur. Nuk nga është fushë, po nga janë malet. Kështu flet shqiponja, mbreti i qiellit". Prandaj Don Kishotin Noli e ka quajtur edhe idealist. Noli tallet edhe me ata, që e quanin veten "Krerë" (moderne- Vipa), por që interesoheshin vetëm të pasuroheshin: "S'ka krerë në Misir. Ka vetëm xhepa dhe qese të kyçura mirë, dhe të cilat kanë gjithmonë një shkak logjik që të mos hapen". Noli sulmonte edhe ata shqiptarë, që gjithë shpresat për ta shpëtuar Shqipërinë i kishin tek të huajt, gjersa t'u mbetej vendi "pa kokë, pa këmbë, pa krahë... Kur të na e bëjnë lakër vendin, atëherë do të na vijnë mendtë". Ai i ftonte bashkëkombësit të luftonin vetë e të sakrifikonin për

atdheun. Dhe përsëri edhe këtë këshillë e mbështet me një anekdotë groteske: “Të mos bëhemi si ai që u mërzi të rrojti dhe vate të mbytej, po tha: Po rri të nxjerr çorapet mos më lagen”. Nuk mendojmë që mbytet kombi, por shikojmë mos i lagen çorapet”. Noli kujton edhe anekdotën tjetër për ata që nuk u vinin kujdes fjalëve e paralajmërimeve të mençura të tij: “Zëri im qe, si i atij në shkretëtirë. Mjaft fjetëm”, u thosha. “Ke të drejtë”, më thoshin, dhe ktheheshin nga ana tjetër e mbuloheshin me dy jorganë... Atëherë fjalët e mia të ngrirat, sa pa arrirë në veshët e të nxehtëve, shkruinin”. Përballë retorikës salepjane të hosanave për “Sulltanin e ndritur” dhe teorizimeve abstrakte kinse intelektualo-elitare, Fan Noli vendos një panoramë rrëqethëse të realitetit, të ravizuar me një gjuhë ekspresive artistike, me tonalitë grotesk popullore, por të kuptueshme e prekëse për cilindo lexues: “Ironi tragjike; qani e qeshni, po kjo është e vërteta!”. Dhe vazhdon në rubrikën “Andej-këtej” shpalosja e kësaj tabloje: “Shqipëria është një trup i shoshitur prej sëmundjesh kronike, i qesënditur me plagë, me xhumba dhe me stigmatë (njolla), shenjat e përleshjeve për vdekje. Rreth saj janë mbledhur heqimët levantinë dhe bëjnë konsulta diabolike”. “Le t’ia lemë kohës, ajo i shëron të gjitha”, thotë fatalisti. “Jo, le t’i këndojmë një tropar e le t’i varrim një hajmali”, llototit fetishisti. “Aspak, le ta spërkatim me ujë të pafolur”, bërtet magjistar. “Jo, po le t’i japim një sherbet me pak affjon”, murmurit sheqerxhiu. “Më ndjeni”, ndërhyjnë bostanxhiu, “duhet t’i vëmë një qepë mi çdo plagë, një hudhër mbi çdo xhumbë dhe një piperkë mbi çdo shenjë”. Përkundrazi, duhet ta rrahim me kopaçe gjersa të ikin djajtë nga trupi”, ulërin jeniçeri”. “Nuk merremi dot vesh, unë, pra, propozoj të thërrasim një specialist evropian”, përsëriti myzeviri. “Tamam, le t’ia ngarkojmë këtë barrë sulltan Salepit të na sjellë nga Roma jo një, po me duzina specialistë, ata pastaj e dinë, ç’ilaç duhet.. Dhe kështu merr fund puna...”, përfundon dallkauku. Sigurisht, na tërheqin vëmendjen diskutimet që zhvilloheshin në fund të viteve 1920-‘30 mbi të ardhmen e shoqërisë shqiptare, kur sajoheshin edhe receta shpëtimi, që sot mund të duken tejet “të mençura” dhe sidomos “intelektualisht të habitshme” e të çmuara edhe për sot.

Don Kishoti i Nolit

Shpesh ato fshehin të vërtetën e atyre kohëve, që aq qartë e patën dhënë fanolistët e vërtetë, dhe nga disa prej këtyre recetave bie edhe përgjegjësia për vargun e ngjarjeve tragjike, që filluan nga fundi i kësaj periudhe dhe që në këtë ose atë mënyrë ndihen edhe sot e kësaj dite, kur diskutojmë siç u stërdiskutua për “identitetin tonë”, duke harruar platformën e Rilindjes Kombëtare, edhe duke rrëmihur për të provuar se jemi “kafë turke-espreso”. Porosia e tij ishte ajo e Sokratit: “Njih vetveten!”, formulë për të cilën interesohej edhe Kalorësi i Fytyrës së Vreosur, Don Kishoti i Nolit. Pas kësaj tabloje groteske do të kuptohet edhe më mirë përse ia përqasi realitetit të atëhershëm shqiptar Peshkop Noli romanin “Don Kishoti”, duke lënë një mesazh të gjallë, edhe për sot e gjatë zvarritjes sonë për të arritur atë që pat ëndërruar prej kohësh Ai. Kjo na duhet jo vetëm kur arsyetojmë për të kaluarën tonë, por edhe për të sotmen e të ardhmen tonë. Një shkollë, që s’ka për t’u vjetruar kurrë, ka për të qenë stili grotesk i Fan Nolit për gjithë talentet, që

do të punojnë në arrën e letrave shqipe; abece-në e stilit grotesk do ta mësojnë nëpërmjet kësaj enciklopedie të groteskut. “Don Kishotin e duam se në fytyrën e tij bëhet qesharak e grotesk kllasi i urryer i bejlurçinave, se Don Kishoti është tallja më e bukur që godet në tërë botën kundër reaksionarëve mendjengushtë, që nuk shohin realitetin dhe që duan ta kthejnë rrotën e historisë prapa, shkurt, e duam Don Kishotin se na bën të qeshim në kurriz të bejlurçinave. Don Kishotin e kini kudo”, na paralajmëron Fan Noli gjenial.

FJALIMI I RRALLË I FAN NOLIT NË ASAMBLENË E LIDHJES SË KOMBEVE

Fan Noli, në veprimtarinë e tij politike dhe letrare veçohet për oratorinë e tij të pashoqe.

Kulmin e oratorisë, Noli e arriti në fjalimin që mbajti në Lidhjen e Kombeve, në Asamblenë e Pestë të Lidhjes, më datë 10 shtator 1924. Edhe shtypi botëror e komentoi këtë fjalim të jashtëzakonshëm. “Fjala më e kthjellët dhe më e mençur” (Mezzogiorno); “Fjalë pa masë e zgjuar dhe e hollë” (Gazette de Lausanne); “Fjalë të drejta. Bombë e peshkopit shqiptar” (Daily Telegraph); “Peshkopi Kryeministër Fan Noli i Shqipërisë i bëri delegatët e Lidhjes së Kombeve të mbeten gojëhapur, kur u mbajti një nga fjalët që bëri bujë dhe pa dyshim një nga fjalët më piktoreske” (New York Times)

Ja fjalimi i mbajtur nga Fan Noli

Kam frikë se më i nxehti paqedashës, po t’i hedhë një sy veprës së kryer nga Lidhja e Kombeve gjatë këtyre 5 vjetëve, do t’i ngrejë duart drejt qiellit nga dëshpërimi dhe do të bërtasë : “ Oh! Më mirë luftë sesa të gjitha këto lllomotitje të mërzitshme për paqen!” Ç’kemi bërë për paqen? Çfarë bëjmë tani në këtë çast në këtë Asamble? Ajo që është bërë këta 5 vjet të shkuar pushon qetë-qetë në paqen e përjetshme, mbyllur fort, varrosur në dosjet e vdekura të Sekretariatit, të ruajtura me kujdes prej atij fort të ndershmit e të shquarit xhentëllmen, që është Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve. Është e vërtetë që Lidhja e Kombeve ka bërë disa shërbime të vogla për paqen në përgjithësi dhe në veçanti nuk lejoi copëtimin e Shqipërisë, duke siguruar kështu paqen dhe rendin në Ballkan. Siç e dini, Shqipëria ishte një kaçkë e fortë për t’u thyer dhe më e rëndë për t’u ndarë, kështu që Lidhja e Kombeve me mençuri vendosi ta lërë Shqipërinë të qetë, të lirë, të lagur nga valët e Adriatikut.

Por, ju lutem, zoti Sekretar i Përgjithshëm, përse refuzoni t’i jepni Shqipërisë një hua që do t’i lejonte të ecte vetë? Ne nuk na duhen më tepër se 300 milion fr. ar. Apo më shumë?

Atëherë po bëj gjestin elegant të zbres në shumën modeste prej 200 milionësh. Ju tundni kokën. E po jam gati të hyj në bisedime për një shumë më të vogël, p.sh., për 100 milionë. Më falni, mos pretendoni se nuk më keni takuar kurrë dhe, pra, nuk jeni i predispozuar të më jepni asnjë dhjetësh? Atëherë merreni këtë kërkesën time dhe varroseni në dosjet e vdekura të Sekretariatit, kyçeni mirë dhe mbyteni fort përpara se ta futni nën akropolin tuaj, sepse mund t’ju dalë nga varri. Ndoshta, Sekretari i Përgjithshëm ka dashur të thotë se ai nuk dëshiron që të hyjë në bisedime për një hua me një qeveri kryengritëse, që nuk ka parlament, një qeveri si ajo që kryeson i përunjuri prift që po ju flet. Po a e dini ju se ç’është parlamenti?

Pa dyshim e dini. Por do të keni një ide më të qartë kur t'ju them ç'mendoj për të. E, pra, parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanë pa shpirt për të bërë prova operate (vivisectionner) në trupin e gjallë të rracës së tyre, një sallë plot me gazra helmuese, gazra mbytëse, gazra që shkaktojnë lot dhe të qeshura dhe gjithë gazrat e tjera që u përdorën gjatë luftës së fundit për t'u dhënë fund gjithë luftërave e për të vendosur paqen, atë paqe për të cilën po flasim.

Por, pasi ngulni këmbë, ne nuk refuzojmë të bëjmë zgjedhje të reja e të thërresim atë plagë, atë fatkeqësi të madhe, atë bestytini të shëmtuar, që është parlamenti, pasi të kemi bërë dy ose tre vjet qeverimi atëror. A do të pranoni atëherë, z. Sekretar i Përgjithshëm të më jepni pas tre vjetësh atë huanë prej 400 milionë fr.ar., për të cilën ramë dakort para disa minutash? Ju përgjigjeni prapë "Jo". E dija.

Mirë, pra, le të flasim për paqen. Më duket se nuk ka gjë tjetër më të keqe se sa të bëjmë këtë. Them "më duket" – I guess – sepse dua që ju të gjithë të dini se unë kam banuar për shumë vjet në Amerikë, në Boston, një qytet që ndodhet diku në Irlandë dhe që është i mbushur me O' Connors, O' Connells dhe Fitzgeralds, të gjithë folës të mirë, folës fort të shquar, të cilët, bashkë me irlandezë të tjerë të ardhur nga qytete të tjera irlandeze, marrin përsipër gjithë barrën e të folurit në fushatat elektorale amerikane. Do të doja që kolegët tanë të nderuar, përfaqësuesit e Republikës së Irlandës, të sjellin këtu disa nga këta oratorë të mbaruar për të na mbytur me fjalime për paqen. Nuk është aspak për t'u çuditur që amerikanët, gjermanët dhe rusët nuk kanë fortdëshirë të hyjnë në Lidhjen e Kombeve. Duket se nuk e çmojnë elokuencën tonë, punojnë me mend. Për emrin e Perëndisë, z. Kryetar, pse nuk i jepni fund këtyre llomotitjeve dhe pse nuk më jepni atë hua prej 500 milionësh fr.ar., që më premtuat para se ta merrja fjalën? Dhe tani që iu përgjigja pyetjes së parë: "Ç'ka bërë Lidhja e Kombeve këta 5 vjetët e fundit?" , më lejoni të vij te pyetja e dytë dhe e fundit: "Ç'të bëjmë ne tani në këtë Asamble?" Përgjigja është shumë e lehtë. Do ta gjeni te Shekspiri: "Fjalë, fjalë, fjalë" , dmth erë e asgjë më tepër. "Është një përrallë e dhënë prej një idioti plot me bujë e tërbim, pa kurrfarë kuptimi. Cili është përfundimi i gjithë këtyre bisedimeve të mençura e të thella mbi çarmatimin dhe traktatet e arbitrazhit?

Këto çështje iu dhanë për shqyrtim një komisioni, që do t'ia kalojë një nënkomisioni, i cili do t'ia parashtojë konkluzionet e tij një konference që do të mblidhet së shpejti, dhe kjo konferencë do t'ia dërgojë përsëri këto çështje një komisioni, pastaj një nënkomisioni, i cili do t'ia referojë komisionit që do t'i dërgojë një raport konferencës. Konferenca do të votojë njëzëri një rezolutë dhe kjo e fundit do t'i jepet për shqyrtim Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Këshilli, nga ana e tij, do t'ia kalojë këtë rezolutë Asamblesë së ardhshme atje lart në qiell. Dhe kur këto çështje të kenë bërë këtë cikël poetik zvarritjesh e kundërzvarritjesh, raportesh e kundëraportesh dhe mendimesh konsultative, atëherë do t'i dërgohen së fundi Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do t'i mbyllë me kyç mirë e mirë dhe do t'i varrosë në dosjet e vdekura të Sekretariatit, ku do të mbahen brez pas brezi.

Dhe kjo do të thotë, natyrisht, se e gjithë kjo histori ka mbaruar siç mbarojnë flluskat e sapunit. Por ç'fjalime, ç'fjalime të bukura, të fryra e të stërfryra

do të shoqërojnë këto rezoluta e këto dëshira! Sa fort i dua! I dua “me atë erën e keqe të moçaleve të fëlliqura, si këрма të pambuluara që helmojnë ajrin ku marr frymë.” Por ja, përse jua drejtova fjalën sot.

Dhe meqënëse po flasim për fluska sapuni, a mund të bëj disa vërejtje lidhur me fluskën më kolosale që ka nxjerrë historia moderne, dua të them për planin Daues (Daëes). Por a është vërtet një fluskë? Jo, është një kombinacion fluskash, kombinacion hipokrit, i ndërlikuar, djallëzor, infernal. Nuk është një fluskë ordinere, është një superfluskë. Por është e kotë të trembeni. Do të mbarojë edhe kjo fatalisht si të gjitha fluskat e vogla që ne lëshojmë këtu.

Është tepër e ndërlikuar që të mund të ketë sukses; ajo mund t’i sigurojë ndonjë post nënpresidenti autorit të saj të shquar; por kam frikë se nuk do të dalin prej andej veçse shumë pak miliarda riparacionesh për Francën dhe Belgjikën. Këto të dyja vërtet t’i marrin. Nuk është aspak qëllimi im që t’i mërzis, por ky është fati. Kjo superfluskë e gjeneralit Daues do t’i përcillet, në fund të fundit, Lidhjes së Kombeve.

I dashur Sekretar i Përgjithshëm, përgatitni, ju lutem, një kënd të thatë, një kënd shumë të thatë në varrin e dosjeve të vdekura, sepse ju e dini se z. Daues është amerikan dhe se Amerika është një vend i thatë, megjithëse nga koha në kohë, me rrugë të nëndheshme, ajo njomet vetëm sa për t’u zbavitur, falë përpjekjeve të kontrabandistëve.

Duke folur për fluska, përsëri më vjen në mend ajo huaja e bekuar prej 600 milionësh, të cilën i nderuar Kryetar i kësaj Asambleje, si dhe i dashur Sekretar i Përgjithshëm, më premtuan për Shqipërinë disa minuta më parë. Kjo hua është një fluskë paqeje, një fluskë paqeje fort konsistente.

Por jo, nuk është aspak një fluskë; ajo që doja të thosha është se kjo hua mund të përgatitë paqen në Ballkan, ajo mund të lehtësojë realizimin e konfederatës ballkanike; por ia vlen të flitet për të? Z. Sekretar i Përgjithshëm, merreni dhe atë dhe futeni në varrin e dosjeve tuaja të vdekura, futeni në nekropolin tuaj.

Pasi iu përgjigja dy pyetjeve që shtrova, më mbetet tani të nxjerr konkluzionin, të cilin do ta diskutoj në trajtën e dy pyetjeve të tjera. Para së gjithash në dritën e fakteve që u përmendën, a e vlen barra qiranë që të kemi një Lidhje të Kombeve? Së dyti, në rast se e vlen, cila duhet të jetë metoda për t’ia arritur qëllimit, që është paqja universale? Pyetjes së parë do t’i përgjigjem në mënyrë pohuese.

Edhe sikur Lidhja e Kombeve të jetë një ëndërr, një utopi që i bën skeptikët të tallen e të shtrembërojnë buzët, ajo duhet të qëndroj aty si një ideal që interpreton aspiratat më fisnike të njerëzimit, ajo duhet të qëndroj aty si një sfidë kundër lavdisë groteske militariste.

Ajo duhet të qëndroj aty si një pohim solemn i vullnetit universal për paqen, ajo duhet të qëndroj aty derisa bukuria e saj, fisnikëria e saj, shpirti njerëzor i saj, nevoja e domosdoshme e qenies së saj të kuptohen nga e gjithë bota. Sepse, fundi i fundit, me gjithë të metat që ka sot, ajo meriton të pritet me këto fjalë:

“Verweile doch, Du bist so schon!”

(“Oh, megjithatë qëndro, ti je kaq e bukur”!)

Përse të jemi kaq pesimistë? Aspiratat për paqe i kemi kudo dhe për këtë s'ka asnjë dyshim. Përndryshe, ne nuk do të kishim as komedinë e flluskave e superflluskave, që po na mbulojnë. Dhe pikërisht sepse popujt duan paqe, burrat e shtetit, politikanët u servirin atyre kohë pas kohe flluska arbitrazhi, flluska çarmatimi, flluska sigurimi dhe superflluska riparacionesh. Por paqja nuk do të vijë prej traktateve; këto janë të destinuara të hidhen shpejt a vonë në shportë. Paqja do të vijë nga edukimi shkollor. Duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë se vrasjet me shumicë janë po aq krim sa edhe vrasjet me pakicë.

Duhet t'u mësojmë se ka vetëm një perëndi që duhet t'i shërbejnë, Perëndia e njerëzimit, i njëjtë për të gjithë tributë. Duhet t'u mësojmë të bëhen anëtarë të ndershëm të supershtetit që do të përmbledhë të gjitha tributë, të bëhen qytetar fisnikë të federatës së përbotshme, që është në realizim e sipër dhe që do të realizohet me siguri. Kur fëmijët tanë të kenë mësuar këto të vërteta të thjeshta, atëherë nuk do të kemi vetëm çarmatimin moral që do t'i paraprijë çarmatimit material, do të kemi gjithashtu bashkëpunimin e vërtetë të të gjitha racave të botës për sigurimin e paqes, progresit dhe prosperitetit ndërkombëtar. Të gjitha të tjerat sillen rreth kësaj. Këtu qëndron thelbi i çështjes. Por përpara se të vijmë aty, duhet të pranojmë njëherë se jemi të gjithë tribu të egra, derisa i bëjmë kurbane njerëzish Molohut të tribusë. Oh, vritini, varini, ndiqini, në të katër anët e botës këto hyjni barbare e antropofage, që e kanë mbushur historinë e njerëzimit me kaq vuajtje e urrejtje, me kaq rrëfime, me kaq gjak, me kaq tmerr!

Vështroini sytë e njerëzimit që vuan pas shkatërrimeve të luftës botërore. Nuk ka dhembje që të mos krahasohet me dhembjen e tij; asnjë sakrificë nuk do të ishte tepër e madhe për t'i shpëtuar fëmijët tanë nga luftëra të reja dhe lot të tjerë. Përpara, o shokët e mi! Flamuri i Lidhjes së Kombeve është më fisniku që është ngritur deri më sot. Ushtarët e saj janë më trimat që ka nxjerrë bota ndonjëherë. Qëllimi i saj është maja e përparimit të njerëzimit. Shpirti i Uillsonit, ati dhe profeti i saj, na udhëheq. Vështirësitë janë tepër të mëdha, por shtrini kurajën tuaj deri në pikën e fundit mundimet nuk do t'ju venë kot.

ARDIAN VEHBIU

IDENTITETE SHQIPTARE E ARBËRESHE

- sprovë për një përkufizim -

Në diskursin e medieve të sotme në Shqipëri, mania e disa entuziastëve për të gjetur bashkatdhetarë të shquar poshtë e lart nëpër botë duket se është pranuar tashmë si pjesë e kulturës së lartë kombëtariste, çka e dëshmon edhe popullarizimi madje kremtimi kohët e fundit i tezës së çuditshme e groteske se Ann Boleyn, e mirënjohura grua e dytë e Henrikut VIII Mbret i Anglisë dhe nënë e Mbretëreshës Elisabeth I, paskësh qenë me prejardhje nga Bolena e Vlorës. Përkundrajt shtimit marramendës të radhëve të atyre që ngazëllehën pa masë nga kuriozitetet të tilla foshnjore, ka vend jo vetëm të pyetet se cilat janë karakteristikat konstitutive të të qenit shqiptar sot e në histori, por edhe të kërkohet përgjigjja përtej miteve kombëtariste dhe retorikës manipuluese të mediave. Një përgjigje e tillë do të orientohet diku midis pozicionit subjektivist e sipërfaqësor se shqiptar është kushdo që e mban veten për të tillë, dhe pozicionit tjetër, mistik e racial, se shqiptarë janë të gjithë ata që u rrjedh në deje gjak pellazgjik.

I vetmi tipar i sigurt që vjen në vështrim për t'ia dhënë të paktën një përkufizim minimal dhe empirik këtij koncepti kaq të barsur me kundërti, është gjuha shqipe, në kuptimin që tingëllon e logjikshme të thuhet se shqiptarë janë të gjithë ata që e kanë shqipen gjuhë të vetën amtare. Ndryshe nga atribute të tjera si ndjenja kombëtare, raca ose prejardhja historike, gjuha gjithnjë mund të identifikohet objektivisht me siguri të mjaftueshme, duke u dalluar empirikisht prej gjuhëve të tjera. Përkufizimi i shqiptarit sipas gjuhës amtare, do të përjashtonte të gjithë ata që rrjedhin nga familje shqiptare, por që nuk e kanë shqipen gjuhë amtare, pavarësisht nëse e kanë mësuar më vonë apo jo, si dhe nëse ndonjë prej prindërve ua ka folur shqipen apo jo. Gjithashtu do të linte jashtë ata që për arsye të ndryshme e quajnë veten shqiptarë por që nuk e përmbushin kushtin e gjuhës, të tillë si shtetasit shqiptarë që megjithatë nuk e kanë shqipen gjuhë amtare. Ka edhe nga ata që nuk e flasin mirë shqipen, sepse e kanë harruar ose nuk e kanë mësuar kurrë mirë, edhe pse mund t'ua ketë mëkuar nëna; të cilët megjithatë do t'i quaja shqiptarë, sa kohë që arrijnë të komunikojnë normalisht me shqipfolës të tjerë.

Kriteri i shqipes si gjuhë amtare nuk është thjesht komod, as formal, as arbitrar. Ta kesh shqipen gjuhë amtare praktikisht do të thotë që socializimi yt ose gdhendja e njeriut në ty të jetë kryer nëpërmjet shqipes, meqë gjuha është pikërisht porta që na lejon të komunikojmë me njerëz të tjerë. Gjatë këtij komunikimi, jo vetëm krijohet një komunitet gjuhësor e kulturor, por përftohen edhe individët vetë, si qenie sociale. Në këtë kuptim, shqiptarë do të ishin ata njerëz që socializohen nëpërmjet shqipes, çka nuk është pak, sa kohë që komunikimi nëpërmjet shqipes

është edhe pjesëmarrje në një kulturë të përbashkët shqiptare. Natyrisht shqipja brenda këtij argumenti nuk duhet njëjtësuar as me një dialekt a të folme të caktuar, as me gjuhën standard të mësuar në shkollë, as me aftësinë për të shkruar ose lexuar tekste shqipe. Është fjala për ç'ka të përbashkët gegërishtja me toskërishten, e folmja e Drenicës me të folmen e Dangëllisë, ligjërimi i Naimit me ligjërimin e Fishtës; pra një shqipe si gjenerator i të gjitha ligjëratave shqipe. Disa gjuhëtarë e filozofë të gjuhës mendojnë se, në një nivel praktik dhe empirik, njeriu flet këtë apo atë gjuhë; por në një nivel më abstrakt është gjuha që e flet njeriun. Ndoshta një ditë do të arrijmë të kuptojmë më mirë lidhjet midis kategorive gramatikore e semantike të shqipes dhe mendësive “tipike” për shqiptarin. Ndërkohë, mund të njaftohemi me bindjen se shqipja është në themel të kombit shqiptar si komunitet real dhe i riprodhueshëm, sikurse është në themel të kulturës shqiptare, ose të formës shqiptare të ekzistencës.

Vlera e një përcaktimi, megjithatë, varet nga zgjidhja që u jep ky përcaktim rasteve kufitare, ose problematike; pse nuk është aspak e vështirë të identifikosh si “shqiptar” dikë që ka lindur, është rritur e është shkolluar në Tiranë, gjatë shekullit XX, i rrethuar nga shqiptarë të tjerë e asnjëherë i ndodhur përballë situatash të tilla sociale dhe ekzistenciale ku t’i duhet ta rrokë mirë në mendje identitetin e vet, e të zgjedhë midis alternativave. Për këtë arsye, ka vend që shqiptaria si identitet kombëtar të përqaset me identitete të tjera të ngjashme e problematike, në lëmin sinkronik e funksional, por edhe në lëmin diakronik e historik. Të gjithë do ta pranonin pranojnë që dibrani, bie fjala, shquhet në mënyrë domethënëse nga skraparlliu, dhe të dy nga shkodrani. Këtu është fjala për diferenca kryesisht krahinore, të cilat tek e fundit i referohen një aksi gegë-toskë. E pranojmë që ka edhe dallime midis vlonjatëve nga familje myslimane dhe vlonjatëve nga familje të fesë ortodokse, pavarësisht nëse besojnë apo jo, e që mund t’i quajmë fetare-kulturore. Përkundrazi, shqiptarët ortodoksë të Podkozhanit në Mokër dallohen nga vllëhtë ortodoksë të Llëngës përsëri në Mokër, sepse këta të fundit janë etnikisht vllahë. Minoritarët grekë të Dropullit gëzojnë identitet kombëtar grek, por qytetari shqiptarë. Statusi i këtyre nuk është as mund të jetë i njëjtë me të komunitetit greqishtfolës të Zvërnecit të Nartës, i cili mund të jetë etnikisht grek, por jo kombëtarisht. Kjo vlen edhe për grekofonët në Himarë e në ndonjë fshat tjetër të Bregut. Një qytetar shqiptar prej Dhërmiut do të dallojë nga një qytetar shqiptar prej Pilurit sepse i pari shpesh përdor greqishten në jetën e përditshme dhe e mban veten grek, ndërsa i dyti gjithnjë shqipen; por kjo nuk i jep të parit ndonjë identitet kombëtar grek, të afërt me identitetin kombëtar të athinjotit ose të kretanit. Përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë, banorët shqiptarë të Kosovës kanë identitet krahinor kosovar të cilin e ndajnë me pakicat serbe, rome e turke të atjeshme, por identitet kombëtar shqiptar – në thelb të njëjtë me shqiptarët e Shqipërisë. Kohët e fundit ka pasur përpjekje për ta kualifikuar identitetin kosovar nga niveli krahinor në nivel kombëtar, krahas me përvijimin e së ashtuquajturës “kosovariste” si formë e mëvetësishme e shqipes, të cilat duket të jenë bërë kryesisht për motive politike e ndoshta kulturore-gjuhësore, e gjithsesi brenda një orvatjeje për diferencim edhe rrënjësor nga shqiptarët prej Shqipërie.

Arbëreshët e Italisë, nga ana e tyre, kanë identitet etnik arbëresh, në kuptimin që janë të vetëdijshëm si arbëreshë; identitet krahinor përkatës sipas krahinës ku jetojnë – Kalabri, Sicili, Molise, etj.; identitet fetar-kulturor si katolikë të rritit grek, ose uniatë, çka i dallon nga masa e italianëve rrethues, të cilët janë të fesë katolike. Megjithatë, kur vjen fjala për identitet kombëtar, nuk është e lehtë t’ua atribuosh, sepse edhe ata vetë stepen e mjaftohen me identitetin etnik, duke u lëvurrur midis identitetit kombëtar italian nga pikëvështrimi realist dhe identitetit kombëtar shqiptar nga pikëvështrimi historiko-mitik; në një kohë që shteti italian i ka njohur prej vitesh si pakicë “gjuhësore”. Statusi identitar i arbëreshëve afrohet disi me atë të vllahve ose arumunëve në Ballkanin e sotëm; sepse të dy këta popuj tani nyjëtohen në komunitete pak a shumë të atomizuara, ose projeksione të një realiteti etnik mesjetar anakronik. Megjithatë, vllahët nuk më rezultojnë të kenë gjetur te Rumania një atdhe të tyrin mitik siç duan të gjejnë disa arbëreshë me Shqipërinë; por dallimet strukturore midis arumanishtes së vllahve dhe rumanishtes nuk duhet të jenë më të mëdha se dallimet midis arbërishtes dhe shqipes. Pakica të tilla si arbëreshët, arvanitasit, vllahët, goranët e romët i përkasin tipologjikisht një epoke parakombëtare që i referohet në mënyrë implicite Mesjetës së perandorive të mëdha; së bashku me greqishtfolësit e bregut të Himarës, grekanët në Itali të Jugut ose arbëreshët e Zarës në Dalmaci e plot pakica të tjera në Mesdhe. Që shumë arbëreshë të mësuar shkruajnë sot e kësaj dite në shqipen standarde të Tiranës, kjo nuk lidhet shumë me ndonjë dëshirë për t’u afruar me “mëmën”, as me vullnetin për të njohur standardin vetë; por sepse shumë nga këta arbëreshë nuk e shkruajnë dot mirë dialektin e tyre. Midis teksteve klasike të letërsisë arbëreshe e mbarëshqiptare (Variboba, De Rada, Dara, Serembe, Santori, Skiro) dhe arbëreshit të sotëm sado të mësuar e të vetëdijshëm për etnicitetin e vet ka një hendek të trishtuar e shpesh të pakapërcyeshëm, e që ka lidhje me mungesën e praktikës sistematike të shkrimit të shqipes në shkolla. Shqipja standarde, përkundrazi, mësohet që në klasë të parë fillore, lexohet në libra e në gazeta, disiplinohet e stërvitet në abetare e në libra ushtrimesh gramatikore, përdoret në filma e në RTV; në një kohë që arbërishtja ekziston kryesisht në trajtë të folmesh të veçanta e në pak vepra letrare përgjithësisht të pakuptueshme nga lexuesit. De Rada, sado i madh e i adhuruar në ngulimet e gjetiu, nuk lexohet dot në origjinal as nga arbëreshët vetë. As mund të thuhet se ekziston ndonjë formë e shkruar e njësuar e arbërishtes, e krahasueshme për nga funksionet me variantin letrar geg të katolikëve të Shkodrës, ose shkodranishten letrare. Në rrethanat e sotme, është krejtësisht e mundshme të hartohet një gramatikë e shqipes standarde, duke i lënë jashtë format dialektore jostandard; por çdo gramatikë e arbërishtes do të jetë gramatikë e të folmeve arbëreshe ose vepër praktikisht dialektologjike. Për këtë arsye, shumë intelektualë arbëreshë janë të detyruar që, për të afirmuar identitetin e tyre etnik, t’i drejtohen shqipes letrare. Nëse hap një revistë arbëreshe të tillë si “Katundi Ynë”, do të shohësh se tekste atje ndjekin kode të ndryshme gjuhësore: ka tekste folklorike në arbërishte pak a shumë të transkriptuara, të tilla si ninulla ose rrëfenja ose proverba shpesh të të folmeve të Kalabrisë; tekste shqipe të shkruara nga arbëreshët në standard ose së paku në toskërishte, e që kanë aromë të fortë të arbërishtes, kryesisht në leksik e në ndonjë formë gramatikore e drejtshkrimore jostandard që u

referohet autorëve klasikë arbëreshë; tekste në shqipen letrare shkruar prej autorësh shqiptarë; tekste në italishten standard, të cilat janë edhe më të lexueshmet nga publiku i “Katundit”, i edukuar gjuhësisht në shkollat italiane.

A duhen konsideruar arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë si shqiptarë? A duhen quajtur folmet e tyre si forma dialektore të shqipes? Këto pyetje janë të lidhura së bashku dhe kërkojnë përgjigje përtej ngashërimit kombëtarist, edhe pse kjo shpesh nuk është e lehtë, as gjithnjë e pranueshme. Dihet se arbëreshët janë zhvendosur nga trojet shqiptare në Ballkan drejt Italisë në një periudhë që pak a shumë koincidon me pushtimin e këtyre trojeve nga Perandoria Otomane. Katundet e tyre janë të shpërndara në krejt Italinë e Jugut: në Kalabri, në Molise, në Puglia, në Sicili, në Basilicata, në Irpinia e në Abruzzo. Nga pikëpamja dialektore, të folmet e ngulimeve arbëreshe i përkasin toskërishtes jugore me tipare arkaike, duke u afruar veçanërisht me labërishten dhe çamërishten.

Historianët sot e kësaj dite ende nuk e kanë shumë të qartë pse u zhvendosën arbëreshët drejt Italisë, pse një palë mendojnë që ikën prej turqve ndërsa një palë tjetër mendojnë se i shtyu kriza e thellë ekonomike në Ballkanin Perëndimor, ose epidemi sëmundjesh vdekjeprurëse të vetat ose të bagëtisë, ose boom-i demografik i popullsisë arbërore të malësive përballë trysnisë sllave e sidomos serbe, ose thjesht pamundësisë së zonave malore për t’iu përgjigjur ekonomikisht shtesës së popullsisë. Historianët mendojnë se shumë nga këto ngulimet arbëreshe janë me prejardhje nga Bregu – zona e Himarës deri poshtë në Prevezë. Zhvendosja e arbëreshëve drejt Italisë nuk mund të shkëputet megjithatë nga zhvendosja e mëparshme arbërore drejt Greqisë – Atikës, Peloponezit dhe ishujve të Egjeut – e cila i parapriu në kohë dhe përgjithësisht nuk ka lidhje me Skënderbeun. Në të vërtetë një pjesë e mirë e arbëreshëve të Italisë u bartën për në Itali nga Peloponezi gjatë shekullit XVI, pasi ranë fortesat venedikase të atjeshme në dorë të Osmanëve, siç na dëshmon tërthorazi edhe kënga tradicionale “Oj e bukura Moré”, ku autori anonim i këndon vendit të origjinës, e pikërisht Morësë, ose Peloponezit, duke e identifikuar këtë vend me Arbërinë (“Oj e bukura Moré/si kur të lash/më nuk të pash/Atje kam u’ Zotin Tan/Atje kam u’ Zonjën Mëmë/atje kam edhe tim vlla/Gjithë mbuluarë në dhe/Oj e bukura Moré/Po të flas me lot në sy/Oj Moré, o Arbëri”). Më së fundi, të folmet arbëreshe kanë ruajtur një numër shumë të madh huazimesh nga greqishtja, mesjetare dhe moderne, të cilat vështirë se mund t’i kenë marrë pas zhvendosjes drejt Italisë së Jugut; pa përmendur tipare të tjera të kulturës materiale, folklorit, muzikës, zakoneve, veshjeve e kuzhinës, të cilat kur nuk janë arbërore të mirëfillta, i afrojnë arbëreshët me botën helene.

Në katundet arbëreshe të Italisë dallohen kështu dy të paktën dy shtresa të ardhurish: nga Bregu dhe nga Moreja. Veç kësaj, ka pasur edhe lëvizje arbëreshësh brenda për brenda Italisë, ose katunde të themeluara rishtas nga të ikur prej një katundi më të vjetër.

Gjatë shekujve XV-XIX praktikisht nuk ka pasur kontakte midis popullsisë arbëreshe dhe popullsisë shqiptare në Ballkan, edhe pse ka të dhëna që klerikë arbëresh i kanë njohur shkrimtarët e vjetër gegë katolikë të Veriut, sidomos Bardhin, Budin e Bogdanin. Sipas Çabejt, arbërishtja si tërësi e lirshme të folmesh jo vetëm u shtjellua në pavarësi të plotë nga shqipja ballkanike për shekuj me

radhë, por edhe brenda komunitetesh të përziera, me të ardhur prej viseve të ndryshme shqiptare të Ballkanit, e ndonjëherë në kombinim edhe me elementë grekë, sllavë e vllleh, me të cilët i bashkonte riti fetar. Në të njëjtën kohë, të folmet arbëreshe iu nënshtuan një ndikimi të fortë të italishtes që flitej përreth, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, nëpërmjet martesash të përziera atje ku kjo ishte e mundshme.

A mund të quhen atëherë arbëreshët shqiptarë? Kësaj pyetje s'i jep dot një përgjigje të drejtpërdrejtë. Vetë arbëreshët, në të folmet e tyre, nuk i kanë fjalët "shqip", "shqipe", "shqiptar"; pse veten e quajnë "arbëreshë" gjuhën e tyre "arbërisht" dhe vendin nga e kanë origjinën "Arbër" ose "Arbëri" (përkatësisht "Moré"). Nuk ka dyshim se edhe shqiptarët vetë e quanin veten "arbër" dhe gjuhën e tyre "arbërishte" deri të paktën në shek. XV por pas gjase edhe mjaft kohë më pas. "Arbëreshë" e quajnë veten edhe banorët e Arbanasit ose Borgo Erizzo, katund afër Zarës në Dalmaci të Kroacisë së sotme, të cilët thuhet se u shpërngulën atje nga Brisku dhe Shestani, katunde të Krajës në bregun e Liqenit të Shkodrës, për t'u ikur persekutimeve nga guvernatori turk i Tivarit.

Nuk ka dyshim se fjalë të tilla si "shqip", "shqipe", "shqiptar" e "Shqipëri" u shfaqën vonë në trojet e shqiptarëve në Ballkan, për arsye që nuk dihen mirë, edhe pse duket afërmendsh se vetëm një tronditje e madhe identiteti ose një traumë demografike mund ta bëjë një popull të ndërrojë emrin me të cilin quan veten dhe gjuhën e vet. Logjika ta do edhe që ky ndërrim emri të lidhet me dy faktorë historikë: (1) pushtimin osman të trojeve shqiptare në Ballkan dhe shkatërrimin me themel të qyteteve mesjetare të krishtera ku përpunohej kultura dhe vetëdija "arbërore" (2) zhvendosjen masive të popullsisë nga Lindja në Perëndim dhe nga mali në fushë, në kuptimin që të ikurve drejt Italisë, në Veri e në Jug të Shqipërisë ua zunë vendin popullsi të zbritura nga zonat e brendshme malore, me identitet etnik disi të ndryshëm, më të kufizuar e më të zbehtë se të ikurit. Kështu, nëse shumë arbëreshëve të Italisë mund t'u gjurmohet origjina në zonën shqiptare të Bregut, shumë banorë të fshatrave të sotme të Bregut, nga ana e tyre, kanë ruajtur mirë gojëdhëna të prejardhjes së tyre nga fise e zona malore deri të Shqipërisë së Veriut.

Po të besojmë se pesë shekuj sundimi osman në Shqipëri nuk mund të trajtohen si incident historik i padëshiruar, atëherë do të pranojmë edhe se këta shekuj janë tanimë pjesë konstitutive e identitetit kombëtar të shqiptarit, pavarësisht nga përkatësia ose prejardhja fetare. Pikërisht ky element konstitutiv u mungon krejt arbëreshëve të Italisë, të cilët për më tepër kanë integruar shumëçka nga identiteti italoфон përreth. Për këtë arsye, megjithëse arbërishtja që flitet në Itali ende mund të trajtohet si një dialekt arkaik i shqipes, identiteti arbëresh do mbajtur i ndarë nga identiteti shqiptar. Arbëreshët e Italisë, me të cilët na lidhin shumë gjëra, nuk e quajnë veten shqiptarë, as gjuhën e tyre, arbërishten, nuk e quajnë shqip. Shkëmbime sociale e njerëzore midis dy anëve të Adriatikut as ka pasur as ka, edhe ngaqë shumica e katundeve arbëreshe janë ngritur në zonat perëndimore të gadishullit të Apenineve, jo në brigjet lindore; madje shumë rrallë buzë detit, e më shpesh në brendësi. Ndryshe nga ngulimet greke të lashtësisë, ngulimet e arbëreshëve nuk u frymëzuan nga ndonjë vullnet për ekspansion e tregti me të

tjerët, por nga nevoja për të mbijetuar në tokë të huaj. Për të njëjtën arsye, nëse ka qenë gjithnjë e natyrshme të flitet për “trojet shqiptare në Jugosllavi”, askush nuk ka folur ndonjëherë seriozisht për “troje shqiptare në Itali”, edhe ngaqë nuk ka kurrfarë njësie territoriale të ngulimeve arbëreshe, ishuj të ndarë prej njëri-tjetrit, të rrethuar nga katunde italisht-folëse e pa qytete si pika referimi kulturore.

Me fjalë të tjera, si njësi etnike arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë janë relike e një periudhe parakombëtare në historinë e Evropës Mesdhetare, dhe nuk ka asnjë arsye për të mos i quajtur pikërisht siç e quajnë ata veten: “arbëreshë”, dhe gjuhën e tyre “arbërishte”. Për fat të keq, nuk kemi një fjalë që t’i mbulojë edhe arbëreshët, edhe arvanitët, edhe shqiptarët (siç quajmë sllavë, për shembull, edhe serbët, edhe kroatët, edhe sllovenët, edhe rusët, edhe polakët, edhe çeket, edhe ukrainasit e kështu me radhë) – pse termi “arbërorë” ende nuk ka ngjitur në përdorim përtej konteksteve historike të specializuara. Të folmet e arbëreshëve, pas ikjes së këtyre nga Ballkani, i humbën kontaktet me trungun kryesor të shqipes dhe u shtjelluan e u zhvilluan në mënyrë të pavarur, si ishuj gjuhësorë rrethuar nga deti i të folmeve jugore të italishtes. Dihet, megjithatë, se gjuha kërkon një masë kritike folësish për të funksionuar normalisht, dhe arbërishtes së Italisë kjo masë kritike shpesh i ka munguar; jo vetëm sepse arbëreshët vetë janë relativisht të paktë, por edhe sepse lidhjet e rregullta mes katundeve arbëreshe janë penguar për arsye nga më të ndryshmet, gjeografike e historike. Arbërishtja, në shumë aspekte, është formë reliktuale mesjetare e vetëdijes sociale të një grupi komunitetesh të cilat tradicionalisht nuk kanë pasur identitet kombëtar të përcaktuar mirë, duke ia kompensuar mungesën me identitetin etnik.

Nëse të folmet arbëreshe janë larguar apo jo nga shqipja ballkanike aq sa të mund të flitet për dy gjuhë të ndryshme dhe jo për arbërishten si dialekt madhor të shqipes, kjo është relative dhe e pamundur për t’u vendosur me kritere objektive. E vërteta është se dallimet në fushë të fonetikës, të gramatikës e të leksikut janë të mëdha, dhe një shqiptar e një arbëresh, si tani si në kohë të De Radës, vështirë se do të mund të merreshin dot vesh përtej ca shkëmbimeve të tipit “çë bën”, “si je” e të tilla si këto. Për të dalë nga kufijtë e shqipes, edhe dialekti i Napolit me dialektin e Venetos ndryshojnë mes tyre më tepër se ç’ndryshojnë, për shembull, gjermanishtja me holandishten; por dy të parat konsiderohen dialekte, ndërsa të dytat gjuhë të veçanta – për arsye historike dhe politike. Në rastin e arbërishtes, megjithatë, aq i rëndësishëm sa lënda e gjuhës është edhe funksionimi i saj social. Ngulimet arbëreshe në Itali janë ruajtur kryesisht sepse kanë mbijetuar në zona të humbura dhe ekonomikisht të prapambetura, por edhe sepse shumë prej arbëreshëve atje ndjekin ritin grek të cilin e sollën me vete kur u shpërngulën, e që vetvetiu i dallon prej katolikëve përreth. Të folmet arbëreshe janë të folme të “vatrës” e të “katundit”, në një kohë që sferat e tjera të funksionimit normal të gjuhës kanë qenë kapur nga gjuhë të tjera. Të gjithë këta faktorë dhe pikërisht moskomunikimi gjuhësor disashekullor me shqipen ballkanike e me popullsitë shqiptare të trungut kryesor; numri relativisht i paktë i folësve; reduktimi e rrëgjimi i funksioneve të gjuhës; atomizimi i komuniteteve; analfabetizmi i masës së folësve dhe mungesa e elitave përtej klerit; ndikimi i fortë i të folmeve e dialekteve italiane limitrofe i kanë larguar shumë të folmet arbëreshe, si grup, nga të folmet e tjera të

shqipes, në një mënyrë të ndryshme nga ç'janë larg njëra-tjetrës, për shembull, çamërishtja nga gegërishtja.

Një tjetër gabim elementar që bëhet nga ideologët e sotëm kombëtaristë mes shqiptarëve, ka të bëjë me ndjenjën kombëtare tek arbëreshët si fill bashkues i brezave, ose në diakroni. Në këtë rrafsh, arbëreshëve në shekuj pak mund t'u atribuohet veç një sigurie të turbullt dhe gjysmë mitike për prejardhjen e tyre nga përtej detit, mbështjellë me mjegullën e kujtimit kolektiv të Gjergj Kastriotit. Çka thonë e ndonjëherë besojnë vetë arbëreshët sot është shpesh rezultat i ndikimit që kanë pasur në vetëdijen e tyre kolektive figura të tilla si De Rada, me tezat e njohura romantike të së kaluarës së lavdishme e profetike për zgjimin e lavdive të djeshme. Nuk duhet harruar, megjithatë, se popullsia e ngulimeve, për nga natyra e ngulimeve vetë, identifikohet kryesisht me besimin fetar ashtu siç organizohet rreth institucionit të Kishës; e aq më tepër vlen kjo po të kihet parasysh se, nga pikëpamja historike-sociologjike, ngulimet arbëreshe në Itali janë tipologjikisht relike të Mesjetës, ose të një periudhe kur identiteti kombëtar ende nuk kishte marrë trajtat që ia njohim sot. Vetë Italia e shekullit XIX të De Radës profet të Rilindjes Kombëtare shqiptare priste lëvizjen e vet të Zgjimit, për t'u bashkuar në një komb të vetëm. Kombi dhe vetëdija kombëtare janë tek e fundit procese dinamike që u përgjigjen rrethanave historike dhe sociale, jo ligjeve të natyrës e të "gjakut".

Miti naiv se stërgjyshërit e arbëreshëve të Italisë, të prirë nga fisnikët e tyre, u larguan nga trojet shqiptare në Ballkan për t'i shpëtuar kuçedrës osmane pas vdekjes së Skënderbeut dhe fundit të rezistencës shqiptare ndaj Portës së Lartë është kështu në masë të madhe produkt i rrëfenjave romantike të Rilindjes dhe i skemave ngushëllimtare të ideologjisë kombëtariste shqiptare. Për ta mbajtur larg shqyrtimit kritik të historisë, nuk mjafton të thuhet që është i sajuar e i mbështetur mbi një interpretim voluntarist të historisë, qoftë ndër arbëreshët vetë nga periudha romantike e këtej, qoftë në Shqipëri më pas. Ndonjë autor ikonoklast, si Arshi Pipa, ka përsiatuar idenë se edhe kujtimi i Skënderbeut ndër arbëreshët i detyrohet një shartimi kulturor të vonë nga ana e elitave, dhe se rapsoditë mbledhur e përpunuar nga De Rada, të cilat gjithnjë janë përdorur si provë e pershendës së kujtesës historike ndër arbëreshë, janë në të vërtetë krijim i De Radës vetë, ose një formë arbëreshe e osianizmit. Pipa gjente kështu diçka të përbashkët midis orvatjes së De Radës për t'ia dhënë një kujtesë historike ngushëllimtare arbëreshëve dhe krejt shqiptarëve, dhe veprës së poetit skocez të shek. XVIII James Macpherson, i cili botoi vëllimin me titull *Fragmente poemash të lashta qëmtuar në malësitë skoceze*, duke e paraqitur si përkthim të poemave origjinale të Osianit, një poet legjendar kelt, por që në të vërtetë e kish shkruar Macpherson-i vetë. Pavarësisht nga kjo hipotezë që mbetet për t'u shoshitur, bustet e Skënderbeut që hijeshojnë sheshet e katundeve arbëreshe, sikurse stemat heraldike të familjeve fisnike arbërore në shtëpitë e arbëreshëve të sotëm, nuk duket të kenë aq lidhje me vijueshmërinë e pandërprerë të kujtesës historike mesjetare ndër arbëreshët e sotëm, sesa me dëshirën për ta pasur një vijueshmëri të tillë historike, në kundërvënien me marginalizimin e arbëreshëve si pakicë në Italinë e sotme. Në të vërtetë, ikje masive pas disfatës së rezistencës shqiptare ndaj Portës së Lartë do të ketë pasur,

por kryesisht nga zonat ku edhe kjo rezistencë ishte vërtet e shprehur në vitet 70 të shekullit XV: Kruja, Shkodra, Durrësi, Lezha, Drishti, Danja, Ulqini, Tivari e në përgjithësi Shqipëria e Veriut dhe e Mesme. Popullsia e atyre zonave do të ketë qenë popullsi geqe a gegërisht folëse, siç na e vërteton, ndër të tjera, e mirënjohura Formulë e Pagëzimit e Pal Engjëllit (e vitit 1462), dokumenti i parë i shqipes së shkruar, në gegërishte të kulluar. Nga ana tjetër, të folmet e arbëreshëve të Italisë sot jo vetëm i përkasin toskërishtes fund e krye, por edhe tipologjikisht u afrohen të folmeve më jugore të toskërishtes ballkanike, dhe pikërisht çamërishtes. Shenja të gegërishtes në të folmet e sotme arbëreshe praktikisht nuk janë gjetur. Ka vend, në këtë kontekst, të pyetet se ku përfunduan gjithë ata gegë, që i dhanë Skënderbeut masën kryesore të ushtrive të veta dhe bazën e nevojshme sociale për rezistencën. Alain Ducellier, i cili është autoritet për diasporat etnike të Mesdheut mesjetar, ka ndjekur gjurmë të shumta të refugjatëve arbëreshë gegë në arkivat e qyteteve e qytezave italiane të Adriatikut, që nga Venecia e poshtë në Abruzzo e Puglia. Duket se këta refugjatë, brenda pak brezash u tretën në popullsinë vendase dhe u italianizuan krejt; pse u vendosën në qytetet dhe jetuan së bashku me banorët italianë, në vend që të themelonin ngulime, si arbëreshët e Jugut; por kryesisht ngaqë arbëreshët gegë ishin të së njëjtës fé me italianët vendas: katolikë. Për të kuptuar rëndësinë kritike që pati feja në ruajtjen e identitetit etnik të arbëreshëve në Itali të Jugut, mjafton të përmendet edhe ekzistenca e një lëvizjeje paradoksale në vitet 1870 në arbëreshë të Italisë së Jugut, për “riatdhësimin” në Greqi, siç edhe u realizua për banorët e katundit Badessa, të cilët u vendosën në katundet arvanitase të Sulimohorëve të Trifilias; në një kohë që arbëreshë të mëtejshëm nuk u pranuan nga shteti grek edhe pse ishin të gatshëm për t’u kthyer në “mëmëdhe” (Aristidh Kola, Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve, Shtëpia botuese “55”, Tiranë 2002, f. 232.)

Megjithatë, një pjesë e elitave lokale arbëreshe, kryesisht priftërinj e mësues, gjithnjë kanë dashur për arbëreshët që t’i afrohen identitetit shqiptar, madje duke e ndier veten edhe si vazhdues të misionit të shenjtë të De Radës e të rilindësve të tjerë arbëreshë, që luajtën rol të dorës së parë në përndjeshmimin e opinionit publik evropian për çështjen shqiptare në Ballkan, gjatë shekullit XIX . Për fat të keq, kjo dëshirë duket të ketë qenë shumë më e fortë në vitet kur Shqipëria ishte “fanar ndriçues” i komunizmit në Evropë, sesa pas 1990-ës. Fiaskoja e Shqipërisë si shtet evropian gjatë këtyre viteve të fundit ua ka prerë hovin të gjithë atyre arbëreshëve që përnjëmend shpresojnë në afrimin shqiptaro-arbëresh përtej retorikës fjalëmadhe të “gjakut të shprishur” e busteve të Skënderbeut në pjacat e katundeve. Të kishte qenë shtet më i suksesshëm Shqipëria, e të ishin sjellë më me dinjitet shqiptarët e shpërndarë në Evropën e pas Luftës së Ftohtë, lëvizja shqiptariste ndër arbëreshët do të kish qenë patjetër më e fortë e më e përligjur. Por sot për sot e me këtë Shqipëri që kemi, pakkush do të dëshironte ta merrnin gabimisht për shqiptar...

Për shqiptarët e sotëm, mitet kombëtariste mbeten megjithatë kolona të identitetit, sikurse edhe shihet nga reaksionet ndonjëherë tepër emocionale sa herë që dikush orvatet t’i marrë në pyetje. Mirëpo mënyra si funksionojnë sot këto mite nuk mund të njëjtësohet me funksionimin e tyre kur po popullarizoheshin, d.m.th.

në kohë të Rilindjes kombëtare. Një shekull e kusur më parë, mitet kombëtare kishin për synim konstituimin e shqiptarëve si komb. Ky funksion sot ka mbijetuar si funksion riprodhues, në kuptimin që mbrojtësit e mitit thonë se ky është i nevojshëm për riprodhimin e ndjenjës kombëtare dhe të përkatësisë në bashkësinë kolektive të kombit. Çështja është, megjithatë, se çfarë po riprodhohet, përveç mitit vetë. Të thuash, bie fjala, që shqiptarë janë ata që e mbajnë veten “pasardhësit e Skënderbeut” (ose të “Lekës”, të “Pirros”, të “Udhësit” e kështu me radhë), duke e bërë të vetin mitin kombëtar të Rilindjes do të thotë ta kthesh përkatësinë kombëtare në një lloj kredoje politike, dhe kombin vetë në organizatë politike me program të caktuar.

Nevoja për një përvijim të kufijve të shqiptarisë sot merr rëndësi praktike edhe në kushtet e ballafaqimit midis shqiptares dhe joshqiptares në përvojën e përditshme të çdo shqiptari të mërguar, i cili e përjeton identitetin e vet edhe si përpjekje për të ruajtur drejtpeshimin midis asimilimit në kulturën vendëse dhe vetizolimit në emër të ruajtjes së shqiptarisë së origjinës. Ndryshe nga arbëreshët e djeshëm, shqiptarët e sotëm nuk janë zhvendosur prej Shqipërie për të themeluar ngulime në brigjet e Mesdheut, por për t’u përfshirë në proceset globale të punës, përvetësimit kulturor dhe krijimit të vlerave materiale; prandaj për ta shpesh asimilimi nuk është rrezik për t’u ruajtur ose kërcënim nga jashtë, por kusht i integritetit në vendet pritëse. Fëmijët e familjeve të mërguara shpesh përfshihen tërësisht në rrjetëzimet komunikative të medieve e të edukimit, ose në proceset që tek e fundit kanë për synim prodhimin e qytetarëve të vendeve ku jetojnë sot të mërguarit shqiptarë, e që nuk mund të shmangen nga askush që synon suksesin në karrierë ose realizimin e vetvetes. Arbëreshët e ruajtën gjuhën si instrument të vyer të riprodhimit të vetëdijes së tyre etnike; ndërsa shqiptarët e sotëm ndihen të pafuqishëm e të pamotivuar përballë trysnisë gjuhësore qendëruese e homogjenizuese të kulturave pritëse, meqë kualifikimi gjuhësor është kusht themelor për integrimin në zonat metropolitane. Për këtë arsye, prirja është që shqipes si tipar përcaktues kombëtar t’ia zërë vendin miti kombëtarist i rrënjëve, ose vetëdija e rreme e “gjakut” shqiptar, si faktor përbashkues i shqiptarëve anembanë botës. Falë këtij mekanizmi surrogato, shqiptaria e diasporave të sotme vjen e u ngjan erëzave në gjellë, duke u katandisur në aromë etnike të një jete të përditshme përndryshe krejtësisht të asimiluar nga kultura pritëse; krahas me këngët popullore shqiptare të luajtura në veturë, medalionet e t-shirt-et me shqiponjën e zezë dykrenare, tavën e kosit e byrekun me gjizë, dhe mitet hiper-inflacioniste të shqiptarëve të kudopranishëm sa në rrënjët, aq edhe në burbuqet e qytetërimit planetar.

QEMAL MURATI

“ENCIKLOPEDIA E JUGOSLLAVISË”: SHQIPTARËT ME PREJARDHJE ILIRE

“*Enciklopedia e Jugosllavisë*”, botuar nga Enti Leksikografik Jugosllav i Zagrebit (Jugoslovenski Leksikografski Zavod, Zagreb, 1983), një institucion me relevancë që e kishte themeluar dhe drejtuar Miroslav Kërlezha, të kaluarën e shqiptarëve e paraqet me objektivitet të duhur shkencor, pa paragjykime dhe pa ideologjizime pansllaviste.

Në tekstin Redaksional të Enciklopedisë, për formimin e shqiptarëve, thuhet:

Shqiptarët si popull kanë filluar të formohen në Mesjetën e hershme. Përderisa ilirët në Ilirikumin verior u shkrinë me sllavët në një proces shumëshekullor, një pjesë e ilirëve të Ilirikumit të jugut gjeti strehim në vendet më të sigurta në jug të Ballkanit, dhe prej tyre heqin prejardhjen shqiptarët. Pikëpamja e prejardhjes së shqiptarëve nga Ilirët nuk mund të mohohet për shkak të pranisë së elementit grek, sllav, vllah, e më vonë dhe elementit turk dhe elementeve të tjera etnike në elementin e tyre vetjak në procesin e krijimit të popullit shqiptar në Mesjetë. Një zhvillim i tillë mund të mbështetet nga hulumtimet filologjike, arkeologjike dhe etnologjike. Monumenti më i hershëm shkrimor që njihet deri më tani që i përmend shqiptarët e Mesjetës (Arbëreshët) është ai i autorit bizantin Mihail Ataliati, në të cilin ky autor flet për ushtarët e kryengritësit sicilian Georgi Maniakis (1043); në shkrimet e shek. XI i përmend dhe Aana Komnena, kronikave e shek. XII (*Enciklopedija na Jugoslavija, izdanie na makedonski jazik, I, Jugoslovenski Leksikografski Zavod, Zagreb, 1983, 145*).

Në tekstin për gjuhën shqipe, të botuar në Enciklopedinë e Jugosllavisë, shkruar nga I. Ajeti, flitet gjithashtu për prejardhjen e kësaj gjuhe nga ilirishtja: Shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër të Ballkanit, dhe studimet linguistike, etnologjike, arkeologjike dhe hetimet e tjera çojnë nga burimi ilir i gjuhës shqipe. Këtë teori e mbrojnë J. Thumann, J. H. Hahn, G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokl, V. Pisani, E. Çabej, W. Cimohowski, A. Desnickaja, R. Katiçiq, etj.

Te *Opća Enciklopedija Jugoslovenskog Leksikografskog Zavoda* (Zagreb 1977) flitet për prejardhjen trako-ilire të shqiptarëve dhe për burimin e gjuhës shqipe nga trako-ilirishtja, që domethënë për autoktoninë e shqiptarëve në viset e tyre të sotme.

ENCIKLOPEDIA SERBE: ILIRËT – TË PARËT E SHQIPTARËVE

(Mala enciklopedia Prosveta, Opšta enciklopedia, Treće izdanje 1, Beograd 1978)

Në Enciklopedinë e përgjithshme në gjuhën serbe, botuar nga Prosveta e Beogradit (*Mala enciklopedia Prosveta, Opšta enciklopedia, Treće izdanje 1, Beograd 1978*), në zërin ku trajtohet Shqipëria dhe shqiptarët, respektivisht historia e këtij vendi dhe populli, autorët serbë shprehin qartë dhe pa mëdyshe përkatësinë e shqiptarëve prej ilirëve:

“*Albanci, Šiptari* (alb. shqiptarët) janë popull indoevropian, pasardhës të ilirëve të vjetër. Jetojnë kryesisht në Shqipëri, pastaj në zonat kufitare të shteteve fqinje, sidomos në Kosovë dhe Epir etj... Territori i Shqipërisë së sotme u pushtua nga keltët, rreth vitit 604 p.e.r.; më vonë Ilirët, të parët e shqiptarëve, prej shek. IV p.e.r. u nënshtruan nga ekspansioni maqedonas, kurse në sh. III p.e.r. nga Roma. Me ndarjen e Perandorisë Romake, hyn në përbërjen e Bizantit. Në gjysmën e shek. XIV Shqipërinë e sundonte cari serb Dushani, i cili këtë territor ua ndau feudalëve serbë dhe shqiptarë; pas vdekjes së Dushanit, forcohet pushteti i feudalëve shqiptarë...”

Edhe për sa i përket gjuhës, kjo enciklopedi serbe vë në dukje që: “*Gjuha shqipe i takon familjes gjuhësore indoevropiane, grupit të ashtuquajtur të gjuhëve satem; qëndron më vete në grupin e gjuhëve të sotme indoevropiane, sikurse greqishtja, d.m.th. me asnjërën nga ato gjuhë të sotme indoevropiane nuk ka afri të veçanta; disa dijetarë mendojnë se është zhvilluar nga iliro-trakishtja, kurse disa të tjerë nga ilirishtja*”.

Të dhënat e mësipërme të enciklopedisë serbe për prejardhjen e shqiptarëve nga ilirët dhe të shqipes nga ilirishtja, që flet kjo për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e sotme dhe historike të tyre, nuk paraqesin ndonjë zbulim të ri të shkencës serbe, por janë konfirmim dhe i dijeve të enciklopedive të tjera relevante në gjuhë të ndryshme të botës, si p.sh. i enciklopedisë franceze, angleze etj.

Më vonë, pas fillimit të shthurjes së Jugosllavisë, shkencë serbe duke u vënë në shërbim të politikës serbomadhe, sidomos Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve, gjatë vitit 1986, me një cikël ligjëratash rreth temës “Ilirët dhe shqiptarët”, të publikuar më pas dhe si botim më vete (Iliri i Albanci, Beograd, 1988), duke harruar qëndrimet e veta të mëparshme në lidhje me gjenezën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, pajtohen me ata ithtarë të cilët gjenezën e këtij etnosi e shohin jo si mbetje ilire, por konsiderojnë se në formimin e tij rolin më të madh e kanë luajtur mbetjet e elementeve të ndryshme të substratit të vjetër paleobalkanik. Qëllimi kryesor dhe i vetëm i ekspertëve të shquar të shkencës përkatëse të Akademisë Serbe të Shkencave e të Arteve ka qenë, -sikundër shprehet I. Ajeti në një recension të argumentuar që i ka bërë këtij botimi, - mohimi i tezës ilire mbi prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij (Ajeti 2006: 73). Duke sakrifikuar bindjet e tyre të mëparshme në përpjekje që t'i problemmatizojnë lidhjet farefisnore të ilirëve dhe të shqiptarëve, sikur këta nuk janë pasardhës të ilirëve, kjo nuk është aspak në dobi të shkencëtarëve serbë, por është në dobi të mjerimit të shkencës serbe.

SHQIPTARËT DHE ILIRËT NË LEKSIKONIN “POPUJT DHE BASHKËSITË ETNIKE TË BOTËS”

Sipas disa hulumtimeve shqiptarët rrjedhin nga bashkësitë etnike proto-ilire-trakase të Gadishullit Ballkanik. Trashëgimisë ilire me gjasë i përket dhe zakoni i përbetimit të vajzave që të mos martohen (në familjet ku nuk ka pasur fëmijë meshkuj), që edhe për një gjeneratë me tesha të burrave simbolikisht të vazhdojë kultin e shtëpisë dhe familjes (Vlahović 1984, 152). Ky zakon ruhet deri dhe në ditët e sotme në Malësinë veriore të shqiptarëve, që njihet me nocionin Burrneshë – virgjëreshë e përbetuar, e cila merr rolin e burrit në Shqipërinë e Veriut. Kur i vdiste burri në luftë, ose për shkaqe të tjera familjare, kur merrte rolin e të parit për të mbajtur familjen, ajo vishej me tesha të burrave si shenjë se nuk do të martohej. Në Rugovë të Kosovës kanë qenë të njohura burrneshat e tilla. Kjo dukuri përbën një element tjetër të rëndësishëm lidhjes gjenetike të shqiptarëve me ilirët.

Libri i autorit Petar Vlahović, *Narodi i etničke zajednice sveta*, (“*Vuk Karadžić*”, Beograd 1984) (*Popujt dhe bashkësitë etnike të botës*), sjell të dhëna edhe për shqiptarët dhe ilirët, maqedonët, etj., të paraqitura me objektivitet shkencor, prandaj ky botim meriton të merret në konsideratë. Në zërin ku flitet për shqiptarët dhe ilirët, Vlahović prezanton këto fakte a të dhëna:

ALBANCI (Shqipëtar = Šiptar), popull i vjetër ballkanik. Më shumë shqiptarë ka në Shqipëri (sipas regjistrimit të vitit 1971 – 2188000), që përbën 96 % të popullsisë së përgjithshme. Në Jugosllavi ka më shumë se 1700 000, kurse një numër të konsiderueshëm ka në Greqi, Bullgari, Rumuni, BRSS, Itali, në Lindjen e Afërme, në Amerikën Veriore dhe atë Jugore, gjithsej 4 milionë. Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare janë krijuar shumë herët, kurse dokumentet e shkruara dalin që nga sh. XV. *Sipas disa hulumtimeve shqiptarët rrjedhin nga bashkësitë etnike proto-ilire-trakase të Gadishullit Ballkanik.* Në gjuhën bashkëkohore dhe kulturën e tyre ka mjaft elemente sllave, që kanë hyrë prej she. VI e këndej. Kontaktet me sllavët e ndalën procesin e romanizimit dhe helenizimit, dhe ndikuan në ruajtjen e veçanësisë së tipareve të tyre etnike. Nga sllavët morën mjetet bujqësore, tipin e banesave (ndërtimit), mjetet e komunikacionit. Për nga gjuha dhe specifikat etnografike, ndahen në *Gegë* (Veri) dhe *Toskë* (Jug), me kufi lumin Shkumbin. Që nga viti 1908 përdorin Alfabetin e përbashkët – me bazë latine.

Sipas veçorive antropologjike, sidomos në veri dhe verilindje, i takojnë tipit antropologjik dinarik. Profesionit i tyre në veri është blegtoria, kurse në jug bujqësia. Banesat janë njëkatëshe ose dykatëshe, prej guri, me frengji në vend të dritareve. Në veri është e njohur kulla masive, në jug shtëpia e tipit turk të lindjes, me katin e dytë të qitur jashtë mbi të parin.

Organizimi fisnor te Toskët në Jug është zhdukur gjatë shek. XIX. Te Gegët në Veri njihet edhe në kohën tonë ndarja në *fise*, *bajraqe* (*vllazni*), *megale* (*fise*) dhe *shtëpi*. Në krye të bashkësive shoqërore qëndron *kryeplaku* (zoti i shtëpisë), *këshilli i pleqve* dhe familja e përbashkët. Me organizimin farefisnor është ruajtur *egzogamia*, zakoni i *gjakmarrjes*, *besa*, *vllamia*, *mikpritja*. Religjioni: myslimanë 73% (Gegë-sunit, Toskë-bektashinj), ortodoksë 17 % dhe katolikë 10%.

ILIRËT (gr. *Ilirioi*, lat. *Illyrii*) – bashkësi etnike indoevropiane, e cila që nga fillimi i periodës së hekurit dhe në periodën antike ka jetuar në Gadishullin Ballkanik. Në juglindje kufizoheshin me *trakasit*, kurse në veriperëndim me *Keltët*. Përfshinin një territor nga gryka e lumit Po në Itali, e deri në Epir në Greqi, dhe nga deti Adriatik deri në Danub.

Sipas Plinit, në fillim, *ilirë* quheshin pjesëtarët e fiseve që banonin Epirin. Më vonë ky emër u zgjerua dhe mori përdorim të përgjithshëm edhe për fise të tjera jo vetëm përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe në brendësi, deri te Danubi e Drava. Si emra më të njohur të fiseve ilire nga veriperëndimi në juglindje, përmenden: *Venetët, Karnët, Histrët, Latobicët, Japodët, Liburnët, Mezejët, Breucët, Dalmatët, Ardiejët, Daorsët, Plerejët, Autarianët, Dokleanët, Labeatët, Pirustët, Partinët, Skordikët* etj. Që nga shek. X para erës sonë fiset ilire nga Epiri u shtrinë në rajonet Italisë juglindore, prej tyre më të njohur janë: *Japigët, Mesapët, Kalabrët, Daunjicët* etj. Në periudhën e mëvonshme u shtrinë në Greqinë e sotme veriore dhe në Peloponez, pastaj dhe në vise të Maqedonisë dhe të Serbisë.

Hipoteza e mëhershme për vendosjen e ilirëve në Gadishullin e Ballkanit nga rajonet e Evropës veriore, zona e kulturës luzhike, në shkencë kryesisht konsiderohet e tejkaluar. Materialet faktografike dëshmojnë për formimin e ilirëve në hapësirat ballkanike, sepse në kulturën e tyre, në vatrat që kufizohen në juglindje të Bosnjës e Hercegovinës, pastaj Malit të Zi, Serbisë jugore, Shqipërisë veriore dhe Maqedonisë perëndimore, ka shumë elemente që flasin për vazhdimësinë e formimit të disa elementeve kulturore autonome pararendëse.

Me ilirët lidhen dhe katundet blegtorale dhe tradita fisnore. Trashëgimisë ilire me gjasë i përket dhe *zakoni i përbetimit të vajzave që të mos martohej* (në familjet ku nuk ka pasur fëmijë meshkuj), që edhe për një gjeneratë me tesha të burrave simbolikisht të vazhdojë kultin e shtëpisë dhe familjes (Vlahović 1984: 152).

Lidhur me këtë mund të theksojmë që një zakon i tillë ruhet dhe te shqiptarët e sotëm, në Malësinë Veriore, që njihet me nocionin *Burrneshë* – virgjëreshë e përbetuar, e cila merr rolin e burrit në Shqipërinë e Veriut. Kur i vdiste burri në luftë, ose për shkaqe të tjera familjare, kur merrte rolin e të parit për të mbajtur familjen, ajo vishej me tesha të burrave si shenjë se nuk do të martohej. Në Rugovë të Kosovës kanë qenë të njohura *burrneshat* e tilla. Kjo dukuri përbën një element tjetër të rëndësishëm lidhjes gjenetike të shqiptarëve me ilirët (Q. M.).

Njohuritë për gjuhën ilire, - shënon Vlahović, - kanë mbetur ende në sferën e paragjytimeve. Konsiderohet që kjo i ka takuar familjes gjuhësore indoevropiane dhe ka qenë e afërt me gjuhët balte, kelte, gjermane, trakase, greke dhe italiane. Këtë e dëshmojnë analizat linguistike të emrave gjeografikë, vetjakë dhe emrave të tjerë ilirë, të cilët në perioda të ndryshme janë shkruar me alfabet të huaj dhe janë ruajtur në përmendoret antike. Si duket, ka vdekur në procesin e romanizimit, e më pas dhe të sllavizmit, në kapërcyell të kalimit nga antika në mesjetë, në periodën e rigrupimeve të reja etnike të popullsisë së atëhershme të Gadishullit Ballkanik.

DORIAN KOÇI

SPROVA IDENTITARE E KONGRESIT TË MANASTIRIT

Gjuha shqipe është ndoshta gjuha e vetme europiane që ka provuar persekutimet, ndalimet dhe dënimet deri në mosushtrimin e saj bash në kohën kur zhvillimi i kulturës së shkruar ishte shndërruar në një kulturë mbizotëruese në Europë. Këto persekutime dhe ndalime sollën si rrjedhim edhe përhapjen më me vonesë të nacionalizmit etnik, pasi ashtu si është provuar prej kohësh, shpërhapja e shtypit të shkruar ka luajtur rol të pazëvendësueshëm ndër kombet e Europës Juglindore. Mirëpo së bashku me këtë zhvillim negativ, ndalimi i saj nga ana e regjimit të Sulltanit otoman Abdyl Hamitit, në fund të shekullit XIX, apo dhe mallkimet dhe shkishërimet si ato të mitropolitëve grekë në Shqipërinë e Jugut që para se të ishin barinj të tufës së Zotit ishin nacionalistë të përbetuar të Megali Idesë, në fakt përforcuan më tepër dëshirën për ta lëvruar ndër shqiptarë dhe për ta parë atë si një nga mjetet e tyre më të suksesshëm për të arritur kohezionin e duhur shpirtëror. Si e tillë, gjuha shqipe ka ardhur përmes zhvillimit të idesë sonë kombëtare dhe evolucionit etnik si një sprovë e fortë e mbijetesës dhe afirmimit tonë si kombësi më vete në Ballkan, por edhe si një njësi vetëpërcaktuese e identitetit tonë. Janë të rralla momentet në historinë e popujve ballkanikë kur procesi i caktimit të një alfabeti të përcaktojë brenda së njëjtës kohë identitetin kombëtar, orientimin politik të popullatës dhe të shërbejë si provë madhore për pavarësinë. Kongresi i Manastirit 14-22 nëntor 1908, kongresi ku u përcaktua se ç'alfabet do të kishte gjuha shqipe, është pa dyshim një nga ngjarjet që kanë shënjuar historinë dhe kulturën e afërt të shqiptarëve. Në Maqedoninë shumënike të fillimit të shekullit XX dhe në qytetin shumëkulturor të Manastirit, shqiptarët hodhën themelet e shkrimit të identitetit të tyre të veçantë linguistik, duke u dhënë jetë përpjekjeve disashekullore për të pasur një alfabet, një popullatë, një komb. Kështu historia dhe kultura e afërt e shqiptarëve nuk mund të kuptohen pa rëndësinë e një trekëndëshi gjeografik e kulturor Prizren-Manastir-Vlorë, si vende ku u themeluan dhe morën jetë idetë kombëtare të shqiptarëve. Në Prizren morën jetë për herë të parë dëshirat për autonomi të shqiptarëve, në Manastir u arrit bashkimi kulturor i tyre dhe në Vlorë u shpall pavarësia.

Përzgjedhja e alfabetit latin për të shkruar gjuhën shqipe, më tepër se një veprim politik përfaqësues drejt Europës siç është komentuar shumë herë, ishte vazhdimësi e një orientimi dhe vetëpërcaktimit të shqiptarëve si një popull europian. Shkrimi dhe lëvrimi i një gjuhe askund tjetër nuk ka marrë një rëndësi të veçantë sesa të shqiptarët që, ndodhur mes Lindjes dhe Perëndimit, pa asnjë institucion të rëndësishëm kombëtar që do të mund t'u mbronte identitetin, të gjuha

dhe kultura e tyre kishin gjetur një nga forcat lëvizëse për të themeluar kombin e tyre. Vështirë të gjesh një numër kaq të madh poetësh dhe mendimtarësh në kulturat e tjera ballkanike që t'i kenë kënduar apo thurur himne gjuhës së tyre kombëtare sa në letërsinë shqiptare të shekullit XIX-XX. “Gjuhë perëndie” e quan Naim Frashëri, ai që nuk flet shqip sipas Fishtës, “duket i ulët...Krejt i turpëruar? Si ai që.... nuk di se kush është babai i tij”. Rëndësinë e gjuhës dhe lëvrimin të saj e jep Kristoforidhi kur shprehet se “nëse gjuha shqipe nuk do të shkruhet, atëherë brenda një kohe të shkurtër nuk do të ketë më Shqipëri në faqe të dheut dhe as do lexohet më emri shqiptar në hartën e botës”.

Këto vargje dhe sentenca të elitës së kohës tregojnë qartë se shqiptarët kishin zgjedhur identitetin kulturor si kështjellën e identitetit të tyre bashkues dhe besoj se kjo zgjedhje e fillimit të shekullit XX në Manastir vazhdon të jetë aktuale dhe sot për të përfaqësuar më mirë shqiptarët në rajon. Kultura dhe gjuha janë dy komponentët më të rëndësishëm të etnosit shqiptar përballë të cilave ndarjet artificiale janë të vogla dhe të papërfillshme. Por, në të njëjtën kohë, shqiptarët janë po aq të ndërgjegjshëm se paqja dhe stabiliteti në rajon kërkon të ketë të zbatuar mes tyre edhe kulturën e pranimit të Tjetrit, si një formë kulture që kultivon një bashkëjetesë të gjatë mes popujve në Ballkan, ndaj, së bashku me fqinjët, duhet të kontribuojnë më tepër në këtë drejtim. Gjuha shqipe, prej kohësh, e ka fituar qytetarinë e saj në Kosovë, por ende duhet të riafirmohet në Mal të Zi, Preshevë dhe në Maqedoni ku, duke qenë një gjuhë zyrtare sipas Marrëveshjes së Ohrit, duhej të kishte status të barabartë me gjuhën maqedonase. Një fat akoma më i keq e ka ndjekur dialektin arvanitas në Greqi, ku sa për mentalitete të prapambetura nacionaliste greke po aq dhe për shpërfillje nga institucionet qendrore në Tiranë, po shuhet ngadalë duke humbur një thesar i paçmuar i trashëgimisë sonë etnike. Një përkujdesje më e madhe për gjuhën tonë, si institucioni shpirtëror prej nga ka nisur kohezioni i kombit, do t'i jepte dimension tjetër kulturës sonë në Ballkan dhe shqiptarëve në rajon. Koha kur Marrëveshja e Ohrit, marrëveshje kyç për ekzistencën e Maqedonisë do të zbatohet plotësisht edhe në rrafshin gjuhësor, por edhe largimi i frikës dhe anktheve të shteteve fqinjë nga statusi i gjuhës shqipe në shtetet e tyre, do të jetë koha që mund të themi pa frikë se Ballkani do ta lërë pas të shkuarën dhe do të përfitojë dimensionin europian të tij.

VINCENT W. J. VAN GERVEN OEI

ÇFARË MUND TË BËJË SHTETI ME GJUHËN?

Qëkur mbërrita në Shqipëri në fund të vitit 2010, e kam ndjekur me interes debatin e këtushëm për gjuhën standard dhe imponimin, mbrojtjen dhe ndryshimet e mundshme të saj. Vjet madje përgatita një artikull të gjatë për revistën letrare holandeze nY, të titulluar “Staatstaal en taalstaat” (“Gjuha e shtetit dhe gjendja [literalisht: shteti] i gjuhës”), që ishte një hulumtim i rolit që luajti njësimi i gjuhës shqipe, në konsolidimin e shtetit shqiptar.

Një nga idetë e mia ishte që, nëse në vendet fqinje feja e përbashkët ofronte një forcë lidhëse në ngjizjen e lëvizjeve kombëtariste, në rastin e Shqipërisë ky rol i kish mbetur shqipes si gjuhë e përbashkët. Kjo varësi nga gjuha e përbashkët si garanci e një kombi të njësuar ende përmendet në debatet e tanishme rreth gjuhës shqipe standard.

Tani vonë, një grup prej njëzet autorësh i bëri thirrje Kryeministrit Edi Rama që të mos miratojë ndryshimin e shqipes standard, por të ngulmojë për përdorimin e saj korrekt anembanë Shqipërisë. Kjo mund të shihet si përgjigje ndaj propozimeve që janë përsiatuar në publik, mes të tjerash nga Akademia e Shkencave, për të përfshirë elemente të ashtuquajtura “gegë” në një gjuhë standard të re, me gjasë më të drejtpeshuar. Meqë blogu ku po del ky tekst i ka kushtuar kohë dhe hapësirë të madhe debatit për reformën gjuhësore, nuk është qëllimi im të ofroj edhe një opinion tjetër të radhës krahas atyre të autorëve të tjerë, shumë më të kualifikuar. Përkundrazi, do të doja të ofroj një studim të shkurtër dhe krahasues me gjendjen e gjuhës në Holandë, për t’i dhënë një përgjigje të mundshme pyetjes që shfaqet në titullin e këtij teksti: “Çfarë mund të bëjë shteti me gjuhën?” Mendoj se kjo është një nga çështjet kryesore që duhen prekur gjatë debatit të tanishëm në Shqipëri për reformën gjuhësore, dhe se holandishtja meriton të studiohet në këtë vështrim, meqë shumë paralele mund të hiqen midis gjendjes në Holandë dhe asaj në Shqipëri.

Dhe po e them që në fillim përgjigjen e pyetjes më sipër: fare pak. Në Holandë, gjuha standard quhet holandishtja standard. Holandishtja standard flitet dhe shkruhet në Holandë, në Flandër (Belgjika veriore), Surinam dhe në pak koloni të mbetura në Karaibet. Një institucion i quajtur Bashkimi për Gjuhën Holandeze kujdeset për rregullat e holandishtes standard nëpërmjet konvencioneve ortografike, botimit të listave të fjalëve, fjalorëve dhe kështu me radhë. Kjo holandishtje standard mund të krahasohet me shqipen standard të sanksionuar nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në 1972.

Holandishtja standard është gjuha e folur nga, për shembull, spikerët e lajmeve në televizionin kombëtar, politikanët kombëtarë dhe në sistemin arsimor. Megjithatë, njëlloj sikurse shqipja standard bazohet në toskërishten, holandishtja

standard flitet “natyrshëm” vetëm në provincën e Holandës Veriore, rreth qytetit të Haarlem-it. Kudo gjetiu në zonën e holandishtes, folësit rriten duke folur dialekte të ndryshme, edhe pse të gjithë e mësojnë holandishten standard në shkollë. Dhe, njëlloj si në çdo komunitet tjetër gjuhësor, gjen diferenca gramatikore dhe leksikore mes folësve, të cilat varen nga mjedisi social, arsimimi, prejardhja etnike, etj.

Holandishtja standard ndryshon shumë nga një grup dialektesh (të cilin disa madje e quajnë gjuhë) që flitet në Flandër. Këto dialekte, që njihen me emrin e përbashkët flamandishte, ndryshojnë po aq shumë nga holandishtja standard, sa edhe disa dialekte të gegërishtes në Kosovë ndryshojnë nga shqipja standard, dhe keqkuptime komike si ai midis Ramës dhe Thaçit së fundi (“A nirthte?...”) ndodhin po aq rëndom. Njëlloj si Kosova dhe Shqipëria, Holanda dhe Belgjika kanë qenë pjesë e një shteti të bashkuar për një periudhë të shkurtër historike dhe, për ta plotësuar analogjinë, ka edhe një grup kolonistësh holandezë që, si arbëreshët në Itali, u larguan nga Holanda për t’u vendosur në Afrikën e Jugut, ku ende sot e kësaj dite flitet një formë e veçantë e holandishtes, e njohur si afrikanishte (Afrikaans). Ka edhe një pakicë të vogël në veri të Holandës, të ngjashme me pakicën greke në Shqipërinë e Jugut, e cila flet një gjuhë krejt të ndryshme – frizishten. Të drejtat e kësaj pakice rregullohen me ligj dhe frizishtja, për shembull, mund të mësohet në shkolla dhe lejohet të përdoret si gjuhë në gjykatat lokale.

Tani le të përpiqemi të ngremë një numër analogjish të ndërlydhura me debatin e tanishëm për reformën gjuhësore të shqipes. E para do të lidhej me nevojën për ta “ndrequr” shqipen standard pas gjase të imponuar nga shteti, duke përfshirë në të “elemente të gegërishtes”. Këtu silllet zakonisht shembulli i ndërtimit të tipit me + pjesore si alternativë ndaj formës për të + pjesore, p.sh.: me punue në vend të për të punuar.

Le të përfytyrojmë sikur një grup intelektualësh flamandë të ngrihej dhe t’i sugjeronte shtetit holandez se holandishtja standard duhej pasuruar me disa ndërtime të flamandishtes, si dëshmi e pasurisë së holandishtes dhe ngaqë holandishtja standard është produkt i shtypjes së provincave jugore nga provincat më të pasura veriore.

Tani, argumentet e sjella nga intelektualët flamandë do të qëndronin, në vetvete; ndryshe nga holandishtja standard, flamandishtja ka ruajtur shumë elemente “arkaike” të holandishtes, të tilla si eptimin rasor; dhe më tej, e vërteta është se holandishtja standard u bazua në dialektin e Amsterdemit meqë ky qytet ishte më i fuqishmi, gjatë Rilindjes Holandeze.

Megjithatë, asnjë nga këto argumente nuk do të mjaftonte që shteti të bënte ndryshime në holandishten standard. Jo vetëm që ndërtimet “origjinale” të flamandishtes janë të panjohura për shumicën e folësve të holandishtes meqë ato nuk studiohen në shkolla; por edhe, pasi të pranohet një ndreqje e tillë, ajo do të vendoste një precedent për shumë ndryshime të tjera të mëvonshme. Për shembull, në qoftë se përfshijmë kallëzoren në holandishten standard, pse të mos përfshijmë edhe format e zhdrejta të përemrave lidhorë (që i ka flamandishtja) ose edhe tonet (që i ka dialekti limburgian); ose pse të mos përfshijmë edhe një dallim në mënyrën si shqiptohen ch dhe g (mbi lumenjtë kryesorë të Holandës dhe në holandishten standard, këto shqiptohen njëlloj; nën lumenjtë, ndryshe).

Përpjekjet për të kënaqur preferencat individuale të (grupeve të) folësve të holandishtes nuk do të mbaronin kurrë. Duke lejuar ndryshime të tilla “rrënjësore” do të minonin funksionin e holandishtes standard, i cili është të ofrojë një standard – përmes sistemit arsimor dhe medie kombëtare – në të cilin gjithkush që flet një variant të caktuar të holandishtes, të jetë në gjendje të komunikojë me të tjerët dhe me shtetin.

Edhe pse kjo mund të mos na pëlqejë, gjuha standard është nga gjërat më konservative në botë. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se nuk mund të ndryshojë. Për shembull, anembanë trojeve ku flitet holandishtja, duket se nyja shquese asnjëherë het po zhduket dalëngadalë. Fare mirë mund të presim që, pas pesëdhjetë ose njëqind vjetësh, kur shumica e folësve të holandishtes të mos e përdorë më het dhe ta ketë zëvendësuar me de, kjo rregull gramatikore të ndryshojë. Por kjo vetëm në qoftë se një ndryshim i tillë i rregullave zyrtare të mos ngrëjë peshë për përdoruesin e gjuhës së përditshme. Në fakt, shteti nuk mund të ndër marrë ndryshime të standardit, përveçse në rrethana të një regjimi shtypës.

Mund të përfytyrojmë një skenar tjetër, kur një gjuhëtar zbulon një thesar të mrekullueshëm fjalësh të harruara të holandishtes, të cilat mund të zëvendësojnë për bukuri neologjizmat e ndryshëm që kanë “ndotur” gjuhën holandeze gjatë shekujve. Për shembull, ky gjuhëtar zbulon fjalën flamande wentelwiek, e cila i referohet atij objekti, të cilin holandishtja standard e quan helikopter. Gjuhëtari ynë do të shpjegonte se wentelwiek është “shumë më tepër holandisht” se huazimi grek (përmes frëngjishtes) helikopter. Dhe ai mund të ketë të drejtë, në kuptimin se edhe wentelen (vërtit, përdredh) edhe wiek (flatër) kanë prejardhje gjermanike, pa çka se, ndryshe nga wentelwiek, fjala helikopter përdoret në të gjitha shkollat e vendit. Pra cila fjalë është, në analizë të fundit, “më holandeze”? (Fakt zbavitës: te zëri “helikopter”, në Fjalorin Etimologjik të Holandishtes, lexojmë: “Ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme për të futururizmat hefschroefvliegtuig dhe wentelwiek.”)

Kjo nuk do të thotë se holandishtja është e pambrojtur ndaj dyndjes së fjalëve të huaja, pa çka se, si gjuhë, ajo gjithnjë ka qenë shumë mikpritëse ndaj huazimeve prej gjuhëve të tjera. Mirëpo një fjalë e huazuar pushon së qeni huazim në momentin që hyn në ligjërimin e përditshëm dhe në tekstet; dhe në këtë kuptim, helikopter është fjalë e holandishtes, pavarësisht nga prejardhja e saj greko-franceze.

Për shembull, fjala holandishte beamer është huazim nga anglishtja, edhe pse kuptimi i saj (“projektor”) është tjetër nga ai me të cilin përdoret në anglishte. Një rast i ngjashëm, me shqipen, do të ishte famëkeqja kinge, e një huazim nga anglishtja tashmë i përshtatur me një prapashtesë të gjinisë femërore. Si mund të pretendohet se kinge nuk është fjalë shqipe? Gjithsesi, fjalë të reja krijohen përditë në holandishte. Shembuj të mirë do të ishindoemdenker (pesimist) dhe regelneef (ndërmjetës, sekser), dhe tani së voni otophoto (selfie). (Fakt zbavitës: të gjitha këto fjalë janë krijuar prej të njëjtit autor, Kees van Kooten.) Fjalët e reja nuk krijohen prej gjuhëtarëve hulumtues të emrave të bimëve të rralla ose pjesëve të një mulliri të vjetër me erë, por prej poetëve, autorëve, politikanëve dhe figurave

të tjera publike që ndërhyjnë në debatet publike dhe sajojnë fjalë që “zënë vend.” Askush tjetër s’mund ta bëjë këtë, dhe aq më pak shteti!

Prandaj, në bazë të këtij ushtrimi të shkurtër në imagjinatë, mund të sugjerojmë se:

Ndërmarrja e reformave me natyrë sintaksore ose morfologjike potencialisht jetëron një masë të madhe të popullsisë nga gjuha që ata përdorin përditë në komunikim me njëri-tjetrin dhe me shtetin; çka minon funksionin thelbësor të një gjuhe standard. Një reformë e thellë, siç do të ishte përfshirja e paskajores me punë mund të ketë sukses vetëm në qoftë se (pothuaj) të gjithë tashmë e përdorin këtë formë në të gjitha nivelet e komunikimit. Por nuk është ky rasti i tanishëm.

Futja puriste e fjalëve të rralla “të humbura” për të zëvendësuar fjalët “e huaja” nuk mund të imponohet anëmbanë vendit nëse nuk ekzistojnë disa rrethana të caktuara, p.sh. në komunitete të vogla dhe të kufizuara me pak ndikime të huaja (Islanda) ose nga një institucion i respektuar dhe me status të padiskutueshëm, si Académie française në Francë. E vetmja rrethanë tjetër që vjen në vështrim, është diktatura, si në rastin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Përndryshe, fjalët e reja zënë vend vetëm kur mbushin një zbrazëti në ligjërimin e përditshëm, e cila ende nuk është zënë nga ndonjë fjalë tjetër. Këto dinamika duket se përkrijnë shumë më tepër me nocionin e optimizimit, sesa me atë të imponimit nga shteti.

Po çfarë mund të bëjë shteti, kur vjen puna për reformën gjuhësore, pa iu kundërvënë komunitetit të përdoruesve të gjuhës? Ja, mund të punojë pak me drejtshkrimin. Në fakt, reformat arbitrare të drejtshkrimit janë bërë një nga engledisjet kombëtare në Holandë, teksa një numër ortografish “të rishikuara” janë propozuar gjatë njëzet viteve të fundit. Po çfarë reformohet në këtë rast? Siç mund të pritet, gjëra që askush nuk i vë re, kur e përdor gjuhën: nëse do të përdoren dy pika apo një vizë ndarëse me disa fjalë (zeeëend ose zee-eend), nëse do të shkruhet një n në emrat e përbërë apo jo (pannekoek ose pannenkoek), dhe të gjitha këto, natyrisht, të shoqëruara me lista të gjata përjashtimesh dhe rregullash që bien ndesh me intuitën. Kjo gatishmëri për reformë ka arritur një nivel të tillë absurditeti, sa që në Holandë aktualisht po përdoren dy (në mos më shumë) drejtshkrime: njëri i mbështetur nga shteti dhe nga Bashkimi për Gjuhën Holandeze (i quajtur “Librushka e gjelbër”) dhe tjetri i mbështetur nga botuesit e mëdhenj dhe gazetatat (i quajtur “Librushka e bardhë”).

Duke pasur parasysh çka u tha më lart, nuk do të habitemi me faktin se propozimet kryesore për reformën drejtshkrimore të shqipes që kanë qarkulluar së fundi, lidhen me çështjen e ë-së së pazëshme. Çfarëdo që të vendoset për të, ne s’do ta dëgjonim dot! Megjithatë, le ta kemi të qartë: edhe kur vjen puna për një shkronjë relativisht të parëndësishme, si ë-ja e pazëshme, ajo është unike për shqipen dhe mbizotëruese në “imazhin e fjalës” për këtë gjuhë dhe në mënyrën si duken tekstet e shkruara. Edhe këtu do të ishte me vend, para se të merrej ndonjë vendim i nxituar, të mbaheshin parasysh shembuj nga historia tani së fundi e reformave (të dështuara) të drejtshkrimit në frëngjishte dhe në gjermanishte. Në Francë, edhe thjesht sugjerimi për të hequr theksin cirkumfleks në ô-në e

fjalës hôtél gati shkaktoi një revoltë publike; dhe janë të shumtë gjermanët që ende vajtojnë humbjen e β -së elegante dhe refuzojnë të pranojnë reformimin e saj në ss. Këto shkronja të pazakonshme janë bërë pjesë e identitetit kombëtar dhe kam një ndjesi se e njëjta gjë vlen edhe për ë-në e shqipes.

Pra, në mbyllje të kësaj eseje, arrijmë në një paradoks mahnitës: edhe pse gjuha standard është një nga forcat më konservative në shoqëri, ajo është aq konservative, sa edhe shteti nuk mund ta ndryshojë dhe as, përkundrazi, ta mbrojë. Dhe kështu duhet të jetë, meqë nuk është ky funksioni i një shteti ndaj një gjuhe kombëtare. Çfarë mund të bëjë shteti është ta përdorë gjuhën standard në mënyrë dinjitoze dhe gramatikisht korrekte. Kjo vlen për ligjëratat politike brenda dhe jashtë parlamentit, fjalimet presidenciale, konferencat e shtypit, etj. Çfarë mund të bëjë shteti, është edhe të sigurojë një infrastrukturë arsimore adekuate, e cila t'i japë mundësi çdo qytetari shqiptar, pavarësisht se ç'variant të shqipes flet në shtëpi, që të komunikojë me shqipfolësit e tjerë brenda dhe jashtë vendit dhe të gëzojë të drejtat e veta të plota si qytetar, në marrëdhënie me qeverinë dhe sistemin juridik. Kjo nuk ka fare të bëjë me “dashurinë për atdheun”, “rishikimin e historisë” ose ndonjë “detyrë të shenjtë”, por ka shumë të bëjë me kujdesin e shtetit për shoqërinë. Shteti nuk duhet të kujdeset, pra, për gjuhën; por për përdoruesit e saj.

[përktheu nga anglishtja: 2Xh.]

HAREDIN XHAFERI

KLASIFIKIMI I LOKUCIONEVE PARAFJALORE SIPAS STRUKTURËS DHE VLERËS SË TYRE SEMANTIKE

Lokucionet me vlerë parafjale janë barazvlerëse semantike me parafjalët por nuk janë parafjalë. Këto të fundit janë pjesë të ligjëratës. Në pjesë të ligjëratës janë grupuar fjalët. Pra, parafjalët janë fjalë. Termi “parafjalë” në tekste a studime të ndryshme nuk është përdorur me vend në çdo rast. Ky term është përdorur edhe për lokucionet me vlerë parafjale ose këto të fundit janë trajtuar bashkë me parafjalët. Për lokucionet parafjalore janë mbajtur qëndrime të ndryshme nga studiues të ndryshëm.

K. Kristoforidhi në gramatikën e vet nën titullin “Rreth parafjalës” ka pasqyruar si parafjalë lokucionet që përdoren me gjinoren: *me anë, ndë vent, ndë sy, për punë* dhe me kallëzoren: *sa për*. Ai i ka shkruar pa nyjën e gjinores, por ka bërë shënimin (*me gjin.*).¹

K. Cipo nuk i ka diferencuar parafjalët nga lokucionet, megjithëse ka shkruar se “Parafjalët dhe lokucionet parafjalore rrinë përpara emrave....” Ai ka përfshirë te parafjalët edhe strukturat *në vënt, në mest, në mjedis*.²

I. D. Sheperi ka dalluar lokucione të formuara nga dy parafjalë, si: *që në, gjer në, që nga, gjer te, që kur, gjer sa, sa për*. Edhe ky studiues nuk i ka ndarë lokucionet nga parafjalët, kur shkruan se parafjalë janë dhe lokucionet “në vend” etj.³

O. Myderrizi ka pasqyruar te parafjalët strukturat: *çë ke, çë në, çë më, deri ke, deri në, deri më, në vend, me anë, sa për, bashkë me*.⁴

A. Xhuvani në punimin për parafjalët i ka ndarë ato sipas funksionit në: parafjalë të mirëfillta a të parme, të thjeshta ose të përngjitura; parafjalë të prejardhura dhe lokucione a shprehje ndajfoljore.⁵ Ai quan shprehje parafjalore “grupe fjalësh që kanë kuptimin e një fjale dhe bëjnë po atë funksion të parafjalëvevet.” Autori ka dalluar strukturat *parafjalë + emër*, të ndjekur nga një nyje a parafjalë tjetër, si: *në mes të, në mjedis të, në lidhje me, në marrëveshje me, në*

¹ K. Kristoforidhi, *Gramatikë e gjuhës shqipe sipas dialektit tosk*, Vepra, I, 2001, f. 241

² K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 183

³ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, 1927, f. 123, 124

⁴ Myderrizi, O., *Gramatika e ré e shqipes*, Për shkollat e mesme, Vëllimi I (Fonologji e morfologji), Tiranë, 1944, f. 276

⁵ Aleksandër Xhuvani, *Parafjalët*, Vepra, I, 1980, f. 267

*pajtim me, për punë të, nga shkaku i, nga puna e etj.*⁶ Siç shihet nga shembujt, lokucionet e gjinore ai i merr bashkë me nyjën e kësaj rase.

M. Domi i ka quajtur shprehje.⁷ Më pas ai, duke pasqyruar konceptin e pranuar në përgjithësi për lokucionet si njësi gjuhësore dhe duke nënvizuar disa çështje që lidhen me to, ka përmendur edhe lokucionet parafjalore.⁸

S. Prifti ka përdorur termin “*lokucion*” a “*shprehje*,” kur emri që i ndjek, është në rasën gjinore.⁹

Sh. Demiraj ka njohur lokucionet: *me anë të (me anën e), në vend të, në mes të etj.*, të cilat i quan lokucione të ngurosura, të formuara nga parafjala, emri dhe nyja e përparme.¹⁰ Sikurse Xhuvani, ai e ka përfshirë nyjën e gjinore në strukturën e lokucionit. Autori i ka klasifikuar parafjalët nga përbërja në: të para, të përngjitura dhe shprehje parafjalore a lokucione, si: *për në, për nga*.¹¹

B. Beci në gramatikën e tij i ka grupuar parafjalët sipas strukturës morfologjike në: të thjeshta, të përngjitura dhe shprehje.¹² Ai i quan parafjalë të rasës gjinore lokucionet *me anë, me anën, në sajë, në vend, për arsye, për shkak*.¹³

M. Çeliku ka kryer një studim më të plotë për parafjalët emërore në gjuhën letrare shqipe. Pjesën e dytë të studimit ai ua kushton lokucioneve parafjalore emërore. Të tilla ai quan “parafjalët e formuara nga bashkimi i emrave me parafjalë të mirëfillta.”¹⁴ Autori ka përfshirë te lokucionet parafjalore emërore edhe parafjalët emërore të formuara me përngjitjen e një parafjale të mirëfilltë me një emër, si: *nëpërmjet, ndërmyjet, ndanë, mbanë*. Sipas tij, pjesa më e madhe e lokucioneve parafjalore emërore janë formuar nga bashkimi i emrave abstraktë me parafjalë të mirëfillta, ndërsa emrat konkretë kalojnë në parafjalë në kuptimin e dytë të tyre. Në semantikën e emrave që kalojnë në parafjalë, qëndron marrëdhënia me diçka tjetër, duke e humbur pjesërisht kuptimin e tyre leksikor.¹⁵ Vendin kryesor në studimin e tij e zë trajtimi i hollësishëm i një numri të madh lokucionesh të këtij grupi, duke i vështruar nga struktura, nga semantika dhe nga shkalla e gramatikalizimit të tyre.

Në monografinë për parafjalët M. Samara u ka bërë një trajtim leksiko - semantik lokucioneve parafjalore. Ai ka trajtuar në monografi edhe çështjen e

⁶ Po aty, f. 330

⁷ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa e dytë, Sintaksa, Botim i tretë, 1957, f. 64, 67, 73, 80

⁸ M. Domi, *Disa çështje të lokucioneve*, SF, 1, 1985, f. 209 - 217

⁹ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 1962, f. 154, 164, 165 (Cituar sipas M. Çelikut, *Lokucionet parafjalore ...*, art. i cit., f. 208)

¹⁰ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1961, f. 271

¹¹ Sh. Demiraj, *Gramatikë e gjuhës shqipe, pjesa e parë, Morfologjia* (Për shkollat pedagogjike), 1962 f. 210

¹² B. Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1997, f. 121

¹³ Po aty, f. 122

¹⁴ M. Çeliku, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, Çështje të gramatikës së sotme shqipe, II, 1975, f. 209

¹⁵ Po aty, f. 210.

strukturës e të paraqitjes leksikografike të tyre. Sipas tij, këto lokucione janë struktura të formuara nga fjalë kuptimplota dhe jokuptimplota me lidhje të qëndrueshme, që kanë vlerën e një parafjale. Vështirësitë e analizës së tyre autori i ka shpjeguar me studimet e pakta teorike lidhur me konceptin dhe identitetin e lokucionit, me strukturën dhe trajtimin leksikografik të tyre. Në monografi trajtohet si problem më vete desemantizimi i elementeve të këtyre lokucioneve, me të cilin ai nënkupton largimin nga kuptimi i tyre fillestar dhe funksionin e ri gramatikor të lokucionit. Sipas tij, Ky shndërrim semantik dhe funksional do të ishte edhe kriteri semantik kryesor për të përcaktuar identitetin e këtyre lokucioneve. Në disa raste autori ka pasqyruar edhe vlerën semantike që ato mbartin.¹⁶ Ai vëren edhe zhvillimin kuptimor të tyre, të cilin e lidh me zgjerimin e lidhjeve leksiko - semantike me fjalë të tjera ose me shtimin e kuptimeve të tyre leksiko - semantike.¹⁷

Lokucionet parafjalore kanë gjetur pasqyrim në gramatikat shkencore dhe në tekstet e gjuhës bashkë me parafjalët.¹⁸ Më gjerë ato janë trajtuar në gramatikat shkencore, por edhe në këto vepra janë përfshirë te parafjalët dhe janë trajtuar si të tilla. Në këtë përfundim ka arritur edhe M. Samara, duke e konsideruar të padrejtë klasifikimin e parafjalëve sipas strukturës morfologjike bashkë me lokucionet.¹⁹ Për klasikimin e tyre ai këshillon edhe aspektin leksiko - semantik, sipas të cilit parafjalët grupohen në: parafjalë njëfjalëshe dhe parafjalë dy - a - disafjalëshe, ku të përfshihen edhe lokucionet.²⁰

Në G I është shkruar se si parafjalë përdoren edhe një numër lokucionesh ndajfoljore, si: *anë e përqark, anë e qark, rreth e rreth, tej e tej, ballë për ballë, mes për mes* etj. Po aty është shkruar se të gjitha këto parafjalë ndajfoljore përdoren me rasën rrjedhore.²¹ Pra, këto lokucione trajtohen si parafjalë, bashkë me parafjalët *afër, larg, brenda, jashtë, përballë, matanë* etj., të cilat e kanë orgjinën nga ndajfoljet. Ky trajtim është bërë nga ndonjë studiues edhe në dekadën e fundit.²²

Sot nga të gjithë është pranuar lokucioni si një grup fjalësh me lidhje të qëndrueshme e të barazvlershme me një fjalë të vetme, por jo të njëjtë me të. Gjithashtu, janë të përcaktuara dhe të njohura tiparet dhe kufijtë e fjalës.

¹⁶ Shih për këto edhe M. Samara, *Parafjalët në shqipen e sotme (Vështrim leksiko - semantik)*, 1999, f. 83 - 97

¹⁷ Po aty, f. 38

¹⁸ Shih *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, 1976, (FG II), f. 336 - 347; *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, 1995, (G I) f. 384 - 396; *Libri i gjuhës shqipe*, 2, Për shkollat e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja, 1988, f. 190 - 195; *Gjuha shqipe*, 7, 2000, f. 167; *Gjuha shqipe*, 7, 2002, f. 167; *Gjuha shqipe*, 7, 2003, f. 165.

¹⁹ M. Samara, *Parafjalët ...*, vep. e cit., f. 21

²⁰ Po aty, f. 22

²¹ *Gramatika ...*, I, vep. e cit., f. 384. Ky qëndrim është mbajtur më parë në FG II, f. 336.

²² M. Çeliku ka përdorur termat "lokucion" dhe "parafjalë" në të njëjtin paragraf të një artikulli (Shih *Disa parafjalë dhe lidhëza të shqipes standarde vështruar në rrafshin normativ*, Gjuha jonë, 1 - 4, 2006, f. 39).

Lokucionet me vlerë parafjale duhen dalluar qartë nga parafjalët dhe duhen trajtuar më vete. Këto lokucione mund të përdoren rregullisht në vend të parafjalëve, duke zbutur, siç pohon M. Samara, “ngarkesën” polisemike të këtyre të fundit.²³

Lokucionet parafjalore janë formuar nga bashkimi i dy ose tri fjalëve shënuese a shërbyese. Në këto struktura fjala shërbyese është parafjalë. Fjalët shënuese janë kryesisht emra, më rrallë përdoren ndajfolje ose folje. Këto lokucione paraqiten të larmishme nga struktura dhe vlera semantike.

A. KLASIFIKIMI SIPAS STRUKTURËS

Struktura e lokucioneve me vlerë parafjale mund të jetë me dy fjalë ose me më shumë se dy fjalë.

I. Lokucionet me strukturë dyfjalëshe

Përbëjnë një numër të madh. Nga kategoria leksiko - gramatikore e fjalës shënuese ato ndahen në grupe të ndryshme.

1. Lokucione të formuara nga dy fjalë shërbyese. Janë të pakta në krahasim me lokucionet e grupeve të tjera. Të tilla janë lokucionet *deri në, deri te, deri më, deri mbi, deri nën, deri ndaj, deri para, deri pas, për në, për te* etj., të formuara me pjesëzën *deri* dhe një parafjalë. Këto lokucione u paravihen emrave a ndajfoljeve për të treguar një cak të tejmë të një rrethane kohe a vendi. *Ajo i ngjante asaj shtëpisë ku çdo gjë: vaji, uji, mielli janë të llogaritura deri në një dhe asgjë nuk tepron dhe asgjë nuk derdhet rastësisht. Udha për te ti po shkurtohej, por lodhja më pëshpëriste se ti nuk më prisje...*

2. Lokucione të formuara nga një fjalë shërbyese dhe një fjalë shënuese. Përbëjnë tipin me numrin më të madh. Fjala shënuese mund të jetë një emër, përemër, folje a ndajfolje. Fjala shërbyese është parafjalë.

2. 1. *Lokucionet e formuara nga një parafjalë dhe një emër* përbëjnë grup mjaft të pasur. Shumica e emrave që marrin pjesë në këto lokucione, janë abstraktë. Emrat konkretë janë më të paktë. Ata nuk përfshihen në lokucion në kuptimin e tyre të parë. Brenda këtij grupi dallohen disa nëngrupe.²⁴

a. Lokucionet e formuara nga *parafjalë + një emër i parmë* janë të shumta. Emri i lokucionit ka shërbyer si temë prodhuese e parafjalës sinonime.²⁵ Ai e ka humbur kuptimin e parë dhe përdoret në një kuptim të dytë. Lokucione të tilla janë: *në krye* (krye), *në majë* (majë), *në prag* (prag), *në rrëzë* (rrëzë), *në fund*, *në skaj* (skaj), *në mes* (mes), *në buzë*, *në faqe* (faqe), *në sy* etj. P. sh. *Atje tej, në krah të karvanit të vendarakëve, vazhdonte drejt përpara, plot besim, ... karvani i gëzuar i muaxhirëve kosovarë. Në prag të dimrit ata i ulnin bagëtinë poshtë në fshat dhe përgatiteshin për t'i dimëruar në ndonjë zonë të bregdetit. Të nesërmen, posa do të dilte në udhë, vuri re Gjonin, që u dha në fund të livadheve, hipur mbi një kalë të bardhë. Me kurriz nga qyteti e me fytyrë nga ullishta u hodh si pa të keq në mes të*

²³ M. Samara, *Parafjalët ...*, vep. e cit., f. 36

²⁴ M. Çeliku ka bërë grupimin strukturor të lokucioneve emërore, duke dalluar tipin *parafjalë + ish - emër* dhe tipin *parafjalë + ish - emër + parafjalë* (*Lokucionet parafjalore ...*, art. i cit., f. 235 – 239).

²⁵ Shih për këtë grupim edhe M. Samara, *Parafjalët ...*, vep. e cit., f. 89, 92.

rrugës, **në mes** të gjermanëve. Edhe Dulla zakonisht gjatë mbrëmjeve të verës shtrihet më kurriz **në buzë** të sofrës dhe numëronte trarët e hajatit ose fluturat që vërtiteshin rreth llambës së elektrikut dhe përsëri trarët... "Siç duket, fizionomia ime, që më parë ishte fshehur prapa gazetës, posa i doli karshi, i imponua, i mposhti dhe ata do t'i kenë dhënë karar që s' ka hije të bisedojnë **në sy** të një njeriu të tillë ca dokrra dashurie!" - tha me vete ai.

Emri te këto lokucione ka humbur kuptimin leksikor dhe funksionin sintaksor. Kjo vihet re edhe kur përdoret në të shquarën. P. sh. *Kjo vazhdimësi pushtetarësh e forcoi kaq shumë pozitën **në sytë** e popullit, sa, edhe kur njeri apo tjetri anëtar i familjes ndëshkohej, pasardhësi i tyre zgjidhej pothuajse gjithmonë nga fisi i tyre.*

Të tilla janë edhe lokucionet: *në të djathtë, në të majtë*. P. sh. *Petriti u ngrit, hodhi një vështrim **në të majtë** e **në të djathtë** të skelës së kanalit, pastaj një vështrim te njeriu shukur diku në errësirë.*

Në disa raste emri që vjen pas këtyre lokucioneve, del pa nyjë. P. sh. - *Ta kam thënë që ky vendi i ngushtë **në mes** tri plevicave është tamam për luftë.*

Lokucioni *në prani* është formuar nga parafjala *në* dhe një emër abstrakt me kuptim të drejtpërdrejtë. P. sh. *Ana u ndje e emocionuar, pasi qe hera e parë që këndonte **në prani** të një publiku kaq të madh.*

b. Lokucionet e formuara nga *parafjalë + emër i prejardhur* janë në numër të kufizuar. Emri i këtyre lokucioneve ka temë prodhuese parafjalën sinonime. Të tilla janë: *në afërsi* (afër), *në largësi* (larg), *në thellësi* (thellë), *në brendësi* (brenda) etj. P. sh. *Italianët kishin lidhur kontratë me një sipërmarrje private për tharjen e kënetave **në afërsi** të Vlorës.*

c. Lokucionet e formuara nga *parafjalë + emër abstrakt* kanë sinonime parafjalën e lokucionit. Të tilla përmendim: *për nevojë* (për), *për nder* (për), *për inat* (për), *për hir* (për), *për faj* (për), *për punë* (për), *për hatër* (për), *nga ana* (nga) etj. P. sh. - *Ndofta do zoti e më shkon mbarë, **për inat** të Anifesë e të Bilos më tepër, të ble shtëpi e ara mu aty në të hyrë të Tiranës... Ai e kishte plotësisht të qartë se gjithë këto përgatitje ishin bërë **për nder** të tij. Gjatë pushimeve ne shkonim një e dy herë tek Toptanajt në Tiranë, farefisi ynë **nga ana** e nënës. Ajo iu duk mjaft e habitshme, interesante dhe pak zbavitëse. E habitshme sepse përngjiste me një histori tjetër. Interesante sepse... ndofta **për hir** të po atij përngjasimi. - Mos mendo t'ua prishësh zemrën të rinjve **për hatër** të Beqir Agës.*

ç. Lokucione të formuara nga *parafjalë + emër abstrakt*, që kanë sinonime parafjalë pa asnjë lloj lidhjeje me elementet e lokucionit, si: *në emër* (për), *në gjurmë* (pas), *në punë* (për), *në shërbim* (për), *me përjashtim* (përveç), *me rastin* (për), *në mungesë* (pa), *në sajë* (falë), *në të mirë* (për), *në frymën* (sipas), *në bazë* (sipas) etj. P. sh. *Puna është se ne i urrejmë armiqtë **në emër** të dritës, kurse ata na*

urrejnë ne vetëm **në emër** të errësirës. **Me përjashtim** të fjetjes, krejt jeta shtëpiake kishte vërshuar drejt kësaj kthine të vetme, dhomës së bukës. **Me rastin** e festës familja e Bujarit i shumëfishonte ushqimet dhe përgatiste edhe disa lloj gjellësh enkas për festë. Për t'i ngjeshur më mirë dërrasat e vozës atij i nevojitej rreth hekuri, por **në mungesë** të tij përdori një rreth druri. - Si je, Bude? - **Në sajë** të zotit dhe tënden, mirë do të jemi. Me këto projekte gjeniale **në të mirë** të Shqipërisë, edhe më vonë kam pasur të njëjtin fat: i kam paguar si frëngu pulën, si i thonë një fjale.

d. Lokucione të formuara nga *parafjalë + emër i prejardhur*, që ka temë prodhuese foljen e lokucionit sinonim. Struktura e këtij të fundit është ndërtuar nga një pjesore, e ndjekur nga parafjala, si: *nën drejtimin* (drejtuar nga), *nën udhëheqjen* (udhëhequr nga) etj. P. sh. *Vetëm më vonë, nën drejtimin* e mësuesit të mrekullueshëm, prof. Jusuf Shpuza efendiu, arrita të kuptoj vlerën dhe rëndësinë e fesë.

Lokucionet *në zbatim*, *nën kujdesin* etj. janë formuar nga emra të prejardhur nga foljet sinonime të lokucionit. P. sh. **Në zbatim** të urdhrit të Madhërisë së tij, sekretariati i oborrit ka nderin të kumtojë me këtë qarkore lajmin e mëposhtëm. Sa të mrekullueshme ishin ato çaste kur unë, mbyllur në dhomën e gjumit, **nën kujdesin** e disa shërbëtoreve, mund të luaja e të harbohesha sa të ma donte zemra.

2. 2. Lokucionet e formuara nga një parafjalë dhe një përemër janë mjaft të rralla. Këtu do të sjellim lokucionin *me gjithë*, që është formuar nga parafjala *me* dhe përemri *gjithë*. Përemri e ka humbur kuptimin leksikor dhe funksionin si përcaktor. Edhe parafja është desemantizuar. E gjithë struktura ka një shkallë të lartë gramatikalizimi.²⁶ P. sh. *Shifrat e gjenin rrugën të sigurta midis kaosit, me gjithë* motin e keq mbi gjithë kontinentin. **Me gjithë** të ftohtit, atij i duhej që të përmbliidhte të gjitha energjitë për të mos u përgjumur asnjë çast. Kjo strukturë del edhe si një fjalë e vetme, që do të thotë se po shkon drejt njëfjalësimi. P. sh. **Megjithë** arsimimin e tij, **megjithë** mënyrën e tij autoritare të jetesës, në të dhe në mendësinë e tij, ai kishte ruajtur tipare që zbulonin në mënyrë të padiskutueshme prejardhjen e mirëfilltë shqiptare.

2. 3. Lokucionet e formuara nga një folje dhe një parafjalë përbëjnë grup të vogël. Folja del në formën e pjesores.²⁷ Të tilla janë: *lidhur me*, *ballafaquar me*, *barazuar me*, *krahasuar me*, *bashkërenduar me*, *shoqëruar me*, *drejtuar nga*,

²⁶ Shih edhe M. Samara, *Parafjalët ...*, vep. e cit., f. 87

²⁷ M. Çeliku pranon si parafjalë foljore strukturën *lidhur me* (*Lokucionet parafjalore ...*, art. i cit., f. 223). Ky lokucion është pasqyruar edhe në G I (f.386). M. Samara merr lokucione me rezerva strukturat *ngjitur me*, *puthitur me*, *mbështetur në*, sepse semantika e pjesores është mjaft e lirë dhe e pavarur (*Parafjalët...*, vep. e cit., f. 96). Edhe ne mendojmë se këto struktura kanë shkallë të ulët gramatikalizimi. Pjesorja e ruan funksionin e saj sintaksor (si përcaktor, përcaktor kallëzuesor etj.). Janë struktura drejt leksikalizimit.

mbështetur në etj. P. sh. *Pemët e sapombjella përgjatë rrugëve të qytetit ishin mjaft të ulëta, krahastuar me ato pak pemë të vjetra, të cilat ende nuk ishin hequr.*

2. 4. Lokucionet e formuara nga një ndajfolje dhe një parafjalë janë në numër më të paktë. Ndajfolja zakonisht ka shërbyer si temë fjalëformuese për ndajfoljen e lokucionit sinonim. Të tilla janë: *pingul me, pingulthi me, përkundër me, përkundrejt me, rrafsh me, shkaras me, shkarazi me, përkitas me, përkitazi me, ballas me, ballazi me, baras me, barazi me, barazisht me, bashkas me, bashkërisht me, bashkë me, brenda në, lart nga, poshtë nga, sipër nga, ndryshe nga* etj. P. sh. **Pingul me** sipërfaqen e liqenit, shkëmbinjtë me faqet e prera si me thikë krijonin një peizazh të veçantë. Ndërsa sot edhe rrënojat e vjetra të këtij vendi janë bërë **rrafsh me** tokën dhe duhej një forcë e madhe përfytyrimi për të marrë me mend që dikur këtu kishte qenë një qendër e rëndësishme kulture dhe tregtie. Turra e letrave u përfshi sakaq nga flakët, e **bashkë me** të edhe perdja. **Brenda në** kabinë ishte ngrohtë dhe unë u ndjeva mirë. **Poshtë nga** livadhet dëgjohehin krisma të rralla.

II. Lokucionet me strukturë me më shumë se dy fjalë

Janë në numër më të vogël se lokucionet dyfjalëshe. Struktura e këtyre lokucioneve është e formuar nga një fjalë shënuese dhe dy parafjalë të ndryshme. Ato përbëjnë grupe të ndryshme.

1. Lokucione të formuara nga dy parafjalë dhe një emër. Janë në numër relativisht të madh. Emri mund të jetë i parmë ose i prejardhur. Ai qëndron në mes të dy parafjalëve.

a. Lokucionet e formuara nga *parafjalë + emër i parmë + parafjalë* janë mjaft të rralla. Të tilla janë lokucionet *në raport me, në harmoni me* etj., të formuara nga parafjala *në* dhe një emër abstrakt i parmë i ndjekur nga parafjala *me*. P. sh. **Në raport me** ditët e tjera, dita e fundit e qëndrimit në fshat Zakës iu sikur kaloi më shpejt.

b. Lokucionet e formuara nga *parafjalë + emër i prejardhur + parafjalë* janë grup më i madh. Emrat janë me prejardhje foljore dhe i ruajnë lidhjet me foljet e orgjinës. Pjesa më e madhe e këtyre foljeve ka formuar lokucione me një parafjalë (grupi I, 4). Të tillë janë: *në dallim nga, në dallim me, në ndryshim nga, në lidhje me, në përputhje me, në pajtim me, në bashkëpunim me, në marrëveshje me, në kordinim me, në krahasim me, në kundërshtim me, në bashkëmarrëdhënie me, në bashkëshoqërim me, në bashkërendim me, në bashkëveprim me, në bashkëvajtje me, në marrëdhënie me* etj. P. sh. - Çfarë? - pyeti djaloshti me triko të gjelbër. - **Në lidhje me** nikotinën ... me lëndët e ndryshme të tymit, - u ngatërrua pak njeriu me çantë. Duhej ngritur përsëri në këmbë një parlament i kontrollueshëm dhe **në përputhje me** kushtetutën, për të ndarë përgjegjësinë dhe për t'u krijuar kështu një ventil synimeve tashmë të zgjuara për liri. Kjo kishte qenë dhe mbetej një nga provincat gjithmonë me një nivel më të lartë, **në krahasim me** shumë pjesë të tjera të perandorisë, një vend me energji të pashtershme materiale dhe shpirtërore. Pasi e kishin pushtuar më 23 prill 1913 **në kundërshtim me**

vendimet e Konferencës së Londrës, malazestë nuk donin ta lironin qytetin. Disa shënime janë marrë nga dorëshkrimi që kam shkruar në vitin 1965, **në bashkëpunim me** të ndjerën baroneshë Ameli fon Godin (Amelie von Godin). Ai dinte të gjente gjuhën më të drejtë e më të saktë **në marrëdhënie me** njerëzit, ndërkohë që unë jetoja në mjegullnajat e fantazisë sime.

2. Lokucione të formuara me konversion.²⁸ Janë struktura të formuara nga lokucione me vlerën e një ndajfoljeje, si: *tej e përtej, rreth e rreth, rreth e rrotull, krah për krah, anë e përqark, anë e qark* etj. P. sh. *Shelgjet tej e përtej lumit i përngjanin një gardhi të çuditshëm dredha - dredha. Kur u kthyen atë mbrëmje Llazi me Karillën, që kishin shkuar pa gdhirë për dru në Pyllin Mbret, u çuditën fort nga heshtja e pakohë që pati rënë bashkë me muzgun rreth e rreth kasolleve. Ata tani duhet të luftonin krah për krah tyre kundër armikut shekullor sllav.*

3. Lokucione të formuara nga një lokucion dhe një parafjalë. Janë grup i pasur. Ato kanë në strukturë një lokucion me orgjinë ndajfoljore dhe parafjalën me. Të tilla janë: *ballë për ballë me, drejt për drejt me, sy ndër sy me, krah për krah me* etj. P. sh. *Çimi ishte mbështetur mbi etazherin e vogël. Një portret ishte varur te muri ballë për ballë me të. E merrja me mend se sa do të habiteshin kur të më shihnin krah për krah me një burrë të veshur me fustanellë shqiptare.*

B. KLASIFIKIMI SIPAS VLERËS SEMANTIKE

Lokucionet me vlerën e një parafjale dallojnë nga lokucionet me vlerën e një pjese tjetër të ligjëratës edhe nga barazvlershmëria semantike. Këto lokucione janë të larmishme edhe në këtë aspekt. Ato sinonimizojnë me një parafjalë a lokucion ose me disa të tilla. Këtu dallohen:

1. Lokucione me vlerën kuptimore të një parafjale. Janë të shumta. Të tilla përmendim: *në cep - cep, në fund - fund, në buzë - buzë, në krah - krah, në ballë - ballë, në anë - anë, me përjashtim - përveç* etj. P. sh. *Sytë e tij diçka dalluan në buzë të zallit, në rrëzë të malit, tamam te vendi i staneve të berbatasteve. Nga shtëpitë e djegura buzë rrugës dilte ende tym. Fshati ishte i vogël dhe shtrihej rrëzë kodrës me shkurre. Edhe për ata, si për ne, vlenin të njëjtat rregulla, me përjashtim të iranianaëve, të cilët në vend të festit të kuq, mbanin kolbakun persian. Përveç asaj radhe, asnjëherë ajo nuk ishte shprehur aq ashpër dhe në mënyrë aq brutale.*

2. Lokucione me vlerën kuptimore të një lokucioni. Të tillë janë: *në ballafaqim me - ballafaquar me, në bashkërendim me - bashkërenduar me, në shoqërim me - shoqëruar me, në krahasim me - krahasuar me, në dallim me - ndryshe nga, nën drejtimin - drejtuar nga* etj. P. sh. *Në krahasim me sipërfaqen e*

²⁸ Është një nga tipat e pasqyruar edhe në GA I (f. 388).

getë të liqenit, fytyra e xha Naimit, me mustaqe e flokë të thinjur, e çarë nga rrudha të thella e me sy të vagëlluar, dukej sikur ishte aty për të treguar edhe një herë rininë e bukurinë e natyrës që shtrihej anekënd me ngjyrat e saj të shumta. Turqit, **në dallim me** evropianët, kanë një kuptim të lartë për besnikërinë, miqësinë dhe mirënjohjen. Ata ishin më të mëdhenj se ne dhe përgatiteshin për në Lice **nën drejtimin** e mësuesit të tyre francez.

3. Lokucione me vlerën kuptimore të dy a më shumë parafjalëve. Nuk përbëjnë numër të madh. Një lokucion mund të sinonimizojë me parafjalë të ndryshme në një a disa kuptime.

- lokucioni në mes sinonimizon:

- Me parafjalën *mes* në kuptimin e të treguarit të pikës kulmore të zhvillimit të veprimit. P. sh. **Në mes** të asaj heshtjeje që sundonte gjatë luftës në Hollandë, shpërthejnë papritmas në rrugë gjashtë krisma të thata.

- Me parafjalën *midis* në kuptimin e të treguarit të vendit a të hapsirës që ndodhet në mes të dy gjërave ose të të treguarit të një vendi a pike të barazlartuar nga skajet a kufijtë e diçkaje. P. sh. *Në lindje, mbi kreshtën e lartë të Tomorrit dhe mbi malet e buta të Sulovës filloi të pritej e të vijëzohej nëpër një vetull drite të zbehtë kufiri në mes të tokës e të qiellit, përzier e bërë një gjer atëhere nga muzgu. Ai ishte plakur para kohe, duke u hequr zvarrë në mes të haremëve të tij me njëqind gra dhe oborrit të sulltanit dhe sigurisht reumatizmi bënte kërdinë në të. Karilla, më këmbë, në mes të asaj kasolleje mbushur me errësirë, tym e rënkime, rrotullonte sytë e zgurdulluar dhe kërkonte armët e gjuetisë. Në mes tyre ishte trimëresha e trimëreshave, Mara e Katorrajve, që ecte e fundit...*

Ka raste kur brenda një fjalie përdoren lokucioni dhe parafjala sinonime. P. sh. *Megjithatë, drejtorin sikur nuk e shqetësonin të gjitha këto që thamë, sikur nuk e shqetësonin as porositë që po u jepte, por diçka tjetër, diçka që qëndronte mbi porositë, diçka që varej diku pezull në mes të dy shoferëve - pikërisht në mes të të dyve - se edhe drejtori, pasi e kalonte vështrimin sa nga njëri te tjetri, më në fund i fiksonte sytë në një zonë asnjëse, dhe kjo zonë asnjëse ndodhej aty, midis dy shoferëve, midis supeve të tyre dhe, nga mënyra se si ai i shikonte, kuptohej se kishte diçka më të rëndësishme se vetë porositë dhe detyra që po u ngarkonte.*

- Me parafjalën *ndërmjet* në kuptimin e të treguarit të vendit që zë diçka në mes të të tjerëve; të të treguarit të marrëdhënieve të anasjellta midis palëve ose të të krahasuarit në mes të dy a më shumë frymorëve a sendeve. P. sh. *Vajza u trishtua në mes të këtyre drurëve, ndjeu njëfarë ankthi që s'e kishte ndjerë herë tjetër, errësira e përpiu fare. Sa për të voglën, që kishte lindur atje në han, në shtëpi të botës e në mes të jabanxhinjve, ajo s'kuptonte dot ndryshimin në mes të thithkës së*

gjirit të nënës, që s'ë vuri dot asnjëherë në buzë dhe të thithkës së biberonit, që e mbante tërë ditën në gojë.

- Me parafjalën *në* në kuptimin e të treguarit të punës, grupit, organizatës ku është dikush a diçka. P. sh. *Ku qëndron ana jokomike, madje dramatike e problemeve të shoqërisë sonë në mes të një shoqërie që mbështetej në mashtrimin dhe parrullat boshe?*

- Me parafjalën *ndër* në kuptimin e të treguarit të vendit në mes të të tjerëve ose në rrethin e tyre. P. sh. *Ishte në atë moshë kur, sa i guximshëm në mes shokësh, aq i turpshëm e i ngathët bëhet një djalë në prani të femrave.*

• Shprehja *në sy* sinonimizon:

- Me parafjalën *sy*, *faqe* si dublet.

- Me parafjalët *para*, *përpara* në kuptimin e të treguarit të personit a grupit të personave, para të cilëve ndodh një veprim a ballafaqohet diçka. P. sh. - *Ah, Sanije, Sanije! M'u qepën gratë e fshatit e më turpëruan në sy të njerëzve të mi për punë të ... Dhe s'ë mbaroi dot fjalën, se e mbytën lotët.*

Në këtë grup përfshihet edhe lokucioni *në cep* - cep, përcep etj.

4. Lokucione me vlerën kuptimore të dy a më shumë lokucioneve parafjalore. Lokucionet e këtij grupi janë të pakta. Të tilla dalin njësitë që kanë në strukturë një emër foljor në mes të dy parafjalëve. Këto shprehje sinonimizojnë edhe me shprehje të formuara nga pjesorja e foljes dhe një parafjalë.

• Lokucioni *në dallim nga* sinonimizon:

- Me lokucionet *në dallim me*,²⁹ *ndryshe nga*, *dalluar nga* si dublete. P. sh. *Shprehja derë e madhe dhe oxhak i lartë vijnë nga kohë të lashta dhe rreken të tregojnë një shtëpi zotërinjsh, në dallim me kasollën ose kullën që kishin një derë të vogël dhe ishin pa oxhak.*

- Me lokucionin *në ndryshim nga* në kuptimin e dallimit midis dy frymorëve, dy sendeve a dukurive. P. sh. *Në këto perandori gjejmë pasardhësit e pushtuesve, që kanë të drejtat dhe privilegjet e fituara me pushtimet e paraardhësve të tyre dhe si pasojë janë klasë e privilegjuar në ndryshim nga ata që duhet të mbajnë në kurriz shtypjen e tyre.*

• Lokucioni *në raport me* sinonimizon:

- Me lokucionin *në krahasim me* në kuptimin e kushtit. P. sh. *Por kjo, prapëseprapë, ishte lodër kalamajsh në raport me katrahurën gazmore në kalanë e Kaninës.*

- Me lokucionin *në lidhje me* në kuptimin e lidhjeve të ndërsjellta ndërmjet sendeve, dukurive a veprimeve të ndryshme. P. sh. *Ishte më i qetë, më i duruar dhe më i përmbajtur në raport me të vëllanë.*

• Lokucioni *në përfundim* sinonimizon:

²⁹ Duke u nisur nga barazvlerësi *dallur nga*, mendojmë që të përdoret lokucioni *në dallim nga* dhe jo në *dallim me*. P. sh. *Në dallim nga të tjerët, ai nuk e vinte rakinë në buzë në asnjë rast, edhe sepse kishte marrë një këshillë nga mjeku.*

- Me lokucionet në mbarim, në mbyllje, në fund. P. sh. *Në përfundim të këtij procesi historik ju do të detyroheni të vrisni njeri - tjetrin dhe populli do të mbytet në gjak.*

5. Lokucione me vlerën kuptimore të parafjalëve dhe shprehjeve me vlerë parafjale. Përbëjnë numër relativisht të madh. Brenda këtij grupi dallojmë disa nëngrupe:

a. *Lokucionet me vlerën e një parafjale dhe të një lokucioni janë në numër të paktë. Për ilustrim po sjellim lokucionin në dëm, i cili sinonimizon:*

- Me parafjalën *kundër* në kuptimin e të luftuarit, të të dëmtuarit të dikujt a diçkaje. P. sh. *Mersin Dema zhvilloi një propagandë të madhe në popull në dëm të kësaj iniciative serbe, aq sa ajo dështoi tërësisht.*

- Me shprehjen *në kurriz* në kuptimin e së keqes që i vjen dikujt a diçkaje nga një shkak i caktuar. P. sh. *E pse duhet të besojmë që ata janë të pazotë e të mos themi, ta zemë, që ju... mund të livadhisni në dëm të të tjerëve sipas oreksit.*

b. *Lokucionet me vlerën e disa parafjalëve dhe të një lokucioni. Janë në numër të paktë.*

• *Shprehja në drejtim* sinonimizon:

- Me parafjalët *për, nga dhe në*, kur përdoret me kuptim kufizimi.³⁰ P. sh. *Lola shihte se në*

krahasim me vitin e kaluar, kërkesat këtë vit ishin më të shumta, si në drejtim të përparimit, ashtu dhe për sjelljen brenda dhe jashtë shkollës.

- Me parafjalën *drejt*, kur përdoret me kuptimin e drejtimit të lëvizjes.³¹ P. sh. *Gjin Bua Shpata nga Arta (viti 1400) i shtriu kufijtë e sundimit të tij në drejtim të jugut, përtej Etolisë dhe Akarnanisë.*

- Me lokucionin *në adresë* në kuptimin e adresimit drejt dikujt, në lidhje me dikë. P. sh. *Britmat dhe sharjet në drejtim të Hejbetulla hanëmit u bënë të padurueshme.*

Të tilla janë edhe lokucionet dublete që kanë lidhje nga prejardhja me lokucione sinonime. Janë lokucione që kanë element kryesor një ndajfolje, e cila ka shërbyer si temë fjalëformuese për ndajfoljen e lokucionit sinonim, si: *paralel me - paralel, paralelisht, paralelisht me; tërthor me - tërthor, tërthorazi, tërthorazi me; shkaras me - shkaras, shkarazi, shkarazi me; drejt me - drejt, drejtpërdrejt, drejtpërdrejt me etj.* P. sh. *Tri pemët e fundit i mbolli larg të tjerave, paralel me anën e murit të banesës. Ai e ngulte shtagën shkaras me fundin e kanalit, kërrusej e kthehej përsëri aty ku kishte qenë, duke e bërë barkën që kishte nën vete të ecte përpara.*

c. *Lokucione sinonime me një parafjalë dhe disa lokucione me vlerë parafjale.* Përbëjnë nëngrup të pasur.

³⁰ Ky përdorim është konsideruar në kundërshtim me normën e sotme të gjuhës letrare (Shih edhe *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, 1976, f. 185).

³¹ M. Çeliku pranon që parafjala (lokucioni - H. Xh) *në drejtim* zëvendëson parafjalët *nga, në dhe drejt*, të cilat kanë kuptime të veçanta, të ndryshme, por nuk pranon që ky lokucion të jetë dublet me parafjalën *drejt*. (*Lokucionet parafjalore ...*, art. i cit., f. 221).

- Lokucioni *në vend* sinonimizon:

- Me parafjalën *për* në kuptimin e të treguarit të personit a diçkaje, në vend të të cilit vepron dikush a përdoret diçka. P. sh. *Po natyra bujare sikur kishte dashur t'i shpërblente banorët me diçka tjetër dhe, në vend të tokës me vlagë, u kish falur pyllin e dendur, të begatshëm dhe të pashoq nga bukuria.*

- Me lokucionin *në këmbë* në kuptimin e vendit, pozitës në shoqëri a në një grup të caktuar njerëzish. P. sh. *Këtë radhë Meti mendonte se respekti për të do të shtohet, pasi po shkonte te miqtë në vend të të atit.*

- Me lokucionin *në këmbim* në kuptimin e zëvendësimit, të përdorimit të diçkaje për diçka tjetër. P. sh. *Ministria e Jashtme, me ndërmjetësinë e ambasadës spanjolle në Romë, ofroi në vend të saj, lirimim e tre italianëve të rëndësishëm që mbaheshin në Austri.*

- Lokucioni *në fushën* sinonimizon:

- Me parafjalën *në* në kuptimin e të treguarit të vendit, hapsirës, fushës, ku kryhet një veprimtari a ndodh diçka. P. sh. *Në fushën e politikës së jashtme kanë ndodhur dy - tri ngjarje për të ardhur keq.*

- Me lokucionin *në lëmin, në sferën* në kuptimin e fushës së një veprimtarie njerëzore. P. sh. *Kujtimi nuk është vetëm projektues i talentuar në fushën e hidroteknikës, por dhe njeri i thjeshtë.*

- Lokucioni *në bazë* sinonimizon:

- Me parafjalën *sipas* me kuptimin e të mbështeturit a të të nisurit nga diku a diçka ose me kuptimin e të treguarit të njësisë, shkallës a rangut për zhvillimin e një veprimtarie. P. sh. *Marrëveshja me shoqërinë "Helenizmos"... flet për... mbrojtjen e interesave politike në bazë të reciprocitetit e të fqinjësisë së mirë. Në bazë të programit të përgatitur që më parë prej komitetit të pritjes, ... arritja e Ismail Qemal Beut mori pamjen e një manifestimi patriotik madhështor. Aktiviteti i nesërm do të kryhet në bazë shkolle, prandaj edhe kërkohej vëmendje e përqëndrim më i madh.*

- Me lokucionin *në përputhje me, në pajtim me* në kuptimin e barazisë a përshtatjes. P. sh. *Në emër të popullsisë së kazave, që i binden dhe në bazë të vendimeve të marra më parë, vendosëm fillimin e një kryengritjeje të re kundër kësaj qeverie tradhtare.*

- Lokucioni *në lidhje me* sinonimizon:

- Me lokucionin *në bashkëvajtje me* në kuptimin e të përdorurit ose të lidhurit me dikë a diçka. P. sh. *Shprehja në mes në lidhje me emrat në rasën rrjedhore, d.m.th. me emrat me mbaresën - sh, përdoret rrallë.*

- Me lokucionin *lidhur me* dhe me parafjalën *për* në kuptimin e togut për sa i përket. P. sh. *Në lidhje me këto të drejta dhe detyra, do t'ju jap më poshtë një shembull që nuk duhet të kishte vend në shoqërinë tonë. Unë parashtrova me këmbëngulje edhe mendimin në lidhje me vendimet e fshehta që kishin marrë ambasadorët e të tri Fuqive të Mëdha.*

Në këtë grup përfshihen edhe: *bashkë me*, që sinonimizon me parafjalën *me* dhe me lokucionet *tok me, së bashku me, në bashkëpunim me, në marrëveshje me, në kordinim me, kordinuar me, në bashkëmarrëdhënie me, në bashkëshoqërim me,*

*në bashkërendim me, në bashkëveprim me, në bashkëvajtje me, me gjithë; në dobi, që sinonimizon me parafjalën për dhe me lokucionet në favor, në interes, në përfitim, në përkrahje, në ndihmë, në të mirë, në shërbim, në mbrojtje, për llogari etj. P. sh. Pastaj hanim drekë **bashkë me** të tre mësuesit tanë. **Bashkë me** hallin, Samiut i duhej të përballonte edhe fjalët e thashethemexhinjve të fshatit. Dëshironim që tabloja e atyre kohëve dhe ngjarjeve shumë interesante që unë kisha përjetuar, të rilindte dhe të ruhej **në të mirë** dhe **në dobi** të brezave të ardhshëm. Dihet se Traktati i Shën Stefanit ... përçau helenizmin dhe gëlltiti Shqipërinë **në dobi** të racave sllave.*

ç. Lokucione sinonime me disa parafjalë dhe disa lokucione me vlerë parafjale. Janë të shumta. Këto lokucione janë dyfjalëshe ose trifjalëshe. Fjala shënuese e tyre është një emër i parmë a i prejardhur ose një ndajfolje a lokucion ndajfoljor. Të tilla përmendim: *me anë* - me, nëpërmjet, në sajë, me ndihmën; *ballë për ballë me* - ballë për ballë, përballë, kundrejt, përkundrejt, kundruall, përkundruall, përballë me, kundrejt me, përkundrejt me, kundruall me, përkundruall me; *përkrah me* - përkrah, krah, bri, përbri, krah për krah, krahas, krah me, bri me, përbri me, krah për krah me, krahas me; *për shkak* - për, nga, nga puna, për punë, për punën, nga shkak, për shkakun, për faj, për arsye, për hir etj. P. sh. *Shqipëria dhe shqiptarët ishin për mua prodhime të fantazisë sime optimiste: një vend dhe një popull i mrekullueshëm, që mund të kenë edhe ndonjë cen të vogël, por edhe këtë për faj o për shkak të të tjerëve. Unë hapa vrik dritaren dhe u ndodha ballë për ballë me fytyrën e bukur të një djaloshi pesëmbëdhjetë - gjashtëmbëdhjetëvjeçar. Nuk nguroj të them se, sido që të përfundojë armiqësia midis këtyre dy fuqive të mëdha, me anë të luftës ose me anë të kompromisit, pasojat do të jenë të këqija, në mos tronditëse për perandorinë dhe për kalifatin ...* Lokucionet me vlerë parafjale janë në numër më të madh se numri i parafjalëve. Ky numër, sipas M. Samarës, është rritur për të shmangur poliseminë të disa parafjalë, si dhe për shkak të zgjerimit të aktivitetit të emrave, një pjesë e mirë e të cilëve janë desemantizuar dhe janë bërë elemente të strukturës së këtyre lokucioneve.³² Nga struktura, këto lokucione nuk janë togfjalëshe, por ndërtime ndërtime dyfjalëshe ose shumëfjalëshe. Numri i tyre i madh dhe larmishëmria semantike kërkojnë studime të mëtejshme për identifikimin e plotë dhe pasqyrimin e tyre në gramatika dhe në fjalorët e shqipes.

³² M. Samara, *Parafjalët...*, vep. e cit., f. 36

MEMLI KRASNIQI

KRIJIMI I SHTETIT SERB DHE LINDJA E PROJEKTIT “CZARTORYSKI”

Abstract: Me Paqen e Bukureshtit të vitit 1812 të nënshkruar ndërmjet Perandorisë Ruse dhe “Portës së Lartë”, përpos të tjerash garantohej edhe autonomia për Serbinë, çka mjerisht paraqiste fillimin e dobësimit të rolit të shqiptarëve dhe defaktorizimit të tyre në Ballkan. Në të vërtetë, shqiptarët, si popullsia në masë e islamizuar, tani në shekullin e XIX me fillimin e procesit të zhbërjes së kontrolluar të Perandorisë Osmane, filluan të konsiderohen nga evropianët si një element i huaj, qëndrim ky që do të ndihmojë në ligjësimin e aspiratave territoriale të shteteve të reja nacionaliste të Serbisë dhe të Greqisë kundrejt hapësirave të banuara me shqiptarë. Pasi që Polonia ishte copëtuar ndërmjet Ruisë cariste dhe Prusisë, atëherë patriotëve polakë u lindi ideja e cila konsistonte në shfrytëzimin e “problemit lindor” si formë për të jetësuar Poloninë e pavarur. Në të vërtetë ata kishin ardhur në përfundim se Perandoria Ruse dhe ajo Austriake planifikonin ndarjen e pjesës Evropiane të Perandorisë Osmane, ashtu siç kishin bërë më parë me Poloninë. Në këtë rast emigrantët polakë planifikonin krijimin e një shteti të madh të sllavëve të jugut që si bërthamë do të kishte Serbinë, dhe e cila në politikën e jashtme do të mbështetej në Francën dhe Britaninë e Madhe. Pra, aty në Ballkan, planifikoheshin rrëzimi i tri perandorive, asaj Austriake, Ruse dhe Osmane, nga gërmadhat e të cilave do të ngriheshin Polonia, Çekosllovakia dhe Serbia e Madhe. Përpilues i këtij projekti famëkeq për shqiptarët ishte Princi polak dhe ish-Ministri i Punëve të Jashtme të Ruisë, Czartoryski.

Në fillim të shek. XIX luftërat e Napoleon Bonapartës kishin sjellë në arenën botërore dy çështje. E para nga këto ishin, që liritë dhe të drejtat qytetare për njësinë e re shtetërore identifikoheshin me kombin, dhe e dyta që ato sollën në shesh, që edhe struktura e vjetër dhe në prag të shembjes të Perandorisë Osmane. Këto vlera të reja dhe moderne evropiane do të fillojnë të bëhen ideale edhe të popullsisë të krishtera që jetonin ende në Perandorinë Osmane, por njëkohësisht u bënë edhe shkas i përpjekjeve të elitës sunduese osmane për të reformuar në rend të parë ushtrinë e pafuqishme jeniçere. Kjo dobësi e Perandorisë Osmane aq shumë e evidente në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të atij XIX, nuk kishte si të mos u binte në sy Fuqive Evropiane, e në rend të parë Ruisë cariste. Kështu perandoresha ruse Katarina II përpiloi një plan më të pranueshëm për fuqitë evropiane. Projekti që njihej si “Projekti Grek” u përpilua më 1782 dhe parashikonte rivendosjen e një pjese evropiane të Perandorisë Osmane brenda krijimit të shtetit të “Dakisë” dhe

“Greqisë së madhe” me kryeqytet Konstantinopolin e dikurshëm.¹ Ndërsa është shumë domethënëse se po në gjysmën e parë të shekullit XIX, më saktësisht më 1812, në një gazetë franceze publikohet “Plani sekret i Petrit të Madh”. Ky plan në posedim të të cilit kishte ardhur një polak, në pikën e tetë të saj theksonte që Rusia duhej të zgjerohej në Veri deri në Baltik dhe në Jug deri në brigjet e Mesdheut, kurse pika e nëntë kërkonte që Konstantinopoli të bëhet pjesë e Ruisë dhe që të rivendoseshin bazat e forta tregtare të saj në Indi.² Pavarësisht origjinës së këtij dokumenti, fillimi i shekullit XIX do të shënonte fillimin e dominimit të Perandorisë Ruse dhe të realizimit të pjesërishëm të ambicieve të saj, por edhe vendosmërisë së Britanisë së Madhe për të mbrojtur pozitat e saj në Mesdhe.

Emigrantët polakë dhe Hotel Lamberti

Po në këtë frymë edhe nacionalisti polak Czartoryski, në cilësinë e Ministrit të Punëve të Jashtme të Perandorisë Ruse, kishte përpiluar një memorandum sekret, në të cilën pos federatës gjermane kishte paraparë themelimin e Polonisë së madhe, e cila do të përfshinte pjesë të Prusisë, ndërkaq Perandoria Osmane nuk do të cenohej njëherë për njëherë, por Rusia cariste do të pranohej si mbrojtëse e sllavëve.³ Hapi i parë në drejtim të realizimit të këtij plani qe pika e Marrëveshjes së Bukureshtit e vitit 1812 e nënshkruar ndërmjet Perandorisë Ruse dhe asaj Osmane, në të cilën parashikohej autonomia për serbët dhe ku për herë të parë ata do të përmenden në një marrëveshje ndërkombëtare⁴. Princi polak që ishte asokohe (1803-1804) edhe Ministër i Punëve të Jashtme të Ruisë cariste, mbi çështjen serbe u informua prej peshkopit ortodoks nga Hercegovina Arsenije Gagoviçit, si dhe nga Kryepeshkopi i serbëve të Austrisë Stevan Stratimiroviçit. Ky i fundit ministrit rus i kishte dorëzuar edhe një memorandum mbi krijimin e “një mbretërie sllavo-serbe” në krye me një princ rus.

Në një frymë të tillë pansllaviste vepronte edhe Czartoryski, i cili deri në kryengritjen e dështuar polake të vitit 1830 të gjithë sllavët i këshillonte që të orientohen dhe të mbështeten në Perandorinë Ruse, kurse pas kësaj periudhe ai fillon të propagandojë kundër influencës ruse.⁵ Qëllimi i patriotëve polakë konsistonte në shfrytëzimin e “problemit lindor” si formë për të jetësuar Poloninë e pavarur. Në të vërtetë ata kishin ardhur në përfundim se Perandoria Ruse dhe ajo Austriake planifikonin ndarjen e pjesës Evropiane të Perandorisë Osmane, ashtu siç kishin bërë më parë me Poloninë. Në këtë rast emigrantët polakë planifikonin krijimin e një shteti të madh të sllavëve të jugut që si bërthamë do të kishte Serbinë, dhe e cila në politikën e jashtme do të mbështetej në Francën dhe Britaninë e

¹ Ćedomir Popov, Istočno pitanje i srpska revolucija 1804-1918, Beograd 2008, f.29.

² Elizabeth (Wormely) Latimer, Russia and Turkye in the nineteenth century, Chicago 1895, f.89-90.

³ A.W.Ward, G.P.Gooch, The Cambridge History of British Foreign Policy 1783-1919, New York 1922, f.335.

⁴ СТАНОЈЕ СТАНОЈЕВИЋ, Историја Српскога Народа, Београд 1926, f.336.

⁵ Dusan T. Batakoviç, Ilija Garasanin's "Nacertanije", www.rastko.rs

Madhe. Pra, aty në Ballkan, planifikohej rrëzimi i tri perandorive, asaj Austriake, Ruse dhe Osmane, nga gërmadhat e të cilave do të ngriheshin Polonia, Çekosllovakia dhe Serbia e Madhe. Kjo nuk mund të bëhej ndryshe pos me një luftë shkatërrimtare çfarë që Lufta e Parë Botërore.

Natyrisht, pasi këto dy shtete ishin vende të demokracisë liberale, atëherë edhe Serbia do të duhej të kishte një rregullim të tillë kushtetues, pra liberal, çka do të bënte një dallim rrënjësor me regjimin autoritar të Rusisë cariste. Duke u nisur nga ky pikëvështrim, Princi Czartoryski më 1843 përpiloi një memorandum special të quajtur "Conseils sur la conduite à suivre par la Serbie" (Këshilla që duhen të ndiqen nga Serbia). Në përpilimin e këtij plani, që në pikëpamje afatgjate do të jetë i kobshëm për shqiptarët, Czartoryski u informua edhe nga poeti i njohur polak Adam Mickiewicz, i cili gjatë vitit 1841 si profesor i literaturës sllave në "College de France", kishte mbajtur një numër ligjëratash mbi Serbinë dhe krijimtarinë popullore serbe, ku natyrisht miti mbi Kosovën do të zinte vendin kryesor dhe me çka fillon edhe nga të huajt të përligjen pretendimet territoriale të serbëve ndaj vendbanimeve shqiptare.

Por pika kthesë në përpilimin e projektit të Czartoryskit qenë shkrimet e David Urquhart, ish- sekretarit të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Stamboll (1836-1837), i cili në shkrimet e tij të botuara në revistën *Portfolio* më 1833, kishte paraparë që Franca si kundërshtarë e Austrisë dhe Rusisë do të ishte fuqi që do t'i ndante këto dyja dhe do të mbushte vakuumin në Ballkan. Në librin e tij të publikuar më 1843 të titulluar *A Fragment of the History of Servia*, që sot vetëm pjesërisht është e ruajtur (fq.14), ai do të shkruante se roli i Serbisë në të ardhmen mund të ishte i njëjtë sikurse ai që ajo kishte në të kaluarën e saj, duke u bërë së bashku me Poloninë bastion kundër dominimit rus në Evropë dhe Ballkan.⁶ Në këto përfundime ai kishte ardhur edhe nga përshtypjet që kishte pasur gjatë udhëtimeve nëpër Perandorinë Osmane, ku në librin e tij "Turkey and it's resources" (Turqia dhe burimet e saj), do të shkruante për islamizimin në masë të shqiptarëve dhe pjesërisht të sllavëve, duke i identifikuar ata me turqit (osmanët-Memli), dhe për të cilët sikur edhe për serbët nuk ishte karakteristike organizimi i jetës qytetare.⁷

Këto pikëpamje të Urquhart-it i ndihmuan Czartoryskit të kuptonte se atdheu i tij Polonia (që duhet ritheksuar i takonte kulturës së krishtere katolike) mund ta fitonte lirinë vetëm duke braktisur flamurin e pansllavizmit aziatik të Rusisë dhe duke e ndërruar atë me flamurin e sllavizmit Evropian. Rrethanat historike në këtë proces përfshinë edhe Serbinë përkundër traditës së saj religjioze lindore, duke e bërë kështu këtë komb një nga më të fuqishmit në Evropën juglindore, dhe në anën tjetër hapësirën jetësore shqiptare, pre legjitime të elitave sunduese serbe. Për të jetësuar këtë plan ambicioz, pikësëpari duhej siguruar që mos të vinte deri te shpërbërja e parakohshme e Perandorisë Osmane, prandaj ajo

⁶ Dusan T.Batakoviç, Ilija Garasanin's "Nacertanije", në web faqen : www.rastko.rs

⁷ David Urquhart, Turkey and it's resources, London 1833, f.41.

nevojitej të reformohej duke mundësuar krijimin gradual të shteteve të reja ballkanike, një nga rolet e të cilave do të ishte edhe pengimi i hegjemonisë ruse. Po ashtu me ndihmën e Francës dhe të Britanisë së Madhe, Czartoryski kishte krijuar një rrjet që sipas standardeve të kohës sonë do të ishte një Organizatë Joqeveritare e quajtur “Rrjeti i Hotel Lambertit” me përfaqësuesit e saj në Stamboll, Romë e Beograd.

Mbështetja e dytë e programit nacional serb që edhe projekti i përfaqësuesit polak në Beograd Franc Zah-ut, i cili përpiloi memorandumun *Plan for Serbia's Slavic Policy*, në të cilën parashikohej forcimi i një sistemi liberal në Serbi, si formë rreth së cilës do të mbledheshin të gjithë sllavët e jugut. Si rezultat i gjithë kësaj që programi politik serb i Ilija Grashaninit i njohur si “Naçertania”, i cili bëri disa modifikime të programit fillestar, duke anashkaluar kërkesën për një shtet federativ të sllavëve të jugut dhe në vend të kësaj sipas tij duhej krijuar Serbia e Madhe⁸. Në gjithë këtë lojë të madhe të zhvilluar në prapaskenë, shqiptarët do të jenë ata që do të humbasin më së shumti, që pjesërisht që edhe rezultat i mospërfshirjes së tyre më masive në lëvizjen evropiane të emancipimit, mungesës së përkrahjes së ndonjë fuqie evropiane, por edhe jo largpamësisë së elitave sunduese osmane. Në anën tjetër, ishin shqiptarët ata të cilët morën pjesë aktive në luftërat çlirimtare të popujve të tjerë ballkanikë, si dhe ishin po ata që u bënë rezistence të fuqishme përpjekjeve të Portës për të centralizuar pushtetin duke eliminuar autonominë e tyre. Kështu, forcën kryesore kryengritëse të Tudor Vlladimireskut në Vllahi më 1821 e bënë shqiptarët,⁹ njëkohësisht edhe në kryengritjen greke për pavarësi (1821-1829) ishin shqiptarët ata të cilët me pjesëmarrjen e tyre masive dhe me udhëheqësit si Marko Boçari, Laskarina Bubulina, Foto Xhavela etj., kontribuan në fitimin e lirisë së popullit grek. Mjerisht, ishin po ata të cilët edhe luftuan për mbrojtjen e kësaj Perandorie, ngase tani në luftërat për çlirim kombëtar, rrethanat imponuan edhe elementin fetar, që më së paku u përgjigjej pikërisht shqiptarëve. Manipulimi me identitetin duke futur në këtë mes edhe religjionin krijoi jo pak probleme për shqiptarët gjatë gjithë shekullit XIX, duke u eliminuar kjo pengesë vetëm me krijimin e shtetit shqiptar.

Në vend të përfundimit

Në fund duhet thënë se Lëvizja Pansllaviste Evropiane, themelet e së cilës u vendosën që në dekadat e para të shekullit XIX, dhe e cila si qëllim të vetin kishte emancipimin e kombeve sllave sipas vlerave qytetëruese perëndimore, por njëkohësisht edhe duke mënjeluar ndikimin rus, pati si rezultat final krijimin e Polonisë, Çekosllovakisë dhe Jugosllavisë, shtete këto të cilat u përkrahën nga Franca dhe Britania e Madhe për aq kohë sa ato shërbenin si pengesë ndaj dominimit rus dhe më vonë të BRSS. Realizimi i projekteve të tilla të cilat shumë

⁸ Robert Allen Berry, Czartoryski and the Balkan policies of the Hotel Lambert (1832-1847), Indiana University, Ph.D., 1974, f.186.

¹¹ Ćedomir Popov, Istočno pitanje i srpska revolucija 1804-1918, Beograd 2008, f.63.

herë kishin karakter konspirativ, u bë në dëm të kombeve të tjera jo sllave siç ishin: shqiptarët, hungarezët dhe gjermanët. Me shembjen e sistemit socialist dhe dominimit të BRSS u humb edhe nevoja për ekzistencën e këtyre shteteve, si rrjedhojë ato u dezintegruan në njësi shtetërore kombëtare, që në rastin e Çekosllovakisë qe kjo një ndarje paqësore, ndërsa RSF e Jugosllavisë u shpërbë dhunshëm përpos të tjerash edhe për arsye të atij plani të vjetër të “Hotel Lambertit”, një pikë e së cilës parashikonte marrëveshjen e kroatëve dhe serbëve për ndarjen e Bosnjës, çka për fat të keq u realizua me marrëveshjen e Franjo Tugjmanit (Kryetarit të R. së Kroacisë) dhe Slobodan Millosheviqit (Kryetarit të R. së Serbisë) pothuaj 150 vjet më vonë.

Kombi që ishte viktima më e madhe e planit të emigrantëve polakë qenë shqiptarët, ngase duke manipuluar me historinë, territori i tyre u nda, ndërkaq shteti amë i mbetur për gati një shekull ishte në vazhdim i kërcënuar dhe i shtyrë për të siguruar ekzistencën e vet, por njëkohësisht edhe me ato pak mundësi që kishte, u mundua për të mbrojtur pjesën e mbetur të kombit jashtë kufijve të saj politikë. Kjo ndodhi vetëm atëherë kur në marrëdhëniet ndërkombëtare ndryshuan prioritetet dhe kur Serbia kishte humbur rolin e një “Tampon Zone”, dhe në kushte të reja përsëri Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe SHBA-të ishin ato që ndryshuan rrjedhën e historisë në Ballkan, por kësaj radhe ato u rreshtuan në anën e së drejtës, çka qe një fatmirësi për shqiptarët, ndërsa vetë serbët paguan çmimin e dezintegrimit, ashtu siç kishin kontribuar më herët në shembjen e Perandorive Osmane dhe Austro-hungareze duke u zgjeruar në kurriz të popujve të tjerë. Mjerisht për këto rrethana lehtësuese dhe favorizuese për shqiptarët u deshën të kalojnë pothuaj dy shekuj. Ndërsa sot në shekullin XXI kemi dy shtete shqiptare, ashtu siç patëm dikur dy pashallëqe të fuqishme (në fillim të shekullit XIX), por tani me identitet dhe shtetësi të pranuar ndërkombëtare. Atëherë u vonuam me fajin tonë dhe të tjerëve në ringritjen kombëtare dhe krijimin e shtetit kombëtar, ndërsa sot kur përsëri është një prioritet ekzistencial integrimi në BE jemi përsëri në bisht të procesit, duke pasur përsëri si rivalë Greqinë që është në BE dhe Serbinë që është pranë hyrjes në të, vende këto që do të përpiqen ashtu si gjatë shekullit XIX që Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia sa më gjatë të mbesin si shtete jofunksionale dhe problematike, të papërgatitura për të hyrë në Bashkësinë Evropiane, dhe ndoshta në kushte më të favorshme për to, do të kërkojnë një ndarje të re, gjithmonë duke arsyetuar se vetëm ashtu mund të ruhet paqja dhe stabiliteti në Ballkan. A do ta arrijnë këtë qëllim këto dy shtete kjo shumë do të varet edhe nga vetë shqiptarët.

NAIM HALIMI

SYLË HOTLA NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE - 140 VJET PAS...

Nga momenti kur historianët tanë filluan të çlirohen nga prangat e komunizmit, historinë nisën ta shkruajnë ndryshe, ashtu si duhet. Kështu filluan t'i marrin vendet e merituar ngjarjet dhe personalitetet historike. Këtu gjen vend e radhitet lart edhe trimi i Karadakut të Kumanovës, Sylejman Sylejmani, i njohur më shumë si Sylë Hotla.

Sylë Hotla lindi në vitin 1875 në fshatin Hotël të Karadakut të Kumanovës, në një familje fshatare me tradita kombëtare dhe fetare, si fëmijë i parë i bacë Hasipit. Për ta trashëguar të parin e kësaj familjeje u emërua Sylejman, e u quajt shkurt Sylë. Sylë, fëmijërinë do ta kalojë në fshat, në familje duke mësuar pak te hoxha e më shumë në oda të burrave. Këtu u njoh me të parët e fisit, të fshatit e të Karadakut, nga të cilët mësoi për popullin e tij, për gjendjen e rëndë nëpër të cilën po kalonte ai, në atë kohë, si pasojë e Krizës lindore dhe qëllimeve grabitqare të shteteve fqinje, të përkrahur nga disa Fuqi të Mëdha. Mirëpo as kjo, e as vdekja e hershme e babës Hasip, nuk e dobësuan Sylën, përkundrazi e bënë më të fortë, më herët të piqet e të bëhet burrë, t'i dalë zot familjes dhe vendit, vatanit. Ky bir i Ahmetajve të Hotlës do të rritet me popullin e kësaj ane, për të qenë me të, dhe në shërbim të tij, gjatë gjithë jetës.

Ata që e njohën Sylën thonë se ishte pika e djali, burrë me halle, i pashëm, shtatlartë, i mençur, trim, bujar, i drejtë, i pasur, por edhe valltar, këngëtar dhe shenjëtar i shkëlqyeshëm. U dallua edhe për mjeshtërinë, drejtësinë, e madhe në pajtimin e gjaqeve dhe në përdorimin e armëve të ndryshme.

Më tepër u angazhua në ngjarjet kombëtare dhe në luftërat çlirimtare. Si luftohet për liri e mësoi nga trimat e anës, por dhe ata të rrafshit kombëtar, nga Idriz Seferi, Hasan Prishtina, Isë Boletini e Bajram Curri, në Kuvendet e Luftërat e Karadakut, në Ferizaj e në Grykë të Kaçanikut. Me kohë e kuptoi pse shqiptarët në Shkup nuk e Shpallën Pavarësinë e Shqipërisë! Pse nuk e kurorëzuan aty fitoren. Kush i pengoi ata. Pse sllavët me ndihmën e Rosisë donin t'i pushtonin tokat shqiptare dhe t'i shfarosin ata, shqiptarët? Këtyre pyetjeve dhe shumë çështjeve të tjera duke u dhënë shpjegim të drejtë, Sylë u bë shumë i dashur, andaj gëzonte respekt të madh në popull, i cili e nderonte dhe dëshironte të identifikohet me të. U betua në perëndi e në Shqipëri, se gjatë tërë jetës do të punojë e luftojë për popull e për atdhe, dhe ashtu veprroi.

Populli kujton se Sylë Hotla luftën me pushtuesit sllav, e filloi në betejën e Kumanovës, në vitin 1912, atëherë kur me shumë trima të kësaj ane dhe të viseve të tjera të shqiptarisë mori pjesë dhe luftoi heroikisht, jo për turq-osmanli, po për

shqiptar-Shqipëri, për liri. Ndonëse kjo betejë, në kufi të Shqipërisë etnike, nuk u fitua për shkak të papërgatitjes së ushtrisë turke-osmane (gjeneralët si Feti e Xhavit Pasha e kishin shitë fitoren), trimat shqiptarë, ata që mbetën gjallë, largohen nga fusha e betejës dhe vazhdojnë qëndresën për mbrojtjen e fshatrave dhe familjeve të tyre. Si rezultat i kësaj qëndrese, mendohet se populli i kësaj ane kaloi më lehtë, ndërsa më keq e pësuan ata të Kumanovës dhe rrugëve duke u tërhequr për në Shkup.

Gjithnjë sipas kujtesës së popullit, kur pushtuesi serb u zëvendësua me atë bullgar në vitin 1916, vojvodë Kërsta e thërret Sylën për të biseduar e për t'u marrë vesh për të bashkëqeverisur. Takimi mbahet në "Kafe të Veselit" dhe posa hapet tema e bisedës Sylja ia pret shkurt "t'kam komshi. Ti në lindje unë perëndim. Kufiri në Tumë (Qendër) të Kumanovës. U kuptuan me pak fjalë dhe ashtu vepruan. Në anën shqiptare, ku qeverisi Sylja, nuk ndodhën të këqija.

Në vitin 1919 komunistët në Kumanovë bënë përgatitje për themelimin e partisë, e thërresin edhe Sylën që të marrë pjesë e t'u bashkohet, por ai nuk shkoi. E kishte formuar bindjen se nga ideologjitë sllave e sidomos nga ato që vijnë prej Rusie, shqiptarët nuk kanë dobi. Përkrahjen e priste nga perëndimi, nga Evropa dhe SHBA-të (mendim i ngjashëm me atë të shqiptarëve sot).

Gjatë kohës së Mbretërisë së Jugosllavisë, Sylë Hotla do të jetë mbret në vend të vet, në trevën shqiptare të Kumanovës. Në të gjitha zgjedhjet, duke qenë me popullin, fitoi si Kryetar i Komunës së Mateçit, madje disa herë mori dhe votat e serbëve e maqedonasve të kësaj ane, duke e mundur kandidatit serb Jovicën, për të cilin flitet se nga e keqja pësoi infarkt dhe vdiq. Për këtë kohë thuhet se ka pasur varfëri, por edhe siguri, zullume të mëdha të Serbisë nuk ka pasur, ashtu siç nuk ka pasur shpërngulje e as vendosje të mëdha të kolonistëve serbë, malazias e rusë.

Në vitin 1941 edhe në këto hapësira shtrihet Lufta e Dytë Botërore. Të parët në Kumanovë erdhën gjermanët, të cilët pastaj sipas marrëveshjes vendin ua lënë bullgarëve. Me vendosjen e bullgarëve në këto anë Sylë Hotla do të arrijë të emërohet Komandant i stacionit policor në Mateç dhe rendin do ta vendosë vetë me bashkëpunëtorë e luftëtarë shqiptarë. Në njësinë e tij policore, vullnetarë, nuk arrin të hyjë asnjë sllav, bullgar, serb apo maqedonas. Në këtë mënyrë, në rrethana të reja ai do të arrijë të punojë në krijimin e një territori autonom shqiptar, me synim të bashkëngjitjes së tij pjesëve tjera të copëtuara të trungut etnik shqiptar. Parimisht, veprimtaria e tij nën pushtetin bullgar do të jetë strategjia e tij afatshkurtër për të pasur hapësirë të nevojshme në veprimtarinë atdhetare. Ky synim i Sylë Hotlës do të vërehet më pas gjatë lidhjeve dhe bashkëpunimit me krerët e tjerë shqiptarë të Karadakut, të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Shqipërisë.

Sundimi bullgar nuk zgjat shumë (8 shtator 1944) dhe Sylë Hotla, si burrë i pjekur që ishte, ndër të parët në këto anë do ta ndiejë rrezikun e ardhjes së proletarëve të kuq dhe ideologjisë së zezë komuniste, e cila nuk ishte gjë tjetër veçse një mashtrim shpirtëror i njerëzve, që kishte për qëllim përhapjen e hegjemonizmit rus, prandaj edhe i pari do ta kundërshtojë deri në pikën e fundit këtë mallkim kombëtar. Në këto rrethana, ai, bashkë me bashkëluftëtarë të tjerë, do të fillojë organizimin e çetave vullnetare shqiptare për të mbrojtur popullsinë e pafajshme shqiptare, madje jo vetëm këtë, nga zullumet e pushtuesve partizanë-

çetnikë, që pritej të ndodhnin. Këtu e kënde, veprimtaria luftarake e Sylë Hotlës për popull e atdhe do të vazhdohet me rezistencë të armatosur ku e kërkon nevoja. Për këtë qëllim do ta harxhojë edhe një pjesë të madhe të pasurisë që kishte. Shumë shpejt lidhet me veprimtarë të shquar antikomunistë. Me iniciativë të tij, në shtator të vitit 1944 në Mateç, në një tubim të madh popullor ku marrin pjesë edhe krerë të lëvizjes së rezistencës, me flamuj kombëtarë nga vise e tjera shqiptare, prefektura e Mateçit u shpall zonë e lirë, e cila ndryshe u quajt “Shqipëri e vogël”, ndërsa kufiri u shtri vijës natyrale, për hekurudhë e xhade të madhe: Preshevë-Kumanovë-Shkup, ku konsiderohej kufiri lindor natyror i Shqipërisë etnike. Nga shtatori e deri në nëntor të këtij viti, forcat shqiptare që numëronin rreth 3.000 veta, arrin t’i përballojnë me sukses sulmet ushtarake të Divizionit të Kumanovës, ku bënin pjesë edhe Brigada XVI dhe XVII maqedonase, të cilat u krijuan në këtë kohë pothuaj nga çetnikë serbë e fashistë bullgarë, për zhbërjen e qenies shqiptare. Si rezultat i luftës heroike të luftëtarëve të Sylës, në këtë rajon, në luftërat përsëj udhës, hekurudhës, në Tabanoc, Llojan, Vaksicë, Runicë, Bellanocë, Orllancë, te Guri i zi, në Tanushë, e ku e kërkoj nevoja, nuk do të mund të bëhen masakra e shkatërrime të mëdha ndaj pronave e popullatës shqiptare, në fillim, por më vonë kur numri i shqiptarëve në brigadat partizane rritet si rezultat i propagandës komuniste të cilët premtuan, e mashtronin popullin, se pas luftës të gjithë do të jenë të lirë dhe të barabartë në këto territore, paraqiten Brigada shqiptare madje edhe të ardhura nga Shqipëria për të luftuar kundër luftëtarëve të Shqipërisë etnike, krerët e nacionalizmës shqiptare mbetën të shokuar dhe për ta penguar luftën vëllavrasëse urdhëruan që forcat e tyre të tërhiqen në brendësi të Karadakut. Në këto rrethana, rrethi i veprimit për luftëtarët e lirisë ngushtohej gjithnjë e më shumë. Meqë tani komunistët kishin fituar në të gjitha vendet e Evropës Juglindore, luftëtarët trima të Karadakut, Sylë, i lëshoi të lirë në shtëpitë e tyre, ndërsa ai vetë i nënti edhe për një kohë do të qëndrojë në fshatrat e malësisë së Karadakut, e sidomos në Brezë, ku kishte mikpritje dhe jatakë të sigurt, duke përcjellë situatën dhe duke pritur ndihmën e aleatëve. Gjatë kësaj kohe, brigadat partizane, e sidomos ajo e XVI-ta dhe XVII-ta, në emër të “çlirimit” vranë e gjymtuan shumë shqiptarë të Karadakut. Nga dora e tyre, shumica e luftëtarëve të lirisë do të vriten, të tjerët do të burgosen e pak do të largohen nga vendi. Organet e sigurimit shtetëror jugosllav do të angazhojnë qindra spiunë sllavë e shqiptarë të shitur, që ta zënë Sylën me shokë, të cilët kishin luftuar së bashku dhe kishin vendosur edhe vdekjen ta bëjnë bashkë, e të cilët konsideroheshin si qëndresa e fundit kombëtare shqiptare jo vetëm në këtë anë por edhe ma gjerë në Maqedoni. Kurthi u përgatit nga agjent të njohur, në Pelister, në kufirin e improvizuar, ndërsa ekzekutimi i tmerrshëm u bë në Shkup, ditën e festës më 11 tetor 1947.

Fundin tragjik të këtij burri të rrallë të kombit, populli shqiptar i Karadakut një kohë të gjatë nuk do ta besojë, e aq më tepër kur një trim si ai do të tradhtohej e vritej edhe me ndihmën e njerëzve të tij.

Sidoqoftë, Sylë Hotla - Hero i Kombit, ra për të mos vdekur kurrë. Shpirti kryengritës i këtij Atdhetari do të jetë shembull për shqiptarët e këtyre kufijve etnikë, të cilët do të jenë përherë të gatshëm të bëhen fli, në të mirë të çështjes së shenjtë kombëtare. Ky shpirt revolucionar do të shpërthejë edhe në tri luftërat e

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

fundit të shqiptarëve në Ballkan: në Kosovë, në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni, pa e realizuar qëllimin përfundimtar, i cili tani tentohet të arrihet përmes rrugëve të tjera.

NEXHMEDIN Z. BARDHI

KOLONIZIMI DHE SHPËRNGULJA NË FSHATRA E MORAVËS SË EPËRME 1912- 1915

Abstrakt. Punimi ka në fokus kolonizimin dhe shpërnguljen në fshatrat e Moravës së Epërme 1912-1915, spastrimin etnik të ushtruar në fazën e pushtimit serb të Kosovës, ku vazhdon zbatimin e planeve dhe elaboreteve serbe të përgatitura që më parë. Vetë fakti që shqiptarët në historinë e tyre janë ballafaquar me këtë dukuri tejet tragjike, e sidomos pas pushtimit të tokave të tyre nga forcat serbomalazeze, në vitin 1912, na jep të kuptojmë se sllavët me ideologjitë e tyre bëjnë çmos t'i realizojnë të gjitha synimet ekspansioniste në praktikë të përcjella me gjenocid klasik.

Objektivi kryesor i këtij studimi është që të analizojë politikën kolonizuese serbe, shpërnguljen, masakrat në këto treva. Qëllimi dhe synim parësor të shpjegojë politikën shtetërore serbe të ndjekur në këtë periudhë historike ndaj shqiptarëve në Moravën e Epërme.

Shtirirja e Moravës së Epërme

Morava e Epërme në aspektin gjeografik bën pjesë në kuadër të Anamoravës, e cila gjendet në jug-lindje të Kosovës dhe territori i saj shtrihet në shpatet veriore të Karadakut të Shkupit në drejtimin veri-veriperëndim. Ajo përfshin edhe luginën e Moravës së Epërme dhe një pjesë të Zhegocit jugor.¹ Ky territor kufizohet në verilindje me Komunën e Gjilanit, në perëndim me Komunën e Ferizajt, në jugperëndim me Komunën e Kaçanikut dhe krejtësisht në juglindje me Maqedoninë.

Morava e Epërme, ku shtrihet territori i Komunës së Vitisë, ka lidhje më të mirë natyrore me luginën e Moravës - Gjilanit dhe Bujanocin, kurse në perëndim - nëpër luginën e Glibushës- me Ferizajn dhe më tutje me Kosovën. Në jug të fshatit Tërstenik ngrihen shpatet e Karadakut të Shkupit, nëpër të cilat është një lidhje e mirë me Grykën e Kaçanikut.

Vendbanimet e lokalitetet të Vitisë datojnë që nga periudhat e hershme historike. Dëshmi për këtë janë gërmadhat e shumta, që gjenden në lokalitete të ndryshme të kësaj komune.

¹ Jusuf Osmani, *Vendanimet e Kosovës - Vitia 7*, Prishtinë, 2004, f. 15.

Kolonizimi në fshatrat e Moravës së Epërme

Pas mbarimit të Luftës së Parë Ballkanike, çlirimin nga pushteti serbo-malazez nga robëria otomane, pjesa e popullatës shqiptare e përjetoi si okupim. Me gjithë premtimet e qeverisë serbe në vigjiljen e luftës kundër Perandorisë Osmane se populli aleat shqiptar në Kosovë do të gëzojë të drejta të gjera, ai iu nënshtrua një terrori të paparë. Vrasjet e masakrat, dhunimet, djegiet e shtëpive etj, ishin këto pamje të viteve pas luftërave ballkanike, por edhe më vonë. Të tilla pamje trishtuese pati në të gjitha vendet e pushtuara shqiptare. Edhe në trevën e Anamoravës, po ashtu. Për këto ngjarje tragjike informoi shtypi evropian i kohës. Publicisti Leo Freundlich, në organin "Albanische Korrespondenz" jepte kronika të përgjakshme, një pjesë të të cilave i mbloodhi dhe i botoi në Vjenë, më 1913, me titull "Golgota shqiptare". Me këto shkrime " Freundlich e quante të nevojshme që në emër të humanizmit, qytetërimit dhe të popullit fatkeq shqiptar t'u drejtohej qeverive të Fuqive të Mëdha dhe mbarë opinionit evropian për ndihmë dhe mirëkuptim"² Mirëpo, shumicës së këtyre qeverive sikur nuk u bënin përshtypje informatat për krimet e ushtrisë çetnike serbe në fshatrat Terstenik, Komogllavë, Vërban, Lubishtë, Gjylekar, Tërpezë, Brest, Korbliq, Shashare, Letnicë, Goshicë, Kabash, Mogillë etj, në të cilat sipas shkrimeve të këtij publicisti thuhej se në 29 fshatra të Karadakut janë djegur 280 ekonomi të shqiptarëve myslimanë, kurse vetëm në fshatrat e përmendura të Moravës së Epërme, u therën në mënyrë mizore 238 burra. Vetëm në Vërban, "në vitet 1912-13, ushtria serbe i vrau mbi 20 vërbanas"³.

Për shkak të kësaj shtypjeje të egër dhe krimeve që bënte ky pushtet mizor mbi popullatën shqiptare, një numër i njerëzve shpërngulen në Turqi dhe në territorin e Shqipërisë së çliruar. Në shtëpitë dhe tokat e të shpërngulurve vendosej elementi sllav. Ky ishte edhe fillimi i kolonizimit të trevave shqiptare, "... që pikësynonte qysh moti zhdukjen e farës së pasardhësve të ilirëve".⁴

Punët rreth kolonizimit përkohësisht i ndërpreu shpërthimi i Luftës së Parë Botërore, për të vazhduar menjëherë pas përfundimit të saj, kur tokat shqiptare u ripushtuan nga i njëjti pushtues. Megjithatë, forma ligjore iu dha me Dekretligjin mbi kolonizimin e viseve jugore të 24.X.1920 dhe të tjera dispozita".⁵ Ky proces zgjati deri në vitin 1938. Regjimi sundues serbomadh "...me rastin e zbatimit të kolonizimit, nuk i përfilli interesat e popullatës vendëse, para së gjithash të shqiptarëve, të cilët përbënin shumicën e popullsisë".⁶ Në të vërtetë, me kolonizimin synohej të vihej një baraspeshë etnike që të sundoheshin më lehtë vendet e pushtuara. Për t'ia arritur këtij qëllimi, fshatarëve ua merrnin (uzurponin) tokat, të cilat i kishin shfrytëzuar shekuj me radhë, madje edhe tokat të cilat i kishin me tapi, duke ua dhënë pastaj kolonistëve arat e bukës, livadhet e meratë. E shqiptari gjithmonë ka qenë i lidhur ngushtë me tokën si

² Zekeria Cana, *Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1914*, Prishtinë, 1986, f.129.

³ Selim Musliu, *Ploja në Anamoravë*, Shkëndija, maj 1991.

⁴ Zekeria Cana, *Ishin ata martirë të kombit*, Bujku, 6 mars.1995.1.

⁵ Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*, Prishtinë,1981, f. 37.

⁶ Radoshin Rajević, *Autonomia e Kosovës- Studim historiko-juridik*, Prishtinë, 1987, f.105.

burim i gjallimit dhe i forcës për të qëndruar dhe mbijetuar. "Fshehtësia më e madhe e qëndrimit ende në këmbë të popullit shqiptar, me gjithë tragjeditë historike që jetoi edhe me gjithë gjakun e njomë që ka derdhur në rrjedhë të shekujve, mund të shpjegohet vetëm e vetëm me lidhjet shpirtërore që ka me tokën, e sidomos me ndjesinë e racës për arat e vatrat e veta".⁷

Reagimi i shqiptarëve të Moravës së Epërme kundër pushtuesit serb gjatë viteve 1912-1913

Pas fillimit të operacioneve luftarake të Luftës së Parë Ballkanike, "Komiteti i Shpëtimit", i formuar në Shkup, më 14 tetor 1912, nën udhëheqjen e Hasan Prishtinës, kishte lëshuar kushtrimin për luftë të armatosur, kundër pushtuesve serbë dhe aleatëve të tyre, jo për ta mbrojtur pushtetin osman, por për të ruajtur trojet e tyre.⁸ Sipas dokumenteve historike, kushtrimin iu përgjigjën shqiptarët patriotë në trevat e Shqipërisë, në përgjithësi, e të Kosovës e Anamoravës, në veçanti, në luftimet në Merdar, Podujevë, Mitrovicë e Prishtinë, Ferizaj, Kumanovë e Shkup, Tetovë, Dibër, Dukagjin, Lumë etj. Këtë obligim kombëtar e mori paria vendore me vullnetarët shqiptarë, si dhe një pjesë e ushtrisë osmane pavarësisht se ato u mobilizuan me vonesë dhe pjesërisht.

Sipas të dhënave dokumentare të shkruara, e sidomos ato nga kujtesa popullore historike, ndër propaganduesit dhe organizatorët për mobilizimin e forcave vullnetare shqiptare kundër pushtuesve serbë, në fshatrat e Moravës së Epërme e më gjerë u dalluan në radhë të parë mësuesit, hoxhallarët dhe nëpunësit patriot, me ndikim dhe autoritet të madh tek masat fshatare.⁹ Duke iu përgjigjur kushtrimin të "Komitetit të Shpëtimit" shqiptar të Shkupit, në krye me Hasan Prishtinën, u angazhuan në radhë të parë mësime të ndërshtesit, klerikët dhe intelektualët shqiptarë. Evidentimi i vullnetarëve, shpërndarja e armëve dhe municioni u bë kryesisht pranë xhamive në: Pozheran, Gërmovë, Sllatinë, Smirë dhe Lubishtë.

Në saje të tyre, nëpër oda dhe në xhami, numër i konsideruar i burrave të moshës mesatare 25-70 vjeç, u paraqiten në njësitë mobilizuese vullnetare, numri i të cilëve ishte mbi 1500 veta. Me rastin e marrjes së armëve vullnetarët shqiptarë deklaroheshin dhe evidentoheshin, "se do të shkojnë për luftë kundër armikut serb." Për ta ishin siguruar edhe armatim, kryesisht pushkë të marra nga depot ushtarake osmane, me regjistra në prani të "miftarëve" (kryepelqve të çdo fshati, një oficeri të ushtrisë osmane - çaushtit si dhe udhëheqësit të grupit vullnetar). Forcat vullnetare shqiptare, nga Anamorava dhe Karadaku i Gjilanit, morën pjesë së bashku me

⁷ Vasfi Samim Visoka, Fejton *Aparati grabitës i reformës agrare i shovinistëve jugosllavë*, në "Bujku", 1996.1.

⁸ Shukri Rrahimi, *Lufta e shqiptarëve për emancipim nacional*, "Revista historisë Jugosllave" (RHJ), nr. 1-2, Beograd, 1970, f. 86.

⁹ Adem Murati, *Lëvizja Kombëtare për arsimin shqip Mulla Syla-mësues dhe veprimtar i dalluar*, Ferizaj, 2012, f. 322.

ushtrinë osmane, në përleshjet kundër ushtrisë serbe në Bujanoc, Preshevë, Kumanovë, Ferizaj, Bibaj, Sojevë, Terstenik, Begracë, Stagovë etj.¹⁰

Për pushtimin e tokave shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri, ishin angazhuar Armata e Tretë dhe Armata e parë serbe.¹¹

Forcat vullnetare shqiptare dhe ato ushtarake osmane në territorin e Anamoravës dhe të Ferizajt gjithsej kishin 15-16 mijë veta me 18 topa, kurse forcat serbe ishin disa herë më shumë.¹² Në fshatrat e Moravës së Epërme, krahas Idriz Seferit, Mehmet Pashë Derallës nga Tetova, Shaban Pashës-Gjinollit-Miftiajve, Sali Agës nga Gjilani etj.

Luftime të përgjakshme ndërmjet ushtrisë serbe të Armatës së Tretë dhe forcave shqiptare, u zhvilluan me 24-25 tetor 1912, në rrethinën e Ferizajt, Kaçanikut dhe fshatrat e Moravës së Epërme në fshatrat: Bibaj, Sojevë, Komogllavë, Tërstenik, Begracë, Stagovë drejt Kaçanikut dhe Vërban, Goshicë, Smirë, Kabash, Lubishtë, si dhe me ato të Armatës së Parë, të cilat depërtonin në viset e Karadakut drejt Kumanovës, Shkupit e Manastirit. Sipas të dhënave historike, në drejtim të Grykës së Kaçanikut - Ferizajt apo të Karadakut, Kumanovës e Shkupit, nga fshatrat Smirë, Lubishtë, Skifteraj, Remnik, shumë vullnetarë kanë marrë pjesë në Betejën e Kumanovës, duke vazhduar deri në Manastir.

Sipas të dhënave të mbledhura nga kujtesa popullore, por shumica dëshmohen edhe nga dokumentet e tjera historike, në shenjë hakmarrjeje, ushtria serbe për rezistencë, e do ti përmendim disa nga rastet më të rënda të gjenocidit ndaj popullatës shqiptare në Anamoravë, pra në Moravën e Epërme, kudo që kaloi ushtria serbe. Në Sojevë pushkatoi 22 veta, fshatin Terstenik u masakruan 60 meshkuj, në Smirë rreth 60 veta, në Vërban 24, Goshicë 58, Lubishtë 102 veta, në Kabash 63 veta, në Tërpezë 17 veta, në Zhiti 7 veta, në Gjylekarë 14 veta etj.¹³

¹⁰ Adem Murati, *Lëvizja Kombëtare për arsimin shqip Mulla Sylva-Mësues dhe veprimtar i dalluar*, Ferizaj, 2012, f. 323.

¹¹ B. Ratković, M. Gjurishiq, S. Skoko, *Serbia i Crna Gora u Balkanskim ratovima 1912-1913*, botimi i dytë, Beograd, 1972, f. 59-62 dhe 68-70.

¹² Aliriza Selmani, *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, f. 276 ; Liman Rushiti, *Rrethanat shoqëroro-politike në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë, 1986, f. 15-16.

¹³ Hysen Terziu, *Ramë Avdyli dhe bashkëluftarët e tij*, Prishtinë, 1997; Adem Murati, *Sali Kupina bashkëluftar i Idriz Seferit*, Prishtinë, 2003; Sabit Avdyli, *Kabashi i Anamoravës*, 1997; Zenun Rexhepi, *Kabashi i Moravës së Epërme*, Prishtinë, 2003; Feriz Ahmeti, *Monografia e Smirës*; Sadullah Brestovci, *Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit-Islam Pira 1866-1931*, Prishtinë, 2008; Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadhe dhe Qëndresa Shqiptare 1844-1990*, Tiranë-Gjakovë, 1991; Xhafer Shatri, *Vështrim i përgjithshëm mbi politikën serbomadhe në Kosovë*, Gjenevë, Zvicër, pa vit botimi; Tefik Raka, *Kaçaniku me rrethinë 1912-1918*, Prishtinë, 1998; Shaban Hashani, *Ferizaji dhe rrethina 1873-1941*, Prishtinë, 1998; Tahir Berisha, *Trojet që nuk shuhet, shënime nga Vërbani dhe Anamorava*, Prishtinë, 1993.

Shpërngulja e shqiptarëve nga Anamorava

Shpërngulja filloi qysh nga tërheqja e ushtrisë osmane. Kjo bëhej për shumë arsye, arsyeja e parë ishte frika se ushtria serbe malazeze do të bënte reprezalje mbi popullsinë shqiptare. Kjo bëri që një numër i madh i popullsisë të linte vatrat e tyre dhe të tërhiqej në male me familjet e tyre deri në dimrin e vonë të 1912, por edhe në fillim të 1913. Presionet e ndryshme të organeve ushtarako-policore ndaj popullsisë joslave ishin të formave të ndryshme, kështu në mungesë të sigurisë për jetë, një pjesë e popullsisë shqiptare vendosi të shpërngulej për Turqi, ku kjo u shkonte për shtati politikës afatgjate të pushtuesit e shpërngulja jo që pengohej, por favorizohej. Shpërngulja ishte e paraparë edhe me dokumentin e Marrëveshjes së Paqes të arritur ndërmjet Turqisë dhe Serbisë, ku në nenin 4 shkruante, Shpërngulja e elementit mysliman-turk në Turqi. Në një shkrim të gazetës “Politika” të datës 09.XII.1914 në mes tjerash shkruante se në atë marrëveshje ishte e paraparë që popullsia e konfesionit mysliman të ketë të drejtë të plotë të shpërnguljes deri në vitin 1915 dhe është liruar nga shërbimi ushtarak në ushtrinë serbe, gëzon ca beneficione, si në pagimin e tatimeve të ndryshme.¹⁴ Këto të dhëna vërtetohen edhe në urdhrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dërguar të gjithë naçallnikëve (kryeshfave) të qarqeve në Maqedoni, në Kosovë dhe në Sanxhak numër 11434, të 26.V.1914, me ç’rast jepeshin udhëzime duke cekur se varej se a dëshirojnë të shpërngulen apo jo, brenda afatit prej 3 vjetëve pas nënshkrimit të marrëveshjes. Kështu të gjithë ata që dëshironin të shpërngulen duhej tu paraqiteshin me shkrim organeve lokale, apo rrethit të pushtetit. Kjo marrëveshje serbo-osmane vlente për të gjitha territoret e Serbisë. Organet policore serbe ishin të detyruara që secilin deklarant të çdo personi në emër të vet apo të familjes, ta pranojnë, ta protokollojnë në librat zyrtarë, si dhe në regjistër të veçantë, për të ditur se cilët persona janë shpërngulur për Turqi me të gjitha të dhënat personale, vendin dhe të vërtetohen nga ato organe.¹⁵

Masovitetin e shpërnguljes e hasim edhe në shtypin turk të kohës, ku gazeta “Zhen Turk “ e datës 28.II. dhe 13. III.1914 shkruante se myslimanët nga Sanxhaku ikin me të madhe për Turqi nga zullumet e papara të organeve të pushtetit. Këtë të dhënë e kishte dërguar i ngarkuari me punë i Serbisë në Sofje, ku kemi reagimin e ministrit të Punëve të Brendshme të Serbisë dhe vetë Nikolla Pashiqit, ku i vunë detyrë të ngarkuarit me punë të Serbisë në Stamboll që ti demantojë këto lajme.¹⁶ Presionet për të detyruar popullsinë drejt shpërnguljes vazhdonin në të gjitha territoret, dhe atë me të gjitha format dhe mjetet, edhe trevat shqiptare të Anamoravës iu ekspozuan këtyre presioneve, të cilat në të shumtën e rasteve rezultojnë me shpërngulje. Në secilin fshat dhe në çdo rast individual, presionet dhe reprezaljet ishin permanente. Dinakëria serbe për të pasur arsyetimin kundrejt opinionit të jashtëm aplikonte formën, ku çdo person, familje që dëshironin të shpërngulej duhej të paraqiste kërkesën me shkrim ja siç e paraqet edhe rastin konkret për disa kërkesa me

¹⁴ Politika, 9.XII.1914.

¹⁵ *Burimet serbe për Historinë e Popullit 1912- 1914*, Shkup, 1979, f. 367-368.

¹⁶ Dokumentet e politikës së jashtme të Serbisë, libri. VII, fletorja,1, SANU, Beograd, 1980,462.

shkrim të disa fshatarëve të Anamoravës-Vitisë, më 08. III.1914, ku banorët e fshatit Binçë, Ramë Hyseni dhe Brahim Hasani, në kërkesën e tyre shprehen: “ Jemi të dëshirës që gjithë tokën t’ia lëmë shtetit serb, e që shteti serb me harxhime të tyre të na dërgoj në Selanik-deri në kufirin turk” , kërkesës iu përgjigj Ministria e Punëve të Brendshme pas 5 ditësh më 13. III.1914, kuptohet me një përgjigje pozitive pro shpërnguljes.¹⁷ Të njëjtën ditë, më datën 8. III.1914 me lutje identike i drejtohen Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë 31 familje nga fshati Buzovik i Moravës së Epërme, të cilët përveç elementeve të cekura të tokës, e të tjera theksojnë edhe anëtarët e familjes së tyre me të cilët do të shpërngulen, dhe nga lista që u paraqit del se 31 familje me 226 anëtarë ishin të evidentuara të gjithë.¹⁸ Edhe këta morën përgjigjen pozitive nga organet e shtetit serb pro shpërnguljes edhe atë me datën 13. III.1914. Kërkesë të njëjtë kishin bërë edhe katër familje të Moravës së Epërme, respektivisht të fshatit Budrikë, të cilët kërkesën e kishin bërë më 7.III.1914. Këta ishin Sali Salihu, Sylejman Mustafa, Behlul Brahimi dhe Rexhep Ajeti edhe lutjet e tyre u shqyrtuan me datën 13.III.1914 që të gjithëve iu lejua shpërngulja, por pa ndihmën e shtetit serb.¹⁹

Kundër shpërnguljes së dhunshme kishte edhe reagime nga gazetatat turke p.sh. gazeta “ Turk Sedasi” në disa numra kishte botuar artikuj të ndryshëm kundër regjimit serb edhe kundër shpërnguljes.²⁰

Pa dyshim që kishte rezistencë të popullsisë shqiptare kundër persekutimeve dhe shpërnguljes, por para një makinerie shtetërore ushtarako- policore, ishte shumë e vështirë qëndresa.

Një tablo realiste të gjendjes së rëndë në tokat e pushtuara shqiptare pa përjashtim , na jep socialdemokrati serb Tucoviq ku shkruan: *”Kryengritja shqiptare e shtatorit (1913), për shkak të së cilës, Serbia u shtrëngua të mobilizojë përsëri afro tre divizione, është një shembull klasik që tregon se si shkaktohen luftërat koloniale. Okupimi i ushtrisë serbe shtrihet prej lindjes e deri në dyert e grykave dhe të qafëmaleve shqiptare. Ky okupim e ndau bujkun prej arës, bagëtinë prej kullosave, kopetë prej lugjeve, fshatin prej mullirit, blerësin e shitësin prej tregut, rrethinën prej qytetit, kurse tërë popullsinë malore prej qendrave ekonomike dhe drithoreve të saj.”*²¹ Shqiptari i andejshëm (i Shqipërisë londineze) nuk guxonte të shkelte më në tokën e tij që i kishte mbetur në këtë anë (në Kosovën e pushtuar). Të gjitha burimet e jetës iu prenë. Populli i dëshpëruar dhe i uritur pa masë, së pari u lut të vijë lirisht në tregje. Por, kur iu ndalua edhe kjo, ndërmjet vdekjes nga uria dhe vdekjes nga plumbi, ai zgjodhi këtë të dytën.

¹⁷ AS, MPB, F-12, r.23, 1914.

¹⁸ Limon Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918* ,Prishtinë, Rilindja, 1986,f. 146-147.

¹⁹ *Dokumentet e politikës së jashtme të Mbretërisë Serbe*, Libri. VII, fletorja .2, SANU, Beograd. 1980,354.

²⁰ Po aty.

²¹ Dimitrije Tucoviq, *”Serbia dhe Shqipëria”*, Prishtinë, 1973.

Në raportin e Fondacionit Carnegie për paqe Botërore, komisioni hetimor i të cilit asokohe kishte qëndruar në Ballkan, shkruan: “Shtëpi dhe fshatra të tëra janë shndërruar në hi, popullata e pafajshme dhe e pa armatosur është masakruar në masë, dhuna e pabesueshme, plaçkitjet dhe brutalitetet e gjithfarë llojeve të këtilla ishin mjetet që janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren nga ana e soldateskës serbo-malazeze, me qëllim që të ndërrohet karakteri etnik i këtyre trevave të banuara kryekëput me shqiptarë”.²²

“Të pushkatosh fëmijë sikur të ishin të rritur, ti përdhunosh para se t’i gjymtosh më pas, ky është një krim suprem në këtë botë. Dhe këtë serbët e kanë bërë shumë herë, ku për këtë janë duartrokitur nga një pjesë e madhe e popullsisë së tyre”.²³ Barbarizmat e tyre serbët kundër shqiptarëve u munduan t’i kryejnë në ato vende larg syrit të kontrollit evropian. Të gjitha mënyrat dhe metodat mizore janë kryer gjatë luftërave ballkanike. Falë shënimeve të komisionit hetues “Carnegiet” 1913-1914 konstatohet: “Djegiet e shtëpive e fshatrave, egërsitë e padëgjua, plaçkitjet, grabitjet dhe barbarizmat janë mënyrat dhe mjetet, të cilat trupat ushtarake serbo-malazeze i kanë përdorur me qëllim për ta transformuar dhe ndryshuar fizionominë etnike të vendeve të banuara dhe të populluara thjesht prej shqiptarëve”.²⁴

Sipas komisionit “Carnegie” nëse shikojmë vetëm ligjet, të cilat i kishte nënshkruar mbreti serb Petar në tetor 1913, për shtypjen e vendeve të aneksuara, në barbarizmin e tyre mjaftojnë për ta denoncuar Serbinë. Ato janë botuar në Carnegie Report, i cili duhet lexuar nga të gjithë ata që në Ballkan të bëjnë një paqe të qëndrueshme me drejtësi.²⁵ Ky është një raport mbi mizoritë dhe çështjen e minoriteteve në Ballkan të bërë nga një komision i dërguar nga Instituti i madh bamirës amerikan Carnegie.²⁶

Komisioni Carnegie Report nxorri në shesh se akuzat dhe mizoritë e përgatitura e të kryera nga “Dora e zezë” serbe ishin të vërteta. Damjan Popoviqi, kryetar i mbretvrasësve, udhëhoqi masakrat në Kosovë, e tërë kjo ishte vetëm një pjese e planit për ngritjen e Serbisë së Madhe. “Dora e zezë” ishte një qeveri brenda qeverisë, por jo zyrtare, por edhe “Mbrotjtja Kombëtare” të dyjat kishin dorë të lirë. Krimet më të rënda kryheshin nga këto organizata terroriste të njohura në tërë botën, të cilat mbështeteshin nën mbrotjtjen e fuqishme të shtetit serb.²⁷

Masakrat, aktet e pabesueshme të dhunës, sidomos ndaj shqiptarëve janë tejet makabre. Mjafton tu referohemi disa fragmenteve nga shtypi i kohës, ku pasqyrohen mizoritë serbe kundër shqiptarëve në vitin 1913. Gazeta e Zagrebit “*Hrvatske Novosti*” shkruan: “Çudi e madhe?! Serbët jo vetëm në kohën e luftimeve, që bënë aq çudira mbi shqiptarët e Kosovës sa gjithë bota u neverit, por edhe sot pas vendimeve

²² Rexhep Qosja, *Çështja shqiptare*, Prishtinë, 1994, f. 135.

²³ Ismail Kadare, *Ra ky mort e u pamë*, Tiranë, 2000, f. 179.

²⁴ Mehmet Vokshi, *Shqipnija e shqiptarëve*, Prishtinë 2001, f. 42.

²⁵ Xheladin Shala, *Pushtimi i Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi 1912-1915 përgjysmimi i Shqipërisë*, Prishtinë 2012, f. 233.

²⁶ Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 2001, f. 269-270.

²⁷ Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 2001, f. 270.

të Konferencës së Londrës, kudo që kanë shkelur, vrasin, presin, vjedhin, burgosin, dhunojnë e plaçkisin popullsinë e pafajshme vetëm pse janë shqiptarë. ” *Gazeta* ” *Daily Telegraph* ” shkruan: ” Historia nuk njeh persekutime më të fëlliqura se sa pasojën e lahtarës së duarve dhe shpirtit të trupave (reparteve) të gjeneral Jankoviqit ”.

Nga kronikat e shtypit të huaj, del se përmasat e shfarosjes fizike të shqiptarëve nga Serbia, janë të trishtueshme.

KONKLUZIONI

Periodha më e vështirë dhe më e përgjakshme, pothuajse gjatë gjithë historisë së popullit shqiptar të kësaj ane, ishte ajo e viteve 1912 – 1915, që në pjesën e popullit dhe të territoreve të pushtuara njihet si kohë e sundimit të Serbisë së parë. Mu atëherë kur dukej se do të agonte liria, në vjeshtën e vitit 1912, trojet shqiptare i përfshiu shtrëngata e Luftës së Parë Ballkanike që ishte shkatërrimtare.

Luftërat ballkanike ishin të përgjakshme dhe të kushtueshme. Gjatë dhjetë javë luftimesh, gjatë gjashtë javësh sa zgjati Lufta e Parë Ballkanike dhe katër javë sa zgjati Lufta e Dytë Ballkanike, u vranë rreth 200.000 luftëtarë, pa llogaritur civilët, përveç dhjetëra mijëra viktima të kolerës, tifos e dizenterisë. Vetëm pena e Dantes mund ta përshkruaj me saktësi udhën që vjen nga Lozengradi, vetëm talenti i tij i mistershëm do të ishte në gjendje të rikrijonte të gjitha tmerret e moçalishteve të akullta, mbi vijat dhe llumin e të cilave ngrihen trupat e gjymtuara dhe të copëtuara të të rënëve shkruante Leon Trocki.

Luftërat ballkanike çuan në një acarim të mëtejshëm të kontradiktave midis popujve, duke shpejtuar kështu fillimin e Luftës së Parë Botërore, ku shpesh çdo arsyetim me qeveritë përkatëse ndeshet në një mur të shurdhët. ” *Megalomania e idealit kombëtar* ” nuk linte shteg as për arsyetim e as për kompromise.

Kosova, kjo tokë shqiptare u dënua prej Fuqive të Mëdha të mbajë në kurriz, një zgjedhë të re shumë më gjakpirëse sesa e përparshmja – zgjedhën militariste serbomadhe, ku me ndihmën e Ruisë, Serbia dhe Mali i Zi, i krijuan kufijtë kolonialë me krime të papara mbi shqiptarët.

Faktikisht në këto luftëra, harta e katër vendeve ballkanike u ndryshua në mënyrë rrënjësore në dobi të tyre, por dëm të madh pësoi çështja shqiptare, duke iu përgjysmuar populli dhe territori historik mijëra vjeçar në Ballkan.

Kështu që pjesa më e madhe e popullit shqiptar gjatë luftërave ballkanike pësoi zhgënjime të hidhura. Ku dihet se trajtimi i problemit të kufirit shqiptar nuk u mbështet në konsiderata etnografike, historike, ekonomike etj, por u bë nga Fuqitë e Mëdha nën prizmin e ” ruajtjes së ekuilibrave të paqes në rajon e më gjerë, ” apo më saktë në mosprishjen e ” *Koncertit Evropian* ”. Në këtë këndvështrim, diplomacia e Fuqive të Mëdha kërkonte të shmang Luftën e Madhe, gjë që nuk u shmang dot.

Vitet 1912 – 1915, ishin një periudhë e një krize jo vetëm ballkanike, evropiane, por në përgjithësi edhe vite të krizës botërore. Shikuar nga aspekti kohor është periudhë e shkurtër, por në fakt gjenocidi i ndodhur paraqet një rën ndërr periudhat më të kobshme të historisë së këtij gadishulli, ku për çdo ditë, javë, muaj, ndodhnin ngjarje nga më makabret, e veçanërisht ndaj popullit tonë, e cila edhe për

Anamoravën është periudha më e dhembshme e gjenocidit të ushtruar nga pansllavistët, gjë që e zbatuan në praktikë në mënyrë të përpiktë të gjitha projektet e elaboratet famëkeqe të përpiluara që nga “Naçertania” e Garashaninit, Vladan Gjorgjeviqit, të pasuara edhe nga shumë të tjera në vazhdim, që u zbatuan nga të gjitha regjimet shtetërore serbe pa dallim, dhe quhej si veprim i shenjtë masakra dhe gjenocidi i ushtruar ndaj shqiptarëve.

BIBLIOGRAFIA

- Ahmeti, Feriz,(2002): *Monografia e Smirës*, Prishtinë.
- Braha, Shaban,(1991): *Gjenocidi sërbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*, Tiranë- Gjakovë.
- Cana, Zekeria,(1982): *Shpalime historike*, Prishtinë.
- Cana, Zekeria,(1990): *Socialdemakracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1914*, Prishtinë.
- Durham, Edith,(2001): *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë.
- Hashani, Shaban,(1996): *Ferizaji dhe rrethina e tij gjatë sundimit të mbretërisë serbe 1912-1915*,”Bujku”, 13-16 nëntor, Prishtinë.
- Leo, Freundlich,(2010): *Golgota e Shqipërisë*, Prishtinë.
- Murati, Adem,(2003): *Sali Kupina bashkëluftar i Idriz Seferit, Jeta dhe vepra e Idriz Seferit*, Instituti Historisë, Prishtinë.
- Murati, Adem,(2012): *Lëvizja Kombëtare për arsimin shqip Mulla Sylja-mësues dhe veprimtar i dalluar*, Ferizaj.
- Osmani, Jusuf,(2004): *“Vendbanimet e Kosovës- Vitia”*, Prishtinë.
- Rexhepi, Zenun,(2003): *Kabashi i Moravës së Epërme*, Prishtinë.
- Rushiti,Limon,(1986): *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë.
- Rushiti, Liman,(1981): *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*, Prishtinë.
- Sekuliq, Millovan,(1980): *Kosovo od 1912- do 1918 godine*, Prishtinë,(dokumente).
- Selmani, Aliriza,(1997): *Gjilani me rrethinë në Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare të vitit 1912*, IAP”Gjurmime Albanologjike”, SSHH,nr.25,1995, Prishtinë.
- Selmani,,Aliriza,(1997): *Anamorava në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912*,” Bujku”, 7 mars, Prishtinë.
- Shala, Xheladin,(1989): *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912- 1918*, Prishtinë.
- Shala,Xheladin,(2012): *Pushtimi i Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi 1912-1915-Përgjysmimi i Shqipërisë*, Prishtinë.
- Tuceviç, Dimitrije,(1973): *Serbia e Shqipëria*, Prishtinë.

SHPEND AVDIU**SHTYPI EVROPIAN MBI ZGJEDHJEN E
PRINCIT TË SHQIPËRISË VILHELM VIDIT
(1913-1914)****Përmbajtje e shkurtër:**

Shtypi ndërkombëtar shkruante varësisht nga interesat e vendeve prej nga shkruante ai shtyp. Kryesisht Fuqitë e Mëdha kishin synim stabilitetin dhe paqen, prandaj edhe fryma e këtij shtypi shkonte në atë drejtim, duke pritur që princ Vidi do të ndikonte stabilizimin e shtetit shqiptar dhe të rajonit, prandaj vendosjen e Princ Vidit e shihnin nga ky prizëm. Në përgjithësi shtypi i huaj veçanërisht ai anglez, gjermanofon dhe ai italian, me ardhjen e Princ Vidit në krye të shtetit shqiptar, e shihnin fundin e ngatërresave brendashqiptare, fundin e sundimit dhe të kurtheve të Esad Pashë Toptanit, largimin nga territori shqiptar të forcave ushtarake serbe, malazeze dhe greke dhe shuarjen së paku të përkohshme, të aspiratave të shteteve fqinje të Shqipërisë, për ndarjen e mëtejme të tokave shqiptare ndërmjet Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi dhe përfundimisht largimin e rrezikut që në krye të shtetit shqiptar të vinte një princ mysliman nga Lindja.

Shtypi serb, nga ana tjetër, që i kushtonte një rëndësi të madhe ardhjes së princit Vid në krye të shtetit shqiptar, vazhdonte të propagandonte, duke u përpjekur në vazhdimësi që të krijonte një opinion destabilizimi për shtetin shqiptar. Natyra e shtypit serb ishte destabilizuese dhe sipas tij, Princ Vidi nuk do të mund të qëndronte gjatë në krye të shtetit shqiptar.

Është interesant konstatimi i një gazete të huaj për huanë e parë që i ishte dhënë shtetit shqiptar se “shteti shqiptar lindi bashkë me borxhin”, duke paralajmëruar kështu një jostabilitet të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare.

Shtypi evropian për figurën e Princit Vidit

Me ardhjen e princ Vidit në krye të shtetit shqiptar po realizohej vendimi që kishin marrë Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër që të zgjidhej një princ evropian për Shqipërinë. Këto Fuqi e kishin zgjedhur një model si për vendet e tjera të Ballkanit që kishin fituar më herët shtetet e tyre kombëtare nga Perandoria Osmane.

Më 8 nëntor 1913 Fuqitë e Mëdha pranuan kandidaturën e Princit për vendosje në Fronin e shtetit shqiptar, i propozuar nga mbreti i Rumanisë Karol.

Ardhja e Vidit në Shqipëri kishte shkaktuar një entuziazëm të përgjithshëm ndër shqiptarët e të gjitha shtresave, “krahinave”, etj¹.

Në kujtimet e tij, Eqrem Bej Vlora shkruante: *Princin nuk e njihite askush në Shqipëri, sikur as mbretin e Rumanisë, por të gjithë më në fund u gëzuan që Evropa bëri diçka për Shqipërinë, kryesore ishte se Shqipëria përsëri u gjend në qendër të politikës evropiane, që ajo ishte shndërruar në një faktor që duhej të merrej parasysh.*² Princi Vid ishte pinjoll që rridhte drejtpërdrejt prej brezit të Vilhelm Oranjës i cili ishte stërnipi i Frederik Vilhelmit të III-të dhe i mbretëreshës Luisa, nipi i Perandorit Vilhelm, i cili është dhe kumbara e tij.³

“Shtëpia e princërve Vid është një nga familjet më të mëdha dhe më të vjetra të Gjermanisë, kjo familje i ka dhënë shumë burra të mëdhenj atdheut të vet, ka dhënë priftërinj, shkrimtarë e filozofë dhe luftëtarë të mëdhenj e njerëz të shkëlqyer ka pasur kjo familje në gjirin e vet, ma emër janë princi Max Milan i cili ka bërë udhëtime të shumta nëpër botë, pastaj Princi Hermon i cili është i njohur për shkrimet e tij filozofike, një tjetër anëtar i famshëm i kësaj familje për të cilën bëjmë fjalë është edhe Arqipeshkvi i Kolnit Hermon.”-Kështu shkruante “Përlindja e Shqipnisë” për familjen e Princit Vilhelm Vid.⁴

Princi Vilhelm Vid lindi më 26 mars të vitit 1876 në Neowid⁵, në një familje aristokrate gjermane⁶, i ati i tij ishte Princi Vilhelm dhe e ëma Princesha Maria e cila i takonte familjes mbretërore holandeze, ndërsa gjyshja e tij rridhte nga familja mbretërore e Rumanisë dhe kishte lidhje me familjen mbretërore të Rusisë. Me 30 nëntor 1906 Princi u martua me princeshën Sofivon Schonburg-Valdenburg. Familja e princeshës është nga familjet më të vjetra të Evropës, rrënjët e kësaj familje* shtrihen deri në shekullin e dymbëdhjetë.⁷ Princesha po ashtu njihej edhe si Princeshë Sofia e Shqipërisë. Princi Vid kishte një shkollim superior dhe kishte zhvilluar një karriere ushtarake të suksesshme dhe ishte pjesë e Akademisë Ushtarake të Luftës në shtetin gjerman, pra së të zgjidhej Princ i Shqipërisë.⁸

Zgjedhjes së Princit Vid në krye të shtetit shqiptar, një vëmendje të madhe i kushtoi edhe gazeta angleze “Daily Telegraph” e datës 29 tetor që shkruante: “Është e sigurt që princ i Shqipërisë do të jetë Vilhelm Vidi i cili po viziton oborret mbretërore të Romës dhe të Vjenës.” Gazeta e përshkruante Princ Vidin si jo të

¹Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës,(më tejASHAK) ,Fondi:Shoqëria kulturore “Drita” Bukuresht –Rumani, Kutia nr.1.

² Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2009,f,358

³ASHAK, Fondi:Fondi: Shoqëria kulturore “Drita” Bukuresht –Rumani, Kutia nr.1.; CarmanSylva, *Cili është’ ay*, Bukuresht, 1914,f,4.

⁴*Perlindja e Shqipëniës*, Vlonë, 20/3Vjesht’ e III 1913.

⁵*Atdheu*, Kostancë, 15 vjesht’e II 1913.

⁶The European Powers in the First World War: An Encyclopedia, Edited by Spencer C. Tucker, Routledge, Neë York, 2013, f, 31.

⁷*Atdheu*, Kostancë, 15 vjesht’e II 1913.

* FamiljaSchonburg-Valdenburg është nga qyteti Potsdamit i ciliështë kryeqyteti i njesisë Federale Gjermane Brandenburg.

⁸ASHAK, Fondi :Drita Bukuresht –Rumani, Kutia nr.1.

pasur, dhe të ardhurat vjetore të tij përshkruheshin 200.000 franga në vit.⁹ Po ashtu gazeta londineze i përshkruante kërkesat politike të Vidit kundrejt Fuqive të Mëdha, e ato ishin që të largohen të gjitha ushtritë e huaja nga territoret e shtetit shqiptar dhe të përfundohet puna me kufijtë e Shqipërisë.¹⁰ Edhe qeveria shqiptare iu kishte drejtuar Fuqive të Mëdha me kërkesën që sa më parë të zgjidhet Mbreti i Shqipërisë. Gazeta angleze shkruante: “Princi Vid është kandidati që gëzon respektin më të madh nga shqiptarët dhe nga Fuqitë e Mëdha”.¹¹

Ndërsa gazeta italiane L’Italie shkruante se koha kur do të shkojë Princi në Shqipëri nuk dihet dhe raportonte se së shpejti pritet që qeveria shqiptare të emërojë Vidin si Mbret të Shqipërisë dhe Fuqitë e Mëdha nuk do ta kundërshtonin këtë vendim.¹² Gazeta beogradase “Politika” transmetonte shtypin evropian se princ Vidi nuk do të udhëtojë në Shqipëri javën e ardhshme. Gjermania nuk është e disponuar të garantojë huan shqiptare të 75 milionëve. Më tutje shtonte: “Sipas informatave tona këto dy lajme janë të pasakta. Përkundrazi sot është e sigurt që delegacioni shqiptar i cili do t’i ofrojë kurorën princ Vidit në emër të vendit do të mbërrijë këtu në mes të muajit janar, e sigurisht Princi do të udhëtojë në Shqipëri në fund të janarit. Sa i përket huazimit shqiptar, negociatat ende nuk kanë mbaruar dhe është i pavërtetë lajmi se Gjermania ka refuzuar të marrë pjesë në të”.¹³

Emërimi i Princit Vid si mbret i Shqipërisë ishte i ngutshëm për Fuqitë e Mëdha. Për këtë insistonte edhe Eduard Grey i cili kërkonte që të plotësohej sa më parë fronti i Shqipërisë, që të shuheshin intrigat e Esat Pashë Toptanit dhe shteteve të ballkanike.¹⁴ Njohja e Vidit si Princ i Shqipërisë nga gjashtë Fuqitë e Mëdha të kohës ndikoi që gjendja në vend të përmirësohej. Shqipëria, nga Vlora deri në Shkodër u bashkua, për arsye se Esat Pasha, i cili kishte një aftësi të veçantë për të krijuar anarki, ndryshoi menjëherë kursin e tij politik dhe u bë në anën e Princit Vid. Esat Pasha kishte provuar edhe më herët që të bëhej i pari i vendit, por dështoi në këtë ndërmarrje të tij. Ai donte të siguronte vendin e dytë dhe donte ta drejtonte Shqipërinë nëpërmjet personit të Princit evropian pa përvojë qeverisëse. Qëllimet e tij i kishin lehtësuar rrethanat politike pas largimit të Ismail Qemalit nga Shqipëria. Ambasadori serb në Paris Milenko R. Vesniq, në fillim të vitit 1914 deklaronte se po kërkohet që Princi Vidi sa më shpejt të shkojë në Shqipëri. Ai mendonte që princi Vilhelm Vid nuk do të mund të qëndrojë gjatë në Shqipëri.¹⁵ Ndërsa Gazeta “Dielli” për këtë çështje shkruante se nga një lajm i përhapur në Berlin më 15 janar 1914 thoshte se imperatori gjerman këshilloi princin Vid që të

⁹ Daily Telegraph, Londër 30, tetor 1913: cituar nga “Dielli”, Boston Mass, 11 vjeshte III, 1913.

¹⁰ Daily Telegraph, Londër 30, tetor 1913: cituar nga “Dielli”, Boston Mass, 11 vjeshte III, 1913.

¹¹ LondonTimes, Londër, 29, tetor 1913: cituar nga “Dielli”, Boston Mass, 11 vjeshte III, 1913.

¹² “L’Italie” Romë, 9, dhjetor 1913 :cituar nga “Dielli”, Boston Mass, 30 dhjetor, 1913.

¹³ “Politika” Beograd, 1 janar 1914.

¹⁴ Xheladin Shala, “Kandidimi dhe njohja e Princit Vilhelmvon Vidit”, *Gjurmime albanologjike: seria e shkencave historike* 17(1987): 269.

¹⁵ Xh. Shala, *Kandidimi*, f. 269.

hiqte dorë nga froni i Shqipërisë sa nuk ishte bërë vonë, këto fjalë ua kishte thënë Kajzeri gjerman dhe shume miqve të tij, duke shfaqur frikën se mos Princi mund të vritej prej ndonjë fanatiku.¹⁶ Po këtë deklaratë e kishte transmetuar dhe shtypi serb. Gazeta “Politika” e përshkruan kështu:”Perandori gjerman në shumë raste ka këshilluar seriozisht princin Vid të mos lëshohet në aventurën shqiptare, në biseda me personalitete tjera. Perandoria nuk e ka fshehur pesimizmin e tij në pamje të pozitës së princit në Shqipëri. Ndodhitë e ditëve të fundit e kanë keqësuar edhe më shumë mendimin e vendeve autoritare mbi kandidaturën e princit. Por, princi nuk do t'i dëgjojë këshillat e mendimet e pothuajse asnjërit njohës të situatës, ai do t'ia mësyj aventurës shqiptare, dhe për shkak të kësaj duhet konstatuar se ai vetë në përgjegjësinë e vet personale i ekspozohet rrezikut. konsiderohet se në rrezik është jeta e tij dhe jeta e familjes së tij, sepse ka shumë fanatikë muhamedanë të cilët vrasjen e princ Vidit do ta konsideronin një vepër trimërie e patriotike. Në saje të raporteve të besueshme mund të konstatohet se Princi pas të gjitha paralajmërimeve të perandorit e të tjerave personalitete të cilat ia duan të mirën, ju përgjigj, se si ai do të kryej një mision civilizues e kulturor në vendin që ka mbetur shumë mbrapa. Qarqet shumë të përkushtuara e dinë se sidomos bashkëshortja e Princit është pasuese e flakët e kësaj ideje, dhe e cila mezi pret ta fillojë punën kulturore në Shqipëri, dhe se mbretëresha e Rumanisë e ka entuziazmuar shumë princeshën në këtë detyrë, dhe se e konsideron këtë si qëllim dhe bindje të jetës së saj. Personalitetet tona autoritare konsiderojnë se fati i çiftit princëror në Shqipëri mund të jetë tepër dëshpërues nëse nuk ndodh ndonjë lëvizje e papritur”.¹⁷

Më 7 janar 1914 gazeta franceze “Le Petit Parisien” në një artikull konstaton se Shqipëria konsiderohej në ato kohë si një nder problemet më të mëdha të Evropës, e përshkruan me disa detaje rastin e Beqir Gerbenës dhe zgjedhjen e një princi mysliman, Izet Pashën, në fronin shqiptar, të cilin e përkrahnin Ismail Qemali dhe Esat Pasha. Po e njëjta gazetë përshkruan edhe dorëheqjen e Ismail Qemalit dhe kalimin e pushtetit të Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, që me këtë akt i hapej rruga Princ Vidit që të ishte sovran i Shqipërisë. Po kjo gazetë shkruante për presionin që i kishin bërë Fuqitë e Mëdha Esat Pashës se duhej të hiqte dorë nga çdo qëndrim armiqësor ndaj princit Vid dhe të ardhmes së tij. Më 27 janar po e njëjta gazetë shkruante për ambiciet e Esat Pashës që i kishte, që të bëhej vetë Princi i Shqipërisë¹⁸. Gazeta franceze “Le Petit Parisien” në janar vitit 1914 shkruante:” Sipas të gjitha gjasave dyshojmë se në Shqipëri do të ketë qetësi. Një tjetër element problematik ka dalë në sipërfaqe, sipas disa titujve të shtypit evropian se Izet Pasha Ministër i luftës i shtetit osman, e të cilin Enver Pasha e zëvendësoi, është shpallur princ i Shqipërisë nga myslimanët e këtij vendi dhe do të vijë së shpejti në Vlorë. Shqipëria që veç ka pasur shumë qeveri të

¹⁶ Dielli, Boston Mass, 20 janar 1914.

¹⁷Politika, Beograd, 4 janar 1914.

¹⁸Le Petit Parisien, Paris, 27 janar 1914.

*përkohshme, dhe kurora e së cilës sipas mendimit evropian i takon princ Vidit, do të rivendikohet nga dy pretendentë*¹⁹.

Gazeta serbe "Politika" duke paragjykuar transmetonte një deklaratë të gazetës turke Tana dhe jepe këtë përshkrim: "*Izet Pasha i deklaroi korrespondentit të gazetës së Stambollit "Tana" se e ka dhënë dorëheqje nga posti i ministrit të luftës për të marrë ofertën e shqiptarëve. Ai nuk ka lidhje me Qemalin dhe as nuk ka vepruar në Shqipëri për interes të vetin, por pasi që një numër i madh shqiptarësh i ofrojnë fronin të cilin do ta pranojë me kusht që ta pranojnë të gjitha palët në Shqipëri dhe të pajtohen me të të gjitha Fuqitë e Mëdha. Për princ Vidin ai thotë se gjykuar nga jo disponimi i elementit mysliman, ai i ekspozohet rrezikut nëse vjen.*"²⁰.

Gazeta "Politika" transmetonte dhe deklaratën e zëvendëskryeministrit shqiptar Dom Nikollë Kaçorrit, që sipas gazetës serbe deklaronte se e vërteta është se në Shqipëri po bëhen luftëra kaçake në mes të mbështetësve të pushtetit të përkohshëm në njërin anë dhe të mbështetësve të Esat Pashës në tjetrën anë dhe këto luftëra nuk kanë asnjë kuptim të luftës qytetare.²¹

Përveç propagandës në shtyp, Serbia kishte edhe njerëz të afërt të saj në Shqipëri, dhe në oborrin mbretërorë Princit Vid.²² Kjo gazetë po ashtu publikonte dhe deklaratën e Esat Pashës, në të cilat ai thotë se po e pret ardhjen e princ Vidit me gëzim. Dhe se të gjitha versionet tjera nuk i përgjigjen të vërtetës.²³ Shtypi evropian e përfshinte edhe Ismail Qemalin në këtë aferë, as shtypi shqiptar nuk dallonte shumë nga shtypi evropian, që e akuzonte Qeverinë e Përkohshme të Vlorës.

Gazeta "Dielli" për këtë çështje shkruante: "*Para pak kohësh vjen në Vlorë njëfarë Beqir aga, merret vesh me të gjithë shqiptarët po thuaj, në konak të kryetarit të Qeverisë së Përkohshme; këmben e ç'këmben vizita dhe telegrame dhe ishte për një marrëveshje turko-shqiptare. Pas nja tri dite vjen një vapor prej Austrie dhe kërkon të zbrazeshin nja 300 veta të ardhur nga Stambolli. Pas këtyre ngjarjeve Qeveria e Përkohshme shpall shtetrrëthimin, mban vaporin peng, xhandarmeria hyn në vapor e marrin një pjesë të tyre dhe i dërgojnë në burg. Pas një kontrolli të vaporit i lirojnë të gjithë. Por pas pak kohe prapë kthehet Beqir aga dhe burgoset*"²⁴.

Autoritetet e përkohshme të Shqipërisë ishin të pa afta të ushtrojnë pushtetin në ato rrethane në të cilat ndodhej vendi. Ismail Qemali kishte kërkuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, ta marrë përsipër pushtetin në vend. Komisioni i Kontrollit ishte pajtuar me këtë propozim, ky Komision mund të merret me administrimin e Shqipërisë deri në ditën kur Princi Vidi do të vijë në

¹⁹ *Le Petit Parisien*, Paris, 7 janar 1914.

²⁰ *Politika*, Beograd, 9 janar 1914.

²¹ *Politika*, Beograd, 9 janar 1914.

²² ASHA K: Fondi :Arkivi i ish-Ushtrisë jugosllave Beograd, 1912-1940., Kutia nr.2.

²³ *Politika*, Beograd, 9 janar 1914.

²⁴ *Dielli*, Boston Mass, 10 shkurt 1914.

Shqipëri.²⁵ Pas këtyre ndryshimeve politike Evropa ishte drejtpërdrejt përgjegjëse e administrimit të shtetit të ri shqiptar. Ajo i ishte drejtuar Esat Pashës, penguesit kryesor të rendit duke i kërkuar t'i ndalë projektet e tij, i cili ushqente ambicie të shpallet vetën Princ të Shqipërisë.

Kushtet e mjerueshme në të cilat ndodhej shteti shqiptar, i cili nuk kishte mjete të mjaftueshme financiar ndikonin në shtimin e anarkisë së shtetit në embrion. Vendet evropiane kishin dhënë një hua për Bankën Kombëtare Shqiptare. Kështu, Shqipëria në një mënyrë lindi në të njëjtën kohë me borxhin e saj. Sipas një artikulli të publikuar në Londër, çështja e Bankës Shqiptare do të vazhdonte të diskutohet në mes të kancelarive, dhe ky institucion u ndërkombëtarizua i tëri. Austria e Italia do të kishin një pjesëmarrje dukshëm të theksuar pa qenë as pjesëmarrja e fuqive tjera shumë e reduktuar.²⁶

Banka Kombëtare Shqiptare u themelua më 4 tetor 1913 me një marrëveshje mes Qeverisë së Përkohshme edhe nga Wiener Bank-Vereinme seli në Vjenë që përfaqësohej nga Baron Karol Pinter dhe Oskar Pollak, si dhe Commercial Italia që kishte selinë në Milano që përfaqësohej nga Pietro Fenodilo e Guido Ansbacher me kapital austro-italian dhe ky koncesion jepej për një periudhë 60- vjeçare.²⁷ Administrata e Vlorës fillimisht nga ana e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit u kthye në atë të tipit “vënor”, me ç’rast edhe qeveria u suprimua, në vend të ministrive u krijua një drejtori e cila përbëhej nga pesë degë.²⁸ Administrata e Shqipërisë u nda në tri degë: Administrimi i brendshëm, drejtësia edhe financat. Administrimin e brendshëm e udhëhiqte Petroviç, delegat i Austro-Hungarisë, ndërsa delegatët e Gjermanisë, Italisë edhe delegati i Ruisë e udhëhiqnin dikasterin e drejtësisë, ndërsa delegatët e Francës dhe të Anglisë udhëhiqnin me financat.²⁹ Gazeta “Daily Telegraph” për princin Vid shkruante: ” *Princi shfaq dëshirën ta pranojë menjëherë fronin e Shqipërisë që do t'i jepet nga deputetët shqiptar. Është e vërtetë që deri më sot i ishte lejuar huaja prej 75.000.000 marka, të cilat Princi i kërkon dhe i janë garantuar nga Fuqitë e Mëdha. Zgjidhja e çështjes të një garancie deri me sot ka marrë një udhë të mirë, se Rusia dhe Franca deklarojnë vetën e tyre të bashkuar me Austrinë dhe Italinë. I vetmi ndalim për momentin mbështetet në kërkimin e Francës dhe Ruisë që Princi Vid kërkon të merret vesh drejtpërdrejtë me ta në vend që gjer më sot Princi është marrë vesh vetëm me anën e zyrës së punëve të jashtme të Gjermanisë.*”³⁰

Për çështjen e kreut të Fronit të shtetit të sapoformuar shqiptar, pas shumë kandidaturave që pati për këtë fron (mbi 17 kandidatura) u bë zgjedhja e princit Vilhelm Von Vid dhe kështu përfundimisht u mbyll varianti për një princ mysliman. Pasi ishte marrë vendimi për zgjedhjen e tij, ai priti një delegacion shqiptar që përbëhej prej 14 vetash i kryesuar nga Esat Pashë Toptani, i cili ia

²⁵ *Le Petit Parisien*, Paris, 15 janar 1914

²⁶ *Le Petit Parisien*, Paris, 20 janar 1914; *Le Petit Parisien*, Paris, 27 janar 1914

²⁷ *Perlindja e Shqipëniës*, Vlonë, 20/3 Vjesht' e III 1913.

²⁸ *Historia e Popullit Shqiptar III*, Tiranë, 2007, f. 46.

²⁹ *Perlindja e Shqipëniës*, Vlonë, 18/31 Kalënduar 1914.

³⁰ *Daily Telegraph*, Londër, 10, janar 1914: *cituar nga Dielli*, Boston Mass, 23 janar, 1914.

dorëzoi kurorën e Princit të Shqipërisë Vilhelm Vedit, më 21 shkurt të vitit 1914. Anëtarë të delegacionit shqiptar ishin nga të gjitha pjesët e Shqipërisë, nga të gjitha religjionet që ishin në Shqipëri, në delegacion bënë pjesë edhe këta delegatë: Esat Pash Toptani, Sami bej Vrioni, Shefqet bej Elbasani, Eqrem bej Vlora, Eqrem bej Libohova, Xhemil bej Vlora, Dr. Ep. Koleka, Dr. Hobdari, Luigji Bumçi, Kaqariqi, Çoba, Xhumurteka, Jusuf Kanina, Lef Nosi, Mihail Turtulli, Husein bej Vrioni, Hasan Bej Prishtina, Abdyl bej Ypi, Miltiadi Salvarietj.³¹ Pas dhënies së kurorës nga delegacioni shqiptar, Vilhelm Vidin e njohën si Princ të Shqipërisë të gjitha Fuqitë e Mëdha duke përfshirë këtu edhe shtetet e Ballkanit³². Shtypi francez e kishte përcjellë më vëmendje zgjedhjen e princit Vid si të parin e Shqipërisë. Para se të nisej për në Shqipëri, Princi Vilhelm Vid vizitoi kryeqytetet e Fuqive të Mëdha të cilat e kishin përkrahur atë të vinte në fronin shqiptar. Më 9 shkurt ai vizitoi Romën, kryeqytetin e Italisë, pastaj Vjenën, kryeqytetin e Austrisë, pastaj Berlinin, Londrën, Parisin dhe Petërburgun.³³ Më 26 shkurt 1914 princ Vidi do të udhëtojë për të mbërritur në Durrës. Do të hipte në Trieste më anijen austro-hungarez Taurus. Taurusin e përcillte anija luftarake italiane Quarto, ajo franceze Bruix dhe ajo angleze Gloucester.³⁴

³¹ *Ushtimi i Krujës*, Durrës, 31-13 shkurt 1914.; *Le Petit Parisien*, Paris, 18 shkurt 1914.

³² *Historia e Popullit Shqiptar III*, f. 58.

³³ *Perlindja e Shqipëniës*, Vlonë, 1/14 shkurt 1914; *Le Petit Parisien*, Paris, 18 janar 1914.

³⁴ *Le Petit Parisien*, Paris, 22 shkurt 1914.



Foto e dy sovranëve shqiptarë ishte bërë në ditën e kurorëzimit të shkallët e Pallatit Mbretëror të Durrësit. 15.03.1914

Das interessante Blatt

Nr. 11. Wien, 12. März 1914. XXXIII. Jahrg.

Die Reise Wilhelm I. von Albanien nach Durazzo.
Der Abschied des Fürstenpaares in Triest.



Kleinanzeigenpreise mit vollständiger Anzeigenliste für Österreich-Ungarn, einschließlich 2 Kronen im Viertel, halbjährlich 4 Kronen im Halbjahr, ganzjährig 12 Kronen im Viertel; für Deutschland einschließlich 4 Mk., halbjährlich 8 Mk.; für alle übrigen Länder nach Abzählverfahren; werbefreie 7 Kronen, halbjährlich 14 Kronen, ganzjährig 28 Kronen. — Hauptredaktion in Wien. — Redaktionen und Abnahmestellen: Wien, III, Währingergasse 11 (Telephon 4199, 9767 und 9540), Stadtredaktion: Wien, I, Schulerstraße 18.

Abbestellung nach dem Abdruckdatum und Nachzahlung.

Hilft Wilhelm und seine Gemahlin Kaiserin Sophie steigen auf der Piazza Grande in ein Motorboot, um sich an Bord des Kriegsschiffes „Laurus“ zu begeben. — Auf unten: Das Fürstenpaar und die Hofdamen senden die letzten Grüße von der Kommandobrücke des „Laurus“. (Siehe Seite 8.)
Nach einer Bitte und fotografischen Aufnahmen.

Lawinentatsrophe im Ortlergebiet. — Eiferjuchtsdrama in Budapest. — Geburt von Fünflingen.

Revista austriake “Dasinteressante Blatt” faqen e parë të saj ia kishe kushtuar udhëtimit të princit Vilelm Vidit nga Triesta për në Durrës, më 12 mars 1914

Për ardhjen e Princit Vid në Shqipëri raportonte edhe shtypi austriak me shumë pak dallime nga ai shqiptar. Shtypi e përshkruante entuziazmin e shqiptarëve për Princin Vid edhe pritjen madhështore që po bëhej për të në një vend të varfër e të prapambetur si Shqipëria. Shtypi e përshkruante ardhjen Princit

Vid si lindje të shtetit shqiptar.³⁵ Madje Mihail Grameno udhëheqës i gazetës “Koha” shkante dhe më tej duke himnizuar Princin Vid, ku propozonte që shtatë marsi të shpallej si ditë e shenjtë për Shqipërinë dhe kombin shqiptar.³⁶ Por nuk ishin të gjithë qytetarët shqiptar të këtij mendimi, oficer dhe njerëz të afërt të Esat Pashës kishin marr fotografinë e Princ Vedit e cila ishte botuar në një gazetënë gjuhën shqipe dhe u thoshin qytetarëve të Shqipërisë së Mesme: “ *Qeveria e Elbasanit dhe toskët, ja këtë kaur duan të e bëjmë mbret...mbaroj myslimanizmi* ”.³⁷

Këtë e dëshmon dhe kryengritja e Shqipërisë së Mesme, ku një pjesë e popullsisë myslimane fanatike u revoltua kundër Princ Vedit të cilët dëshironin aneksimin e Shqipërisë nga Perandoria Osmane.³⁸

Princ Vidi arriti në Shqipëri përkatësisht në Durrës më 7 mars 1914, e më pas, ai i vizitoi disa qyte të Shqipërisë. Princi Vid iu përmbajt sugjerimeve të Fuqive të Mëdha, veçanërisht këshillave të Austro - Hungarisë dhe të Italisë. Pas një kohe të shkurtër formoi qeverinë në krye me Turhan Pashë Përmetin, qeverisja e të cilit zgjati gjashtë muaj dhe nuk solli asgjë të re.³⁹ Princi Vid e udhëhoqte një vend të gabuar në kohën e gabuar, fat i keq për të ishte se filloj Lufta e Parë Botërore. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, zhvillimi i shoqërisë shqiptare gjendej në një stad të ultë sidomos në aspektin kulturor, ekonomik e politik. Gjashtë muaj të Princit Vid mund të vlerësohen me presione brendshme dhe të jashtme edhe me mungesë të një platforme politike për udhëheqjen e një vendi bllkanik si Shqipëria⁴⁰

³⁵ *Dasinterssante Blatt, Vien, 12 mars 1914; Viener Bilder, Vien 15 mars 1914.*

³⁶ ASHAK. Fondi i Mikrofilmave Sig I/19-1.

³⁷ Teuta Hoxha, Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh), 1888-1919, Tiranë ,1982,f, 380.

³⁸ Kryengritja kundër Princ Vedit më 1914 O.T, cituar ng:, Lef Nosi, Dokumente Historike – 1912- 1918, Tiranë, 2007,f,187.

³⁹ *Historia e Popullit Shqiptar III.*, f,58; Xh. Shala, *Kandidim...*, f. 285.

⁴⁰ Ferdinand Selleo, *Shqipëria : gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë 2001, f, 153-161.


Figura e Princ zu Widit sipas shtypit satirik gjermanofon

Interesimin jashtëzakonisht të madh të vendeve gjermanofone për zhvillimet në Shqipërinë e kohës dëshmon më së miri fakti se këto ngjarje ishin shtrirë deri te shtypi humoristik dhe sarkastik gjermanofon, Personazh kryesor në këtë shtyp përmes karikaturës, sarkazmës dhe humorit behet personaliteti i Esat Pashës edhe problemet që i kishte shkaktuar shtetit shqiptar asokohe e sidomos regjimit të Princit Vid dhe dorëzimin e Shkodrës Malit të Zi.


Këto karikatura gjenden në Bibliotekën Nacionale të Austrisë të cilat padyshim kanë një vlerë të madhe për kulturën shqiptare. Kjo tregon sa shtypi austriak i ka kushtuar vëmendje të madhe çështjes shqiptare. Në këtë shtyp shihen qindra karikatura dhe ilustrime të shtypit austro-hungarez për çështjen shqiptare, i cili asokohe ishte një prej më të zhvilluarve në botë. Këto gazetë e karikaturës kishin jetë që nga shek. XIX.

Periudha e pavarësisë së Shqipërisë është paraqitur në mënyrë të shumanshme në këtë shtyp, në këtë karikaturë. Në këto karikatura janë paraqitur ngjarje shumë të rëndësishme për fatin e kombit shqiptar, si luftërat ballkanike dhe fati i shqiptarëve gjatë zhvillimit të këtyre luftërave, lufta e Shkodrës dhe dorëzimi i saj nga ana e Esad Pashës tek Mali i Zi, pastaj Konferenca e Ambasadoreve në Londër, kontributi i Austro-Hungarisë në themelimin e shtetit shqiptar. Çështja e zgjedhjes së Mbretit të Shqipërisë, dhe ardhja e mbretit Vid në Shqipëri, ku pjesa më e madhe e karikaturave për çështjen shqiptare iu kanë kushtuar princit Vilhelm Vid. Në këto karikatura ka zënë vend edhe kryengritja e Shqipërisë së mesme, ku është paraqitur në shumë dimensione. Këto karikatura kanë një vlerë të posaçme pasi paraqesin gjendjen politike, ekonomike, kulturore dhe sociale të popullit shqiptar.


Një pjesë e këtyre karikaturave nuk iu dihet autori pasi që në to jepen vetëm inicialet ndërsa në disa të tjera dihen autoret e këtyre karikaturave. Gazetat në të cilën gjenden këto karikatura janë: “Wiener Caricaturen”, “DieMusketen”, “Kikiriki”, “Figaro”, “Der Floh” etj.



Gazeta satirike "Figaro", që botohej në Vjenë dhe Berlin, për herë të parë paraqet një karikaturë "Mbreti Shqiptar" për zgjedhjen e një princi evropian për shtetin e sapoformuar shqiptar dhe themelimin e një mbretërie të re në Evropë. (31 maj 1913)




Krahasimi i Princ Vidit në etapa kohore, 19 mars 1914.



Froni i dyshuar shqiptar, 2 nëntor 1913, në revistën vjeneze “Kikiriki”.

(Fqinjët e Shqipërisë: Serbia, Greqia, Mali i Zi, Bullgaria pretendime për minimin e Fronit shqiptar)



Gazeta satirike austriake "Kikiriki" duke përqeshur Princ Vidin në një karikaturë më titull: "Kjo bukuri gjumi nga Durrësi" maj 1914. (Esat Pasha duke ia vënë shpatën mbi kokë Princ Vedit)

MARISA KËRBIZI

PARADIGMA E DASHURISË SË ËNDËRRIT NË ROMANIN “VERA PA KTHIM” TË BESNIK MUSTAJ

Dashuria, si tërheqje ndërpersonale (Eros), është një ndjenjë komplekse e përkufizuar në një shumësi trajtash. Ajo herë emërtohet si *“instinkt i mbijetesës”*, *“kusht i domosdoshëm për të arritur drejt vlerës absolute”*, *“kënaqësi për lumturinë e tjetrit”*, si një kombinim mes *“shqetësimit për rritjen shpirtërore të partnerit dhe narcizizmit të pastër”* etj. Ky pluralitet i shfaqjes së Erosit lidhet me prerje të veçanta konceptuale që i bëhen shenjës në qytetërimet të ndryshme. Ashtu siç pohon dhe Paul Kristeller-i, ndryshimet kulturore në konceptimin e ndjenjës sjellim ndryshimet në përkufizimin e saj. Varësia që krijon ndjenja “nga mjedisi social e kohor ku rritet” e bën atë të përvijojë tipare specifike.

Në romanin “Vera pa kthim” (Botimet Toena, 2015), dashuria përvijohet si sakrificë sublimë, si besnikëri që shkon përtej ndarjes që sjell vdekja, këmbëngulje për t’i falur tjetrit që mungon, çdo çast të ditës tënde. Në këtë këndvështrim “Vera pa kthim” është njëherësh roman i dashurisë dhe i vetmisë së madhe. Ndjenja dhe mungesa janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, aq sa ndjenja provohet nëpërmjet detyrimit të vetes për vetmi, ndërsa vetmia kthehet në shenjë të besnikërisë së përjetshme ndaj partnerit. Kësisoj romani “Vera pa kthim” mund të emërtohet ndryshe si roman i vetmisë së madhe, vetmi e cila zgjerohet në formë rrathësh ujqorë. Përvoja narrative nis me trajtësimin e vetmisë së ditës së gruas që i nënshtrohet fatit të saj; vazhdon me vetminë natore të femrës që ka nevojë të çlirojë energjitë libidike të ngërthyera keqaz në psikikën e saj, kulmon me vetminë e përbashkët të aktantëve, që nuk e mbushin dot “zbrazëtinë” që boshi i vdekjes sjell.

Roli i referencave jashtëletrare në përvojën narrative

Edhe pse “Vera pa kthim” është një roman për dashurinë e pamundur, ndjenja ndërpersonale nuk lidh vetëm dy aktantët, duke i shkëputur nga bota. Marrëdhënia ndjenjësore mes Gorit dhe Sanës vendoset në një kontekst të caktuar jashtëletrar, në kohën e diktaturës. Rrëfimi për sistemin totalitar, nuk kthehet në qëllim në vetvete, megjithatë shenjat e tij referenciale nuk janë të parëndësishme. Përmendja e një sërë të dhënash si frika e Gorit nga dëshmitarët e rremë, dyshimi

në të vërtetat e institucionalizuara, shkrimi i rremë i historisë, gjykimi arbitrar i njerëzve, prishja e kishave dhe e xhamive etj., e vendosin rrëfimin në kohë totalitare. Shenjat e kësaj kohe zënë hapësirë minimale në tekst, megjithatë karakteristikat e saj i japin “shijen” hetero-kozmosit të B. Mustafajit. Njësitë referenciale vijnë kryesisht përmes fjalëve të Gorit, i cili hedh dritë mbi arbitraritetin e ngritur në sistem. Nga ana tjetër, Sana i pasuron shenjat arbitrare të totalitarizmit nëpërmjet apostazisë së rremë fetare. Edhe pse deklaron nëpërmjet një gjuhë neutrale për prishjen e kishave, në të vërtetë besimi në praninë e një jete tjetër pas vdekjes, kthehet në njësi strukturore për ndërtimin e narracionit. Gjithashtu, evokimi i Zotit, djallit etj., ndihet si një nevojë shpirtërore për t’i deleguar destinin e jetës së vet, fuqive omnipotente. Kjo do të thotë se metamorfoza apostazike e njeriut nën sistemin totalitar, preku në të vërtetë sipërfaqen e dukjes së tij. Ky kontrast i thellë mes artikulimit të jashtëm dhe ndjesisë së brendshme, mes dukjes dhe qenësisë, bëhet shkak për krijimin / thellimin e neurozave.

Gjithashtu, nga realiteti kulturor shqiptar, ndërfiten në roman shenja të tilla si mitizimi i “institucionit” moral të virgjërisë, sakrificat e panevojshme në emër të reputacionit të mirë etj. Rrëfimi për neurozat erotike, për çlirimin libidik gjatë procesit të ëndërrimit, shënjojnë deformimet psikike që vijnë si pasojë e respektimit të kodeve të panevojshme morale. Në pavetëdijen e Sanës, dashuria (si energji konstruktive) përballet me vdekjen që i ka rrëmbyer fizikisht partnerin), por dhe me Egon, e cila nën presionin e Superegos ka konsoliduar norma morale. Ëndrra e Sanës, nis nga një energji libidike që ka nevojë të konsumohet, por ushqehet nga Ego, që kërkon të vendosë parimet “e botës jashtë” edhe në pavetëdije. Nga këto dy beteja simbolike “Eros-Thanatos”, “Eros-Ego”, e fundit është më intensive.

Kthimi i Gorit (fitorja mbi Thanatosin), nuk shënjohe vetëm si triumf i dashurisë. Gori nuk karakterizohet si rifunksionalizim i Romeos (që bën gjithçka në emër të ndjenjës, vdes kur e dashura nuk është dhe ngrihet nga vdekja për hir të saj). Pritshmëria është që Gori kthehet sepse **e do** Sanën, ndërsa në rrëfimin për fjalët e tij, materializohet gjuhësisht se ai kthehet sepse **duhet** (premtimi). Zëvendësimi i karakteristikave qendrore të dashurisë (ndjenja, pasioni) me tipare periferike (fjalëdhënia/besa), shënjon ndërhyrjen e njësive nga realiteti. Bota jashtë me parimet e funksionimit të saj (kujtojmë rëndësinë e institucionit të besës në botëkuptimin shqiptar), kushtëzon përvijimin e ndjenjës. Dashuria nuk formësohet si “entitet i vetëmjaftueshëm”, edhe pse ndodhet në terrenin e saj, në pavetëdije. Ego e mësuar me rregullat e forta (të Superegos), e ka të pamundur gjendjen e prehjes, ajo ndërhyr në pavetëdije dhe përpiket të modelojë dashurinë dhe tiparet e shprehjes së saj; p.sh. lidhja mes dashurisë së largët dhe mallit është e qenësishme, sa shpeshherë sema mall barazohet me dashuri. Malli, një gjendje paqetësie “kronike” për njeriun që dashuron, në pavetëdijen e Sanës kthehet në “logjikë të pastër” që ushqen veprimin.

Kthimi i Gorit shpjegohet me ndjesinë e fajit që ai ka, për “fundin” e jetës së saj emotive: *“Malli më kishte përvëluar, por edhe të kisha lënë vetëm. Krejt vetëm... Do të vija pra se s’bën. Ti gjithmonë je mërzhitur shumë nga vetmia. Ke qenë një vajzë që dije të gëzoheshe aq bukur, por jo në vetmi”*. Në rrëfimin për fjalët e Gorit, materializohet vetëm një herë fjala “mall” (si përgjigje ndaj shprehjes së dashurisë nga Sana) dhe katër herë përmendet vetmia e Sanës si detyrim/dënim i saj pas “ikjes/vdekjes” së të dashurit. Në botëkuptimin shqiptar, ka një mbivendosje midis tërheqjes romantike (përzgjedhje e një kandidati specifik) dhe lidhjes afatgjatë të partnerëve në angazhime, si: martesë, të pasurit familje, fëmijë etj. Kjo do të thotë se lidhja dashurore (edhe si tërheqje romantike) zakonisht bashkëshoqërohet me besnikëri të përhershme nga partnerët, sidomos femrës.

Në këtë kontekst, pëlqimi mes partnerëve (stadi i dytë i ndjenjës, sipas Fisher-it), shoqërohet me tensionin e familjes/komunitetit që kërkon fejesë (ligjërimi i lidhjes në sytë e të tjerëve), ndërsa fejesa në shumicën e herëve barazohet me martesën (në vështirësinë / pamundësinë e ndarjes). Kjo do të thotë se lidhja emotive mes Sanës dhe Gorit (në gjallje të tij), e detyron Sanën me besnikëri të përgjeshme. Pas “ikjes” së objektit dashuror, ajo është e dënuar me “pritje”, “me vetmi”. Në një shoqëri të mbyllur si kjo e jona, kategorizimi i dashurisë si një fenomen social (më shumë sesa emocional, konjitiv etj.), është tipar thelbësor për formësimin e ndjenjës. Lidhja e të dashuruarve me “botën”, pamundësia e “vetizolimit” të tyre në ishullin e kënaqësisë, janë karakteristika të botëkuptimit shqiptar në përvijimin e Erosit.

Prania emocionale e “të tjerëve” gjatë rrëfimit është e madhe, sepse zëri i Egos që sjell rregullat e botës reale (shqiptare) është shumë i fortë; *“Sana shihte me çudi dhe me njëfarë pakënaqësie të papërcaktuar majtas e djathtas. Si nuk po ndeshnin asnjë të njohur. Ku qenkan mbyllur kështu sot?! Donte të takonte ndonjë nga ata që, edhe pse me dashamirësi të çiltër, sa herë vinin në shtëpi e bezdisnin dhe ia shtonin vuajtjet duke i qarë hallin për jetën e saj të vetmuar”*. Presion i fortë që i vjen Sanës nga jashtë (nga komuniteti) për kanalizimin e Erosit sipas normave morale, e bën atë të përpiqet të reagojë. Padurimi për të vërtetuar kthimin e Gorit në sytë e komunitetit, është për Sanën një formë hakmarrjeje, dëshirë e saj për t’i komunikuar të tjerëve fitoren e saj. Ajo përpiqet t’i ikë fatit të përcaktuar, nëpërmjet shmangies së pritshmërisë stereotipale për femrën e vetmuar. Për të gjithë ata që e dënuan me vetmi, ajo i përgjigjet me paradën krahu për krahu me Gorin e saj. Edhe pse sytë e tij janë si *dy hijet e guaskave të zbrazëta, zhurmërima e frymëmarrjes pa avullin e frymës, zëri si të padalë nga një fyt njerëzor e trupi i ngrirë*, Sana është e lumtur, sepse ajo e do / i duhet dashuria e saj e vetme.

Hakmarrja ndaj botës përvijohet në pavetëdijen e Sanës jo vetëm si vazhdim i lidhjes romantike, por edhe si kurorëzim i saj. Dasma e ëndrrës së Sanës, nuk është gëzimi i të gjithëve, por vetëm i saj. Në mënyrë egocentrike, ajo mban lumturinë për vete e pezmin për të tjerët. Binomi gëzim-pezëm nuk përvijohet së pari në pavetëdijen e Sanës. Binomi parimi i kënaqësisë - parimi i realitetit

karakterizohet nga këto tipareve. Gëzimit të kërkuara nga Sana, i përgjigjet pezmi që i shërbehet nga shoqëria (gëzimi i saj mbaroi me vdekjen e të dashurit). Në ëndrrën e saj të dy “shijet” janë sërish aty, por *vice versa*, lumturia është e gjitha e saj dhe shastisja, dhimbja, trishtimi për botën. Ëndrra e saj nuk është vetëm martesë, por arratisja nga dasma për ta shijuar këtë çast special vetëm me të dashurin e saj. Martesa dhe ikja nga dasma anë dy njësi semantike që nuk shkojnë paralelisht me njëra-tjetrën. Martesa nënkupton bashkimin ligjor të çiftit dhe gëzimin e harenë që burojnë nga ky akt. Largimi nga dasma nënkupton rebelimin ndaj një bashkimi të padëshirueshëm. Sana krijon një marrëdhënie të dyfishtë me secilën njësi të antipodit martesë-ikje. Ajo është pjesë e dasmës, e mikluar nga sytë e të ftuarve, deri kur ajo vendos të qëndrojë e më pas ikën... për të shkuar te... dhëndri. Kjo lloj skeme, kundërshton stereotipin e zhvillimit të dasmës. Kjo ëndërr e Sanës mund të analizohet dhe zbërthehet në nënnyjësi:

a) Sana e do dasmën, gjersa e ëndërron të vishet nuse dhe të miklohet për nurin që ka.

b) Sana e do dhëndrin, gjersa vendos të ikë me të.

c) Sana urren detyrimin për të ndarë gëzimin e saj me të tjerët dhe për t’u bërë vetë skllav i të tjerëve, i pritshmërisë që ato kanë ndaj saj.

Thyerja e një tabuje kaq të rëndësishme në botëkuptimin shqiptar, solemniteti i dasmës, shpjegon gjendjen komplekse të Sanës. Përfytyrimi i saj përmbledh gjithë forcat që luftojnë në pavetëdijen. Në të gjendet intensiteti i Erosit (që kurorëzohet në martesë), Thanatosin që përvijohet si mungesë fizike e dhëndrit (ai nuk përmendet si pjesë e dasmës; tradita e do që Gori të marrë Sanën nga dasma / nga shtëpia e të shoqes, ndërsa në përfytyrimin e Sanës ndodh e kundërta, ajo dëshiron të shkojë tek ai). Vdekja si mungesë përvijohet mjegulltazi, ajo është ndjesi periferike në përfytyrimin e saj. Kurorëzimi i Erosit në një lidhje afatgjatë, si martesë, e tkurr ndjesinë e vdekjes. Binomi Eros-Thanatos njihet fitues të plotë Erosin.

Nga ana tjetër, hakmarrja alla “dhëmbë për dhëmbë” (dënimi me pezëm e trishtim për ata që e kanë bërë të përjetojë të njëjtat ndjenja), shënjon pamundësinë e Sanës për t’u shkëputur nga bota jashtë. Ajo jo vetëm që është e pranishme në lidhjen e ëndërrit të saj, por i imponon lidhjes, tipare të ashpra, karakteristike për realitetin (hakmarrja, vuajtja, dhimbja, trishtimi etj.) Kësisoj binomi Eros-Ego në pavetëdijen e Sanës, nuk njihet dashurinë fituese, sepse rregullat, normat, tiparet e formësimit të ndjenjës në jetën reale, janë të pranishme edhe në pavetëdije. Bota jashtë e tjetëron ndjenjën (edhe në ëndërr), sepse tensioni i kodit zakonor e moral shqiptar depërton e modelon ndjenjën dashurore edhe thellë në të pandërgjegjshme.

Teknikat narrative dhe gjuhësore

Romani “Vera pa kthim” ngrihet mbi rrëfimin mbi procesin e ëndërrimit të personazhit. Ëndrra si proces i ndërlikuar psikologjik, gërshet në roman një shumësi imazhesh dhe gjendjesh. Për më tepër, përvoja narrative pasurohet edhe

me dilemat e halucinacioneve (të ndodhura në gjendje të thellë tronditjeje), apo me përvojën e zhvendosjes spirituale (që “ushqehet” si alternativë leximi nga ndryshimi i datës së vdekjes së Gorit etj.) Të gjitha shenjat e mësipërme funksionojnë si rrafshet e ngjashme leximi dhe e pasurojnë tekstin me tipare të romanit onirik. Asnjë nga rrafshet nuk e përjashton tjetrin, por mbivendoset mbi të parin duke theksuar procesin e ndërtimit të tekstit në pavetëdije. Koha e rrëfyer nis në mëngjes, kohë në të cilën mendja nuk është shkëputur ende nga pushteti i subkoshencës “*një kohë e ndërmjetme, kur njeriu ende është disi nën pushtetin e ëndrrave të natës, e bile, jo rrallëherë, i ndodh të priret edhe për t’u shtuar diçka nga ëndrrat figurave reale që e rrethojnë*”; segmenti narrativ mbyllet me një të dhënë fundore, që edhe pse vjen në përfundim të diskursit, nuk ka funksionin e mbylljes, por rihapjes së dilemave të leximit.

Rrëfimi mbi ëndërrimin i jep romanit frymë surrealistë, e cila ushqen **relativizmin** logjik. Mbizotërimi i mendimit të brendshëm, shpesh i shkëputur nga kontrolli i arsyes, kthehet në njësi identifikuese për veprat surrealistë. Vepra të tilla shoqërohen nga teknika gjuhësore, që theksojnë paqëndrueshmërinë e arsyes. Qendërzimi i përvojës narrative në botën e ëndërrimit e pasuron veprën me defamiljarizimin e gjuhës dhe praninë kaotike të mendimeve. Këto dukuri shprehen në roman me anë të teknikave të tilla si:

1) Ngatërrimi i zërave të brendshëm është tipar karakterizues i romanit. Kalimi nga një zë në tjetrin pa shenja formale që dëshmojnë tranzitimin e mendimit, krijon ndjesinë e një mjegulle kuptimore. Në të vërtetë, kjo “errësirë” formale lidhet me vështirësinë e identifikimit të zërave që artikulojnë mendimin. Në pjesën më të madhe të rasteve luhet me shumësinë e zërave të brendshëm të të njëjtit aktant (Sana). Megjithatë shpeshherë zëra të jashtë interferojnë në vetëdijen e Sanës, duke krijuar një lojë parakuzike. Prania e halucinacioneve auditive brenda monologut të brendshëm e pasuron romanin me një nivel të lartë ndjeshmërie.

2) Romani karakterizohet nga thyerje të rregullave drejtshkrimore. Thyerjet më të shpeshta lidhen me përdorimin arbitrar të shkronjës së madhe. Përdorimi i saj ka si qëllim të potencojë kuptimin semantik. Shkrimi i fjalëve bërthamë me shkronja kapitale (p.sh. gjithë ndajfolja e vendit ATJE, shkruhet me shkronjë të madhe), shoqërohet me lëvizjen kuptimore të shenjës. Kjo lëvizje ka të paktën dy nivele:

a) **Veçimi kuptimor** (kalimi nga sfera e të përgjithshmes drejt të veçantës), kryhet nëpërmjet kapitalizimit të shkronjës së parë të fjalës (p.sh. atje - Atje).

b) **Potencimi i kuptimit** (kalimi nga sfera e të zakonshmes në të pazakonshmen), nëpërmjet kapitalizimit të të gjithë fjalës (p.sh. Atje - ATJE). Kapitalizimi i një njësie të plotë tekstore sjell abstragimin e shenjës, zgjerimin e saj kuptimore me tipare të reja, të panjohura.

Gjithashtu, tipar i veçantë karakterizues i tekstit, është përdorimi arbitrar i shkronjës së madhe e të vogël brenda fjalëve. Kështu në disa njësi tekstore, përdoret shkronja e madhe në shkrimin e bashkëtingëlloreve dhe shkronja e vogël

për shkrimin e zanoreve (“*a S'iSHTe e DHiMBSHMe Të BRaKtiSeJ aSHTu TRuPI NJë DiTë PRëJ DiTëSH, Si Të MoS KiSHTe QeNë i yTi? TRuPi , PëR Të CiLiN ViTe Të TëRa, GjITHë JeTëN, iShe KuJDeSuR Më SHuMë Se PëR SHPiR-TiN?*”). Edhe pse një përdorim i tillë mund të konsiderohet arbitrar në raport me drejtshkrimin, e pasuron njësinë tekstore me kuptim të ri.

Potencimi i njërive bashkëtingëllore, nëpërmjet kapitalizimit të tyre bashkëshoqërohet me një lloj “errësimi” formal të zanoreve. Në këtë këndvështrim, piku silabik “zbut” forcën e vet, ndërsa margjinat potencohen. Ky ekuilibër i prishur, ndihmon për përcimin e kuptimit; gjuha e artikuluar është gjuha e errësimit sonorik. Ulja e rëndësisë së zanoreve brenda strukturës së fjalisë, përkon me kuptimin që ato kanë, realizimi i tingullit pa presionin glotik apo me trake vokale të hapur. Gjuha me të cilën Gori ndërftu kornizën e subjektit (rrëfimi për plakun që kërkonte shpellën ku ndaheshin botët) është gjuha e pengesës dhe jo e lirshmërisë, është gjuha e artikuluar me vështirësinë e ruajtjes së mendimit, gjuha e kufizimeve verbale. Binomi mes asaj që duhet thënë (kufizimi) dhe mendimit që del lirshëm, përkon me këtë marrëdhënie formale mes bashkëtingëlloreve (mbyllja / kufizimi i trakut vokal) dhe zanoreve (lirshmëria vokale). Kjo do të thotë se nëpërmjet kësaj formë arbitrar drejtshkrimore, krijohet një gjuhë e veçantë, gjuha e kufizimit dhe e “mbylljes” së mendimit. Së fundmi, nisur nga etimologjia (latin. *Cōnsonāns*) dhe fjalëformimi si kalk etimologjik, bashkëtingullore (bashkë + tingull) janë afunksionale për të qëndruar më vete. Theksimi i vlerës së tyre, nëpërmjet kapitalizimit, shkon në asosacion me idenë se shumësia e eshtrave (nëpërmjet të cilave, përcillet shpesh imazhi i Gorit) është i pamundur të formojë një qenie njerëzore.

Roli i rimarrjeve intertekstuale

Romani “Vera pa kthim” ka në thelb rimarrjen intertekstuale të legjendave, përrallave nga letërsia orale shqiptare. Që në nisje, kthimi i Gorit nga bota tjetër, e bën atë të përvijohet me tipare të ngjashme me Kostandin. Pasioni që nuk e lë të dashurin larg objektit dashuror, zëvendësohet me detyrimin që vjen nga fjalëdhënia. Ai nuk kthehet se do, por kthehet se duhet. Modaliteti i domosdoshmërisë e mbështjell si një pëlhurë gjithë përvojën narrative. Binomi i aktantëve Sana - Gori, pritet nga vetmia (Sana - vetmi - (...) Gori). Kësisoj lidhja (riafrimi) mes tyre nuk motivohet nga domosdoshmëria ndjenjore (nevoja për të ndarë frymën me tjetrin), por **vetmia** që funksionon si mekanizëm psikologjik që motivon kërkesën për prani. Në këtë këndvështrim Gori dhe Kostandini lidhen me të njëjtin shënjuar: *fjalëdhënien për të mbushur vetminë e tjetrin*. Në të dyja rastet, vetmia mbushet me ardhjen e dashurisë; kthimi i motrës te nëna dhe kthimi i Gorit te Sana. Në këtë këndvështrim, dashuria nuk është motivues veprimi, por “*instinkt i mbijetesës*” që aktivizohet kur njeriu e ndjen veten të rrezikuar nga vetmia.

Megjithatë, legjenda e Kostandinit përvijohet sipërfaqshëm në roman, krahasuar me praninë fizike të rrëfimit për detarin. Ky rrëfim përbën ngrehinën

strukture të romanit. Rrëfimi për detarin, për të shoqen e lënë shtatzënë, për mungesën e tij të gjatë, për vetminë e kahershme që bashkëshoqëron të renë, për lindjen e djalit gjarpër, për përpjekjen e nuses për ta kthyer atë në njeri me fuqinë e dashurisë dhe sakrificës, vdekjen e saj etj., përkon me përvojën narrative për Sanën e Gorin. Analiza strukturore që përftohet nëpërmjet paraqitjes lineare të segmenteve narrative është shumë e ngjashme. Matricat paradigmatiche përputhen në mjaft njësi, duke formuar çiftet binomike jetë / vdekje, bashkëshort / bashkëshorte, dashuri / vetmi etj.

Gjithashtu, edhe pjesa më e madhe e funksioneve (nëse ndjekim modelin e Propp-it), përputhen. Të dyja skemat narrative nisin me funksionin *e largimit* (që gjendet në vend të 11-të në strukturën e Propp-it); ikja e detarit është pothuajse identike me ikjen e Gorit. Ngjashmëria narrative ndiqet nga përmbushja e funksionit të parë në listën e Propp-it, *mungesa* është e pranishme në të dyja strukturat narrative. Ajo materializohet në pritjen nëntë vjet të së shoqes së detarit dhe vetëdënimit me vetmi të Sanës. **Rikthimi i** heroit korrespondon me kthimin e Gorit dhe të detarit. **Ndryshimi / shndërrimi** shihet tek paraqitja e Gorit me tipare ambivalente të të gjallit dhe të të vdekurit. Nga ana tjetër, ky funksion plotësohet me shndërrimin e gjarpërit në një djalë të bukur në përrallë. Funksion i 25-të në skemën e Propp-it, **funksioni i detyrës së vështirë** shprehet me detyrën e Gorit për të lënë pasardhës biologjikë, që shkon njëherësh me detyrën e vështirë të gjarpërit për të qëndruar në formë njerëzore.

Martesa (e gjendur në pozicionin e 31-të në listën e funksioneve), shprehet me bashkimin romantik të çiftit Sana - Gori dhe ripërsëritet në formë mungesore (nuk rrëfëhet drejtpërdrejtë, por nënkuptohet) në çiftin e parë detari - bashkëshortja dhe gjendet si prani tek çifti gjarpri - e shoqja. **Ndalimi** gjendet te gruaja e gjarpërit, në përpjekjen për të kryer metamorfozën gjarpër - njeri (përpjekja e saj për të penguar të shoqin për të riveshur lëkurën e të shoqit). Njëherësh ajo shfaqet te Sana në mundimin për ta mbajtur Gorin në një botë që nuk i përket. Funksioni i tretë në skemë, **dhunimi i ndalimit** - mishërohet nëpërmjet gjarpërit që rikthehet në lëkurën e vet nga njëra anë dhe Gorit që braktis Sanën në stacion.

Nga ajo që shihet më lart (nëpërmjet një analize të thukët të listës së funksioneve që gjenden në roman), mund të thuhet se rimarrja intertekstuale e përrallës shërben si njësi strukturore për ndërtimin e përvojës rrëfimtare mbi Gorin dhe Sanën. Edhe pse përvoja intertekstuale ndërfitet si një kornizë subjekti në fund të romanit, marrësi dekodifikon përvojën e konsumuar vetëm në asosacion me intertekstin. Ashtu si edhe analiza funksionale sugjeron, ngjashmëria realizohet në dy nivele:

a) Në përvojën narrative mbi çifte binomike *Gori – Sana* nga njëra anë dhe *detari - e shoqja* nga ana tjetër. Kjo ngjashmëri ushqehet mbi perceptimin që i bëhet lidhjes dashurore dhe objektit dashuror nga Sana.

b) Përkimet me çiftin e dytë binomik *Gori - Sana* nga njëra anë dhe *gjarpri - e shoqja* nga ana tjetër. Shenjat duale të Gorit si i gjallë dhe i vdekur njëherësh,

përkojnë me ftohtësinë e gjarprit si një kafshë htonike, me jetën e tij të dyfishtë mbi dhe nën tokë.

Kësisoj, theksohet se rimarrjet intertekstuale, kanë një vend qendror në strukturën narrative. Interteksti shërben si një medium; mendimi nuk transferohet drejtpërdrejtë nga dhënësi tek marrësi, por me anë të “filtrit” të kodit oral.

Nga analiza e mësipërme, dilet në përfundimin se “Vera pa kthim” është roman i **mendimit** që shtresëzohet në nivele të ndryshme të strukturës tekstore (në thyerjet e rregullave drejtshkrimore, në dhunimin që i bëhet gjuhës, në rimarrjet intertekstuale etj.) Teksti ngrihet mbi iluzionin semantik, lehtësia në dekodifikimin e kuptimit është një “lojë”; vetëm kur romani mbaron, marrësi ndihet se ka zotëruar një përvojë minimale tekstore, sepse kuptimi semantik nis të plotësohet pas “konsumimit” të leximit. Kjo ndodh sepse përgjithësisht romanet e Besnik Mustafajit karakterizohen nga ndërtimi mbi kulmimin e rremë; përvoja narrative ofron disa klimaksë të vegjël, që shërbejnë për të mbajtur ndezur vëmendjen e marrësit, ndërkohë që piku i vërtetë semantik “shtyhet” drejt fund të tekstit. Kjo lloj skeme narrative i jep romanit të Besnik Mustafajt një frymëmarrje të gjerë polisemike.

Në mbyllje duhet thënë se “Vera pa kthim” është një roman, që duhet të lexohet duke mbajtur në mend sugjerimin e Renë Magritte se: *Shumëçka nuk është ashtu si duket* (kujtojmë: *This is not a pipe*). Leximi i këtij romani, i ngjan procesit të formimit të një *puzzle*; në fund fare, atëherë kur faqja e mbrame e librit mbaron, bëhet zbulesa e mrekullishme e “figurës mbi qilim”, magjia e të cilës të shtyn ta rinisësh leximin e tekstit nga e para.

JOLANDA LILA

EUFONIA, TIPAR MBIZOTËRUES NË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT

Bukurtingëllimi, ose eufonia, është një nga parimet krijuese më të larta klasike që Dritëro Agolli e ka bartur, ruajtur dhe zhvilluar më tej në lirikën e tij. "Eufoni quhet përdorimi i përsëritur i një ose disa tingujve gjatë frazës, vargut, strofës, ose në të gjithë poezinë"¹. Pikërisht, përsëritjet e tingujve brenda njësave poetike, brenda strofave dhe të gjithë njësisë së poezisë, në mënyrë të harmonishme, janë tipar jo thjesht melodioz i vargjeve agolliane, por shpesh këto përsëritje mbartin edhe vlera kuptimore, prandaj eufonia konsiderohet me vlerë semantike.

Në studimet gjuhësore, raporti i tingullit me kuptimin është parë si subjektivitet i pastër. Ndërsa në fushën e studimeve letrare, e veçanërisht në analizimin e poezive muzikore, ky lloj raporti duket mjaft domethënës. Vlen të përmendim rastin e poezisë së njohur të Rembosë "Les Voyelles", në të cilën, secilës zanore i përgjigjet nga një ngjyrë, gjë që dëshmon për ekzistencën e tingujve me vlerë kuptimore. "Kur në poezi, tingulli i fjalës bashkëvepron me kuptimin dhe kënaq mendjen e veshin, pikërisht ky efekt quhet *eufoni*"². Kur flasim për përsëritje tingujsh në formë të harmonishme, duhet të kemi parasysh se tingujt gjatë rimarrjeve, përveçse fitojnë një pozicion të ri, ata marrin edhe një kuptim të ri. Edhe kur përsëritja është e ngjashme, ajo ndryshon, duke marrë një nuancë të re kuptimore në raport me kontekstin.

Sipas Uellek dhe Uoren, për të kuptuar më qartë konceptin e eufonisë, na duhet të bëjmë dallimin midis dy aspekteve të ndryshme të këtij koncepti: "midis elementeve inherente (qenësore apo të pandashme) dhe relacionale (relative) të tingullit. Me të parat, kuptojmë individualitetin e veçantë të tingullit, p.sh. a ose o, l ose p, që nuk varen nga sasia, sepse ekziston vetëm një a ose p. Në dallimet inherente sipas cilësisë zënë fill veprimet që zakonisht i quajmë "muzikalitet", ose "eufoni". Dallimet relacionale, nga ana tjetër janë ato që mund të bëhen bazë e ritmit dhe e metrit: lartësia e tonit, zgjatja, theksimi, përsëritja e shpeshtuar, ku të gjitha këto elemente mund të dallohen për nga sasia."³

¹ *The Penguin Dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin Books, USA, 2001, f. 278.

² Pope, Alexander, *Essay on Criticism*, (Publikimi i parë më 1711), The floating press, Auckland, New Zealand, 2010, f. 12.

³ Wellek & Woren, *Theory of Literature*, Harcourt Brace & World, New York, 1956, f. 234.

Për ndërtimin e eufonisë, Dritëro Agolli përdor figura konkrete, në mënyrë që situata të ngulitet dhe të bëhet sa më e perceptueshme. Kështu, p.sh. në poezinë "Gri", përsëritja tingullore e fjalës *gri*, nuk paraqitet thjesht si një përsëritje me efekt ritmik, por në çdo rimarrje fjala merr një nuancë të re kuptimore, përmes pranëvënies me figura dhe elemente konkrete. Koncepti i ngjyrës *gri* merr kuptime të shumëfishta në momentin që bashkohet me materie të ndryshme, si: uji, pikat dhe qielli; më tej, bashkohet me sendet, objektet dhe ndjesitë e brendshme, si: palltoja, dritarja, strehët, letrat, titujt dhe ndjenja e vetmisë. Të gjitha këto imazhe pamore vihen në funksion të ndërtimit të figurës kryesore, apo fjalë-çelësit të poezisë që shënjohet që në titull: *gri*. Për ta kuptuar më qartësisht analizën e përbërësve bukurtingëllues, po paraqesim vargjet e poezisë "Gri"⁴:

Shumë ujë gri, shumë qiej gri,
Gri në dritare, gri në vetmi,
Ikin lejlekët larg në arrati,
Shumë ujë gri, shumë qiej gri.

Pikojnë strehët melankoli,
Shumë strehë gri, shumë pika gri.
Postier përtaci vjen në shtëpi
Me pallto gri, me letra gri.

Hesht pas dritares maçoku i zi,
Gazeta hapet me tituj gri,
Gri në dritare, gri në vetmi,
Ikin lejlekët larg në arrati...

(1991)

Në këtë poezi bukurtingëllimi formohet përmes tri mënyrave, të cilat përplotësojnë njëra-tjetrën. Së pari, eufonia krijohet nga asonancat, konsonancat dhe rimat, së dyti, nga aliteracioni dhe së treti nga përsëritjet befasuese funksionale të fjalës gri, përsëritje që shfaqen në trajtën e anaforave, epiforave, anadiplozave dhe të simplokave. Kjo tërësi kombinimesh tingullore krijon një melodi trishtimi që e përndjek njeriun ngado, brenda strehëzës së tij e jashtë saj. Vetmia, mërzia dhe trishtimi i subjektit lirik paraqitet përmes rimës, ritmit dhe tingujve që përsëriten në formën e një kënge vajtimi për shqiptarët, të cilët ikin larg në kërkim të një jete më të mirë. Largimet masive të shqiptarëve në fillimvitet e demokracisë në Shqipëri, krahasohen me shtegtimet e lejlekëve, të cilët nuk e durojnë dot ftohtësinë dhe zymtësinë.

Arratia është vendi i papërcaktuar, që nënkupton edhe kohën e papërcaktuar, në të cilën shqiptarët ikin për t'i shpëtuar burgut të izolimit në vendin e tyre dhe kronotoposi i kësaj ikjeje mbetet i paqartë, pasi nuk dihet se ku do të vendosen dhe as sa kohë do të zgjasë qëndrimi në emigrim.

⁴ Agolli, Dritëro, *Lutjet e këmbanës –Poezi të zgjedhura*, Botimet Toena, Tiranë, 1998, f.66.

Asonancat, konsonancat dhe rimat e japin efektin ritmik në fund të vargut, ndërsa aliteracioni e jep këtë efekt në të gjithë strukturën e brendshme të poezisë. Eufonia krijohet përmes tingullit *i*, i cili përbën jo thjesht rimën vargore, por bart edhe funksion kuptimor, sepse përmes këtij tingulli fundor jepet atmosfera e trishtë dhe e zyrtë e periudhës së eksodit të shqiptarëve drejt vendeve të ndryshme të botës. Përsëritja e këtij tingulli të sjell ndërmend gjendjen kaotike, si dhe pasigurinë dhe ëndrrat e vrara, ku çdo kënd i të vështuarit është i errët.

Leximi vertikal i strukturës ritmiko-intonative përbëhet nga fjalët-emra, ose fjalët-mbiemra: *gri-vetmi*, *arrati-gri*, *melankoli-gri*, *shtëpi-gri*, *i zi-gri* dhe *vetmi-arrati*. Çiftet e pranëvëna i përkasin të njëjtës fushë leksikore, konkretisht konceptit të trishtimit, i cili shenjohet drejtpërdrejt përmes mbizotërimit të fjalës *gri*, në raport me fjalët e tjera. Në të gjitha çiftet ritmike të strukturës së poezisë, me përjashtim të pranëvënies së fundit (*vetmi-arrati*), fjala *gri* udhëheq vargjet ritmike. Kjo përsëritje ka vlera të larta bukuringëllouese dhe kuptimore, sepse vetë sistemi i gjuhës shqipe është shumë prodhimtar në fjalët që mbarojmë me *i*, por në këtë poezi duket sikur autori, qëllimisht, nuk e ka shfrytëzuar arsenalin e pafund të fjalorit dhe të fushës leksikore të këtij koncepti, por ka theksuar vetë fjalën "*gri*", përmes rimarrjes së herëpashershme e të larmishme.

Përveçse në strukturën ritmike në fund të vargut, tingulli *i* është mbizotërues edhe në trupin e brendshëm të vargjeve. Në rastin e poezisë "*Gri*", aliteracionet e përdoruara kanë si funksion themelor theksimin e kumtimit, prandaj ato mund të quhet edhe aliteracione të kushtëzuara, duke qenë se i nënshtrohen drejtpërdrejt brendisë së tekstit. Konkretisht, tingujt e vargjeve dhe të strofave janë të përbashkëta me fjalën "*gri*", e cila bart kuptimin kryesor të poezisë. Aliteracioni mbizotërues e ka prejardhjen te tingujt e kësaj fjale. Kështu, tingulli *i* është përdorur 35 herë në poezi, ndërsa bashkëtingëllorja *r* është përdorur 21 herë dhe bashkëtingëllorja *g* është përdorur 16 herë. Po t'u referohemi këtyre shifrave, rezulton se kemi përshkallëzim të tingujve, ku sipas dendurisë së përdorimit renditen në rend invers, nga përdorimi më i ulët tek më i larti: *g-r-i*, sepse kështu rritet edhe jehona tingullore dhe efekti semantik i fjalës-çelës të poezisë së marrë në shqyrtim.

Një përdorim tjetër të dendur në këtë poezi ka edhe tingulli *t*, i cili përdoret 20 herë. Edhe përdorimi i këtij aliteracioni i shkon për shtat vijës ideore të vargjeve, duke krijuar efektin e imazhit dëgjimor të një *-t,-t, -t, -t, -t, -t, -t, -t*-je që është bashkëshoqëruese e gjendjes së ftohtë e të zyrtë, ku mungesa e ngrohtësisë dhe e shpresës i shtyn shqiptarët të enden rrugëve të botës në kërkim të një jete më të mirë. Kjo klithmë e brendshme është e vazhdueshme dhe oshtin në skutat më të thella të qenies njerëzore, sepse të gjitha pikat e orientimit dhe të ndërlidhjes me të tjerët janë *gri*: qielli, uji, dritarja, streha e deri te postieri, prej të cilit presim lajme të reja.

Një tjetër element përbërës i bazës eufonike të kësaj poezie janë edhe përsëritjet befasuese me karakter funksional. Kështu, shenjuesi "*gri*" shfaqet në trajta përsëritjesh e rimarrjesh nga më të larmishmet, duke krijuar një ritëm të këndshëm muzikor, por edhe duke forcuar shprehësinë dhe duke veçuar kuptimin e fjalëve që përsëriten. Thurjet kompozicionale nisin me përsëritjet brenda të njëjt

varg (Shumë ujë gri, shumë qiej gri); me anadiplozat ose dyfishimet, ku fjala gri në fund të vargut të parë rimerret edhe në fillim të vargut të dytë (Shumë ujë gri, shumë qiej gri/Gri në dritare, gri në vetmi) dhe kështu bartet kuptimi për t'u përplotësuar në vargun pasues, meqenëse nuk është realizuar brenda njësisë së vargut të parë.

Përveç skemave klasike të ndërtimit të figurave tingullore, Dritëro Agolli sjell edhe modele tërësisht origjinale, të cilat vijnë me natyrshmëri e thjeshtësi para lexuesit, duke mos rënë pre e modeleve që shpërfaqin mbllaçitje shabllonesh të drunjta. Shumë prej përbërësve të stilit të tij krijues mbeten "të paemëtuara" nga stilistika dhe termat teorike mbi mënyrat e ndërtimit të vargjeve poetike. Kështu, ai ndërton skema përsëritëse befasuese, siç është rasti i rimarrjes së të njëjtit varg, në fillim e në fund të strofës së parë. Vizualisht kjo lloj përsëritjeje të krijon përfytyrimin e bazamenteve të një ndërtese, pikërisht tavanit dhe tabanit, të cilët mbajnë brenda tyre elementet e tjera të poetizuara. Kjo ide përvijohet më tej teksa ndalesh tek shënjesit poetikë: **uji** (simbol i vijimësisë dhe vitalitetit në tokë) dhe **qielli** (*simbol i strehëzës së shpirtrave të vdekur*, por edhe simbol i lirisë së pakufishme), shënjesit të cilët ndërtojnë bazamentin e shoqërisë njerëzore (tokën dhe qiellin) dhe gjithçka vërtitet rreth tyre. Përpos aspektit simbolik e funksional që shkon drejt së njëjtës hulli, këta dy përbërës kanë të përbashkët edhe aspektin pamor, sepse si uji ashtu edhe qielli, në gjendje normale janë ngjyrë blu. Kur ia behin stuhitë, të dy kthehen në ngjyrë gri dhe turbullohen e amorfizohen. Uji i tokës gjendet në pozita vasaliteti me gjendjen e qiellit, sepse kur kushtet klimaterike të qiellit përkeqësohen kjo reflektohet menjëherë në tokë. Si pasojë e egërsimit të qiellit dhe të ujit, lejlekët ikin në arrati në kërkim të hapësirave të qeta e ngrohta. Përsëritja e të njëjtin varg, në fillim dhe në fund të strofës së parë, mbart thelbin e mesazhit poetik agollian dhe nuk është një përsëritje vetëm me efekte ritmike.

Në shumë raste të tjera, përsëritjet në poezinë e Dritëro Agollit kanë thjesht efekt imitues dhe nuk janë në përbërje të fjalëve kryesore të poezisë. Këto përsëritje u përngjajnë onomatopeve, sepse kanë në bazë imitimin e zhurmave të natyrës, ose të qenieve të gjalla. Përsëritjet, paraqiten në trajtë asonancash e aliteracionesh dhe kanë karakter shprehës, sepse sjellin atmosferën kuptimore të poezisë. P.sh. Një efekt thjesht bukurtingëllues ndihet në poezinë "Pleqtë e qytetit tim":

Dhe zë kërcet kurrizi në karrige,
Në tavolinë shuhet një çibuk;
Dhe kulmi i kafenesë si kaike
Mes degëve të rrapit humb si muzg.

"Aliteracionet: kër-, kurr-, karr-, rra- janë riprodhim i kërcitjes, i kërr-, kurr-, karr-it të karriges dhe të kockave të lashta të veteranëve që poetizohen në këtë poezi".⁵
Gjithashtu, vetë bashkëtingëllorja *k*, e cila ka përdorimin më të gjerë në këto vargje,

⁵ Bashkim Kuçuku, "Afri me poezinë popullore, bartje e përbërësve të saj", pasthënie në vëllimin poetik të Dritëro Agollit "Luçjet e këmbanës", Toena, Tiranë, 1998, f. 366.

jep idenë e ngadalësisë e të kërkëllitjes,^{6*} duke krijuar kështu mozaikun e imazheve dëgjimore, që e bëjnë poezinë e Agollit të ngjashme me muzikën.

Në çdo poezi të tij ka bukurtingëllim, efekt ky që krijohet falë "orkestrimit" të mjeteve gjuhësore në mënyra të larmishme. Ashtu siç kombinohen shtatë notat muzikore për të përfutur miliona motive muzikore, ashtu kombinohen edhe 36 shkronjat e alfabetit të shqipes nga ana e Dritëro Agollit për të krijuar një larushi motivesh poetike me bazë eufonike.

Duke iu referuar edhe analizave të poezive të mësipërme, shohim se karakteristikë kryesore e stilit krijues agollian është muzikaliteti, i cili vihet në shërbim të përmbajtjes dhe të kuptimit të poezisë. Elementet formale të stilit poetik, si: ngjyra e tingujve, përsëritjet, ritmi dhe rima, janë harmonizuar me përmbajtjen për të përçuar më tepër ndjenjën dhe mesazhin poetik. Pikërisht, për këtë tipar të të shkruarit, vargu mund të konsiderohet jo vetëm auditiv e melodioz, por shpërfaq edhe trajtën vizuale për shkak të përdorimit të shprehjes konkretizuese dhe të figurave imazh, të cilat edhe idetë e mesazhet më abstrakte i kthejnë në përbërës konkretë.

Shtresa tingullore në poezinë e Dritëro Agollit shfaqet në trajtën e imazhit dëgjimor, që shërben si faktor integral për veprimin estetik të poezisë. Toni emocional krijohet nga kombinimet dhe përsëritjet tingullore. Për shndërrimin e tingujve gjuhësorë në faktorë artistikë janë të nevojshme kuptimet, konteksti dhe toni. Prandaj konkludojmë se eufonia në poezinë e Dritëro Agollit shfaqet në dy forma kryesore: së pari, imitimi i tingujve fizikë, ose imazhet dëgjimore, që realizohen përmes riprodhimit të zërave natyrorë me anë të tingujve të shënjesve prej të njëjtës fushë leksikore dhe së dyti, përmes simbolikës tingullore, ku vetë tingujt mbartin domethënie. 3

Simbolizmi fonetik i metrikës është bërë objekt studimi në shkencën shqiptare rreth një shekull më parë nga Luigj Gurakuqi dhe kjo teori është pranuar edhe nga studiuesit e mëvonshëm, sidomos në rastin e analizimit të poezisë së traditës klasike shqiptare⁷. Në përputhje me idetë që sugjeron, Dritëro Agolli ndërton edhe strukturën ritmike të vargut. Amplitudat e mendimit të tij poetik shkrihen në efekte ritmike, dhe anasjelltas, këto efekte sugjerojnë nuancat e mendimeve. Ai synon të realizojë orkestrimin e domethënies së fjalës me ritmin sugjestiv të saj, ku njëri mjet e plotëson tjetrin.

Ndërsa në aspektin tematik, eufonia është e pranishme kudo, pavarësisht motivit të përzgjedhur për trajtim. Për këtë aspekt të kudogjendur, studiuesi Ali Aliu thotë: "Ngarkesa emocionale dhe estetike, që është rezultat i harmonisë ritmike dhe eufonisë tingullore, vjen si një natyrë e brendshme, përherë e pranishme e poetit, që botën, njerëzit, përditshmërinë i përjeton si një harmoni të

^{6*} Referuar librit "Shumësia e tekstit" të autorit Rexhep Ismaili (Rilindja, Prishtinë, 1980, fq. 180) ku thuhet se Luigj Gurakuqi e karakterizonte bashkëtingëlloren *k* si element që bën pjesë në grupin e bashkëtingëlloreve të ngadalta, së bashku me bashkëtingëlloret *q* dhe *g*.

⁷ Kemi parasysh këtu studiuesin Rexhep Ismaili, i cili i referohet konceptit të simbolizmit fonetik të Luigj Gurakuqi, në një kapitull të veçantë të librit të tij studimor "Shumësia e tekstit", Rilindja, Prishtinë, 1980.

tillë të pranishme në natyrë, që nga lindja. Kjo harmoni, pra, vjen së bashku me frymëzimin, së bashku me poezinë. Pavarësisht nëse bota, përditshmëria vjen miqësore apo armiqësore, harmonia dhe eufonia janë tharm i patjetërsueshëm, janë ritëm i të jetuarit të poetit..."⁸

Bibliografia:

1. Agolli, Dritëro. *Lutjet e këmbanës –Poezi të zgjedhura*, Botimet Toena, Tiranë, 1998.
2. Ali Aliu, Për librin "Lypësi i kohës", botuar në: Studime për Agollin në Kosovë, përmbledhje nga Merxhan Avdyli, Argeta LMG, Tiranë, 2006.
3. *Aspects of Word Frequencies*, "Word frequency diversity and typology", (Group of authors: Ioan-Iovitz Popescu, Jan Macutec, Gabriel Atman), RAM-Verlag@t-online.de, 2009.
4. Bashkim Kuçuku, "Afri me poezinë popullore, bartje e përbërësve të saj", pasthënie në vëllimin poetik të Dritëro Agollit "Lutjet e këmbanës", Toena, Tiranë, 1998.
5. Bourdieu, Pierre. "The imposition of form", in *The rules of art – Genesis and structure of the Literary field*, Stanford University Press, California, USA, (first published 1992, Edition du Seuil), 1996.
6. Ismaili, Rexhep. *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
7. Pope, Alexander, *Essay on Criticism*, (Publikimi i parë më 1711), The floating press, Auckland, New Zealand, 2010, f. 12.
8. *The Penguin Dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin Books, USA, 2001, f. 278. Wellek & Woren, *Theory of Literature*, Harcourt Brace & World, New York, 1956.

⁸ Ali Aliu, Për librin "Lypësi i kohës", botuar në: Studime për Agollin në Kosovë, përmbledhje nga Merxhan Avdyli, Argeta LMG, Tiranë, 2006, f. 138.

DANILLO KISH

DISA KËSHILLA PËR TË GJITHË SHKRIMTARËT E RINJ

Mos shko për asnjë ide në vdekje, dhe mos e nxit dikë të mbytet. Mos u bëj qyqar, dhe urreji qyqarët. Mos harro se heroizmi kërkon çmim të madh. Ushqeje dyshimin kundër ideologjive në pushtet dhe princave. Ruaju që të folurin tënd të mos e ndotësh me gjuhën e ideologjisë. Beso se je më i fuqishëm nga gjeneralët, por mos u mat me ta. Mos beso në projekte utopike, por në ato që i krijon vetë. Bëhu njësoj fodull ndaj princave dhe ndaj masës. Ruaje ndërgjegjen e pastër në raport me privilegjet që t'i sjell zanati yt prej shkrimtari. Mos u preokupo me urgjencën historike dhe mos beso në metaforën mbi trenat e historisë.

Pra, mos kërce në trenat e historisë, sepse kjo është vetëm metaforë e turpshme. Ta kesh gjithmonë parasysh idenë: kush e godit cakun gjithçka i shkon huq. Mos shkruaj reportazhe nga vendet ku ke qëndruar si turist; mos shkruaj fare reportazhe, ti nuk je gazetar. Mos beso në statistika, në shifra, në deklarata publike: realiteti është ai që nuk shihet me syrin huq. Mos i vizito fabrikat, kooperativat, kantieret: përparim është ai që nuk shihet me syrin huq. Mos u merr me ekonomi, sociologji, psiko-analizë. Mos i paso filozofitë lindore, zen-budizmin.

Bëhu i vetëdijshëm për faktin se fantazia është motra e rrenës dhe së këndejmi e rrezikshme. Mos u shoqëro me askënd: shkrimtari është vetëm. Mos u beso atyre që thonë se kjo botë është më e keqe nga të gjithat tjerat. Mos u beso profetëve, sepse ti je profet. Mos u bë profet, sepse arma jote është dyshimi. Ta kesh ndërgjegjen e qetë: princat nuk të interesojnë, sepse ti je princ. Ta kesh ndërgjegjen e qetë: minatorët nuk të interesojnë, sepse ti je minator. Dije se atë që nuk e ke thënë në gazeta, nuk ka dështuar për gjithmonë: kjo është torfë.

Mos shkruaj me porosinë e ditës. Mos lidh bast për çastin, se do të pendohesh. Mos lidh bast as për amshimin, sepse do të pendohesh. Bëhu i pakënaqur me fatin tënd, sepse vetëm budallenjtë janë të kënaqur. Mos u bë i pakënaqur me fatin tënd, sepse ti je përzgjedhës. Mos kërko arsytim moral për ata që kanë tradhtuar. Ruaju konsekuencës së tmerrshme. Ruaju analogjive të rrejshme. Besoju atyre që shtrenjtë e paguajnë jokonsekuencën e vet. Mos u beso atyre të cilët jokonsekuencën e vet e paguajnë shtrenjtë. Mos e përfaqëso relativizmin e të gjitha vlerave: hierarkia e vlerave ekziston. Çmimet që t'i ndajnë princat merri me indiferencë, por mos bën asgjë që t'i meritosh. Beso se gjuha në të cilën shkruan është më e mira nga të gjitha gjuhët, se ti tjetër nuk ke. Beso se gjuha në të cilën shkruan, është më e keqe nga të gjitha gjuhët, ndonëse nuk do ta ndërroje me asnjë gjuhë tjetër. Mos u bë servil, sepse princat do të marrin për portier. Mos u fry, se do t'u ngjash portierëve të princave. Mos lejo të të bindin se shkrimet tua janë pa dobi

shoqërore. Mos mendo se shkrimet tua janë punë e dobishme shoqërore. Mos mendo se edhe ti vetë je anëtar i dobishëm i shoqërisë. Mos lejo të të bindin se për këtë shkak je parazit shoqëror.

Beso se soneti vlen më shumë nga fjalimet e politikanëve e të princave. Dije se soneti yt nuk do të thotë asgjë, karshi retorikës së politikanëve e princave. Për çdo gjë të kesh mendimin tënd. Mos e thuaj për çdo gjë mendimin tënd. Ty fjalët të kushtojnë më së paku. Fjalët tua janë më të çmueshme. Mos u prezanto në emër të kombit tënd, se kush je ti që të jesh përfaqësues i dikujt pos i vetvetes! Lufta kundër padrejtësive shoqërore, duke mos bërë nga kjo program. Lufta kundër padrejtësisë shoqërore të të mos largojë nga rruga jote. Njihe mendimin e të tjerëve, pastaj refuzoje. Mos krijo program politik, mos krijo kurrfarë programi: ti krijohesh nga magma dhe kaosi i botës. Ruaju nga ata që të ofrojnë zgjidhje përfundimtare. Mos u bë shkrimtar i pakicave. Sapo ndonjë bashkësi nis të të përvetësojë, këqyre veten.

Mos shkruaj për lexuesin mesatar: të gjithë lexuesit janë mesatar. Mos shkruaj për elitën, elita nuk ekziston; elitë je ti. Mos mendo mbi vdekjen, dhe mos harro se je i vdekshëm. Mos beso në pavdekshmërinë e shkrimtarit, këto janë marrëzi të profesorëve. Mos u bën tragjikisht serioz, se kjo është komike. Mos u bë komediant, sepse aristokratët janë mësuar t'i argëtojnë. Mos u bë palaço oborresh. Mos mendo se shkrimtarët janë ndërgjegjja e njerëzimit: veç ke parë aq faqezi. Mos lejo të të bindin se nuk je askush dhe asgjë: veç e ke parë se aristokratët u frikësohen poetëve.

Mos shko për asnjë ide në vdekje, dhe mos e nxit dikë të mbytet. Mos u bën qyqar, dhe urrej qyqarët. Mos harro se heroizmi kërkon çmim të madh. Mos shkruaj për festa e jubile. Mos shkruaj lëvdata, se do të pendohesh. Mos shkruaj fjalime mortore për kolosët, se do të pendohesh. Nëse nuk mund ta thuash të vërtetën – hesht. Ruaju gjysmë të vërtetave. Kur është kremte e përgjithshme, nuk ka arsye të marrësh pjesë edhe ti. Mos u bënë tolerant nga mirësjellja. Mos e kërko drejtësinë në pe: me budallenjtë mos u grind. Mos lejo të të bindin se të gjithë kemi të drejtë njësojë, dhe për shijet nuk vlen të debatohet. Kur të dy bashkëbiseduesit janë gabim, kjo ende nuk do të thotë se të dy kanë të drejtë. (Popper). Të lejosh që tjetri të ketë të drejtë, nuk na mbron nga një rrezik tjetër: të besojmë se ndoshta të gjithë kanë të drejtë. Mos debato me injorantët mbi gjërat të cilat për herë të parë i dëgjojnë nga ti. Të mos kesh mision. Mos beso në mendimin shkencor. Mos beso në intuitë. Ruaju cinizmit, pra edhe atij vetjak. Evitoji vendet e përgjithshme ideologjike dhe citatet.

*Danilo Kish (1935-1989) ishte njëri prej shkrimtarëve më të njohur të Ballkanit dhe kritik i ashpër i nacionalizmit serb. Vdiq në Paris. Është autor i disa romaneve mbi tragjeditë private dhe publike të shekullit XX-të. (dialogplus.ch)

IZAIM MURTEZANI

RRETH RITIT TË RRAHJES SIMBOLIKE TË DHËNDRIT

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë trajtesë shkencore mëtohet të jepen disa të dhëna rreth ritit që i referohet rrahjes simbolike të dhëndrit si mbijetojë e një institucioni tejet të lashtë që është i njohur si iniciacion, apo rishtari e pubertetit, apo adoleshencës si më tipike në kuadër të shoqërive arkaike. Rrahja simbolike e dhëndrit mund të ndërlihet me ritualin e lashtë të rishtarisë pasi torturimi fizik nënkuptonte vdekjen simbolike të rishtarëve, përkatësisht “vdekjen” e fazës së djalërisë, apo beqarisë dhe aderimin në një fazë tjetër, apo më konkretisht në atë të burrërisë.

Në esencën e përmbajtjes së ritualit të rishtarisë çdoherë qëndron vdekja simbolike e rishtarëve, apo e fazës së mëparshme inferiore me qëllim që të përgatitet “lindja e re”, nënkuptohet me një status të ndryshuar shoqëror, siç është burrëria si një fazë më superiore gjatë së cilës përfitohej e drejta e martesës, apo krijimit të familjes dhe lënies së pasardhësve.

Fjalë kyçe: mbijetojë, rishtari, dasmë, ritual, rrahje, paganizëm, mit, lindje, vdekje, torturë, dhëndër, kaos, kozmos, mit, etj.;

1. Vrojtime hyrëse

Folklori dhe etnologjia hulumtojnë traditën tonë popullore përmes eksplorimit, sintetizimit dhe seleksionimit të materialit empirik i cili pastaj u nënshtrohet analizave të ndryshme shkencore nëpërmjet të cilave mëtohet të depërtohet në prapavijën e esencës së tij përmbajtësore. Nënkuptohet se kjo materie, qoftë me prapavijë etnologjike, apo folklorike i nënshtrohet një modifikimi të përhershëm të përmbajtjes së saj duke pasur parasysh faktin e kalimit, apo tejbartjes nëpër periudha të ndryshme dhe të stërzgjatura kohore. Në këtë kontekst, ka të drejtë studiuesi me famë botërore, Sentiv, kur thekson se tradita popullore nuk mund të krahasohet me ndonjë thesar të varrosur: ajo paraqet tërësi të thesareve të ndryshme të çdo lloji, bartje të pafund të mijëra e mijëra krijimeve të nduarnduarshme të cilat populli ua dhuron kombeve të qytetëruara. Zinxhiri i artë i traditës nuk prehet i palëvizur në ndonjë arkivol të mbyllur hermetikisht, por njësoj si edhe yjet, i nënshtrohet lëvizjes së çuditshme dhe të pandërprerë. Pikërisht, kjo lëvizje e pandërprerë e vlerave folklorike dhe etnologjike ndikon që ato t'u nënshtrohen transformimeve të shumta të cilat ndonjëherë janë aq të mëdha, saqë e zbehin plotësisht tabanin e tyre fillestar pagan mbi të cilin edhe janë ngritur dhe zhvilluar më vonë gjatë periudhave historike (sipas Eliade, 2002: 76).

Duke e pasur parasysh një fakt të tillë, atëherë imponohet nevoja që të jemi shumë më të kujdesshëm në vlerësimin dhe venerimin e dukurive folklorike dhe etnologjike, pasi ato në përbajtjen e tyre ngërthejnë, apo kanë përthithur shtresa të ndryshme kulturore, varësisht nga kontekstet kohore nëpër të cilat kanë kaluar. Megjithatë, edhe përkundër transformimit që ka pësuar pothuajse çdo lëndë me prapavijë etnologjike dhe folklorike, megjithatë ajo ka arritur të ruajë qoftë edhe pjesërisht tabanin e saj pagan, apo fillestar, por duke përfituar më vonë si zakonisht edhe ndonjë shtresë tjetër kulturore, por që nuk ka arritur ta cenojë edhe aq shumë karakterin parak të saj, apo karakterin pagan.

Një ndodhi e kësaj natyre e karakterit folklorik dhe etnologjik është padyshim dasma e cila në brendinë e saj përbajtjesore ka arritur të ruajë një numër të madh të elementeve me prapavijë pagane, por që më vonë të përthithë edhe elemente tjera, varësisht nga konteksti kohor në të cilin është zhvilluar dhe përçarur ajo. Në këtë kontekst, në përbajtjen e kompleksit të riteve që ekzekutohen gjatë dasmës, kanë mbetur praktika zakonore, apo mbijetoja të caktuara të kohërave pagane të cilat duhen të studiohen dhe të nxirren në sipërfaqe me të gjithë prapavijat e tyre religjioze. Përndryshe, dasma me një varg ritesh të saja duke përfshirë edhe ritin të cilin e kemi në epiqendër të trajtesës sonë shkencore, paraqet një segment të rëndësishëm dhe kompleks të ciklit jetësor antropologjik, pasi nëpërmjet saj mundësohen një numër i madh ndryshimesh të statusit sociologjik, apo ontologjik të protagonistëve më kryesorë të saj. Përmes dasmës, thotë Kliford Gerc, transmetohen një tok mesazhesh të nduarnduarshme, si dhe vlera jashtëzakonisht të rëndësishme kulturore me të cilat karakterizohen ritet e kalimit (nga një fazë jetësore në një fazë tjetër jetësore). Dasma, në trajtë të dendur, reflekton realitetin shoqëror, raportet ekonomike dhe fisnore, pozitën e gruas, raportin ndaj botës tjetër dhe paraqet ngjarje paradigmatiche të kulturës sonë (Geertz, 1973: 276-277).

Dasma me dy kryeprotagonistët e saj - nusen dhe dhëndrin, paraqet një dramë të llojit të vet për shkak se për të gjithë pjesëmarrësit e saj, është përcaktuar paraprakisht roli të cilit duhet t'i nënshtrohen. Nënkuptohe se kryeprotagonistët e saj e kanë rolin parësor, e sidomos nusja e cila braktis gjininë e saj për t'iu bashkangjitur asaj të bashkëshortit të ardhshëm. Në këtë kontekst, edhe dhëndri është bartës i riteve të ndryshme përmes të cilave mëtohet të ndillet mbarësia dhe pjelloria me qëllim që të sigurohet kalimi, apo tranzicioni sa më i denjë prej statusit të djalit në atë të burrit. Dhëndri në cilësinë e kryeprotagonistit të dasmës u nënshtrohet një numri të madh të aktiviteteve rituale dhe magjike me prapavijë pagane, por kësaj radhe do të ndalemi për të shqyrtuar më gjerësisht vetëm një rit, apo praktikë zakonore që e kemi hasur në trevën e Dervenit të Shkupit, por edhe më gjerë. Bëhet fjalë për ritin e rrahjes simbolike, apo grushtimin e dhëndrit që nuk përjashtohet mundësia të paraqesë ndonjë relik të riteve të rishtarisë, apo iniciacionit, qenësinë e të cilit do ta shpjegojmë më poshtë. Riti i njëjtë është i pranishëm edhe në rrethinën e fshatrave të Tetovës dhe është përshkruar në mënyrë shumë të detajuar nga dr. Fadil Sulejmani në librin e tij me titull "Lindja, martesja dhe mortja në Malësinë e Tetovës".

2. Përshkrimi i ritit në fjalë

Ritet, apo praktikat zakonore çdoherë ngërthejnë në brendinë e tyre karakterin manifestues dhe latent. Karakteri manifestues mund të vërehet gjatë ekzekutimit të tyre, përkatësisht bëhet fjalë për pjesën përmbajtjesore të riteve e cila pasqyrohet para nesh, në trajtë të konkretizuar, kurse karakteri latent i dedikohet të dhënës se vështirë interpretohet prapavija religjioze e ekzekutimit të riteve, sidomos nga distanca e sotme kohore. Përndryshe, pjesëmarrësit e ritit kur i pyet për qëllimin apo prapavijën e ekzekutimit të tij, në shumicën e rasteve, i rrudhin krahët dhe nuk kanë përgjigje adekuate duke theksuar faktin se ritin e ushtrojnë pasi si të tillë ua kanë lënë stërgjyshërit, nënkuptohet në cilësinë e trashëgimisë kulturore. Nga kjo rezulton se prapavija religjioze e ekzekutimit të riteve, ka humbur nëpër hullitë e kohës, pa lënë gjurmë në ditët tona, andaj i mbetet studiuesit që ta shpjegojë dhe diagnostifikojë prapavijën e ekzekutimit të riteve, nënkuptohet në bazë të përjasjeve me materiale tjera të kësaj natyre, por që janë regjistruar te popujt, apo fiset më arkaike që kanë regres në rrugën e zhvillimit të tyre kulturor si pasojë e zhvillimit të ulët tekniko-teknologjik. Këto bashkësi indigjene kanë ruajtur sot në mënyrë më autentike botëkuptimet që u referohen vlerave të ndryshme folklorike dhe etnologjike.

Në vazhdim do të paraqesim përmbajtjen, apo anën manifestuese të ritit në fjalë që pastaj më vonë t'i kthehemi pjesës latente, apo prapavijës religjioze që qëndron në esencën e tij. Bartës i ritit në fjalë është dhëndri i cili me ekzekutimin e këtij riti përmbyll pjesën publike të ekzekutimit të riteve që pastaj t'u nënshtrohet riteve tjera, veçmas gjatë natës së gjerdekut, por në praninë, vetëm të nuses së tij të ardhshme. Pra, në prag të mbylljes së dhëndrit me nusen, në prani të anëtarëve më të ngushtë të familjes dhe farefisit më të afërm, pasi këndohet duvaja islame nga hoxha i fshatit, dhëndri fillon të përshëndetet për herë të fundit me të pranishmit (farefisin e tij) dhe më në fund edhe me prindërit duke u kërkuar ndjesë, nëse ka bërë eventualisht ndonjë mëkat ndaj tyre në periudhën e djalërisë, të cilës i jepet fund në këto çaste dramatike. Përshëndetja e fundit me prindërit është shumë e dhimbshme, sepse djali me aktin e martesës përfundimisht del nga përkujdesi i tyre, apo tutoria e tyre dhe bëhet subjekt i pavarur i cili tani e tutje mban vetë përgjegjësi për veprimet e kryera. Sekuenca e tillë ritualeske shënohet edhe nga dr. Fadil Sulejmani në librin e sipërpërmendur të tij në të cilin theksohet se "të marrët në grykë të prindërve, marrja e hallallëkut nga ta, ka të bëjë me ndarjen e përjetshme të djalit nga nëna dhe babai, të cilët ia bëjnë hallall çdo gjë të mirë e të keqe që ka bërë prej kur ka lindur e deri në atë moment. Ndarja e djalit nga prindërit është pak a shumë e ngjashme me atë të vajzës" (1988: 281).

Pas përfundimit të përshëndetjes me prindërit fillojnë goditjet, apo grushtimet nga të pranishmit (pjesëtarë të farefisit më afërt të dhëndrit) që përfundojnë në shpinë, apo në pjesët tjera trupore të dhëndrit. Ai me këtë rast duhet të manifestojë zhdërvjelltësi të theksuar me qëllim që t'u shmanget më lehtë goditjeve që pasojnë. I vetmi person që i del në mbrojtje dhëndrit është shoqëruesi i tij i cili prej fillimit e deri në fund ka rolin përkujdesës për mbarëvajtjen e procesit ritualesk duke dhënë edhe këshilla të nevojshme për këtë. Ndërkaq, dhëndri është i

obliguar që t'i zbatojë me përpikëri urdhrat e shoqëruesit apo përcjellësit të tij, pasi ky i fundit është i njohur detajisht me sprovat e tilla ritualeske, meqë njëherë ka qenë bartës i tyre. Në të kaluarën thuhet se goditjet kanë qenë aq të rënda, saqë ndonjëherë kanë shkaktuar edhe lëndime serioze tek iniciantët (rishtarët apo neofitët). Praktikimi i këtij riti, sot, është vetëm formal dhe simbolik, madje në shumë raste edhe nuk gjen përdorim. Ky rit, përkatësisht kjo provë nëpër të cilën duhet të kalojë dhëndri, apo rishtari, sipas elementeve me të cilat është e mbarur, paraqet ndonjë survival, apo mbijetëse eventuale e ritualit të rishtarisë (iniciacionit) me ekzekutimin e të cilit në të kaluarën e largët është shënuar kalimi nga një fazë jetësore në një fazë tjetër jetësore. Si më paradigmatiche dhe më kuptimplote ka qenë gjithsesi rituali i rishtarisë së pubertetit, apo adoleshencës.

Studiuesi Ndoc Papeleka duke kërkuar rrugët më të përshtatshme të zbërthimit të prapavijës së disa njësive folklorike dhe etnologjike me taban pagan me të drejtë thekson se "qëmtimi dhe studimi i asaj shtrese të folklorit ku ka reminishenca të inicimeve (rishtarisë) të qëmotshme mund të kryhet vetëm duke u mbështetur tek analizat e historianëve të religjioneve dhe ato të etnologëve, sepse vetëm kështu mund të shohësh përtej figurave stilistike simbole magjiko-religjioze, të bësh atë që M. Eliade e quan "rivleresimi metafizik i imazheve tradicionale" (Papeleka, 1999: 126). Duke u nisur nga një thënie e tillë, atëherë edhe riti i rrahjes së dhëndrit duhet të kundrohet në kontekst të riteve të rishtarisë të cilat edhe sot e kësaj dite praktikohen në shumë shoqëri arkaike të cilat kanë zhvillim historik më të ngadalësuar dhe si rrjedhojë e kësaj edhe ruajtje apo konservim të praktikimit të riteve të cilat u përkasin kohëve më të mugëta të zhvillimit njerëzor. Ritet e rishtarisë, apo iniciacionit që praktikohen te shoqëritë apo fiset e tilla arkaike, sidomos janë kuptimplote dhe të fuqishme gjatë kohës së pubertetit. Pas mbarimit të këtyre sprovave ritualeske të rishtarisë, individët përfitonin të drejtën e martesës. Supozohet se ritet e rishtarisë së adoleshencës, si më paradigmatiche, apo më tipike, me kalimin e kohës janë zhvendosur dhe janë bërë pjesë përbërëse e kompleksit të riteve të dasmës, ashtu siç ka ndodhur edhe me ritin të cilin e kemi në epiqendër të trajtesës sonë. Pra, në kushte të familjes monogamike njerëzore dhe si pasojë e kësaj - familjes patriarkale martesore, iniciacioni, apo rishtaria parësore e pubertetit në shoqëritë arkaike, është bartur, apo zhvendosur në rishtarinë e riteve të dasmës ku ka gjetur një strolull më të përshtatshme për të jetuar në trajtë të mimikruar edhe më tej, madje edhe sot e kësaj dite.

3. Riti në fjalë si reminishencë e rishtarisë

Që të kuptohet më mirë riti në fjalë duhet thënë disa fjalë për përmbajtjen e iniciacionit, apo rishtarisë e cila në të kaluarën ka pasur rol parësor në sistemin religjioz, pothuajse të të gjitha bashkësive njerëzore në botë. Iniciacioni nga aspekti sociologjik, nënkupton "rit të kalimit" nga një identitet në një identitet tjetër shoqëror. Kjo nënkupton faktin se bëhet ndërrimi i statusit shoqëror të rishtarëve të cilët kalojnë nga statusi inferior në cilësinë e vajzës, apo djalit drejt statusit superior në cilësinë e gruas, apo burrit. Skenari i riteve të iniciacionit, apo kalimit, çdoherë, sipas Genepit ndërthen në vete tri faza: atë të reparacionit (veçimit, ndarjes,

shkëputjes) së rishtarit, margjinalitetit (liminalitetit), përkatësisht fazës kufitare në të cilën pleksen, apo kryqëzohen braktisja dhe aderimi në statusin e ri shoqëror dhe së fundmi faza e agregacionit (bashkimit, apo integritit të rishtarit në statusin e ri shoqëror). Faza e parë nënkupton ndarje të subjekteve të ritualizuara nga konteksti shoqëror i mëparshëm, përkatësisht izolimi në ndonjë vend të caktuar ku ata u nënshtrohen sprovave të vështira rituale, faza e dytë paraqet çastet e kalimit ritualesk nga një status shoqëror në një tjetër dhe faza e fundit, rikthim të iniciantëve, apo rishtarëve në kontekstin shoqëror, por me status më superior. Në kontekst të dasmës, ritet e separacionit përfshijnë fazën e cila fillon në çastin kur subjektet e ritualizuara (vajza dhe djali) shpallin publikisht fejesën e tyre dhe vazhdojnë deri në ditën e dasmës kur ritet në fjalë kalojnë në fazën tjetër, përkatësisht në atë të margjinalitetit ose liminalitetit kur subjektet e ritualizuara ndodhen në prag të ndërrimit të statusit të tyre sociologjik, përkatësisht nga të pamartuar në të martuar. Faza e fundit apo agregacionit (integritit në mjedisin e ri shoqëror) fillon pas natës së gjerdekut kur dy protagonistët kryesorë të dasmës fillojnë të bëhen pjesë përbërëse e rrethit të ri shoqëror të të martuarve duke e ndërruar njëherë e përgjithmonë mjedisin e tyre të mëparshëm shoqëror.

Rrahja simbolike e dhëndrit ndodh në fazën margjinale, pra në kohën kur individi i ritualizuar-dhëndri, ndodhet në prag të hyrjes në gjerdek. Kjo është një kohë që shënon kufirin midis fazës së beqarisë dhe asaj së burrërisë. Faza e dytë, përkatësisht ajo e margjinalitetit apo liminalitetit fillon prej çastit kur protagonistët e ritualizuar veshin rrobat e nusërisë, përkatësisht dhëndërisë e deri në mbylljen e tyre në dhomë gjatë natës së parë të martesës. Në këtë fazë, subjektet e ritualizuara janë në gjendje të jodefinimit të statusit të tyre sociologjik, pra ndodhen në një gjendje mes personave të pamartuar dhe atyre të martuar. Pikërisht për shkak të një statusi të tillë të padefinuar të rishtarëve, në këtë fazë vijnë në shprehje sjellje të pazakonshme rituale që marrin trajtën e sprovave serioze dhe të vështira të cilat duhet të përballohen dhe të tejkalohen, vetëm përmes manifestimit të qëndrueshmërisë fizike si element i vetëm i testimit të aftësisë fizike të iniciantëve (rishtarëve), sidomos të gjinisë mashkullore. Kjo fazë rituale ngërthen në brendinë e saj elemente që simbolikisht ndërliken me vdekjen dhe lindjen e re, pasi kemi të bëjmë me përmbylljen, apo “vdekjen” e një periudhe kohore – beqarisë dhe lindjen e një periudhe të re – burrërisë.

Sprovat e tilla fizike që u nënshtrohen rishtarët, sipas logjikës arkaike, paraqesin shëmbëlltyra të shkaktimit të "vdekjes së përkohshme" me qëllim që pastaj të krijohen kondita për ringjallje apo "lindje të sërishme". Në funksion të këtij konstatimi shkon edhe e dhëna se në fiset arkaike ku ndodh ky fenomen ritualor, rishtarët pas mbarimit të ritualit në fjalë, me rastin e kthimit në shtëpi, kinse harrojnë emrin e tyre të vjetër, apo të mëparshëm duke marr emër krejtësisht të ri, sepse, sipas botëkuptimit arkaik, bëhet fjalë për "lindje" të një subjekti të ri i cili ka ndërprerë vazhdimësinë me të kaluarën në mënyrë absolute. Jam i mendimit se gjurmë të tilla hasen edhe në mjedisin tonë kur në kushte të martesave patriarkale, gratë ishin ato të cilat prej çastit të martesës e humbnin emrin e vajzërisë duke u thirrur me emrin e burrit të saj që i shtohet vetëm prapashtesa e gjinisë femërore: -ica.

4. Vdekja dhe lindja simbolike si elemente qenësore të ritualit të rishtarisë

Ky ritual gjatë të cilit del në sipërfaqe vdekja dhe lindja e sërishme simbolike, është shumë i pranishëm, madje edhe sot e kësaj dite, sidomos në shoqëritë arkaike. Ky ritual në trajtën e tij më klasike praktikohet gjatë fazës së pubertetit, apo në fillim të pjekurisë seksuale dhe jo rastësisht është i njohur si ritual i rishtarisë së pubertetit, apo adoleshencës. Me mbarimin e ritualit në fjalë, rishtari mendohet se kalitet dhe si rrjedhojë e këtij fakti, bëhet anëtar i barabartë i bashkësisë fisnore me ç'rast përfiton edhe të drejtën e martesës. Supozohet se rishtari gjatë këtij rituali, siç cekëm më lartë, "vdes" dhe pastaj "ringjallet" si subjekt i ri. Kjo është e ashtuquajtura "vdekje" e përkohshme simbolike. Veprimet më të shpeshta paradigmatiche me të cilat ndillet "vdekja e përkohshme" në shoqëritë arkaike kanë të bëjnë me futjen e iniciantëve, apo rishtarëve në ndonjë kasolle të improvizuar e cila ka trajtën e ndonjë kafshe. Logjika arkaike e nënkupton këtë akt si "gllabërim" të rishtarëve në barkun e kasolles-kafshë, kurse dalja prej saj, interpretohet si dalje, kinse prej barkut të kafshës, por në trajtë të qenieve të reja që porsa kanë "lindur".

Qëndrimi i rishtarëve në brendinë e kasolles-kafshë ka qenë i përcjellë me tortura të ndryshme fizike duke përfshirë këtu edhe raste më ekstreme, si prerje të gishtërinjve, nxjerrje të disa dhëmbëve të shëndoshë, si dhe tortura tjera fizike. Këto janë trajtat e ritualit primordial, apo parak të cilat kanë mbetur edhe sot e kësaj dite në shoqëritë arkaike, sidomos në kontinentet e Afrikës dhe Australisë, veçmas te pjesëtarët e popullatave aborigjine. Nënkuptohet se një ritual i kësaj natyre është zhdukur te shoqëritë më të avancuara në aspektin kulturor duke përfshirë edhe shoqërinë shqiptare, por megjithatë kanë mbetur gjurmë të caktuara të cilat janë bartur deri në ditën e sotme, nënkuptohet në formë të reduktuar. Në këtë kontekst, rituali i rrahjes së dhëndrit është rudiment i ritualit të tillë arkaik të iniciacionit (rishtarisë) së pubertetit. Ky rit, përkatësisht rrahja, apo tortura fizike e rishtarëve ka qenë e ndërlikur kryekëput me rishtarinë e pubertetit, por më vonë me zhdukjen e këtij rituali tejet të çuditshëm me siguri se ka kaluar në rishtarinë e dasmës, apo më konkretisht në ritualin e rrahjes simbolike të dhëndrit.

Nga e tërë kjo që theksuam më lartë rezulton se riti në fjalë, përkatësisht grushtimi apo rrahja e dhëndrit paraqet rudiment, apo survival të "vdekjes së përkohshme", apo mbytjes simbolike të rishtarit me qëllim që ai pastaj të lindë me një status të ri ontologjik. Sipas kësaj logjike arkaike rezulton se për të lindur diçka e re, patjetër të zhduket e vjetra, apo e kaluara, përkatësisht t'i hapet rrugë lindjes së re. Kjo gjë mund të vërehet edhe gjatë sëmurjes së dikujt kur praktikohet futja në ndonjë lëkurë deleje që simbolizon kthimin e të sëmurit në barkun e nënës, përkatësisht në fazën e vdekjes me qëllim që pastaj dalja e tij, të përkojë me daljen e frytit të ri nga barku që i përgjigjet lindjes së sërishme. Nga kjo rezulton se asnjë shpresë për "ringjallje" dhe kalim në gjendje transcendentë të ekzistencës, nuk mund të ketë, pa vdekje paraprake dhe se rruga e vetme kah "ringjallja" është rruga e torturave nëpër të cilat duhet të kalojë çdo rishtar. I tërë iniciacioni, apo rishtaria është e mbështjellë me këtë simbolikë ambivalente: vetëm me ndihmën e torturës

dhe qëndresës që identifikohet me vdekjen mund të arrihet "lindja e sërishme". Në skenarët e ritualeve të rishtarisë, sipas studiuesit të njohur të religjioneve, Elijade, "vdekja" i përgjigjet përfundimit kohor të "kaosit"; d.m.th. ajo është shprehje ideale për fundin e një mënyre të dhënë të ekzistencës: asaj të padijes dhe papërgjegjesisë fëmijërore. Vdekja e rishtarëve mundëson që tabula rasa, të formohet njeri i ri. Edhe Bahtini në veprën e tij me titull "Krijimtaria e Fransoa Rablesë", thekson se "goditjet kanë kuptim simbolik të zgjeruar dhe ambivalent: goditjet janë ato të cilat njëkohësisht shkaktojnë vdekjen (në rastin më të keq), por edhe dhurojnë njëkohësisht një jetë të re, pasi që i japin fund asaj që është e vjetër dhe fillojnë atë që është e re (Bahtin, 1978: 212).

Meqenëse rituali i rishtarisë ngërthen në brendinë e tij elemente, apo simbole të vdekjes duhet theksuar se edhe dasma nuk është e përjashtuar nga një logjikë e kësaj natyre, pasi ekzistojnë përkime të caktuara midis mortjes dhe dasmës. Kështu, përderisa vajtimet, apo ndarja e të ndjerit nga gjiri familjar është e përcjellë me pikëllim, po ashtu një ndjenjë e njëjtë krijohet edhe gjatë përcjelljes, apo daljes së vajzës-nuse nga shtëpia e saj duke e krahasuar këtë akt me gjysmëvdekje, sidomos në kontekst të martesave patriarkale. Analogjia mes riteve të dasmës dhe atyre mortore, është edhe shumë më e gjerë, por qëllimi ynë është që të vihet në spikamë e dhëna se njeriu arkaik e ka kundruar realitetin objektiv si produkt të "lojës" që zhvillohet midis vdekjes dhe lindjes së sërishme, qoftë në planin makrokozmiq, qoftë në atë mikrokozmiq. Ritualu ka qenë mjeti më i mirë për formësimin e këtyre përfytyrimeve.

5. Përmbyllje

Një veçori e përbashkët jo vetëm e këtij rituali, por edhe e shumë ritualeve tjera, qofshin të ciklit kalendarik, apo të atij antropologjik, është zhdukja e entropisë dhe krijimi i rendit dhe harmonisë. Ritualu e zhdok kaotiken që krijohet, pikërisht në ndonjë fazë që shënon kalimin nga një periudhë e vjetër e qenësisë në një periudhë tjetër të re. Çdoherë në epiqendër të tij, qëndron lufta që zhvillohet mes asaj që është e kaluar dhe asaj që është e ardhme. Ritualu me gramatikën dhe sintaksën e sjelljes së llojit të vet, në kuadër të kodit joverbal paraqet mënyrë të tejkalimit, pikërisht të atyre situatave të krizave nga zgjidhja adekuate e të cilave edhe varet vazhdimësia e mëtejme e bashkësisë biologjike, shoqërore dhe kulturore.

Logjika e njeriut arkaik është nisur çdoherë nga fakti se për të lindur diçka e re, ajo patjetër duhet të zhdoket njëherë, apo t'i nënshtrohet vdekjes. Dy modalitetet kozmike: jetë/vdekje, kaos/kozmos, shterpësi/begati, paraqesin në esencë, dy momente kyçe të një procesi të njëjtë. Kjo fshehtësi të cilën njeriu e zbuloi pas zhvillimit të bujqësisë ku më së miri vërehet "lindja" dhe "vdekja" e prodhimeve bujqësore, do të mbetet parim i vetëm i shpjegimit të botës, jetës dhe ekzistencës njerëzore.

Në kohën e jetës bashkëkohore kur gjithnjë e më shumë ndeshemi me zhdukjen e ritit tradicional, ndeshemi njëkohësisht edhe me varfërinë shpirtërore ose humbjen e kuptimësisë të mposhtjes së krizave jetësore. Këtë gjendje më së

miri e ilustron thënia e studiuesit të spikatur amerikan Xhozef Kembel, sipas së cilës: "njeriu nuk din kah cili synim të hapërojë. Akti heroik, sot, nuk është ai që ishte në kohën e Galilejit. Aty, ku më herët kishte errësirë, tani ka dritë; por, aty ku më herët kishte dritë, tani ka errësirë. Akti bashkëkohor heroik patjetër të jetë tentativa që sërish të nxirret në dritë Atlantida e humbur e shpirtit të ekuilibruar" (Campbell, 1956: 75).

Bibliografia:

- Bahtin, Mihail (1978): Stvaralaštvo Fransoa Rablea i narodna kultura srednjega veka i renesanse. Nolit. Beograd.
- Campbell, Joseph (1956): The Hero with a Thousand Faces. New York. Meridian.
- Елиаде, Мирча (2002): Посвещаване, ритуали, тайни общества. Прозорец. София.
- Geertz, Clifford (1973): The Interpretation of Cultures. Basic Books. New York.
- Genep, Van Arnold (1981): Rites de passage. Paris. Picard.
- Kokjara, Đuzepe (1984): Istorija folkloru u Evropi (2). Prosveta. Beograd.
- Paplejka, Ndoc (1999): Kulte, rite, magji në traditën orale. Botimet Toena. Tiranë.
- Sulejmani, Fadil (1988): Lindja, martesja dhe mortja në Malësinë e Tetovës. Rilindja. Prishtinë.

ERMAL MEHMETI

KËNDIMI POLIFONIK TE POPUJT E BALLKANIT

Jetojmë në kohë të ndryshimeve të thella të paradigmatave në të gjitha sferat e jetës bashkëkohore, të cilat para se të gjithash janë të lidhura me globalizimin, ku vazhdimisht janë prezente tendencat e marginalizimit të karakteristikave dhe dallimeve të popujve, në veçanti në sferën e folklorit, i cili përfaqëson një nga elementët lidhës më të fuqishme në memorien e një populli, veçanërisht në segmentet e sferës së kulturës, arteve dhe literaturës të cilat karakterizohen me një kontinuitet në aspektin e proceseve kulturore dhe civilizuese evropiane. Sot në botë, në qarqet shkencore, objekt i së cilës është Europa Juglindore apo Ballkani, imponohet obligimi moral në vetëdijen e saj shkencore të thirren në vlerat përbashkuese multietnike, të cilat mund të kontribuojnë “*në krijimin e një urë mendore dhe një rrugë që do të çojë nga njeri tek tjetri*”.¹

Në këtë kontekst, për shembull, imponohen imperativët e etnologjisë ballkanike, e cila si disiplinë shkencore domethënëse i studion kulturat në hapësirat ballkanike mbi bazë komparative. Sipas rezultateve të studimeve individuale dhe krahasuese, sot paraqiten hipoteza bindëse se popujt ballkanikë krahas dallimeve të mëdha etnike dhe kombëtare posedojnë një serë vlera përbashkuese gjuhësore, letrare, kulturore, folklorike etj. Fenomen i cili vështirë se mund të vërehet në ndonjë tjetër vend tjetër të Europës.²

Gjurmë të këtyre karakteristikave të përbashkëta gjenden edhe në forma të larta kulturore, për shembull tek poezia, muzika vokale dhe instrumentale si dhe në artin figurativ. Ballkanologu Moskovit Tatjana Cvijan, për shembull postulon “*model ballkanik*” – për konvergjencën e kulturave ballkanike, siç realizohet në të përbashkëtat në strukturat gramatikore në gjuhët e palidhura ballkanike.³

Kjo konvergjencë e kulturave rezulton edhe nga struktura e veçantë që ka reliefi ballkanik, e cila si simbol kryesor e ka mbylljen dhe izolimin, duke i detyruar njerëzit që të hulumtojnë drejt rrugëdaljeve të përbashkëta, e cila nuk ngelet pa reflektuar në artin e tyre popullor. Me fjalë të tjera, ky dinamizëm ekzistencial gjen një reflektim logjik në të menduarit në ndërtimin dhe adaptimin e njerëzve, si dhe në strukturimin artistik në domenin e këndimit, tregimit, muzikës,

¹ Cf. Проф. др. Габриела Шуберт, професор на Универзитетот во Јена “Културните традиции како сврзувачки елементи во мултиетничка Македонија”, (Prof. dr Gabriella Shubert, Kulturele Traditionen als verbindende Elemente in multietnischen Makedonien, in Deutch-Makedonischen Klulturen, Jena 29 november – 2 december 2001 s. 31-32).

² Ibid., s. 32.

³ T. V. Cvijan: Lingvisticeskie osnovy balkanskoj modeli mira, Moskva, 1990.

lojve si dhe formave të tjera të shprehjeve kulturore dhe artistike. Kërkimi për rrugëdalje, qoftë nëse bëhet fjalë për modelin mitologjik të labirintit, reflektimin e tij do ta gjejë tek popujt ballkanikë, vetë kërkimi për harmoninë vokale të zërave të vendosur në mënyra të ndryshme, si dhe vallet ballkanike, të cilat mund të interpretohen si variante të ndryshme në kërkim të një rrugëdaljeje harmonike, nëpërmjet magjisë së aftë koreografike.

Polifonia në Gadishullin Ballkanik përfaqëson një nga kulturat më të lashta, e cila do të mbijetojë ndër shekuj kundrejt të gjitha proceseve të mundshme erozive të kohës dhe kështu, e kristalizuar në forma të thjeshta, do të transmetohet nga brezi në brez, për të arritur edhe në kohët tona si thesar i çmuar.

Gjatë periudhave të gjata historike dhe në rrethana të caktuara historike, të cilat do t'i imponohen në mënyrë të jashtme dhe të brendshme Ballkanit, në rajonet e veçanta të tij, si dhe në tërësi, kjo kulturë muzikore polifonike, diku paraqitet e izoluar, e rudimentuar, diku dhe në formë më të zgjeruar deri në katër zëshe. Shikuar nga aspekti gjeografik përdorimi i polifonisë varion në forma më pakë karakteristike deri tek format e saj tipike. Ndërkaq në Ballkan fenomeni polifoni qysh në kohët antike ka qenë objekt i diskutimeve dhe mospajtimeve të ndryshme, në veçanti ndërmjet Platonit dhe oponentit të tij Timotea Mileçanin në shekullin e tretë para erës së re. Megjithatë duhej të kalonin shekuj që në kohërat e reja ky fenomen muzikor nga provenienca popullore të bëhet objekt hulumtimi edhe jashtë shteteve ballkanike. Kështu që para opinionit shkencor botëror do të botojnë punime shkencore: Carl Shtrumpf, Guido Adler, Erih Hornbestel, Kurt Sax, Ernest Kloson, Ludvig Kuba, Jane Sugarman, e cila i jep theks te veçantë këngës polifonike shqiptare, dhe shume të tjerë.

Këta punonjës shkencorë do ta shtyjnë para opinionit shkencor botëror problemin e polifonisë-heteronomisë popullore dhe do të përfaqësojnë hyrje në hulumtime sistematike nga fundi i shekullit 19 dhe tërë shekullin 20 si dhe në regjione të veçanta ballkanike. Në Bullgari këngët popullore dy zëshe i pari do t'i vërejtë në vitin 1981 Angel Bukureshtliev. Më vonë do të paraqitet dhe Vasil Stoin si folkloristi i parë muzikor i cili e paraqet “tezën për prejardhjen bullgare të diafonisë vokale”⁴.¹⁰ Pothuajse pas një periudhe hulumtuese njëqindvjeçare të materialeve të mbledhura në Bullgari paraqiten dhe punimet e N. Kauffman për këngën popullore Bullgare shumë zëshe si dhe të A. Abrasheva për dy zëshmërinë popullore Bullgare⁵.

Punimi i N. Kauffman, i shënuar nga përvoja personale, mbron tezën se këndimi dy zësh është stil burdonë origjinal më terminologjinë e vet.

⁴ Cituar sipas Smokvarski (Б. Стоин“Хипотеза на бугарскиот исход на дијафонијата”, referat i Akademise muzikore 28. maj,viti 1925 .).

⁵ N.Kauffman, Kënga bullgare shumëzëshe, Shkenca dhe arti,Sofje, 1968.

⁶ Cf. Beniamin Kruta, Polyphonie albanaise – traits commun et difference dialectales, in Studia albanica, Nr. 1-2, 1991-pp. 29-44.

⁷N. Kaufman, Kritikmenin under lider folklore der Balkan, Sofia,1966.

Në format e saj të para të rudimentuara të Ballkanit, polifonia paraqitet si dyzëshe qysh në periudhën romake. Sipas hipotezës së njohësit eminent të polifonisë shqiptare Benjamin Kruta⁶, polifonia dy zëshe tek popujt e vjetër ballkanikë, në format e saj të para në bazamentin e saj kanë vlera të përbashkëta si burim i lashtë i përbashkët, i cili mund të vërtetohet me fakte. Ndër elementet që janë të bazuara në strukturat gjenetike dhe formale-intonative. Në këtë kontekst numërohen vetëm disa:

1. *Lëvizja në sekonda paralele nëpërmjet gërshetimit të zërave*
2. *Karakteri antifonal dhe imitimi i zërave*
3. *Përfundimet e zërit të dytë të një sekonde të madhe nën zërin e parë në fundin e këngës.*
4. *Përfundimet në harmoninë e vogël septimale, në veçanti në fundin e këngës.*
5. *Ndërtimi arkitektonal në kuadër të vargut poetik.*
6. *Përdorimi i modeleve binarë dhe trinarë ritmikë.*

Këto elemente janë prezentë si të përbashkëta në këngët polifonike dy zëshe në Ballkan. Paralele ballkanike në domenin e polifonisë vërehen edhe nga ana e autorëve të tjerë⁷, por ekzistojnë autorë të cilëve elementet e përbashkëta të polifonisë u shërbejnë si objekt i krahasimit të një ose disa terrene. Në këtë mënyrë elementet konvergjente të cilët vërehen në kuadër të polifonisë dy zëshe, në Ballkan janë më shumë rezultat i fillimeve mbi bazën gjenetike dhe me burim supstrakt, sesa pasojë i kontakteve të mëvonshme ndërghjuhësore. Madje edhe në kuadër të shumëzëshmërisë polifonike, elementet konvergjente, dyzëshmëria është më e ndjeshme, sidomos në elementët përbërës thelbësorë dhe strukturorë. Elementët divergjentë të cilët paraqiten, në thelb, janë shprehje e zhvillimit konstant në polifoninë dy zëshe shqiptare dhe ballkanike, në hapësirë dhe kohë. Kuptohet, sipas B. Krutës, edhe elementet divergjente, si në aspektin e formës, lëvizin edhe në aspektin e përmbajtjes, ato janë gjithnjë e me shumë prezent në zhvillimin diferencial i cili imponohet nga brenda dhe jashtë tek popujt ballkanikë gjatë proceseve të veçanta historike⁸.¹¹ Interesant është të vërehet fakti se polifonia dy zëshe në disa rajone të Ballkanit, me përjashtime të rralla në Shqipëri u tregua mjaft produktive në hapësirë dhe kohë dhe ka dhënë lloje të polifonisë më të zhvilluar si polifoni tre dhe katër zëshe.

⁸ B. Kruta, Vendi i polifonisë shqiptare në polifoninë ballkanike, Kultura popullore, 1/990/fq. 13-14.

⁹ Revista shkencore Kultura popullore br. 1/190 g. Botuar në Tiranë nga Instituti i Kulturës popullore, Tiranë kushtuar simpoziumit "Polifonia tek popujt ballkanik" (mbajtur me 6-7 Korrik, viti 1989).

¹⁰ Iniciativa që të mbahet ky simpozium me muzikolog të famshëm ka pasur karakter univerzal me interes mbarëkombëtar.

Një nga çështjet e hapura kur trajtohet këndimi polifonik shqiptar në kontekstin ballkanik dhe universal mbetet: a është polifonia tre dhe katër zëshe rezultat i zhvillimit të brendshëm dhe se a buron nga format më të thjeshta nga shumë zëshmeria polifonike? Formimi i mikro zëshmerisë ose njëzëshmerisë brenda zërit kolektiv është dukuri e vetë mënyrës së këndimit në grup. Pikërisht këto fenomene të cilat ndodhin me zërin kolektiv të këngës dy zëshe do të jenë edhe arsyeja kryesore për lindjen e zërit të tretë.

Krahas numrit të tyre të kufizuar, këta shembuj sot kanë vlerë të madhe, sepse përfaqësojnë monumente autentike, të cilat e shpjegojnë qartë rrugën e evoluimit të polifonisë dy zëshe shqiptare në këngën tre dhe katër zëshe.

Në lidhje me gjenezën dhe prejardhjen e polifonisë tek popujt ballkanikë, më shumë punonjës shkencorë eminentë e trajtojnë këtë çështje, e cila zë vend kryesor edhe në simpoziumin e mbajtur në Tiranë në vitin 1989 me temë “Polifonia e popujve në Ballkan”⁹, nën organizimin e Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë, me pjesëmarrës nga shtete të ndryshme të Europës dhe Ballkanit¹⁰.

Muzikologu Cvjetko Rihtman qysh në vitin 1952 shprehu mendimin se këndimi shumë zërësh i popullit “ndoshta përfaqëson reminishencë nga kultura e vjetër trako-ilire”^{11,12}. Ky muzikolog i famshëm, i cili la pas punime të rëndësishme nga lëmi i polifonisë në Bosnje dhe Hercegovinë, sipas B. Krutës paraqet hipotezën se prania e këndimit polifonik dy zësh në BiH, në këtë rajon qendror ballkanik, mund të interpretohet edhe si një trashëgimi nga fiset antike ilire, ose siç thekson Rihtman është e mundur hipoteza se traditën polifonike e kanë ruajtur Ilirët e sllavizuar¹².

Hipotezën e Rihtmanit në atë periudhë (viti 1952) do ta përkrahin edhe punonjës shkencorë të tjerë, si për shembull muzikologu holandez me famë botërore J. Kunst¹³. Muzikologët shqiptarë, në veçanti B. Kruta, i pranojnë hipotezat e G.F.Mesner¹⁴ dhe Gjurgjev¹⁵, të cilët dëshmojnë se “format dy zëshe në zonat e Rodopeve dhe të Epirit, si dhe më gjerë duhet të përfaqësojnë mbetje të kulturës muzikore ballkanike të periudhës para romake”.

Siç e theksuam më parë, por tani me një aksent më të theksuar, në kontekstin komparativ dhe ballkanik në tretmanin e këndimit polifonik, me një analizë më të thellë të dyzëshmerisë, mund të vihet tek hipotezat mjaft interesante

¹¹ Cf. C. Rihtman, O ilirskom porjeklu polifonia oblika narodne muzike, Bosne i Hercegovine, “Rad Kongresa folklorista Jugoslavije”, na Bjelasnici, 1955, i u Puli, 1952, Zagreb, 1958. (Citirano spored Vasil S. Tole, Folklori muzikor-iso-polifonia, Uegen, Tirana, 207, f. 28.

¹²C. Rihtman, “O ilirskom porjeklu polifonia oblika narodne muzike Bosne i Hercegovine” Rad Kongresa Folklorista Jugoslavije, op. cit.

¹³C. Rihtman, op. cit.

¹⁴ G. F. Mesner, “Die Diaphonie bei den slaviscen gabrigsbewohnern auf der balkhanalbinsel in vergleichend musikwissenschaftlicher sicht”, in “Зборник на XIX Конгрес на Сојузот на здрженијата на фолклористите на Југославија, Крушево, 1972, Скопје, 1977, ст. 233.

¹⁵ N. Gjurgjev, “Mbeturina të një kulture muzikore pararomane në folklorin bullgar”, Kongresi i trakologjik, Sofie, 1972, spored G. F. Mesner, st. 233.

me kuptim më të gjerë si dhe në domenin e këndimit polifonik universal në Ballkan dhe mediteran.

Siç patëm mundësi të zbulojmë etno substrat të përbashkët në më shumë elemente të kulturës, gjuhës dhe traditat tek popujt ballkanikë, dyzëshmëria në këndimin polifonik tek popujt e përmendur ballkanikë duhet të vërtetojë një substrat të përbashkët më burim antike. Elementët konvergjentë janë më prezent në dy zëshmërinë polifonike sesa në tre dhe katër zëshmërinë. Këndimi polifonik dy zësh në atë mënyrë imponohet si një nukleus i përbashkët i konsiderueshëm mbi të cilin më vonë ndërliken format e tjera të polifonisë, dhe mundëson tipologjinë e saj të mëtutjeshëm.

Dy zëshmëria polifonike me fuqinë e saj burimore në depërtimin dhe mirëmbajtjen dhe përmes strukturave të tjera më komplekse, jo vetëm që lejoi prodhimin e varianteve me më shumë zëra, por edhe në mënyrë motivore-tematike të shtyn forma të ndryshme të traditës polifonike tek popujt të ndryshëm ballkanikë. Dy zëshmëria polifonike ka qenë veçanërisht e fuqishme në kohën dhe vendin e saj si strukturë bazike në format e tjera shumë zëshe.

Sot edhe tradita e këndimit polifonik tek Shqiptarët, zgjerimi dhe kontinuiteti i tij, në Shqipëri, por edhe më gjerë tek diaspora shqiptare, me format e saj tre dhe katër zëshe, edhe në format e sotme, nuk paraqet vetëm rezultat të formave muzikore dy zëshe të cilët relativisht herët e tejkaluan stadiumin e heterofonisë, duke arritur në një periudhë të gjatë ta mundësojnë formimin dhe kristalizimin e saj. Ky fakt është prezent edhe sot në format e ndryshme të dy zëshmërisë polifonike në veçanti gjatë manifestimit të zërit të parë, kur ndërliken më shumë zëra duke përfunduar në grup.

Formimi i mikro zërit të brendshëm në zërin kolektiv, në fakt e pretendon polifoninë në grup, ku janë konstant prezent evitimet e heterofonisë. Pikërisht këto fenomene të cilët ndodhin në këndimin kolektiv ose përndryshe një zë i këndimit dy zëshë përfaqësojnë edhe arsye për lindjen e një zë të ri të tretë, në fillim me një përkushtim heterofon, por i cili me kohë kristalizohet dhe individualizohet. Problematika komplekse dhe e ndërlikuar e dyzëshmërisë polifonike në traditën polifonike shqiptare, me format e lidhjes me tipat e këndimit me dy dhe tre zëshmëri, dëshmon për një nga format origjinale të këndimit polifonik tek shqiptarët, i cili meriton një vëmendje të veçantë, relevante edhe për vetë gjenezën e polifonisë.

Në vitin 1958 muzikologu bullgar Nikolae Kauffman do të përfaqësojë pothuajse të njëjtën pikëpamje në lidhje me gjenezën e polifonisë Ballkanike, duke e paraqitur me argumente të reja në simpoziumin e përmendur¹⁶.¹³ Në punimin e tij për “Këngët vajtuese shumëzërëshe popullore në Bullgari”, së bashku me këndimin vajtues homofonik, sipas këtij autori, ekziston edhe tip i këngëve polifonike vajtuese në sferat e Epirit, ku kryesisht ky tip i këngëve janë dy zëshe (me iso).

¹⁶ Krahaso Nikolae Kaufman, Vajtimet popullore shumëzërëshe në Bullgari”, në Jeta Shkencore, f. 65-69

Kauffman shton edhe një tjetër lloj të këndimit vajtues: një grua zakonisht i “këndon” vargjet me anë të improvizimit, përdorisa dy ose tre gra të tjera e ndjekin në këndim duke i përsëritur vargjet. Ky punonjës shkencor shfaq edhe të tjera këngë vajtuese polifonike nga rajone të ndryshme të Gadishullit Ballkanik. Bashkë me muzikologë të tjerë të famshëm, si dhe autoritete të tjera të shquara shkencore nga kjo lëmi, ndër të cilët një vend të veçantë zë Lorenzo Tardo, do paraqitet edhe teza se polifonia popullore paraqet një dukuri parabizantine, e cila do të jetë e mbështetur edhe nga një numër më i madh pjesëmarrës nga simpoziumi i përmendur.

Në këtë kontekst etnomuzikologu gjerman Rudolph Brandl ka paraqitur në mbledhjen shkencore fakte-materiale për ekzistencën e polifonisë dy zëshe që në mesjetë, ku ka qenë theksuar se faktet për ekzistencën e polifonisë popullore mund të kërkohej edhe në periudhat më të lashta¹⁷. Sipas këtij studiuesi të mirënjohur shkencor komparative dhe evolutive nga fillimi i shekullit të kaluar në mënyrë të gabuar kanë qenë të kuptuara format polifonike të muzikës vokale në Ballkan duke i llogaritur si “praforma arkaike” të polifonisë ose si një lloj “tingëllimi magjik primitiv”. Këndvështrimi i tij meriton një vëmendje të posaçme në raport “diafoninë e ndryshueshme”, e cila ka zhvillimin spontan evolutiv, ndërsa polifonia perëndimore bazohet mbi dominimin e spektrave tingëlluese harmonike mbi bazën e një tingulli bazik të përbashkët (bas) të akordeve. Megjithatë, i ashtuquajtur “dëgjimi i tingullit bazik”, përfaqëson më shumë procesin e dëgjimit (ose kthimi i vëmendjes), si një kompleks psikoakustik (“virtual”)¹⁸.

Kultura muzikore e polifonisë ballkanike karakterizohet në të gjitha segmentet e saj me një bukuri të rrallë, me një origjinalitet dhe me një pasuri të madhe intonative dhe modale. Për qarqet shkencore nga sfera e muzikologjisë, polifonia nuk paraqet vetëm moment kulturor të së kaluarës, por edhe një dukuri bashkëkohore artistike. Polifonia popullore në tërësi, si dhe polifonia e popujve ballkanikë në veçanti vazhdimisht e tërheq vëmendjen e rrethve shkencore etnomuzikologjike.

Interesante janë njohuritë e muzikologut grek Nikos Dionisopoulos për polifoninë e re popullore greke në veçanti, e fiksuar në segmentin e ishullit Karpatos, si një dukuri tipike për format polifonike të kësaj toke¹⁹. Sa i përket gjenezës së formave polifonike në format e para, studiuesi shkencor grek paraqet dy hipoteza: a) iso – mund të përfaqësojë reminishencën e traditës bizantine. b) isoja mund ta ketë prejardhjen e imitimit të tingullit të gajdes. Në këtë mënyrë, këto dy forma të polifonisë rudimentare në Karpatos mund të lidhen me prezencën e gajdes në ritualet e dasmave. Në fund, muzikologu grek e paraqet vështrimin përmblyës: a janë këto fenomene polifonike të pavarura, ose janë dy raste pa implikime të mëtejshme, ose si përjashtime interesante nga rregulla e monofonisë në muzikën lindore?²⁰.

Spektrin e pikëpamjeve etnomuzikologjike për këndimin polifonik ballkanik sigurisht e plotësojnë edhe vërejtjet shkencore të profesorit rumun Tiberiu Aleksandru, i njohur veçanërisht për studimet e organologjisë, të cilët i nxjerr në punimin e tij “Forma polifonike në muzikën popullore rumune”²¹. Megjithëse në muzikën popullore rumune dominon monodia, polifonia e ka

gjithashtu vendin dhe traditën e vet. Ajo është prezente në format rudimentare, por edhe në format më të zhvilluara²². Teza e tij relevante është se këngë polifonike të spikatura ekzistojnë në dialektin muzikor arumun. Ai do t'u kushtojë vëmendje të posaçme lidhjeve në mes të polifonisë tingëllore dhe instrumentale.

Mozaiku i pikëpamjeve shkencore të polifonisë ballkanike plotësohet edhe me punimin e dr. Murat Karabulut për “Polifoninë vokale dhe instrumentale përmes formave të saj ekzistuese në Turqi”²³, i cili kryesisht në punimin e tij ndalet në disa instrumente si: qemane, bagllama, tullum, gajde dhe çifte, nga të cilët mund të nxirren dy ose tre tinguj njëkohësisht, e thekson edhe rëndësinë e polifonisë vokale, e cila është mjaft e shpërndarë në rajone të ndryshme në Turqi, si në pjesën europiane ashtu edhe në pjesën aziatike. Veçanërisht dallohet lloji i polifonisë *dem*, e cila kryesisht këndohet në Anadoli, në të cilën shpeshherë ndërrohen oktavat. Në meloditë e improvizuara si dhe në këngët vajtuese (uzun hava), përveç melodisë kryesore, përsëriten edhe melodi të tjera, e cila nxjerr në pah karakterin polifonik.

* * *

Në kërkimin e “sinfonisë së ndryshimeve” në kulturat e popujve ballkanikë, nga shembujt e theksuar në disa shtete ballkanike, në domenin e traditës popullore, polifonia vokale dhe instrumentale zë vend të posaçëm. Në këtë kontekst zë vend të veçantë hulumtimi i mëtutjeshëm i problematikës rreth gjenezës së kulturës muzikore polifonike të popujve të gadishullit Ballkanik.

Kjo është një nga përfundimet e simpoziumit ndërkombëtar të përmendur në temën Polifonia e popujve të Ballkanit, si dhe në takime të tjera ndërkombëtare për folklorin e popujve ballkanikë, që spikatja e karakteristikave kryesore intonativo-modale, të strukturave dhe stileve muzikore të polifonisë popullore, duhet të paraqesë një nga imperativët shkencor të muzikologëve jo vetëm në Ballkan, por edhe më tej.

Këto hulumtime janë veçanërisht domethënëse në domenin e secilit popull, etnik, pakica dhe komunitete të tjera, jo vetëm në Ballkan, por edhe në Europë dhe në Mediteran, veçanërisht në kohën e proceseve depersonalizuese të mondializimit. Sidomos bëhet i rëndësishëm në zonat ku polifonia është ende gjallë dhe është në kërkim për gjenezën e saj, në vazhdimësinë e tij si një kategori estetike në fushën e artit muzikor. Kultura muzikore te popujt e Ballkanit, polifonia, paraqet njëkohësisht edhe interes të rëndësishme shkencor në fushën e etnomuzikologjisë. Zbulimi i karakteristikave të përbashkëta të polifonisë te popujt e ndryshëm të Ballkanit do të përfaqësojë edhe një nga urat e afrimit të tyre të ndërsjellë, zbulim dhe solidaritet.

GJOVALIN SHKURTAJ**EPOSI I KRESHNIKËVE DHE MBLEDHËSIT
E SHQAR TË PERLAVE**

Këngët e kreshnikëve na japin një pamje të gjerë të asaj mënyre të shprehjes gjuhësore popullore ku politesa dhe arroganca, miklimi dhe ironia, shpotia dhe sarkazma etj, paraqiten me mjete gjuhësore të qëlluara, të gjetura mirë e të bukura, me larmi e përpikëri, që dëshmojnë për shije të hollë artistike, po edhe për traditë të lashtë të shprehjes së përpunuar, të gjuhës si mjet arti. Nga ky këndvështrim, nuk e teprojmë kur themi se këngët e kreshnikëve janë përmendore madhështore e kulturës së gjuhës shqipe.

Të tillë e kanë vlerësuar edhe shumë albanologë dhe folkloristë të shqar shqiptarë e të huaj. Ka studiues që janë dashuruar me eposin dhe deri në fund të jetës janë marrë me bukuritë e tij si argjendarët që rijnë e shkëlzejnë “rgjätet” e moçme për t’ua shtuar vlerën e çmimin faqe konsumatorëve. Për fat të mirë, eposit tonë i janë kushtuar rreshta dorëmbarë nga mbledhës të zellshëm, në krye të herës Marin Sirdani, pastaj etërit Bernardin Palaj e Donat Kurti, me lëndën e paçmueshme të botuar në “Visaret e Kombit”, po në atë lëmë kanë punuar edhe mbledhës e studiues të huaj si M.Lambertz e A.Lord, A. Desnickaja etj., pastaj dijetarët e folkloristët shqiptarë nga IF, sot IKP, si dhe nga IAP me mbledhjet e qëmtimet e vijueshme e botimet më të plota të vëllimeve të Eposit të Kreshnikëve na kanë vënë themelet e ngehinës madhështore të eposit tonë si thesar i pavdirë i artit të fjalës dhe na kanë çelur edhe shtegun e mbarë të të vlerësimit të këngëve të kreshnikëve si relikat më të bukura të palcës së kombit shqiptar.

Këngët e kreshnikëve apo Epika popullore shqiptare e Veriut ka qenë dhe vijon të jetë si mineralet e çmueshme, që mblidhen e nxiren prej thellësive të nëntokës e prej rrethinave a viseve malore më skajore, porse ato, pikërisht për shkëlzimin, hijeshinë dhe vlerat e tyre të çmueshme, bëhen menjëherë objekt gjakimi e pëlqimi prej masës së gjerë të studiuesve, njësoj si ari e argjendi prej zejtarëve ndejtarë e të ngulur të qyteteve. Siç vlerësonte me të drejtë Qemal Haxhihasani: “Ashtu si kanë ndihmuar për njohjen e antikitetit grek poemat homerike, për karakterin kompleks të shtetit këngët akritike, për mesjetën gjermane e frënge këngët e Nibelungëve e të Rolandit, ashtu ndriçojnë për shekujt e Mesjetës të vendit tonë edhe rapsoditë monumentale të ciklit të kreshnikëve, të cilat qëndrojnë denjësisht krahas krijimeve epike më të mira të popujve të tjerë”. Ja, pse, atyre u janë qasur me ëndje e përparësi jo vetëm mbledhës e studiues nga Veriu, si: B.Palaj, D.Kurti, K.Taipei, Anton Çetta, Zymer Neziri, Agron Xhagolli, Shaban Sinani etj., po edhe aq shumë dijetarë prej viseve të Shqipërisë Jugore e Qendrore, si: Eqrem Çabej, Zihni Sako e Qemal Haxhihasani, Jorgo Panajoti, Alfred Uçi, Vasil Tole etj. Me vlerë të madhe ka qenë, ndër të tjera, studimi hyrës nga

Z.Sako e Qemal Haxhihasani në vëllimin “Folklor Shqiptar, II Epika Legjendare, Tiranë, 1966, ku jepet një pamje e hapët e vlerave të këngëve të kreshnikëve si pjesa më përfaqësimitare e shpirtit krijues të popullit shqiptar dhe posaçërisht e Malësisë së Veriut ku ndodhet edhe vatra e tyre.

Atje, me javë e muaj kanë qëndruar mbledhësit e studiuesit e shquar, si Qemal Haxhihasani, folkloristi ynë i famshëm dhe i dashuruar pas eposit e mbledhejs së tij, aq sa, në vitet '60 do të kalonte javë të tëra në Gjocaj të Shoshit, në Rrilë të Bregut të Matës e deri në Nikaj-Mërturin e largët, për të të dëgjuar e mbledhur me dorën e vet këngët e rapsodëve të përmendur si Sokol Martini, Osman Arifi, Mirash Ndou (Shosh), Ndue Lulashi e Gjon Nikoll Sokoli nga Kelmendi, të rënë herët në Bregun e Matës, Nikollë Loshi në Ishull të Shëngjinit e Llesh Prekushi në Balldren të Lezhës. Ashtu ka vepruar në anët e Kosovës edhe Zymer Neziri, një nga folkloristët më të dalluar të ditëve tona.

Qysh kur isha student, në vitet 1962-1966, me nxitjen e Zihni Sakos e të Qemal Haxhihasanit, kam mbledhur jo pak këngë kreshnikësh në Kastrat, Shkrel e Hot të Malësisë së Madhe. Këngë kreshnikësh kam mbledhur, me raste, edhe në gjë të anketimeve dialektologjike në Kelmend, Hot e gjetkë, duke pasur si informatorë disa këngëtarë relativisht të shquar edhe si rapsodë, si Tom Marash Curri nga Kastrati, i shpërngulur në qytetin e Shkodrës, Ndue (Nosh) Deda nga Shkreli etj. Po përmend, gjithashtu, rastin e lumtur që kam pasur në vitin 1974, kur, për rreth një muaj rresht, kam dëgjuar e regjistruar këngë kreshnikësh nga rapsodi i mirënjohur Mirash Ndou, i caktuar si shoqëruar zyrtar i studiueses daneze Mina Scafte Jensen. Mina S.Jensen, studiuese e Universitetit të Kopenhagës, ka ardhur në Shqipëri në vitin 1974 me ftesë të IF dhe kishte si objekt pune studimin e Eposit homerik, të cilin ajo dëshironte ta krahasonte me Epikën popullore shqiptare. Fryt i asaj pune dhe i studimit të saj krahasues është edhe libri i saj ”The Homerik Question and the oral-formulaic Theory”, Museum Tusculanum Press, Copenhagen 1980, në parathënien e të cilit e ka theksuar pikërisht rëndësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë me eposin shqiptar si mjet për të kuptuar më mirë eposin homerik. Këngët e Mirash Ndout dhe përvoja e punës që fitova prej studiueses Mina Jensen patën për mua vlerën e asaj që ka sot një Master, madje ndoshta më shumë. Prej saj kuptova më mirë se “arka ime” ku kisha ndryrë copëza e këngë të plota kreshnikësh qysh në moshë të njomë, do të më vlenë shumë gjatë gjithë jetës sime si studiues. Kryekreje dëshiroj të theksoj se kam qenë dhe jam i bindur se gjuha e epikës heroike shqiptare duhet kundruar, studiuar e vlerësuar jo vetëm si pjesë të shprehjes e të formësimit artistik të Eposit, por edhe si shkrim e mishërim i dashurisë së shqiptarit për të bukurën, për vlerat e vërteta artistike dhe për marrëdhëniet e ndërsjella të gjuhës me kulturën në planin kombëtar shqiptar, po edhe më gjerë, duke përfshirë edhe shkëmbimet kulturore e huazimet gjuhësore e artistike të natyrshme e të pamungueshme në një trevë aq të shkëmbyeshme e të gjallë si ajo ballkanike. Atyre që kam pohuar e thënë më parë në disa kumtesa e artikuj, si dhe në ndonjë prej librave të botuar, u përmbahmem edhe më tej dhe, në dritën e botimeve e prurjeve më të reja, do të do të mëtoj më të sillen shqyrtime të reja për kumtin dhe kuvendimin në Epos në dritën e teorisë së sotme të komunikimit dhe

sidomos nga pikëpamja e etnografisë së ligjërimit. Synimi ynë është në disa kahe të ndërlidhura mes tyre:

Së pari, të ritheksojmë vlerësimin e gjuhës së Eposit si model i ligjërimit, po edhe i sjelljes (komportimit) burrërore, mbase, mund të thoshim i mënyrës sjelljes (bihejviorizmit), sepse kemi bindjen se ligjërimi njerëzor është pjesë e shfaqje e qartë pikërisht e sjelljes, e mendësisë dhe kulturës së individëve të veçantë dhe e krejt bashkësisë shoqërore përkatëse.

Së dyti, të parashtrijmë, qoftë edhe ende në formë piketash a syzimesh për t'u vijuar më tej, disa vlera kryesore të gjuhës e të ligjërimit të eposit, si kahe e vija hetimi e hulumtimesh rreth leksematikës, frazeologjisë dhe figurshmërisë së pakundshoqe të eposit, duke u mbështetur sa më fort në fjalët dhe mënyrat e të thënit e të emërtimit të bëmave, veprimeve dhe mjediseve të kreshnikëve, si një truall ende i pastudiuar në gjithë gjerësinë dhe thellësinë që meritojnë.

Disa herë, natyrisht, në funksion të shqyrtimeve dialektologjike e sociolinguistike, ma ka dashur puna të merrem edhe me vlerat e ligjërimit të folklorit e në veçanti të eposit. Në librin e Dialektologjisë në pjesën kushtuar gjuhës së folklorit, kemi dhënë edhe disa vlerësime për gjuhën e eposit, duke e cilësuar atë si përmendore madhështore të kulturës së gjuhës. Kam shkruar e botuar edhe ndonjë studim kushtuar gjuhës së këngëve popullore në përgjithësi e të këngëve të kreshnikëve në veçanti. Më tej, në rrjedhë të viteve, si pedagog titullar i dialektologjisë në Universitetin e Tiranës, i kam "yshtur" (me sa kam ditur e mundur) studentët të marrin edhe tema diplome e masteri kushtuar pikërisht vlerave ligjërimore të eposit të kreshnikëve dhe kam ngulmuar në pohimin se leximi i eposit të kreshnikëve për studentët e degës së gjuhës e të letërsisë vlen, në mos tjetër, sa një lëndë mësimore e programit të shkollimit përkatës.

Këtij pohimi i mbahem edhe sot e gjithë ditën dhe, si shembull, po lejohem të sjell një fakt të thjeshtë: u dhashë, para disa vjetve, studentëve të degës së gazetarisë të UT-së, të komentonin shprehjen "Gjuhë ruajma kokën" dhe ka qenë një nga temat që ata shkruan sprova shumë të bukura. Këtë temë nuk e pata shpikur, por e kisha gjetur pikërisht në një nga këngët e Eposit të kreshnikëve, që thotë:

"M'ka pasë thanun Gjeto Basho Muji:

"N'bejleg fjalët, kur t' bajsh me ra ndër burra,

Ruejma kryet, gjuh-o vedit me i thanë!"

(Lule Frangu, "Folklor Shqiptar, II Epika Legjendare, Tiranë, 1966, f.339)

Së treti, disa kundërime rreth "auditorit" të Eposit dhe proceseve të evoluimit të formave të shprehjes së tij. Këngët e kreshnikëve këndohen në tubime popullore me rëndësi, në festat kombëtare a fetare, në oda të burrave, në dasma, në mjediset familjare etj. Kur këndohen këngët e kreshnikëve auditori dëgjon me nderim e vëmendje të madhe. Burrat e moçëm përhumben në kujtime e derdhin lotë. Eposi është, pra, krijim hijerëndë e burrëror, që nuk i qas vulgarizmat dhe fjalët e pakrehura. Në mbarim të këngës, të gjithë dëgjuesit e pranishëm e urojnë njëzëri këngëtarin me fjalët: "Të lumtë goja!", "Të këndoftë zemra!", "Ia laç djalit!" etj.

Gjithmonë ky Epos është vlerësuar si krijimtari me peshë ndikuese edukative, prandaj në Malësi deri vonë, këngëtarëve me lahutë, u bëhej ftesë dhe u jepej vend i dukshëm krahas pleqnarëve më të njohur në odat e burrave, sepse vlerësohej që “Këngët e kreshnikëve e burrërojnë njeriun, e bëjnë trim, i shtien zemër të durojë plumbat, gjakun, luftat ku tresin mashkujt”. Eposi i kreshnikëve përbën një përmendore të mrekullueshme të kulturës së gjuhës, një trashëgimi të paçmueshme në të cilën mund të verifikohen dëshmi shumë interesante të proceseve historike e dialektologjike të shqipes. Në këtë kuadër të studimit të gjuhës së Eposit bien në sy dy anë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën: nga njëra anë, tematika e pleksur me elemente mitologjike e brendiore të lashta, me mbeturina e tregues legjendarë e mendësi të shekujve të shkuar; nga ana tjetër, një gjuhë që kuptohet pa ndonjë vështirësi të veçantë nga brezat e rinj të kohës sonë, jo vetëm në Gegëni, po edhe më gjerë. Kjo dëshmon se gjuha e Eposit ka pasur përpunim të një shkalle të lartë, prandaj edhe është konsideruar me të drejtë si “përmendore e artë e gjuhës sonë poetike”. Gjuhë të bukur, figura të hijshme e leksik të zgjedhur ka mbarë krijimtaria poetike e popullit tonë, por Eposi i kreshnikëve “da në shenj”, sepse ka përpunim e gdhendje të posaçme. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse shumë studiues, shqiptarë e të huaj, kanë pohuar e mbështetur fuqimisht mendimin se Eposi shqiptar “është një vepër me të vërtetë madhështore e krijuesve popullorë, që të mahnit e të lë pa gojë me bukurinë e vet”.

Eposi ynë i kreshnikëve, kjo përmendore madhështore e kulturës së ligjërimit, ka qenë e do të mbetet edhe më tej si gurrë e pashtershme e modelimit poetik e gjuhësor në shqipen. Ndikimet e eposit mund t'i hetojmë në krijimtarinë letrare të autorëve madhorë, sidomos te Gjergj Fishta dhe “Lahuta” e tij si vlerë e shtuar e Eposit në rrethanat e reja të kohës. (Në Epos thuhet se “Muji â pshtet, e po e ka dhe:z kamishin me duhan”, te Fishta në “Lahutë” gati pa asnjë ndryshim gjejmë “...zgjeshun brez e ashtu në të holla, / kall kamishin Knjaz Nikolla”).

Edhe N.Mjeda, poet kryesisht lirik, në vjershat e tij e ka pasur një “vrujim” prej metaforikës së eposit malësor. Le të kujtojmë, sidomos, “Vajin e bylbylit”, metaforë që na kishte dalë qysh shumë kohë para tij në këngën “Ajkuna qan Omerin”, ku thuhet shprehimisht: “Mirë bylbylat djalin po ma vajtojnë”. Nga studimet tona kemi arritur në përfundimin se në gjuhën e epikës, qoftë risitë (inovacionet), qoftë ruajtjet (konservacionet) janë të lidhura më tepër me brendinë, me stilin dhe me mëtimet artistike, gjë që shkakton lëvizje më të shumta në fushën e leksikut dhe të morfosintaksës. Sistemi fonetik, ndërkaq, mbetet i njëjtë me atë të gjuhës së folur të trevave përkatëse, për arsye se ai nuk mund të kryejë funksione artistike-stilistike si ato që përmbushen me anën e leksikut.

RINI USEINI

ZANAT NË MITOLOGJINË SHQIPTARE – ASPEKTI DIAKRONIK DHE SIMBOLIK I TYRE

Mitologjia popullore është segment i një kulture vazhduese e cila merret me procesin etnopsikologjik të një populli, në varësi prej rrethanave ku ka jetuar populli i cili ka qenë i detyruar të mendojë dhe për gjëra të cilat i ka imagjinuar për shkak të situatave të pashpjegueshme në kohë të caktuara. Sipas atyre besimeve ato po ashtu kanë një rreth jetësor të mbyllur me norma të caktuara në mënyrën e jetesës ose janë identifikuar me to ose janë inspiruar për diçka që jeta të ketë kuptim. Kështu janë krijuar shumë besime me ide fantastike, diçka mbinatyrore e cila mund ta dëmtojë ose ta ndihmojë vetë njeriun. Në këtë ide janë paraqitur dhe zanat tek të gjithë popujt me origjinë antike, si qenie të cilat janë në fazën më të zhvilluar, edhe pse në njëfarë kuptimi totalisht të papërcaktuar përveç bukurisë dhe fuqisë së tyre. Shtrohet pyetja e thjeshtë a janë zanat totem apo besim animik?

Në këtë trajtim do flasim rreth fuqisë së tyre, mënyrën e jetesës e cila është e largët për njerëzit e zakonshëm, përveç disa heronjve të krijuar prej tyre të cilët i dëmtojnë apo i ndihmojnë në situata të pakëndshme apo janë në shërbim të tyre. Ato paraqiten dhe si tregimtare të gjërave të fshehura të natyrës të cilës i takojnë, dinë dhe të mjekojnë dhe t'u ndihmojnë heronjve të tyre. Këtu paraqiten dhe segmente që lidhen me këto qenie siç janë drunjtë e pyjeve të fshehta ku ato jetojnë. Kurse lidhjen me letërsinë shqiptare, ku zanat janë shumë të përmendura do ta paraqesim në veprën "Lahuta e Malcis" nga Gjergj Fishta në të cilën zana analizohet për punën e saj për vetëdijen kombëtare të shqiptarëve në kohën e revolucioneve kombëtare.

Në shumë paraqitje të kulteve natyrore, në to dhe figura të besimeve popullore të përkatësisë së njëjtë, e ruajtur ndër shqiptarë deri në një të kaluar të afërt kanë pasur jo pak hulumtues dhe shkencëtarë të etnokulturës shqiptare. Ato janë të ruajtura me një stabilitet specifik, si relikte të një panteoni antik, në bashkësitë fshatare nëpër malet e larta, dhe kanë ardhur të pastra deri në shekullin XX, kështu dhe pas Luftës së dytë Botërore në mite, rituale, besime, në monumente të krijimeve popullore, me rrënjë nga mesjeta dhe më tej. Të dhëna për këto kulte dhe për figurat e veçanta të besimeve popullore të panteonit pagan kanë zënë vend, edhe pse më së shumti në aspektin gjuhësor, deskriptiv dhe fragmentar, në përshkrimet e shkencëtarëve si A. Boue, J. G. Von Hahn, F. Nopça, E. Durham, M. Lambert, Sh. Gjecovi, D. Palaj, E. Çabej etj.

Përmbajtje më të plotë dhe më arkaike të këtyre kulteve janë ruajtur deri në dekadat e para të shek. XX, në disa krahina, të përhapura ndërmjet bjeshkëve, me ekonomi natyrore si dhe me komunikim të paktë e të vështirë me qendrat urbane.

Të këtilla ishin malet në Shqipërinë e Mesme, veçanërisht në brendësi të Alpeve, malet në Labëri, diku-diku dhe në krahinat e tjera në qendrat e banuara në mes bjeshkëve¹. Pas figurës së zanës me atributet e saj me të rëndësishme qenësore, jetonte një hyjni në eposin mitologjik mesjetar të shqiptarëve, ajo ishte e pranishme në vepra e heronjve të këtij eposi. Vendin qendror e zinte dhe në disa balada mesjetare, në legjendat mitologjike, atë e hasim në kategori të ndryshme të krijimeve folklorike. Kjo figurë ka ardhur e tërësishme, por edhe e segmentuar me qeniet e tjera mitike, me paraqitje të ndryshme në besimet popullore, në kulte të vendeve të shenjta me rituale të veçanta. Ajo sjell që krijimet e kësaj tematike të jenë më atraktive, dhe njëkohësisht zgjojnë interes tek hulumtuesit shkencor, pasi nëpërmjet saj shpjegohet vetëdija arkaike e miteve dhe në këtë mënyrë plotësohen njohuritë tona për një kulturë shpirtërore të së kaluarës.² Në besimet popullore zana paraqitet me pamje të një gruaje të re, të një vajze me bukuri të përkryer, si simbol i bukurisë, e veshur me veshje tradicionale të nusërisë të vendit apo krahinës ku ruhen besimet popullore për të, në Malësinë e Madhe me xhubletë, në Labëri me veshje tradicionale labe. Kështu dhe në Çamëri, Dibër, në regjionin e Tetovës, në Karadakun e Shkupit dhe Kumanovës etj. besohej që vendbanimet e zanave ishin në mes bjeshkëve të shenjta, të fshehta, ku nuk mund të shkel këmba e njeriut, por dhe nëpër shpella. Shpella mund të ishte në ndonjë humnerë apo pjerrtësi të ndonjë shkrepit ku këmba e njeriut nuk mund të shkojë. Ato e kalojnë kohën me punët e tyre në majat e maleve, mbi shkëmbinj, tek guroret e freskëta, apo tek mrizet e veta. Kështu ekziston Shkëmbi i Rajës apo Shkëmbi i Zanave (Nikaj-Mertur), Shpella e Shkëmbit të Kuq (Temal-Pult), Burimi i Zanave (Himarë), Shpella e Zerës (Paramithi, Çamëri) etj.³ E në zonën e Strugës mund të hastet në fshatin Pohum Kroi i Çoucës, që sipas mendimeve dhe legjendave të treguar nga vendasit ka qenë vend i frikshëm. Në vetvete zanat kanë fuqi zotëruese për shërim, që t'i bëjnë njerëzit më të fuqishëm dhe t'i shpëtojnë nga rreziqet që u kanosen.

Heroi në fëmijërinë e tij ka qenë një fëmijë i butë për nga shëndeti, dhe për shkak të ndonjë mirësie që ia bën zanës duke i shpëtuar fëmijët e saj përderisa kanë qenë në djep në mes pyjeve mbi shkëmb, ajo e pyet se çka dëshiron si shpërblim. Dhe ai kërkoi forcën. Tri herë i japin nga një pikë prej qumështit të tyre dhe kështu ai shndërrohet në hero aq të fort saqë mundej të mbante mbi shpatull një shkëmb të madh (sipas varianteve të ndryshme). Në variantet e tjera, Zanat i japin Mujos të pijë një lëng të nxjerrë nga një lloj bime magjike të cilën mund ta gjejnë vetëm zanat.

Zanat kështu e ruajnë pyllin e virgjër nga shfrytëzimi njerëzor, gjë që ka shumë domethënie. Në disa raste kur luftojnë me heronjtë, ata humbin, kurse në raste e tjera dhe vëllazërohen me to dhe u ndihmojnë po ashtu. Mendoj që këtu

¹ Mark Tirta „Mitologjia ndër shqiptar“, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2004, fq.112

² Изаим Муртезани, Митски елементи во албанскиот и македонскиот епос и балада, Институт за Фолклор „Марко Цепенков“, Скопје 2006, fq.171

³ Ibid, fq.113

paraqiten nivele të ndryshme të evoluimit të kësaj hyjnie në varësi të periudhave të ndryshme të zhvillimit shoqëror. Besimtarët e malësisë, atje ku më së shumti ruhet ky kult, nuk duan ta përmendin emrin e saj, pa ndonjë arsye, duke menduar se është mëkat⁴.

Zanat janë figura që më së shumti shprehen në Shqipërinë Veriore. Zanat në jugun e Shqipërisë njihen dhe si zëra, ato janë moira malore të letërsisë shqipe, të njëjta me vilat e sllavëve të jugut. Ato gjallërojnë në periudhën pranverore në afërsi të rrëzës së Alpeve në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë, kështu që besohet që secila bjeshkë ka zanën e vet. Ato imagjinohen si vajza të mira, muza të maleve, të cilat këndojnë, mbledhin lule dhe lahen lakuriq në pyjet e mëdha. Zanat janë shumë të guximshme, sikurse Palas Antena të Greqisë antike mbrojtjen e tyre e kryejnë si luftëtare, prandaj njihet dhe thënia "Trim si Zana". Nëse vritet ndonjë luftëtar, atëherë zana qan për të me zakon si një nënë që qan për djalën e saj. Zanat janë temperamente dhe mund ta rrezikojnë çdo hero i cili përpiket që ta shohë atë kur lahet. Për këtë rast kishte një ligj për njerëzit që kalonin nëpër pyje, bërtisnin me zë që të largohet zana pasi ato kalojnë. Kur dikush vuante nga epilepsia mendohej që ka shkelur i pavëmendshëm mbi zanë, dhe të njëjtin e pyesin: *mos ke shkelur në ndonjë travezë zanash?*

Zana ishte burim inspirimi për shumë ndodhi në Shqipërinë Veriore, prej ku ato kishin mundësi të shohin shumë beteja në mes fiseve shqiptare dhe kundërshtarëve të tyre nga majat e larta malore dhe kanë intervenuar nëse ka qenë e nevojshme. Kuptohet ato e kanë frymëzuar dhe shkrimtarin françeskan Gjergj Fishta në poemën e tij të përkryer "Lahuta e Malcisë", duke e krijuar Fishta na tregon që zanat ishin mbrojtëse të muzës Mont Helion e cila gjendet në pjesët veriore dhe mbetet atje (lahuta e malcisë)⁵. Në këngën greke, roli i zanës është si një lajmëtare, këshilluese apo si mjeshtre e natyrës, të cilën e përmbush një zog, ndonjëherë dhe vetë natyra në formë të një mjegulle. Në këngën e njëjtë shqiptare zana është i njëjti zog grek. Por në ciklusin arkiktik mund të zbulojmë një ndërthurje, e njëjtë me vilën para se të arrihet tek zogu i grekëve të sotëm, ajo është Amazonja e Aleksandrit të Madh, me të cilën lufton Digenis akritis njëjtë siç lufton mbreti Marko me vilën sllave⁶.

Zana përveç në eposin popullor, paraqitet dhe në rolin e qenieve mitike dhe në prozën popullore, përkatësisht në përrallat dhe besimet popullore. Në këtë drejtim duhet të shtojmë, se në epikën shqiptare, si qenie mitike e njëjtë me zanën paraqitet dhe Ora. Në besimet popullore, Ora paraqitet edhe si mbrojtëse e familjes, vëllazërisë fisnore, kurse zana është mbrojtëse e heronjve epikë.⁷

⁴ Mark Tirta „Mitologjia ndër shqiptar” , Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 2004, fq.115

⁵ Robert Elsie , A dictionary of Albanian religion, mythology and folk culture, Hurst & Company, London, 2001

⁶ Eqerem Cabej, (1971), Diana dhe Zana, Studime gjuhësore, V, Rilindja, Prishtinë, fq.125

⁷ Mehmeti Enver, Figurat mitike në ciklin e kreshnikëve, Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore, Materiale nga sesioni shkencor, mbajtur në Prishtinë me 7-8 shtator 1979, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1983, fq.84

Dushku paraqet dru me të cilin janë të lidhur shumë besime, druri i cili me jetëgjatësinë dhe paraqitjen madhështore ka përçaruar respekt te populli. Ai është dru i shenjtë, vend i realizimit të ritualeve, por dhe deri në atë shkallë të respektohet dhe si hyjni. Dushku është i lidhur me zanën, si vend i shtëpisë së saj. Besohet se ndër degët e dushkut janë të mbledhura zanat dhe atje i organizonin dasmat e tyre. Kështu hasen dhe dushqe të quajtur Dushku i Zanës. Dushk të tillë ka dhe në fshatin Broshtica të Dibrës, ku ka qenë i lidhur një zinxhir ku kanë lëvizur apo janë luhatur zanat. Njeriu nëse vjen në kontakt me zanën sëmurët. Prandaj është e nevojshme në këto dushqe të vendoset tërpez në emër të njeriut të shytuar. Për atë mbahen nga tre kolaçe, të cilët vendosen në tri vende të ndryshme, së bashku me produkte të tjera ushqimore, me shpresë se zanat do t'ia kthejnë shëndetin të sëmurit. Tek dushku i Zanave shkon një grua që të vendos tre kolaçe rreth e përçark, si pirosti, në tre vende, për të sëmurin apo të shytuarin. Gruaja që i vendos thotë: "Kjo e kaurrit, kjo e turkut, njëra zgjedhëse!" - domethënë do të vërejë cili kolaç do të hahet. I vendonte në mbrëmje, një natë të flenë, të jenë ushqim softe për zanat. Kanë lënë dhe arra, bukë dhe ushqime të tjera. Në mëngjes si dëshmi ishin zanat. Varësisht cilin kolaç e kanë ngrënë zanat, shërimi të kërkohej mbi atë bazë, ose në kishë të shkojnë ose në xhami. Ekziston besimi që në dushqet e zanave lëshohen shqiponja të kryqëzuara të cilat dyluftojnë me lamijat të cilat sjellin të reshura. Në territorin e Maqedonisë hasen dushqe të mëdhenj, më së shumti *Querrens peduculi flora K. Koch* nga rrënjët e së cilës rrjedh uji. Mendohet se ky ujë është shërues dhe në ditë të caktuara njerëzit shkojnë për t'u larë dhe për të pirë ujë, duke lënë dhurata të ndryshme në degët e saj. Dushqe të tilla ka në fshatin Shumovo të Prilepit, Dushku i kryqëzuar në fshatin Radozhde të Strugës etj.

Bjeshkët sipas funksioneve mitike gjithmonë i kanë atributet me të cilat karakterizohet bota tjetër. Kështu, sipas besimeve popullore "pylli" përkatësisht malësia mendohet si e shenjtë, për arsye se është më afër qiellit "ku qëndrojnë hyjnitë". Ky fakt ka kushtëzuar të besohet se hapësira në male, apo pjesa e sipërme e arealit të vet, është e veçantë dhe ka qenë e rezervuar për manifestime sakrale. Në religjionet e ndryshme, pikërisht në majat e larta, hyjnitë e kanë caktuar vendin e kultit të vet.

Në religjionet e ndryshme konstatohet se zana është e ndërlidhur ngushtë me malin, prandaj mund të përfundohet se ajo është personazh që i takon "botës tjetër", kurse gjithçka që vjen nga bota tjetër i ka atributet e të pathyeshmit, pasi kjo hapësirë është e përbërë nga hyjnitë e përjetshme të cilët kërkojnë respekt nga njerëzit, në të kundërt i ndëshkojnë ashpër, posaçërisht nëse nuk i respektojnë rregullat e këtij vendi të shenjtë. Kur jemi këtu duhet të kufizohet linja, në fakt ndryshimi në mes „kësaj dhe asaj" bote.

Nga kjo mund të nxirret konstatimi i kësaj kohe, fuqitë natyrore të personifikuara në qenie të ndryshme mitike, udhëheqin me njeriun për shkak të zhvillimit të vetëdijes njerëzore. Kështu edhe zana si dhe një varg të tjerash qenie mitike nga bota "tjetër" udhëheq me arealin e saj gjeografik dhe nuk lejon të jetë e ofenduar nga ata të cilët nuk shqetësohen për sjelljet e tyre në këtë hapësirë që ajo e udhëheq. Zanat kanë fëmijë të cilat i luhasin në pemë, vallëzojnë, këndojnë, luajnë, u bien instrumenteve muzikore, por asgjë nuk dihet apo flitet për lidhjen e tyre

martesore, diku besohet se ata lindin pa kontakt me burra. Në këtë kontekst edhe zanat shqiptare cilësohen për trimëri dhe aftësi mbinjerëzore luftarake. Thuhet “*ai është i guximshëm si zana*”, “*luftëtar si Zana*”, “*i fortë si Zana*”, e gjithë kjo në konotacion të aftësive mbinatyrore. Siç mund të vërehet, në këtë pikëpamje kanë ngjashmëri me Amazonet antike në Azinë e Vogël.

Dihet se sipas besimeve tradicionale nata është kohë e aktiviteteve intensive të qenieve mbinatyrore. Për arsye të ndërprerjes së të gjitha aktiviteteve nga ana e njerëzve, nata gjithashtu karakterizohet si kohë e huaj, interval që u takon qenieve të "botës tjetër", përkatësisht botës jonjerëzore. Domethënë opozita ditë-natë është një betejë e rëndësishme e cila e dallon “këtë” nga “ajo” botë. Në këtë kontekst zanat shqiptare në eposin heroik paraqiten si qenie të cilat kënaqen me ardhjen e natës dhe prandaj lusin Diellin që të mos dalë, kurse Hëna ta vazhdojë shkëlqimin edhe më tej: *Mos u ngut ti moj hanë!, Ujt e freskët tek ke qëllue, si mos kur flladi po fry’, Ishona dritën nëpër ato biga*⁸. Me këtë fakt del që zanat dhe me këto cilësi paraqiten si qenie të sferës lunare.

Hëna si atribut i zanave karakterizohet me errësirën e saj dhe qëndron në opozitë me Diellin, përkatësisht me principin solar. Aktiviteti i natës së zanave zgjat deri në agim, derisa këndojnë gjelat e parë. Në këtë termin secili ballafaqim me zanën është fatal për njeriun. Ky motiv sipas Krstiqit, i njohur me përmbajtjen se si vilat, nuk e lejojnë njeriun të shkojë natën për ujë, derisa të këndojnë gjelat, është gjerësisht i përhapur tek sllavët e Ballkanit dhe është vërejtur në shumë variante të shkrimit e mbledhësve të folklorit. Megjithatë, takimet e personazheve të këtyre këngëve janë tragjike, pasi ato mbesin viktime të këtyre qenieve mbinatyrore për shkak të "sulmit" të hapësirës së tyre dhe në kohë të gabuar. Në eposin heroik shqiptar, nuk hasim motive ku paraqiten lidhje të përkohshme martesore në mes burrit dhe zanës. Në këtë drejtim etnologu i mirënjohur Mark Tirta, në një material, duke folur rreth zanës shqiptare thotë se "*asgjë nuk dihet dhe nuk flitet, diku besohet se ato lindin fëmijë pa kontakt me meshkuj. Pra vërehet para së gjithash, në këtë drejtim kanë ngjashmëri me Amazonet e lashta të Azisë së Vogël*". Këtë mendim për zanat shqiptare e ndan edhe autori shqiptar Bernardin Palaj i cili thotë se „ *asnjëherë nuk përmendet mashkull në gjirin e tyre, por ndonjëherë duket se për shkak të dashurisë apo me forcë mund të bëhen edhe gra të ndonjë heroi legjendar apo të ndonjë malësori të vërtetë, i cili arrin që ta përfitojë për vete*.

Zanat dhe Orët nuk kërkojnë asnjë sakrificë prej njeriut, përveç besës dhe respektit. Ai respekt bëhet pa ceremoni fetare. Personifikimi i këtyre qenieve është modeluar sipas identitetit të botës njerëzore.

Kalimi i shpirtit në qenie të tjera është besim i lashtë totemik. Zanat shqiptare me këto cilësi paraqiten të njëjta me figura të tjera, nga mitologjia popullore shqiptare si lubia, vampiri, divi, gogoli etj., të cilat paraqiten edhe në përralla popullore shqiptare. Dhe këto figura mitike të cilat për dallim nga zanat janë plotësisht monstroze, që të jenë të paepura e kanë transferuar fuqinë në disa

⁸ Qemal Haxhuhasani, Folklor shqiptar, II, Epika legjendare, Instituti I Folklorit, 1966, Tiranë, fq.94

qenie apo në të tjera objekte të fshehura. Megjithatë si në eposin heroik, përkatësisht me këngët me këtë motiv, gjithashtu dhe në përrallat popullore, njeriu arrin që t'i mundë pengesat irracionale pas zbulimit të fuqisë së transferuar të figurave mitike.⁹ Hulumtuesi më i njohur shqiptar, Eqrem Çabej, duke e shpjeguar ndërlidhjen e zanës me dhinë e egër thotë se "*nuk është asgjë e rastësishme që në kultin e Artemis Agroterasi në Spartë së cilës hyjni i ish-in bashkangjitur dhi të egra në formë të viktimave kurse nga ana tjetër në motivet relievo në Delminum, Diana paraqitet në skulpturë me këmishë dhe zagar, kurse burimi i fuqisë së zanës i vinte nga pyjet halore, të cilat paraqiten në tre dhi të egra me brinjë të arta.*"¹⁰

Këto simbole kanë fillesa nga "nënvetëdija kolektive" përkatësisht nga ajo pjesë e psikikës e cila e ruan dhe e transmeton trashëgimin e përbashkët psikologjik të njerëzimit. Këto elemente të përbashkëta mitike, Jung i quan arketipe "të cilat mund të ndryshojnë në detaje, nëpërmjet së cilës nuk e humbin formën e tyre thelbësore. Një tjetër kundërshtues i teorisë së Jungut, Josef Henderson, mendon se në duelet e heronjve me qeniet me fuqi mbinatyrore fshihet komponent psikologjik. "Në vetëdijet e njeriut zhvillohet figura e heroit e cila paraqet ndërmjetësim psikologjik nëpërmjet së cilës egoja triumfon mbi nënvetëdijen dhe e çliron njeriun e pjekur nga tendencat regresive që të kthehet fëmijëria e lumtur, në botën kur ka dominuar nëna e tij. Kur Mujo është i rrethuar nga kundërshtarët në shtëpinë e tij, ai bërtet aq sa mundet, dhe e dëgjon zana e cila flinte në shpellën e saj dhe kur vjen e pyet Mujon çka po i ndodh, Mujoja i thotë që të shkojë t'u tregojë shokëve të tij që t'i vijnë në ndihmë.

Zanat marrin vend domethënës në rolin e shërimit të heronjve. Ka shumë sekuenca ku ato qëndrojnë afër heronjve dhe ua shërojnë plagët e marra. Ilaçet të cilat i shfrytëzojnë për shërimin e plagëve janë nga bimë të llojllojshme përbërja e fshehtë e së cila është e njohur vetëm nga zanat. Kështu, në një këngë të heroit të eposit shqiptar, nëna e heroit, e nxitur nga ndjenja që të marthet me Bajlozin - skllav i djalit të saj, do ta verbojë djalin e vet, do ta lirojë Bajlozin dhe do të arratiset me të. Por, zana me ndihmën e bimëve do t'ia kthejë shikimin heroit i cili pastaj do të kujdeset që nëna e tij të marrë dënimin e duhur. Megjithatë, shërimi i syve të verbëruar të heroit është i treguar në konstruksionin e mëposhtëm poetik: *njatherë orët po e ndigjojnë, / malit barin po e kërkojnë kanë këput një lulzë malit, / ma kanë shtrydhë përmby sy t'djali, / sall tri pikë qi m'i kanë ra, / sallë një herë ja kanë la, / e kanë ba djalin me pa, / ja kanë kthye syt s'i i ka pas.*¹¹

Dhe protagonistin kryesor epik, Mujo, ndihmohet prej zanave apo orëve, të cilët i informojnë zanat për gjendjen e rëndë shëndetësore në të cilën është heroi i tyre, i cili është i plagosur nga kundërshtarët, pasi ka luftuar në ditën kur nuk ka pasur bekimin e tyre. Por dhe për këtë arsye, zanat intervenojnë dhe ia shërojnë plagët. Si në këngën: *Ora e malit atherë ka fol, / Ju, moj motra, betë i paskit ba, /*

⁹ Enver Mehmeti, Studime ne fushen e letersise gojore, Tetovë, fq.155

¹⁰ Eqerem Cabej, Disa figura te besimeve popullore shqiptare, Gjurmime Albanologjike, Folklor dhe etnologji, II, Instituti Albanologjik i Prishtines, 1972, Prishtine.fq.14

¹¹ Qemal Haxhihasani, Folklori shqiptar, II, Epika legjendare, Instituti i Folklorit, 1966, Tiranë, fq.129

po ju mue barnat me m'i dhanë, / me orok unë barnat me ja qitë, / ni sahat o tamam kur të bahet, / varrë në trupë Muja mos me gjetë. Domethënë me këto cilësi që i posedojnë si shëruese me ndihmën e bimëve dhe ujit, zanat tregojnë se janë qenie të natyrës ktonike, sepse i dinë sekretet e bimëve dhe ujit që rrjedh nga bota nëntokësore. "Për atë aftësi të tyre, ata duhet t'i jenë faleminderuese njohjes së bimëve mjekësore, pasi për secilën sëmundje ekziston bimë mjekuese, të cilën njerëzit nuk e dinë, por zanat e dinë. Jo vetëm për secilën sëmundje, por dhe për vdekjen, zanat e dinë ilaçin - ato dinë për bimën e jetës, të cilën asnjë nuk e ka gjetur dhe nëse e gjen nuk do të mund ta ruajë.

Këtu mund të përkujtohemi në Gilgameshin, i cili arriti që ta gjejë ilaçin për jetë të përhershme, por nuk arriti që ta ruajë. Kompliciteti i zanave, përkatësisht gjysmëfunktionaliteti i tyre është shprehje e shumë attributeve nga demonët e tjerë femërorë, të cilat janë përhumbur dhe kanë mbetur vetëm zanat. Në këtë aspekt, janë evidente shumë transformime kryqëzuese të shumë miteve shpirtërore dhe zhanre të ndryshme, pasi miti nuk mund të mbesë si cilësi i një zhanri stabil, por gjithmonë i ushqen dhe zhanret e tjera gojore. Elementet që pasqyrohen nga një mit në tjetrin, kanë funksione të ndryshme në aspektin tekstual dhe kontekstual me një zhanër tjetër. Në këtë ndërlidhje mitologjizmat për zanat kanë absorbuar në vetvete shtresa të ndryshme nëpërmjet të cilave pasqyrohet dhe evolucioni i vetëdijes mitike ndër kohë.

PËRFUNDIM

Nga të gjitha këto fakte, falë punës së shumë hulumtuesve shkencorë kemi të dhëna të tregojnë se jeta e popullit ka qenë e lidhur me botën irracionale, apo me idetë me të cilat ata kanë jetuar duke besuar se përveç tyre, jetojnë edhe qenie mbinatyrore prej të cilëve duhet të ruhen pasi mund t'i dëmtojnë. Por nëse e lidhim zanën me njeriun e zakonshëm i cili me ndihmën e tyre është bërë hero, mund të themi se ato nuk ishin aq të këqija nëse nuk i dëmton apo shqetëson. Këtë mund ta ndërlidhim edhe me qenie të tjera, për shembull gjarpri, të cilit barinjte i kanë thënë mos më dil para pasi nuk duam të të lëndojmë. Në të kundërt mund të cekim se zanat ishin mjaft dashamirëse, pasi pas mbrojtjes së fëmijës së zanave nga ana e Mujos ata me vullnetin e tyre shprehën dëshirë t'i ndihmojnë varësisht prej kërkesave të tij. Nga këtu del konkluzioni se dashuria amësore është mbi gjithçka dhe mbinatyrore, ajo është aq e madhe saqë mund të dhurojë vetëm dashuri dhe ndihmë për të gjithë. Zanat ishin aq dashamirëse saqë i ndihmojnë heroit në secilin vend dhe në secilën kohë, kudo që do të jetë hero i ato janë me të. Në këtë mënyrë kërkoi ndihmë dhe Fishta në veprën e tij "Lahuta e Malcis", që zanat t'i ndihmojnë popullit të tij që të zgjohet nga robëria, me këngët e tij ai dëshironte që të ngrejë vetëdijen nacionale që njerëzit të jetojnë jetë më të mirë, të lirë dhe të ditur. Kjo pjesë e mitologjisë është shumë impresionuese, sepse flet për gratë të cilat i takojnë jetës matriarkale, ato janë të fuqishme, të bukura, nxisin lirinë, ashtu siç dhe ato jetojnë të lira nëpër pyje, nuk i duan armiqtë dhe u ndihmojnë atyre të cilëve u nevojitet ndihmë. Ato do të jenë inspirim në çdo kohë kur njeriu duhet të jetë njeri në çfarëdo kuptimi, punëtor, dashamirës dhe ndihmëtar i atyre që kanë nevojë.

BERNARD LEWIS

ISLAMIZMI DHE PERËNDIMI

Nëse popujt e Lindjes së Mesme vazhdojnë në rrugën e tanishme, kamikazët mund të bëhen një metaforë për krejt rajonin dhe nuk do të ketë shpëtim nga spirali i urrejtjes dhe inatit, i zemërimit dhe i vetëkeqardhjes, i varfërisë dhe i shtypjes.

Gjatë shekullit të 20, u bë e qartë se në Lindjen e Mesme, në fakt në të gjitha vendet ku sundon Islami, gjërat kishin shkuar shumë keq. Krahasuar me Krishterimin, rivalin e tij qindravjeçar, bota e Islamit ishte dobësuar, kishte rënë në varfëri dhe injorancë. Perëndimi kishte dalë në vend të parë dhe dominimi i tij ishte i dukshëm. Ai ishte shtrirë në çdo aspekt të jetës publike të myslimanëve, madje çka ishte më e dhimbshme, kishte hyrë edhe në jetën e tyre private.

Ithtarët e modernizimit me reformë apo me revolucion të botës islame i përqendruan përpjekjet në tri aspekte: ushtarake, ekonomike dhe politike. Por rezultati ishte zhgënjyes, për të thënë më të paktën. Përpjekjet për të arritur fitore me ushtri moderne sollën një sërë disfatash të hidhura. Edhe përpjekjet për zhvillim ekonomik nuk patën sukses. Në disa vende ato çuan në ekonomi të varfra dhe të korruptuara, që vareshin te ndihmat e huaja. Në disa vende të tjera sollën varësinë te nafta si burimi i tyre i vetëm. Madje edhe nafta e tyre nxirrej me anë të shkencës perëndimore dhe shfrytëzohej nga industria perëndimore. Herët a vonë, ajo është e destinuar të shterojë ose ndoshta të anashkalohet nga përdoruesit e energjisë, tani që komuniteti ndërkombëtar po e kupton gjithnjë e më tepër ndotjen që ajo i sjell tokës, detit dhe ajrit gjatë përdorimit ose transportit, po e kupton se nafta e lë ekonominë botërore në mëshirë të një klike autokratësh kapriçozë. Më e keqja e të gjithave janë rezultatet politike: përpjekjet e gjata për liri kanë lënë në Lindjen e Mesme një sërë tiranish mjerane, duke filluar nga autokracitë tradicionale e deri te diktaturat, të cilat janë moderne vetëm në aparatit e tyre të shtypjes dhe të indoktrinimit.

Për shërimin e gjendjes u provuan formula të ndryshme: armatime dhe uzina, shkolla dhe parlamente, por asnjëra nuk dha rezultatin e dëshiruar. Aty-këtu ato çuan në ndonjë zbutje të problemeve dhe për disa elementë të kufizuar të popullatës sollën ndonjë përfitim. Por ato nuk e ndreqën, madje as që e frenuan disbalancën në rritje mes Islamit dhe botës perëndimore.

Dhe kjo nuk ishte e gjitha. Myslimanët ndiheshin keq që, pas shumë shekujsh pasurie dhe fuqie, ishin bërë të varfër e të dobët, që kishin humbur pozitën udhëheqëse, të cilën e konsideronin si të drejtën e tyre dhe që kishin përfunduar në rolin e ndjekësve të Perëndimit. Por shekulli i 20, sidomos gjysma e tij e dytë, u sollti një poshtërim të mëtejshëm, kur ata e kuptuan se nuk ishin më as në radhët e para të këtyre ndjekësve, por po mbeteshin prapa në sërën e gjatë të vendeve që po

modernizoheshin sipas shembullit të Perëndimit, sidomos atyre në Azinë Lindore. Ngritja e Japonisë ishte një inkurajim por edhe një qortim. Ngritja e mëvonshme e fuqive të tjera ekonomike aziatike solli vetëm qortim. Trashëgimtarët krenarë të qytetërimeve të lashta ishin mësuar tashmë të paguanin firma perëndimore për të realizuar gjëra që teknikët dhe kontraktorët e tyre nuk i bënin dot. Sundimtarët dhe biznesmenët e Lindjes së Mesme e panë tani të udhës të ftonin kontraktorë dhe teknikë nga Koreja, e cila vetëm pak dekada më parë kishte dalë nga sundimi kolonial japonez. Nuk është mirë të ndjekësh dikë nga pas, por është shumë më keq kur e ndjek duke çaluar. I parë nga të gjitha standardet e botës moderne, siç janë zhvillimi ekonomik, krijimi i vendeve të punës, niveli i shkollimit, arritjet në edukim dhe shkencë, liria politike dhe respekti për të drejtat e njeriut, ky qytetërim dikur i fuqishëm, tani ka rënë mjaft poshtë.

“Kush na e bëri këtë?” është reagimi më i natyrshëm i njerëzve kur punët nuk shkojnë mirë. Këtë pyetje e kanë bërë dhe e bëjnë shumë njerëz në Lindjen e Mesme. Zakonisht është më e lehtë t’ua hedhësh fajin të tjerëve për hallet e tua. Për një kohë të gjatë, fajtorët më të zakonshëm ishin mongolët. Pushtimeve mongole të shekullit të 13 u hidhej faji për shkatërrimin e fuqisë dhe të qytetërimit islam si dhe për dobësinë dhe stanjacionin që pasoi. Por pas një farë kohe, historianët, myslimanët dhe të tjerët kuptuan se ky argument kishte dy të meta: Së pari, disa nga arritjet më të mëdha kulturore të Islamit, sidomos në Iran, erdhën pas dhe jo para pushtimeve mongole. Së dyti, një fakt më i vështirë për t’u pranuar, por i pamohueshëm ishte se mongolët përmbysën një perandori, e cila tashmë ishte e dobësuar për vdekje; përndryshe është e vështirë të kuptosh se si perandoria dikur e fuqishme e kalifëve mund të kapitullonte përpara një hordhie kalorësish endacakë që vinin nga stepat e Azisë Lindore.

Rritja e nacionalizmit, që në vetvete ishte importuar nga Europa, solli perceptime të reja. Arabët mund t’ua hidhnin fajin për problemet e tyre turqve, që i kishin mbajtur nën sundim prej shekujsh. Nga ana e tyre, turqit mund t’ua hidhnin fajin për stanjacionin e qytetërimit të tyre peshës së vdekur të së kaluarës arabe, në të cilën kishin mbetur të paralizuar energjitë krijuese të popullit turk. Persët mund t’ia hidhnin fajin për humbjen e lavdisë së tyre të lashtë arabëve, turqve dhe pjesërisht mongolëve.

Në shekujt e 19 dhe 20, dominimi britanik dhe francez në një pjesë të mirë të botës arabe solli një element të ri dhe të pëlqyeshëm ku mund të kërkohej faji: imperializmin perëndimor. Në Lindjen e Mesme ka patur mjaft arsye ku mund të bazohej një akuzë e tillë. Dominimi politik perëndimor, depërtimi ekonomik i Perëndimit dhe sidomos ndikimi i tij kulturor, që ishte më i gjatë, më i thellë dhe më tinzar se gjithçka tjetër, ia ndryshuan faqen rajonit dhe transformuan jetën e popujve të tij. Ky element u solli atyre drejtime të reja, zgjoi shpresa dhe shqetësime të reja, krijoi rreziqe dhe pritshmëri të reja, të papara në të kaluarën e tyre kulturore.

Por dominimi anglo-francez ishte relativisht i shkurtër dhe mori fund gjysmë shekulli më parë, ndërkohë që tatëpjeta e Islamit kishte filluar shumë kohë më parë dhe vazhdoi pareshtur pas kësaj. Në mënyrë të pashmangshme, roli prej fajtori që u atribuohet britanikëve dhe francezëve u zëvendësua nga Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, krahas aspekteve të tjera të lidërshiptit perëndimor. Përpyekja për ta transferuar fajin tek Amerika ka fituar mbështetje të konsiderueshme, por, për arsye të ngjashme, nuk është bindëse edhe sot e kësaj dite. Sundimi anglo-francez dhe ndikimi amerikan, ashtu si edhe pushtimet mongole, ishin pasojë dhe jo shkak i dobësive të brendshme të shteteve dhe shoqërive të Lindjes së Mesme. Disa vëzhgues, brenda dhe jashtë rajonit, kanë vënë në dukje se ka patur diferenca në zhvillimin post-kolonial të ish zotërimeve britanike, për shembull mes Adenit në Lindjen e Mesme dhe Singaporit apo Hong Kongut, ose mes viseve të ndryshme që dikur ishin pjesë e Perandorisë Britanike në Indi.

Një tjetër element europian në këtë debat është anti-semitizmi dhe hedhja e fajit hebrejve për të gjitha problemet. Hebrejntë, në shoqëritë islamike tradicionale kanë provuar kufizimet normale dhe rreziqet e herëpashershme që sjell statusi i të genit pakicë. Para lindjes dhe përhapjes së tolerancës perëndimore në shekujt e 17 dhe 18, ata jetonin më mirë nën regjimet myslimane se në ato të krishtera, në aspektet më të rëndësishme. Me përjashtime të rralla, aty ku në traditën islame ekzistonin paragjykitime armiqësore ndaj hebrejve, përgjithësisht shoqëritë islame ushqenin më tepër përbuzje dhe mospërfillje se sa dyshime apo fiksime kundër tyre. Prandaj, ngjarjet e vitit 1948, dështimi i përpyekjeve për të penguar krijimin e shtetit të Izraelit, u pritën me tronditje. Siç vinin në dukje disa autorë të asaj kohe, të mundeshe nga fuqitë e mëdha imperialiste të Perëndimit ishte poshtëruese; të pësoje të njëjtin fat në duart e një bande të përbuzur hebrejsh ishte e padurueshme. Anti-semitizmi dhe imazhi i tij për hebrejntë si një monstër e ligë që thur vazhdimisht plane të fshehta, u kthyen në një antidotë për të qetësuar dhembjen.

Deklaratat e para anti-semite në Lindjen e Mesme u bënë nga pakicat e krishtera dhe u ngjanin atyre që e kishin zanafillën në Europë. Ndikimi i tyre ishte i kufizuar. Për shembull, gjatë gjykimit të çështjes Dreyfus në Francë, kur një oficer hebre u akuzua padrejtësisht dhe u dënua nga një gjykatë që u tregua armiqësore ndaj tij, komentet e myslimanëve zakonisht ishin në favor të hebreut dhe kundër përndjekësve të tij të krishterë. Por helmi vazhdoi të përhapet dhe, duke filluar nga viti 1933, Gjermania naziste bashkë me agjenturat e saj, ndërmorën një fushatë të orkestruar dhe përgjithësisht mjaft të suksesshme për të nxitur anti-semitizmin e stilit europian në botën arabe. Lufta për Palestinën e lehtësoi mjaft pranimin e interpretimit anti-semit të historisë, duke i bërë disa njerëz t'ia atribuonin çdo të keqe në Lindjen e Mesme, madje në të gjithë botën, kompleteve të fshehta të hebrejve. Ky interpretim ka mbizotëruar një pjesë të mirë të diskursit publik në rajon dhe kjo pasqyrohet mes të tjerash në arsim, në media madje edhe në botën e argëtimit.

Një argument që përdoret herë pas here është se shkak i ndryshimit të marrëdhënieve mes Lindjes dhe Perëndimit nuk qëndron te rënia e Lindjes së Mesme por te ngritja e Perëndimit, te zbulimet dhe revolucionet shkencore, teknologjike, industriale dhe politike që e transformuan Perëndimit dhe e shtuan mjaft pasurinë dhe fuqinë e tij. Mirëpo, një argument i tillë të shtyn ta shtrosh pyetjen ndryshe: Përse atëherë zbuluesit e Amerikës u nisën nga Spanja dhe jo nga ndonjë port mysliman i Atlantikut, nga të cilët për hir të së vërtetës ka patur

përpjekje në kohë më të hershme? Përse zbulimet e mëdha shkencore ndodhën në Europë dhe jo, siç mund të pritej, në botën më të pasur, më të përparuar dhe në disa aspekte më të iluminuar të Islamit?

Një formë më e sofistikuar e lojës së fajit i gjen fajtorët brenda dhe jo jashtë shoqërisë islame. Një fajtor i tillë është feja, madje për disa, është vetë Islami. Por, t'ia hedhësh fajin Islamit është zakonisht e rrezikshme dhe përpjekje të tilla nuk bëhen shpesh, nuk është as shumë bindëse si arsye. Gjatë pjesës më të madhe të Mesjetës, qendrat kryesore të qytetërimit dhe përparimit nuk ishin as kulturat e vjetra të Lindjes dhe as ato të reja të Perëndimit, por ishte bota e Islamit. Atje u rigjallëruan e u zhvilluan shkencat e vjetra dhe u krijuan të reja; atje lindën industri të reja, prodhimi dhe tregtia u përhapën në nivele të papara. Atje qeveritë dhe shoqëritë fituan një liri të tillë mendimi dhe shprehjeje që i bëri hebrejtë e përndjekur madje edhe disidentët e krishterë të iknin nga Krishterimi për të kërkuar strehë në Islam. Në krahasim me idealet moderne, madje edhe me praktikën moderne në demokracitë më të përparuara, bota mesjetare islamike ofronte liri të kufizuar, por kjo ishte shumë më tepër se sa ofronte çdo paraardhës i saj, shoqëritë e tjera të kohës apo shumica e atyre që do ta pasonin.

Shpesh bëhet pyetja: Nëse Islami është pengesë për lirinë, për shkencën dhe për zhvillimin ekonomik, atëherë si ka mundësi që shoqëria islame në të kaluarën ka qenë pioniere në të tria këto fusha dhe kjo kur myslimanët ishin shumë më afër në kohë nga burimet dhe frymëzimi i besimit të tyre se sa janë tani? Disa e kanë formuluar pyetjen ndryshe; jo “Çfarë u ka bërë Islami myslimanëve?”, por “Çfarë i kanë bërë myslimanët Islamit?” dhe janë përgjigjur duke ua hedhur fajin dijetarëve, doktrinave dhe grupeve konkrete.

Për ata që sot njihen si islamistë dhe fundamentalistë, dështimet dhe mangësitë e vendeve moderne islamike kanë ardhur për shkak se ato kanë përqaftuar nocione dhe praktika të huaja. Ato u shkëputën nga Islami i vërtetë dhe kështu e humbën madhështinë e dikurshme. Ata që njihen si modernistë apo reformatorë kanë pikëpamjen e kundërt dhe e shikojnë shkakun e kësaj humbjeje jo tek braktisja, por tek ruajtja e mënyrave të vjetra e sidomos tek qëndrimet e palakueshme të klerit islamik. Sipas tyre, kleri i gjithëpranishëm islamik është përgjegjës për vazhdimin me këmbëngulje të besimeve dhe praktikave që mund të ishin krijuar dhe përparimtare njëmijë vjet më parë, por nuk janë më të tilla. Taktika e zakonshme e modernistëve është të mos e dënojnë fenë, aq më tepër Islamin, por ta drejtojnë kritikën te fanatizmi. Sipas tyre, është fanatizmi dhe sidomos autoritetet fanatike fetare, që i kanë zënë frymën lëvizjes shkencore islamike, dikur madhështore, dhe përgjithësisht lirisë së mendimit e të fjalës.

Një mënyrë më e zakonshme e trajtimit të kësaj teme ka qenë ajo e diskutimit të një problemi konkret: vendi i fesë dhe i eksponentëve të saj në rendin politik. Në këtë pikëpamje, një shkak kryesor i përparimit të Perëndimit është ndarja e fesë nga shteti dhe krijimi i një shoqërie civile që funksionon me ligje shekullare (laïke). Një pikëpamje tjetër e gjen fajtorin kryesor te pozita e ulët që i jepet gruas në shoqërinë myslimane, gjë që e privon botën islame nga talentet dhe energjitë e gjysmës së popullatës dhe ia beson edukimin e gjysmës tjetër nënave analfabete dhe të nëpërkëmbura. Bëhet fjalë për formimin në vitet e para të rritjes,

që është me rëndësi vendimtare. Produktet e një edukimi të tillë, thuhet, kanë prirjen të bëhen ose arrogantë ose të nënshtruar, pra të papërshtatshëm për një shoqëri të lirë e të hapur. Pavarësisht se si mund të gjykohe pikëpamjet e shekullaristëve dhe të feministëve, sukcesi ose dështimi i tyre do të jetë një faktor kryesor që do të ndikojë mbi të ardhmen e Lindjes së Mesme.

Disa zgjidhje, që dikur mbështeteshin me pasion, sot janë harruar. Dy lëvizjet mbizotëruese në shekullin e 20 ishin socializmi dhe nacionalizmi. Që të dy janë diskredituar, i pari nga vetë dështimi i tij, i dyti nga sukcesi dhe më pas ekspozimi që iu bë si i paefektshëm. Liria, e interpretuar në kuptimin e pavarësisë kombëtare, u pa si hajmalia e madhe që do të sillte të gjitha përfitimet e tjera. Shumica dërmuese e myslimanëve sot jetojnë në shtete të pavarura, por kjo nuk ka sjellë zgjidhjen e problemeve të tyre. Nacional-socializmi, shartimi i të dyja ideologjive, vazhdon të bëjë ligjin në disa shtete që kanë ruajtur stilin nazifashist të qeverisjes diktatoriale dhe të indoktrinimit përmes një aparati të gjerë sigurimi dhe të sundimit të një partie të vetme. Këto qeveri kanë dështuar në çdo drejtim, me përjashtim të mbijetesës, dhe nuk kanë sjellë asnjë nga përfitimet e premtuara. Madje, infrastrukturat e tyre janë më të vjetruara se sa ato të shteteve të tjera myslimane, ndërsa forcat e tyre të armatosura kanë si qëllim kryesor terrorin dhe shtypjen.

Sot për sot, dy përgjigje për pyetjen “Çfarë nuk shkon?”, secila me diagnozën dhe recetën e saj, gëzojnë mbështetje të gjerë në Lindjen e Mesme. Njëra ia atribuon çdo të keqe braktisjes së trashëgimisë së shenjtë të Islamit dhe kërkon kthimin tek e kaluara, reale apo imagjinare. Kjo është rruga e revolucionit iranian dhe e të ashtuquajturave lëvizje apo regjime fundamentaliste në vende të ndryshme myslimane. Tjetra dënon të kaluarën dhe është për demokracinë shekullare, të mishëruar më së miri në Republikën Turke, që u shpall në vitin 1923 nga Qemal Ataturku.

Për qeveritë shtypëse dhe të paefektshme që sundojnë në një pjesë të madhe të Lindjes së Mesme, gjetja e arsyeve për të shkarkuar fajin i shërben një qëllimi të dobishëm, madje thelbësor, sepse kështu ato shpjegojnë varfërinë që nuk kanë mundur ta zbusin dot dhe përlligjin tiraninë që kanë vendosur. Ato përpiqen ta devijojnë zemërimin në rritje të qytetarëve të tyre drejt elementëve të tjerë, të jashtëm.

Por njerëzit në Lindjen e Mesme gjithnjë e më shumë po përqafojnë një qëndrim më autokritik. Pyetja “Kush na e bëri këtë?” ka çuar veçse në fantazira prej të marrësh dhe në teori komploti. Ndërsa pyetja “Çfarë bëmë gabim?” natyrshëm ka shtruar pyetjen tjetër: “Si mund ta përmirësojmë gjendjen?”. Pikërisht te kjo pyetje dhe te përgjigjet e ndryshme që do të gjenden, qëndrojnë edhe shpresat për të ardhmen.

Për një vëzhgues perëndimor, që është shkolluar në frymën e teorisë dhe praktikës së lirisë perëndimore, është pikërisht mungesa e lirisë – liria e mendjes nga detyrimi dhe indoktrinimi, liria për të shtruar pyetje dhe për t’u shprehur; liria e ekonomisë nga korrupsioni dhe keqdrejtimi; liria e gruas nga shtypja e burrit; liria e qytetarëve nga tirania – që përbëjnë bazën e shumë problemeve të botës

myslimane. Por rruga drejt demokracisë, siç e tregon qartë përvoja perëndimore, është e gjatë dhe e vështirë, është plot kurthe dhe pengesa.

Nëse popujt e Lindjes së Mesme vazhdojnë në rrugën e tanishme, kamikazët mund të bëhen një metaforë për krejt rajonin dhe nuk do të ketë shpëtim nga spirali i urrejtjes dhe inatit, i zemërimit dhe i vetëkeqardhjes, i varfërisë dhe i shtypjes. Herët a vonë kjo mund të kulmojë me një tjetër sundim të huaj, ndoshta nga një Europë e re që i kthehet zakoneve të vjetra, ndoshta nga një Rusi që kërkon shpagim, apo nga ndonjë superfuqi në Lindje që kërkon zgjerim. Por nëse ata lënë mënjanë grindjet dhe viktimizimin, zgjidhin mosmarrëveshjet dhe bashkojnë talentet, energjitë dhe burimet në një përpjekje krijuese me pjesëmarrjen e të gjithëve, ata mund ta bëjnë përsëri Lindjen e Mesme ashtu sikurse ishte në lashtësi dhe në Mesjetë, një qendër madhështore të qytetërimit. Sot për sot zgjidhja është në dorën e tyre.

(Bernard Lewis, është një historian britaniko-amerikan, specialist i studimeve orientale dhe njëherazi njihet edhe si një intelektual i dalluar dhe komentator i njohur politik në Amerikë dhe në Europë. Si Profesor Emeritus i Studimeve mbi Lindjen e Mesme pranë Universitetit Princeton në Shtetet e Bashkuara, Ai njihet si ekspert i historisë së Islamit si dhe specialist i marrëdhëneve midis Islamit dhe botës Perëndimore dhe gjithashtu shquhet veçanërisht në qarqet akademike për punën dhe veprat e tij mbi Perandorinë Otomane).

Bisedë me shkrimtari malazez, Jovan NIKOLAIDIS:

NE BALLKANASIT DIMË MIRË VETËM SI TË ZIHEMI

Ky burrë simpatik mund të njihet shumë mirë nëse njihet Kazanxaqis, shkrimtarin e tij të adhuruar. Në dejet e Nikolaidis ka gjak sllav, shqiptar dhe pak grek, por nga zakonet është thjesht një malazezo-shqiptar i gëzuar. Është i qetë, dhe befaz shpërthen, duke derdhur një lumë fjalësh. Intervista u zhvillua në serbisht, ku autori e ndjen veten më familjar, por shpesh vetë shkrimtari e ndërpreu me shprehje shqip, redaktorin. I qartë dhe i vendosur, ai rrëfeu shumë për konceptin e tij ballkanik...dhe identitetin. Ai ishte shkrimtari mik i Shtëpisë së Shkrimtarëve në Tiranë.

Ju shquheni për një shikim interesant të Ballkanit. A është ky gadishull burim i vërtetë ushqimi, që do t'ia kishte zili çdo shkrimtar?

“Absolutisht! Në këtë botë të ngopur me gjithëfarë lloj ofertash konsumizmi, e përmytur me oferta t’pafundme për çdo gjë, ushqime sintetike dhe pije, ku ekstrakti i një fryti reklamohet si një avantazh i dorës së parë, ndërsa ushqimi organik si të ishte sukcesi i zbulimit të Amerikës, apo kur në SHBA dhe në Evropë fara të modifikuara gjenetikisht janë tashmë standarde të mbrojtura me ligj në prodhimin e ushqimit, ku kemi një të vërtetë virtuale më shumë se atë syresh që është lakuriq, dhe ku informacioni është duke u bërë më i rëndësishëm se sa vetë lutjet te Perëndia për shëndetin, ne, në Ballkan, jemi gjithsesi rehat me veten, pasi në të gjithë këtë botë të tjetërsuar tregojmë atë që ata e kanë harruar: pra, jeta s’është vetëm dhuratë e Perëndisë, por edhe forma më e madhe e lirisë. Dhe, në këtë të vetmen liri, ne pajtohemi të jemi skllevër. Liritë tona janë të shfrenuara, të egra, anipse ato flasin për përparësitë e përgjithshme të Ballkanit mbi vdekjen e gëzimeve të vërteta të botës prej Perëndimit. Ne do zihemi me njëri-tjetrin, ngandonjëherë edhe duke ia vendosur thikën në fyt, ne bërtasim dhe mallkojmë, fshijmë hundën me mëngë, hamë me gishta (sepse mu atëherë ajo gjellë është më e shijshme!), ndodh që në zemërim e sipër vrasim dhe të afërmin, djegim sanën e fqinjit, por, sak në momentin tjetër, do qajmë sepse u treguam të ashpër ose do të përqafojmë vëllamët krejt në hidhërim pse atij i lëshuam at’ fjalën e keqe. Askush tjetër në botë nuk mund të urrehet aq shumë, e as fal aq shumë, sa ne ballkanasit. Ne jemi ekstremi i ekstremeve. Ky është hapi i parë i epërsisë së Ballkanit në lidhje me standardet strikte, rregullat dhe mënyrën sesi jeton Perëndimi. Njeriu do t’ishte zog në qoftë se do mund të fluturonte. Popujt e Ballkanit mendojnë se janë të aftë për të fluturuar. Ndaj ndodh që humbjet e tyre janë më të dhimbshme sesa disfatat e

njerëzve në zonat e tjera të këtij planeti t' trazuar. Ama, ëmbëlsinë e jetës që kemi ne, e kanë shumë pak të tjerë në botë.

E gjithë kjo, dhe ajo që ende më tepër e ruan Ballkanin, është një burim i pashtershëm, një burim mistik për çdo shkrimtar. Për shkrimtarin duket aspak reale dhe fantastike, por në të vërtetë dalin tema të mira dhe zgjedhje. Problemi është se gjuhët tona janë të vogla, që janë si brirë në një thes, e që nuk kemi një strategji të përbashkët në kulturën, që politikanët tanë mendojnë fare pak për ato që humbasin, ndërsa më shumë bluajnë në mëndje për ato që ende nuk kanë marrë, dhe kur i marrin, do të thotë që del një e Tretë gjë, nuk na pyesin nëse ishim të kënaqur me atë që na dhanë, apo atë që na imponohet. Arti dhe letërsia në përgjithësi në lidhje me këto ekstreme që do vijnë, duhet të kujdeset t'i parashikojë dhe të ketë një përgjigje të qartë. Letërsia e Ballkanit është një sfidë për një energji të re ndaj kulturës së lodhur të Evropës. Le ta shfrytëzojmë atë”.

Si e shikoni letërsinë që bëhet sot në Ballkan. A mund të jetë kjo letërsi një burim për letërsinë evropiane, siç ka qenë vite të shkuara?

“Për të qenë i qartë: askurrë bota nuk na ka parë ndryshe qoftë si burim por edhe si model. Sa i përket kulturës ballkanike, Bota e ka marrë thjesht si një Panteizmi ekzotik dhe mistik, folklorist dhe si zbukurim. Kemi qenë dhe mbetëm thjesht një geo-hapësirë e barabartë dhe njësoj me çdo lloj gjeografie tjetër koloniale. Ballkani është pjesa tjetër e botës (si për Perandorinë Osmane dhe Austro-Hungarinë) më së shumti një lloj hapësirë që thjesht duhet të shfrytëzohet apo abuzohet.

Nëse ju mendoni për trashëgiminë helene dhe pasuritë tona të këngëve epike panballkanike, kjo po, por Evropa, helenizmin tonë e ka ‘vjedhur’. Ne nuk kemi qenë në gjendje për ta formësuar atë për veten tonë, edhe pse ajo ishte pjesë e brendshme e qenies sonë. Po ashtu edhe pasuria e madhe e kulturës arabe dhe letërsisë, poezisë sufiste, misticizmit të dervishëve, format pagane të shprehjes dhe lirika e Koinesë malore iliro-duklljanskog , ne, po ashtu, nuk kemi ditur për t'i mbajtur për veten tonë.

Letërsia e Perëndimit ishte konstantja jonë në letërsi, shkrimtarë e Ballkanit e kanë marrë si model, e më shpesh si bazë për tema. A kemi qenë më së shumti epigonë dhe anakronikë?

Ne kemi nevojë dhe duhet të gjejmë një emërues të përbashkët. Që secila pjesë të ruajë integritetin e saj (në çdo fushë të jetës shoqërore), dhe që me strategji të qarta ta ndërtojmë performancën në botë si një të tërë. Tërësinë e Ballkanit. E integruar dhe e vetëdijshme për vlerat e saj individuale dhe kolektive që t'i jepemi botës si një thesar i përbashkët. Kjo është rruga e letërsisë së Ballkanit, kjo është një mundësi që ne mund dhe duhet ta vlerësojmë”.

Ka shumë urrejtje në Ballkan. Ndërkohë, në një nga pjesët tuaja një personazh i rrëfen botanistit të madh Baldaçi se vetëm të vdekurit janë “Soj i mirë”. A është e vërtetë që ballkanasit flasin mirë vetëm për të vdekurit?

“Eh, miku im Ben! Nëse do ta dije (dhe unë jam i sigurt se ti e di!) sesa shumë, kushdoqoftë qoftë: irlandez e urren anglezin; fshatari frëng punëtorin gjerman; baskët spanjollët; kalabrezët ata italianët, që janë nga rajoni i Komos; polakët rusët; racistët e bardhë të Misisipit të zinjët; teksanët meksikanin. Pra, ballkanasit tanë janë mjaltë dhe qumësht. Evropa dhe Amerika e rrisin kultin e vdekjes dhe jo ne Ballkani. Nëse s’do të ishte nacional- socializmi serb dhe klerofashizmi që solli lufta, në Ballkan dhe në hapësirat e tij s’do të mund të kishte as edhe një pikë të vetme nevralgjike. Kemi qenë gjithmonë e vetëm thjesht viktima të turbulencave historike të imponuar nga lart. Kur themi: “Ballkani është një fuçi baruti”, menjëherë dua të përgjigjem: “se cili rajoni i botës vallë nuk është ‘fuçi baruti’? Nuk ka moment që t’i të mos dëgjosh të shtëna dhe vrasje nga të gjitha anët e botës. Vrasja dhe lufta është një karakteristikë e përgjithshme e njeriut. Njerëzit e Ballkanit janë të përfshirë në të, si gjithë të tjerët në planet. Është e vërtetë se në Ballkan vdekjet përsëriten rregullisht, ky është një lajtmotiv i jetës tonë dhe historisë tonë, por mos harroni: për të shkaktuar vdekje, veçanërisht ato kolektive, ka qenë edhe puna e Evropës. E kjo madje prej shumë kohësh.

Kush e krijoi fashizmin dhe nazizmin? Krimet e serbëve në Srebrenicë janë të ‘mësuar’ nga vdekja në Auschwitz. Evropa i çoi Kryqtarët për të pushtuar varrin e Krishtit por gjatë rrugës ata bastisën çfarë mundën. Në Spanjë, bërtisnin “Viva la muerte! Stalinizmi, nga ana e tij, ka vrarë miliona njerëz. Dy luftërat botërore janë produkt i përçarjes evropiane rreth kapitalit. Kurse amerikanët sot vriten që nga Lindja e Mesme dhe deri te Lindja e Largët. Kë kemi sulmuar ne ballkanasit? Ne, përgjatë të kaluarës vetëm jemi mbrojtur nga e keqja e të Mëdhenjve. Dikur jemi mbrojtur madje edhe nga vetja jonë. Ne jemi të zotët vetëm të grindemi me fqinjët dhe të vrasin ata që i kemi të afërt. Ne nuk kemi bërë kurrë Luftëra të Mëdha”.

E ndërrojmë temën. Nga e merr më shumë impulsin për të shkruar?

“Ndikimet e mia letrare janë: në prozë prej Marguerite Yourcenar, Borislav Pekiç dhe Nikos Kazanzaqis, kurse në poezi nga e gjithë trashëgimia e poezisë sufiste. Marguerite Yourcenar-së më ka mësuar të jem i qartë në çdo fjali dhe të kujdesem për atë që unë them: se në letër duhet të jetë ‘e pastër’. Borislav Pekiç më ka zbuluar hapësirën e pafund të jetës dhe kulturës së Ballkanit, që nga bizantinët, turqit, serbët, grekët e rinj, ciganët dhe shqiptarët, në labirintet jugore sllave në shekullin e njëzetë. Pekiç është sigurisht shkrimtari më i madh i Ballkanit në Ballkan. Nikos Kazanzakisit i jam mirënjohës sepse më tregoi se çfarë është liria dhe pathosi për njeriun. Dua të udhëtoj ashtu si deshi në të gjallë Kazanzaqis dhe t’i respektoj popujt e Ballkanit ashtu si Nikos i vlerësoi. Ndërsa ndjeshmëri sufiste dhe fshehtësia në poezinë e tyre është e barabartë me të miam”.

Flitet për bashkëjetesë fetare, por përfaqësuesit e thjeshtë të komuniteteve fetare në vendin tonë, qëndrojnë shumë larg. A mendon se Ballkanin, në përgjithësi, e ka vështirësuar edhe më shumë kjo përbërje heterogjene fetare?

“Unë nuk mendoj kështu dhe shpresoj se kam të drejtë. Bashkëjetesa fetare, qoftë në Shqipëri por edhe në Malin e Zi, ndoshta nuk mund të jetë ideale, por ajo sigurisht që është një matricë e kënaqshme për tolerancë dhe unitet. Kur nuk e përzien me çështjen dogmatike, kur myslimani, ortodoksi, katoliku dhe protestanti, e lë vendasin të kryejë ‘pikëpamjet e shpirtit dhe botës’ së tij fetare, dhe kur asnjëri prej tyre nuk do ndërhyjë në punët e shtetit, atëherë na mjafton kjo tokë, ku ne të gjithë vuajmë dhe sflitim, pa marrë parasysh se çfarë feje dhe njerëzish jemi. Pasi, jeta e sotme shoqërore është realisht si ferr.

Janë të njohura shmangiet që feja i zbaton sot, e unë i di shfaqjet ekstreme. Unë e kam të qartë tashmë në këtë shekull ku po jetojmë, se ndryshe nga shekulli i njëzetë (kur Zoti ka “vdekur”) tani ai është ngjallur, madje më keq në mesin tonë, dhe feja është nganjëherë më e rëndësishme se jeta. Megjithatë, nuk duhet shumë përpjekje dhe as shumë durim për të arritur nivelin, ku do jetë e mundur që të gjallët të jenë krah njëri-tjetrit, të ketë ekuilibër multi-etnik dhe unitet në diversitet. Vetëm se të gjithë duhet të zbatojnë atë që shprehin librat e shenjta për vëllazërinë mes njerëzve, le të rilexojnë disa pasazhe prej atyre që bektashiu Naim Frashëri shkroi në “Letrat e një Bektashiu”, disa politikanëve në Ballkan u duhet ndaluar ta përdorin fenë (krimin) për të arritur politikën e tyre destruktive dhe disa prej priftërinjtë dhe hoxhallarëve të mos flasin për atë që s’është zeje e tyre -vetëm atëherë do të jetë një lule e shëndetshme dhe e ndryshme në kopshtin qiellor të Ballkanit”.

“Tespihet...” tuaja kanë pasur përcjellje të mirë në Shqipëri. A mund të thuhet se në dejet e Jovanit rrjedh gjak shqiptari apo i gjithë Ballkani është një familje e madhe?

“Ne jemi një familje e madhe, e fortë, e bukur dhe e zgjuar, ne jemi vëllazër në pikëllim dhe në gëzim, ne kemi një shans të mirë që në Evropën e Bashkuar të jemi një komunitet i shëndetshëm dhe i fortë. Ne kemi një territor të mrekullueshëm. E ardhmja jonë është e mirë. Vetëm se ndonjëherë ne ndalojmë para se të nxitojmë për të vendosur dorën para gojës kur duhet të bërtasim. Shpejtësia është e mirë kur konkurron, por jo e mirë kur do të martohesh. Në genin tim ekzistojnë pjesë të geneve shqiptare dhe unë gjithmonë ndjehem edhe më mirë me këtë dhuratë gjenetike në vetvete, e nuk ka rëndësi sesi e gjeta atë. Përpos në mesin e shqiptarëve, unë ndihem edhe i gëzuar”.

Ku e ndjen shprehjen më të mirë letrare Jovani, tek poezia apo proza?

“Në prozë jam poet, në poezi realist, në esetë jam filozof. Megjithatë më e mira është të mbash një narrativë të pastër. Me këtë mësoj të ardhmen”.

A flasim diçka më ndryshe. Letërsia juaj pretendon të shkojë shumë drejt një këndvështrimi filozofik të jetës. A është kjo qëllim në vetvete?

“E lemë. U përgjigja njëherë Ben...”.

Tek libri juaj për identitetet shtrohen pyetje të ndryshme për njeriun e Ballkanit. Cili është identiteti i përbashkët i një ballkanasi?

“Nuk është e lehtë për t’iu përgjigjur pyetjes tuaj, përderisa marrëdhënia ime me identitetin është krejtësisht indiferente edhe pse kam shkruar shumë për këtë fenomen. Identiteti nuk është konstant, ai ndryshon. Në të, ka ndikim historia, kultura, feja, ideologjia. Në këtë lloj mënyre edhe identiteti përshtatet. Nëse garantohen të drejtat e njeriut dhe zhvillohen mirë liritë civile, historia e identitetit është e panevojshme. Çdo qenie në vetvete e di se cila është, çfarë është, i kujt është dhe nga cila është. Përndryshe, ne jemi duke hyrë në fushën e spekulimeve dhe identiteti bëhet një karikaturë sociale. Pesëdhjetë vjet më parë identiteti ynë ka qenë i përcaktuar nga ideologjia dhe ne të gjithë, pak a shumë, ishim proletarë, komunistë kontrakomunistë, internacionalistë, kozmopolitë, edhe pse gjithashtu ishim shqiptarë, malazezë, grekë, serbë, turq, kroatë. Kjo e fundit për ne ishte më pak e rëndësishme se e para. Ne ishim Gnostikë, Agnostikë apo dhe ateistë. Edhe më përpara identiteti ynë ishte i lidhur me përkatësinë fetare. Si pjesë e njeriut apo një populli tjetër, më parë se përkatësia etnike, ne pranonim faktin se jemi myslimanë, ortodoksë apo katolikë. Banorët e Tiranës, të themi, sot janë shqiptarë, por papritmas dhe Ballkanas, dhe do të jenë dhe evropianë. Nëse arsyetojmë më tej, është pakufi ajo hapësirë në të cilën mund të përcaktohet identiteti i njeriut.

Problemet fillojnë atëherë kur identiteti rreshtohet me ekstremizmin, me nacionalizmin dhe shovinizmin ndër ne, e njerëzit i japim përparësi në lidhje mbi gjërat e tjera dhe ... kjo nuk ka më fund. Dhe gjëja më e keqe që mund t’i ndodhë identitetit është fakti i trishtuar, i cili u vërtetua në luftën e fundit në ish-Jugosllavi: se identiteti bëhet shkak dhe pasojë e gjakderdhjes, shkatërrimit dhe persekutimit. Atëkohë i tërë populli u kërcënua, më së pari nga ata që kishin identitet të ndryshëm. Dhe mu atëherë, identiteti ynë qëndron vetëm me tufën e vet, pasi për veten e vet, ai mund të mos rritet. Identiteti ynë atëherë vrau Njeriun. Çfarë na duhet identiteti ynë, nëse jemi – kriminelë? Unë jam me fat që në ADN-në time ekzistojnë katër identitete, por mua s’më intereson askush në veçanti, pasi individualizmi është identiteti im i vetëm. E rëndësishme për mua është ajo që jam UNË – nuk më intereson fare – NE. Por as edhe nuk kam nevojë për çoban, sepse Bariu s’është i nevojshëm për askënd. Këtë Dikushi e di dhe kush është dhe ku do shkojë. Bariun e thërrasim kur duhet të mbajë tufën. Këtu po e mbyll: Nuk e di nëse isha në gjendje t’iu përgjigjesha cili është dhe çfarë është – identiteti ballkanik?!”

Është e vështirë të jesh shkrimtar bilingue? Si i vinë, më së pari, mendimet shkrimtarit Jovan?

“Unë mendoj në të gjitha gjuhët, të cilat pretendoj se njoh dhe të gjitha mendimet e mia janë njësoj të rëndësishme. Unë shkruaj, megjithatë, në një gjuhë që është kombinim i gjuhëve sllave të Jugut, të cilat njihen tani si malazeze, kroate, boshnjakisht dhe serbisht. Kjo është gjuha serbo-kroate, me të cilën jam kultivuar si shkrimtar.

Kurse në gjuhën shqipe arrij e u shkruaj letra miqve. Ata kurrë s’më fajësojnë nëse përdor fjalët e gabuara ose shkruaj ngandonjëherë në ndonjë fjali një apo dy fjalë – sllave. Por unë besoj dhe shpresoj, që një ditë të shkruaj me një gjuhë të pastër shqiptar. Edhe pse jam boll i vjetër – jeta është para çdo gjëje ajo që dua dhe respektoj”.

Intervistoi: Ben ANDONI

MOS U BESONI ATYRE QË THONË SE KUJDESEN PËR IDENTITETIN TUAJ!

Prof. Raymond Detrez: "Para shekullit XIX, jeta e popujve të Ballkanit, e zhytur në religjion. Qesharake të kërkohet në të "kombëtarja"

Prof. Raymond Detrez, balkanolog dhe historian, në intervistën për DW, flet për krijimin e shteteve kombëtare dhe zhvillimin e identitetit në Ballkan

DW: Profesor Detrez, në Bullgari u publikua libri Juaj që i dedikohet identiteteve kolektive parakombëtare në Ballkan, nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit të XIX . Cila është teza juaj kryesore?

Detrez: Teza ime kryesore në libër është se para shekullit të XVIII njerëzit në Ballkan e kanë konsideruar veten para së gjithash si të krishterë ortodoksë, ndërsa kombësia e tyre ka qenë një çështje dytësore. Kjo spjegon se përse në këtë kohë nuk përmendet kombësia e "Të përvuajturve të rinj" (viktimave të pushtimit otoman), pse ortodoksët bullgarë janë martuar me ortodoksët grekë, vllehtë, me shqiptarë, madje edhe me arabë, por jo edhe me bullgarët katolikë dhe pomakët. Pse bullgarët në viset urbane janë turqizuar aq lehtë, përderisa ndryshimi identitetit etnik nuk e ka prekur identitetin fetar? Pse shqiptarët, bullgarët, vllehtë dhe popujt e tjerë ortodoksë në Perandorinë Osmane, gjatë kohës e kanë përdorur greqishten si "gjuhë të tyre letrare". Përse kanë marrë pjesë në kryengritjen greke të vitit 1821, e cila ka filluar si kryengritje e të krishterëve ortodoksë kundër pushtetit osman? Këto janë fakte historike. Jeta kulturore e popujve të Ballkanit para shekullit të XIX, është thellë e zhytur në religjion dhe të kërkohet në të "kombëtarja" është e pafrytshme dhe qesharake. Unë nuk them se njerëzit në Ballkan nuk kanë ditur për kombësinë e tyre. Por them se për ta, përkatësia etnike nuk ka pasur ndonjë rëndësi të veçantë. Megjithatë, kjo situatë ka ndryshuar gjatë shekullit XIX. Të krishterët ortodoksë, nga prejardhje të ndryshme etnike, të cilët me shekuj kanë jetuar së bashku pa asnjë problem, që kanë pasur shkëmbim tregtar mes tyre dhe kanë formuar familje të përbashkëta, nën ndikimin e "Zgjimit kombëtar", të mbetur pa shpresë u detyruan të përzgjedhin një kombësi-kategori kjo me të cilën deri në atë kohë nuk ishin marrë dhe kjo kategori tani do t'i dallonte nga të tjerët. Një humorist holandez thotë se ka sëmundje nga të cilat njeriu nuk mund të preket nëse nuk i njeh. Kështu është edhe me identitetin kombëtar. Jeton në qetësi derisa nuk të pyesin se cili është identiteti yt dhe derisa nuk të bindin se identiteti yt është ky apo ai dhe se identitetin duhesh ta ruash. Me fjalë të tjera: mos u besoni atyre që ju thonë se kujdesen për identitetin tënd kombëtar.

Cilat janë temat që bëjnë lidhjen e shtetit bullgar të formuar në vitin 1878 me dy shtetet mesjetare bullgare?

Këto lidhje janë shumë të dobëta. Para shekullit të XIX në të gjithë Evropën aplikohen ideologji të ndryshme kombëtare. Disa prej tyre kanë sukses dhe mundësojnë krijimin e bashkësive kombëtare dhe shteteve kombëtare, ndërsa ideologjitë e tjera u treguan si jo frytdhënëse. Komponente e rëndësishme e këtyre ideologjive kombëtare është rrëfimi për shtetin e mesjetës, i cili duhet të rilindë. Por jo të gjitha kombet disponojnë një shtet të tillë. Dhe nëse nuk ke histori të bujshme mesjetare ti je i privuar nga një instrument i rëndësishëm propagandues, por në fund të fundit kjo nuk është aq fatale. Shqiptarët, maqedonasit, letonezët, estonezët, sllovakët, bjellorusët, ukrainasit etj. në të kaluarën nuk kanë pasur shtetin e tyre për t'u marrë me një punë të tillë. Ose në qoftë se ata e kishin, ato shtete mesjetare janë kontestuar nga të tjerët. Megjithatë shumica e tyre tashmë me dekada jetojnë si bashkësi kombëtare.

Në dekadat e fundit të shekullit XIX Rusia dhe Fuqitë e Mëdha po bëjnë përpjekje për të instaluar influencën e tyre në Ballkan. A mendoni se edhe për momentin ekziston një interes i ngjashëm?

Ky proces nuk është ndalur që kurse Fuqitë e Mëdha filluan të merren me Ballkanin. Në kohën e Luftës së Ftohtë, Ballkani ishte i ndarë në sferat e influencës midis Lindjes dhe Perëndimit. Pas luftës së ftohtë, NATO e plotësoi vakuumin që doli pas rënies së bllokut lindor, respektivisht pas shkatërrimit të Paktit të Varshavës. Mund të kuptohet se pse vendet e Baltikut, Çekia, Polonia dhe vendet e tjera nga Evropa Qendrore kërkojnë mbrojtje nga NATO, pasi gjysmë shekulli ato ishin të okupuara nga Bashkimi Sovjetik. Gjithashtu e kuptohet se pse Rusia ndjehet e rrezikuar për shkak të zgjerimit të NATO-s në Lindje. Edhe pse gjatë gjithë historisë së tyre pa ndërprerje kanë bërë luftëra agresive, rusët gjithmonë e kanë konsideruar veten si viktima të agresionit të jashtëm. Arsyeja kryesore e konfliktit në Ukrainë është baza detare e Krimesë, të cilën rusët nuk dëshirojnë ta humbin, aq më tepër nuk dëshirojnë që ajo të bjerë në duart e NATO-s.

Prof. Raymond Detrez (67vjeç) është Balkanolog, drejtor i Qendrës për kërkime Juglindore në Universitetin Gent, Belgjikë.

"DW"

*AGIM RUSHITI***ABETARES (SË PËR)BASHKË(T)
TË GJITHË T'I GËZOHEMI**

Viti 2012, për shqiptarët, kudo që gjallojnë ata, ishte një vit shumë domethënës. Ishte vit që shënonte bashkimin e së kaluarës së lavdishme me të tanishmen krenare kombëtare. Pa mëdyshje, të gjitha këto kthesa historike pozitive që po i përjeton kombi shqiptar, kulminuan me shënimin e 100- vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar.

Margaritar i kurorës së shekullit të pavarësisë së Shqipërisë, akt i një rëndësie po aq të rëndësishme, për të mos thënë edhe historike, në periudhën më të re, ishte edhe promovimi i Abetares së përbashkët Shqipëri-Kosovë, në Prizren, nën Kështjellë pranë Shtëpisë së Lidhjes Shqiptare.

Historia e Abetares shqipe është e lidhur ngushtë me rritën e shqiptarëve, e ndërlidhur me udhën e shkronjave, e cila përbrenda ruan sakrificat, vuajtjet dhe viktimizimin e shqiptarëve ndër shekuj.

Deri më tani, bota shqiptare krenohet me botimin e mbi 150 abetareve në pjesën më të madhe të trojeve shqiptare. Ajo nisi para 169 vjetësh me botimin e Abetares së parë (me titullin origjinal “*Fort i shkurtër e i përdorçim ËVETAR SHQIP*”) të Naum Panajot Haxhi Llazar Bredhi, që në letërsinë shqiptare është i njohur si Naum Veqilharxhit, nga Vithkuqi i Kolonjës, shtypur më vitin 1844. Titulli i kësaj abetareje, në kopertinë, ishte i shkruar në greqisht (“Procheiron alvanikon alfavitacion”), që në brendi të vazhdojë të frymojë shqip, me një alfabet origjinal të krijuar nga vetë autori.

Nga bibliografia e Abetareve të para të gjuhës shqipe mund të vërejmë se, deri me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, ato u botuan kryesisht me alfabetin grek e arab dhe dritën e tyre e gjetën, krahas vendeve në Shqipëri (Elbasan, Shkodër, Korçë, Tiranë), edhe në qytetet jashtë mëmëdheut Shqipëri (Stamboll-Konstatinopojë, Bukuresht, Sofje, Selanik, Milano), por edhe në qytetin e Manastirit. Në qytetin e Manastirit, pas mbajtjes së Kongresit të alfabetit shqip, në Shtypshkronjën “Bashkimi i Kombit”, më vitin 1909 do të botohet Abetarja e Parashqevi Qiriazit, kurse më vitin 1911, në Shtypshkronjën “Tregtare Nërcombëtare” do të botohen Abetarja e Dhimitër Papparisto, Abetarja e Parashqevi Qiriazit dhe Abetarja e Simon Shuteriqit.

Gjatë Periudhës së Pavarësisë së Shqipërisë, Abetaret shqipe gjetën botimin e tyre në qytetet brenda Shqipërisë së Pavarur (Korçë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Tiranë, Konstancë), por edhe jashtë tij (Paris, Milano, Vjenë, Laibzig, Firenze).

Gjatë periudhës së sistemit totalitar në Shqipëri, Abetaret shqipe filluan të botohen në alfabetin gegë e atë toskë, për shkak të mungesës së një gjuhe të njëzuar shqipe, dhe që të gjitha dritën e panë në shtypshkronjat e Tiranës.

Gjatë sistemit pluralist në Shqipëri, Abetaret shqipe botoheshin kryesisht në Tiranë. Përjashtim bën Abetarja mbarëkombëtare nga Rita Petro etj., botuar më vitin 2009 nga Shtëpia botuese Albas në Tetovë. Ky libër, edhe pse ishte i një kualiteti mjaft dëshirues dhe ishte me logo të botimit Tiranë-Prishtinë-Tetovë, asnjëherë nuk e fitoi statusin për të cilin mëtonte- Abetare e përbashkët gjithëkombëtare. Arsyeja ishte se nuk ndoqi procedurat e rregullta institucionale për përdorim në institucionet edukativo-arsimore në shtetin e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.

Vlen të theksohet me këtë rast edhe kontributi i parë për botimin e Abetares së posaçme për nxënësit shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë nga autori Urti Osmani, botuar më vitin 2011 në Tiranë.

Në Kosovë, abetarja e parë është botuar në vitin 1946, në Prizren, nga ana e Drejtorisë arsimore e Këshillit Popullor Krahinor për Kosovë e Metohi. Nga kryeqytetet e ish- republikave jugosllave të banuara edhe me shqiptarë, Abetarja parë për klasën e parë të shkollave fillore u botua në Beograd, më vitin 1947, nga autorët Mehmet Gjevori, Stathi Kostari dhe Jani Gjino. Në Shkup, më vitin 1970, nga autori Xhevat Tahir-Gega, në botim të “Prosvetno Delo” u botua Abetarja e parë shqipe për nxënësit shqiptarë të shkollave shqipe në Republikën e Maqedonisë. Në botim të Entit Republikan për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit, më 1984, u botua në Titograd Abetarja e parë shqipe në Mal të Zi.

Në periudhën e pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Abetarja e parë shqipe u botua në vitin 2000 në Prishtinë, nga autori Qamil Batalli.

Përfundimisht më vitin 2012, në Shtypshkronjën Dukagjini në Kosovë, u botua Abetarja për klasën e parë të arsimit fillor, Abetare e parë e përbashkët Kosovë-Shqipëri, nga autorët Mimoza Çano-Gjokutaj, Islam Krasniqi, Shezai Rrokaj dhe Saranda Kumnova Pozhegu. (pa autor nga Maqedonia?)

Promovimi solemn i saj u bë më 17 Majit të 2012-shit, në Qendrën e sporteve “Sezai Surroi”, në qytetin e kulturës, heroizmit, patriotizmit, të bashkimit, të krenarisë kombëtare-Prizrenin, si Abetare më e re e përbashkët për nxënësit e shkollave shqipe të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Në këtë qytet, tanimë edhe universitar, ku si në asnjë vend tjetër e kaluara ka më shumë kuptimësi të afrohet me të sotmen, atë ditë të bukur maji frymonte shqiptaria, krenarie, fitorja. Atë mjedis dhe atmosferë edhe më shumë e bënë të jetë joshëse dhe kuptimplote edhe prezenca e presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçit, kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, Ramë Buja, ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, Myqerem Tafaj.

Në fjalimin e vet emocional, me rastin e promovimit të Abetares, kryeministri kosovar, Hashim Thaçi, do të deklarojë: “Kjo është fitore për të gjithë shqiptarët,..., fitore e kombit shqiptar”.

Kjo bukuri e rrallë e shqiptarëve, nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë, zoti Sali Berisha u cilësua si “Abetare e parë e të gjithë shqiptarëve” duke shpërndarë dëshirën dhe porosinë që së bashku kudo që janë shqiptarët të “festohet Abetarja e përbashkët”.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i Republikës së Kosovës, Ramë Buja, theksoi se “ky libër është bërë për të gjithë gjeografinë shqiptare”.

Si e ndiem ne shqiptarët e Maqedonisë daljen në dritë të një Abetareje të tillë? E ndiem si Rilindje të identitetit, e përjetuam si kthesë historike, si përpjekje për të frymuar si NJË shpirt. E njohur na është se shqiptarët e Maqedonisë gjithmonë u jemi gëzuar arritjeve të shqiptarëve nga ato hapësira, me një dozë më shumë se sa u jemi gëzuar sukseseve tona brenda në Maqedoni.

Shqipëria dhe Kosova na janë dukur dhe ende ashtu e ndjejmë si truri dhe zemra i një trupi që quhet shqiptari.

Dorën në zemër, shqiptarët e Maqedonisë (së paku unë ashtu u ndjeva), nga e gjithë ky hapërim i shenjtërisë në rrugën e shkronjave, u ndiem paksa të lënë anash, për të mos thënë të zhgënjyer. Kjo filloi që nga iniciativa e marrë për hartimin e Abetares së përbashkët, e deri te promovimi dhe aplikimi i saj.

Çka i mungoi, respektivisht çka duhet të bëhet që vërtet kjo Abetare të jetë gjithëkombëtare dhe për tërë gjeografinë shqiptare?

Së pari, pa e mohuar suksesin dhe përpjekjet shumë fisnike të ideatorëve të saj, Abetarja për klasën e parë të arsimit fillor, Abetare e parë e përbashkët Kosovë-Shqipëri, nga autorët Mimoza Çano-Gjokutaj, Islam Krasniqi, Shezai Rrokaj dhe Saranda Kumnova Pozhegu, nuk është abetare e përbashkët për të gjithë shqiptarët (siç e promovoi Sali Barisha), ngase ajo nuk gjen përdorim në trojet e banuara me shqiptarë jashtë Shqipërisë dhe Kosovës. Madje, ky libër nuk mund të thuhet se është bërë për gjithë gjeografinë shqiptare (siç zëshëm e theksoi ministri Ramë Buja), ngase për të qenë i tillë duhet të pasqyrojë edhe veçantitë e gjeografisë shqiptare, e që (është më me rëndësi) të marrë edhe bekimin profesional dhe institucional edhe nga shtetet ku shtrihet ajo gjeografi shqiptare.

Nga ana tjetër, sado që duket formale, është bërë edhe një lëshim. Në ekipin autorial të Abetares së përbashkët Kosovë-Shqipëri, përkundër deklaratimit se kjo ishte e rastësishme, e përbëjnë dy autorë nga Republika e Shqipërisë dhe dy nga Republika e Kosovës. Kjo pikërisht korrespondon me realitetin Abetare e përbashkët Kosovë-Shqipëri, por assesi nuk përket me synimin Abetare e përbashkët unike gjithëkombëtare. Nëse për asgjë tjetër, së paku për simbolikë, do ishte dashur të mendohej që në këtë ekip autorial të ketë përfaqësues (autorë) edhe nga Republika e Maqedonisë, trojet e banuara me shqiptarë përreth Kosovës e Shqipërisë, dhe madje edhe nga diaspora shqiptare. A nuk ishte e tillë edhe nisma e organizimit të Kongresit të alfabetit në Manastir, më vitin 1908, kur në grupet punuese merrnin pjesë intelektualë shqiptarë nga gjeografia e gjerë shqiptare dhe përkatësitë e ndryshme fetare.

Madje, një simbolikë e tillë shumë domethënëse mungoi dhe nuk u planifikua së paku as në fazën e konstituimit të Komisionit për miratimin e Abetares së përbashkët. Komisioni i miratimit të Abetares së përbashkët Shqipëri-Kosovë ka qenë i përbërë nga përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë (Hali

Shamata, Jovan Kristaqi, Pranvera Kamani, Besnik Rama) dhe nga përfaqësues të Republikës së Kosovës (Nehat Mustafa, Drita Kadriu, Ramush Leka dhe Selim Mehmeti). Çka do të kushtonte ose do të pengonte që në një komision të tillë të mos merrnin pjesë edhe ekspertët shqiptarë nga Maqedonia e më gjerë?

Lëshimi tjetër (do të dëshiroja të jetë i rastësishëm) që pasoi në këtë rrugëtim të daljes në dritë të Abetares së përbashkët Shqipëri-Kosovë ishte momenti i promovimit solemn të këtij libri në qytetin historik të Prizrenit. Dakord jam me simbolikën, por një simbolikë e tillë ndoshta edhe më kuptimplotë do ishte po kjo përzgjedhje të ishte bërë (edhe) në qytetin e Manastirit në Republikën e Maqedonisë, çerdhes së alfabetit shqip të njësuar, apo edhe ndoshta edhe Tirana, foleja e gjuhës së njësuar shqipe. Apo edhe në të tria së bashku. Çka u mungoi në këtë drejtim manifestimeve të 100- vjetorit të Shtetit të Shqipërisë që u zhvillua në Shkup (Maqedoni), Prishtinë (Kosovë) e në Tiranë-Vlorë (Shqipëri-shqiptari).

Fakt tjetër që bie në sy, e që nuk shkon në favor të tezës se u promovua një abetare gjithëkombëtare ishte edhe përbërja e trupit të zyrtarëve politikë e shtetërorë në ceremoninë e promovimit të këtij libri. Krahu për krahu, njëri afër tjetrit, qëndronin presidentja e Republikës së Kosovës - Atifete Jahjaga, kryeministri i Republikës së Kosovës - Hashim Thaçi, kryeministri i Republikës së Shqipërisë - Sali Berisha, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës - Ramë Buja, ministri i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Shqipërisë - Myqerem Tafaj. A thua nuk pati vend për së paku z/ministrin shqiptar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, zotin Safet Neziri. Por, nuk mund ta shoh arsyen edhe në mungesën e politikanëve shqiptarë (Ali Ahmeti, Menduh Thaçi, Rufi Osmani, Kastriot Haxhirexha, Isni Shaqiri,...). Madje, assesi nuk mund ta kuptoj se si në këtë manifestim nuk morën pjesë edhe njerëzit e parë të Universiteteve shqiptare në Republikën e Maqedonisë (rektorët e USHT, UEJL, e pse jo edhe atij privat të Strugës).

“E bëme këtë libër të nismës, Shqipëri-Kosovë, jo vetëm për vete, por për tërë gjeografinë shqiptare, sepse gjithandej trojeve tona, pavarësisht ndarjeve, na karakterizon një gjuhë, një kulturë, një etnos, një histori, një traditë” - do theksojë në evenimentin e përrurimit të Abetares shqipe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i Republikës së Kosovës, Ramë Buja.

Por, si duket Ramë Buja ka harruar se ai është vetëm ministër i një shteti, e jo edhe i shteteve të tjera ku gjallojnë shqiptarët. Nuk mora përgjigje se si kjo Abetare, kjo begati kombëtare, do të futet në sistemin arsimor, bie fjala, në vendin tim-Maqedoninë? Ndoshta e ka pasur fjalën në suaza të integritimeve rajonale e kontinentale (duke harruar se këto shkojnë duke kaluar mbi rrugët e integritimeve kombëtare).

Nëse e ka menduar se e gjithë kjo do të marrë një fund të mbarë vetëm me përpjekjet e përmbyllura në llojin e deklaratave të tipit (që ministri kosovar Ramë Buja do t'i japë në një intervistë) “Do të bëjmë një kërkesë të përbashkët, unë dhe ministri Myqerem Tafaj, për Ministrinë e Arsimit të Maqedonisë që t’iu mundësohet përdorimi i kësaj abetareje edhe shqiptarëve të Maqedonisë dhe besoj kjo nuk do të jetë pengesë. Pra, besoj se së shpejti edhe gjithë gjeografia shqiptare

do të pajiset me këtë libër të përbashkët, të cilin që moti kemi pasur dëshirë ta kemi”, atëherë kjo mbetet zhgënjim i pritur.

“Nga Prizreni, dua t’u themi fqinjëve tanë, çlirohuni nga shqiptarofobia, ajo është një mbeturinë e primitivizmit të trashëguar tuajin. Shqiptarët janë një komb që dinë të ruajnë dhe të mbajnë miqësi, por gaboheni rëndë në qoftë se vazhdoni të shfaqni shqiptarofobinë tuaj me skena si ato të Preshevës, të cilat faktojnë se jeni akoma shumë prej jush në stadet primitive”, – do t’u drejtohet fqinjëve, me një mesazh nga Prizreni, kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha.

Por, ja që edhe më tej fqinjët e Shqipërisë dhe Kosovës ende janë (dhe mbeten) të paçliruar nga shqiptarofobia dhe, shumë nga ata, janë akoma në stadet primitive. Ja që edhe më tej një kërkesë e përbashkët nuk iu drejtua Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë.

Dhe, çka? Duhet të qëndrojmë duarkryq? Assesi jo. Assesi të heshtur dhe nën hijen e mëshirës nga të tjerët.

Pa mëdyshje dhe pa rënduar askënd këtu në Maqedoni, elita politike dhe ajo intelektuale në Maqedoni, lidhur me çështjen e aplikimit të Abetares së përbashkët Shqipëri-Kosovë edhe (së paku) në Maqedoni, ishte jo mjaft e organizuar. Qytetari i rëndomtë do të mendonte se kjo zgjidhje do të duhej të dilte dhe të realizohet nga njerëzit e parë shqiptarë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit të Republikës së Maqedonisë. Duke qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i gjithë këtij aktiviteti, nuk do e lavdëroj, por do them se në këtë vijë nuk ka munguar përpjekja, por rezultatet kanë munguar. si mund të jetë (bëhet) abetarja e përbashkët shqipëri-kosovë, abetare gjithkombëtare?

Është për t’u përshëndetur deklarata e zëvendëskryeministrit Musa Xhaferi, se Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë do të bëhet realitet edhe në Maqedoni. Por, a mjafton kjo? Ku është elita intelektuale dhe sidomos ajo administrative shqiptare që për çdo ditë e më tepër po i mbulon institucionet shtetërore. A mos po pritet që pala maqedonase do të japë propozimin e drejtë në këtë rrugë? Unë nuk pres një gjë të tillë.

Jetësimi i një iniciative të tillë, përpos dëshirës dhe vullnetit, kërkon edhe përshtatshmëria e saj konform dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore.

Duke analizuar dispozitat ligjore, aktet nënligjore dhe dokumentet e tjera që rregullojnë çështjen e miratimit të plan-programeve mësimore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, shumë lehtë mund të vihet në dukje fakti se ata nuk paraqesin ndonjëfarë pengese serioze që libri fillestar i arsimit të marrë epitetin Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë-Maqedoni.

Në Republikën e Maqedonisë, në bazë të Ligjit për arsim fillor, puna edukativo-arsimore në shkollat fillore organizohet sipas planit dhe programeve mësimore për shkollat fillore, të cilat i përgatit Byroja për Zhvillimin e Arsimit, dhe i miraton ministri i arsimit dhe shkencës. Plani dhe programet mësimore hartohen mbi bazë të Konceptcionit për edukim dhe arsimim fillor të cilin e sjell ministri për arsim dhe shkencë. Me programet mësimore përcaktohen qëllimet arsimore, përmbajtjet, kuptimet themelore, aktivitetet dhe metodat e mësimi,

vlerësimi i të arriturave të nxënësve, kushtet për realizimin e programit mësimor dhe normativi i kuadrit mësimor.

Gjithë këtë e theksoj për faktin që, mbi bazë të kësaj analize, të vë në dukje se nuk ekziston pengesë edhe ligjore që një abetare e tillë të shtrihet edhe në shkollat shqipe në Maqedoni.

Një ndër pengesat kryesore (o zot) që e theksojnë “laikët” zyrtarë në Maqedoni është ajo se Abetarja e tillë nuk mund të gjejë përdorim në këto hapësira nga fakti se Abetarja gjen përdorim në sistemin arsimor fillor tek ne që nga klasa e dytë, ngase klasa e I-rë konsiderohet si vit përgatitor (duke harruar faktin se edhe viti përgatitor në arsimin fillor është inkorporuar në planin mësimor për shkollat fillore dhe është pjesë e strukturës që njihet periudha e parë edukativo-arsimore, e që përfshin klasën e I-rë, II-të dhe III-të). Ky fakt është “i vërtetë”, por aspak nuk korrespondon edhe me kërkesat ligjore.

Në dokumentin “Konceptioni për edukimin dhe arsimimin fillor nëntëvjeçar” të përgatitur nga Byroja për zhvillimin e arsimit, e të miratuar nga ana e Ministrit për arsim dhe shkencë të Republikës së Maqedonisë (shkurt, 2007) thuhet: “Me programet mësimore, nga fillimi i arsimimit në periudhën e parë në arsimit fillor (nga klasa e I e deri në klasën e III), ka nevojë të mundësohet gradualisht dhe rrënjësisht të planifikohen qëllimet, përmbajtjet dhe aktivitetet, që të arrihet përputhshmëri më e madhe të mësimit dhe nxënies me dallimet individuale të nxënësve. E domosdoshme është që qëllimet të shpërndahen në tërë periudhën prej klasës së I e deri në klasën e III, që të mund nxënësit ato t’i arrijnë, me shpejtësi të ndryshueshme në të mësuar, deri në fund të klasës së III-të”. Nga ky dokument mund të nxjerrim konkluzion se qëllimet që i shtron Abetarja nuk është e thënë të jenë domosdoshmëri të realizohen vetëm në klasën e parë apo të dytë, por ato duhet të jenë të shpërndara për realizim gjatë gjithë ciklit të parë të arsimit fillor (prej klasës së I-rë e deri në klasën e III-të). Pra bie teza se Abetarja në Maqedoni përdoret që nga klasa e II-të.

Sipas Konceptonit...në klasën e I-rë, zhvillimi i të menduarit paraoperativ tek fëmijët kalon në drejtim të shkallës së operacioneve konkrete. Por, këto ndryshime, megjithatë, nuk ndodhin te të gjithë fëmijët njëkohësisht dhe as njësoj, por vazhdojnë edhe në klasën e II-të dhe III-të (Pra, nuk është pengesë që Abetarja të përdoret edhe në klasën e I-rë). Edhe programi mësimor nuk obligon që nxënësit njëkohësisht t’i arrijnë dituritë e pritura për lexim dhe lexim deri në fund të klasës së I-rë, por ato të planifikohen, mbi bazë të dallimeve individuale, nxënësit t’i arrijnë tërësisht deri në fund të klasës së III-të.

Në planin mësimor për shkollat fillore prej klasës I-IX, si lëndë e obligueshme për klasën I-IX figuron Gjuha shqipe (si gjuhë amtare). Në Programin mësimor për Gjuhën shqipe për klasën e I-rë të përgatitur nga Byroja për zhvillimin e arsimit, kurse e miratuar nga Ministri i arsimit dhe shkencës së RM (2007), në pjesën Mjetet mësimore, thuhet “Për realizimin e mësimdhënies së lëndës Gjuhë shqipe në klasën e parë nuk këshillohet shfrytëzimi i abetares, por parapëlqehet përdorimi i doracakut për leximin dhe shkrimin fillestar..., doracakëve..., lojërave didaktike...”. Por, kjo nuk ndalon (as që një e drejtë e tillë është në duart e hartuesve të programit mësimor) përdorimin e Abetares që nga

klasa e I-rë, por vetëm sugjeron. E gjithë kjo varet nga aftësitë e mësimnxënies së fëmijëve të moshës 6-vjeçare.

Gjithashtu, në Programin mësimor për lëndën Gjuhë shqipe për klasën e II-të, në pjesën Mjetet mësimore, thuhet “Për realizimin e mësimdhënies së lëndës Gjuhë shqipe në klasën e dytë, përveç abetares, këshillohet përdorimi i doracakut për leximin dhe shkrimin fillestar..., i doracakëve..., lojërave didaktike...”. Pra, sugjerimet janë edhe të asaj natyre që nuk eliminojnë edhe mjetet mësimore që sugjerohen të përdoren edhe në klasën I (e gjithë kjo na fakti klasat I-III konsiderohen si një tërësi në aspektin e arritjes së qëllimeve).

Po të shikohet programi mësimor për Gjuhën amtare (shqipe) e hartuar në Shqipëri, Kosovë dhe ajo në Maqedoni, pothuajse nuk dallohen për nga përmbajtjet e tyre (pos në fizionomi, respektivisht në strukturë të shtrimit).

Përfundimisht, Abetarja e promovuar në Prizren vitin që lamë pas, nuk paraqet kurrfarë problemi që të përdoren në sistemin arsimor shqip në Maqedoni, që nga klasa e parë.

Por, nëse nisemi edhe nga fakti se, në klasën e I-rë, nxënësit qëllimet e programit mësimor i realizojnë kryesisht përmes aktiviteteve, pra mungon mësimnxënia, atëherë Abetarja nuk ka kurrfarë pengese të përdoret edhe duke filluar nga klasa e Dytë.

Mbetet që kompetentët shqiptar në Ministrinë e arsimit dhe shkencës, e sidomos ata të Byros për zhvillimin e arsimit në Maqedoni, urgjentisht të punojnë në drejtim të ngritjes së iniciativës për shpalljen e konkursit për tekst shkollor – Abetare, elita intelektuale dhe ajo arsimore të punojnë në propagimin që të mos ketë rivalitet në konkurs, duke i hapur rrugë që Abetarja e përbashkët të jetë e vetme konkurruese në konkurs për librin e shkronjave – Abetaren.

ANGJELINA HAMZA

GLOBALIZIMI DHE TRADITA E USHQIMIT NË KULTURËN SHQIPTARE

Përmbajtja e shkurtër

Një nga temat më të popullarizuara të ditëve të sotme është pa dyshim edhe procesi i globalizimit me karakteristikat e veta pozitive dhe negative. Me globalizim vendet e botës janë bërë edhe më shumë të varura nga njëri tjetri dhe proceset politike, ekonomike, kulturore tanimë nuk mbeten brenda kufijve përkatës dhe asnjë shtet apo subjekt tjetër nuk mund të qëndroj jashtë ndikimit të ngjarjeve që ndodhin nëpër botë.

Një nga ndikimet e pamohueshme të globalizimit, që në një farë forme nënkuptohet si një tentues për përhapjen e llojeve të ndryshme të kulturave, në një kulturë tjetër, është edhe ndikimi në ushqim dhe ekzistimi i llojeve të ndryshme të ushqimit në treg, dhe konsumimi i tyre në sasi të madhe.

Është mjaft i rëndësishëm fakti që të dihet për mënyrën e të ushqyerit të popullit shqiptar në të kaluarën se më ç'farë janë ushqyer, sa ka qenë i shëndetshëm ai lloj ushqimi, mënyrat e të përgatiturit edhe përkundër faktit që nuk ka pasur një studim të mirëfilltë dhe hulumtues për ushqimin në atë kohë.

Disa përkufizime për globalizimin

Një nga temat me të popullarizuara të ditëve të sotme është pa dyshim edhe procesi i globalizimit, proces i cili bart në vete ane negative dhe pozitive e sidomos për vendet në tranzicion e sipër, siç është Kosova.

Duke u nisur nga fakti, se në lidhje me temën e globalizimit si proces tashme gjithë përfshirës në mbare botën, ekzistojnë njohuri dhe të dhëna paraprake nga shumë studiues. Globalizimi, në thelbin e tij, përshkruan dhe shënon jo më tepër se një botë e cila karakterizohet me rrjete të lidhjeve që i kapërcejnë hapësirat multi-kontinentale.

Duke e huazuar idenë e grekëve të vjetër, në një kontekst tërësisht tjetër, çdo njëri bashkëkohor sot mund të thotë lirish "asgjë njerëzore nuk është e panjohur", ngaqë çdo gjë mund të ketë reperkusione për secilin nga ne që jemi këtu, bie fjala, Marshali Makluani, shumë më herët, në mënyrë gjeniale, e pati prejjudikuar këtë proces, ndërsa i pari e paralajmëroi dukurinë a fenomenin e “

fshatit global”, pra një botë me komunikime të mëdha, e cila do të ngjasojë vërtetë një fshati.¹

“Globalizimi” si term është shume i gjere dhe me kuptime te ndryshme për njerëz te ndryshëm. Disa e shohin globalizimin si fuqizim i organizatave ndërkombëtare si : Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, etj. Te tjerë me globalizimin kuptojnë rritjen e transaksioneve monetare rritjen dhe lehtësimin e qarkullimit te njerëzve. Ndërsa për disa globalizimi është thjesht imponim i kulturës dhe ideve perëndimore tek te tjerët, ide qe shpesh quhet edhe perendimizim. Anthony Giddens e përkufizon globalizimin si “ Intensifikim i marrëdhënieve mbare botërore te cilat lidhin vendet e largëta ne atë mënyre qe rrjedhat ne vend formësohen nga ndodhitë qe kane zënë vend me kilometra larg dhe anasjelltas”.²

Prandaj, globalizimi me gjithë anët negative dhe pozitive, qe mund te themi janë te padiskutueshme, ka ndikim te madh dhe esencial ne zhvillimin dhe përparimin ekonomik dhe kulturor te një shteti apo vendi ne tranzicion ne përgjithësi. Zhvillimi i teknologjisë informative, dhe atë te komunikimit globalizimi i ka dhënë hov formave te reja te ndërlidhjes ekonomike dhe , derisa njerëzit vazhdojnë te jetojnë ne kontekste lokale, ata ndikohen dhe integrohen ne këto bashkëpunime ekonomike duke zgjeruar rrjetet ne rrjedha globale. Globalizimi nuk është një forcë homogjene e as nuk është i njëtrajtshëm në ndikimin që ushtron në një vend. Përkundrazi, globalizmi është një proces shumë i koklavitur që karakterizohet me ndërveprim në nivele të ndryshme dhe me dinamikë të ndryshme. Autorët që flasin për këtë proces, procesi social i tkurrjes së botës në një ‘fshat global’, mund të ndahen ne tri grupe:

- hiperglobalistët,
- skeptikët dhe
- transformacionistët³

Pra, Globalizimi është emër me te cilin me se shpeshti emërtohet koha ne te cilën jemi duke jetuar dhe vepruar ne.

Ky globalizim në përgjithësi, dhe në sferën zhvillimore të aspektit ekonomik, erdhi si ndikim i asaj që :” Shtetet provojnë të hartojnë”rregulla qarkullimi” për mallrat, në mënyrë, që të ndalojnë që tregtia dhe investimet të kenë pasoja të

¹ Fadil Maloku, ”Refleksione Sociologjike mbi shtetësinë dhe raportet ndëretnike”, Zëri Ynë, Prishtinë, 2011, fq-100.

² Daniele Archibugi dhe Simona Lammarino “ the policy implications of the globalisation of innovation”, Reserch Policy 28.1999 317-336, Institut for Studies on Scientific Research and Documentacion, National Research Council of Italy, Via C De Lollis, 12, 00185 Rome, Fq-1.

[http://www.danielearchibugi.org/downloads/papers/Globalisation_of_techn_and_science/P
olicy_implications.pdf](http://www.danielearchibugi.org/downloads/papers/Globalisation_of_techn_and_science/Policy_implications.pdf)

³ Bryane Michael “Theorising the Politics of Globalisation: A Critique of Held et al.’s “Transformationalism”, Journal of Economic and Social Research 4 (2), 3-17, fq. 1 (<http://jesr.journal.fatih.edu.tr/Globalisation.pdf>)

dëmshme dhe të papritura. Këto janë rregulla që lidhin shtetet, shoqëritë dhe individët e veçantë. Ka një radhë organizatash ndërkombëtare dhe sisteme rregullash lidhur me pjesë të ndryshme të ekonomisë botërore.⁴

Kosova dhe Globalizimi

Siç e theksuam edhe më lartë, globalizimi si dukuri shoqërore, ka prekur edhe vendet në tranzicion. Njëra nga këto vende është edhe Kosova e pasluftës së fundit.

Për Kosovarët, të cilët për dallim prej të gjithë të tjerëve, natyra trazimeve të brendshme, kur është në pyetje ndërtimi i kapaciteteve të reja të institucionit shtet komb, ka gjithandej specifika të cilat nuk mund t'i hasësh në asnjë model zhvillimor të procesit të ndërtimit të ekonomisë shtetërore, e kjo përfshin dhe ekonominë familjare, e shumë sfera te jetës shoqërore dhe kulturore. Procesi i globalizmit, së bashku me fenomenin “e plakjes” të shoqërive me te përparuara, po i krijon disa fenomene interesante. Në shoqëritë te cilat po “plakën” është duke u rritur kërkesa për fuqi punëtore te re, kurse ne anën tjetër, globalizmi po përhape vlerat universale te cilat shumica gjithnjë e me shume po i përvetësojnë si mënyre te sjelljes se organizimit perëndimor te jetës. Përgjithësisht, njerëzve kjo dukuri kulturore e perëndimit, është bere kryesore dhe gjithnjë me e afërte.⁵ Pra, globalizimi i ka dhënë hov formave të reja të ndërlidhjes dhe ndër varshmërisë botërore. Derisa njerëzit vazhdojnë të jetojnë në kontekste lokale, ata ndikohen dhe integrohen gjithnjë e më shumë në rrjete dhe rrjedha globale. Nga këtu si duket edhe rrjedh emërtimi globalizim.

KOSOVA është dhe vazhdon te jetë sot e lidhur ngushtë me ekonominë globale për të gjithë arsyet që lidhin vendet e një tregu të lirë financiar dhe ekonomik me njëri-tjetrin. Një rënie e investimeve të biznesit apo të dërgesave të emigrantëve nga jashtë tregut tonë, ndikon direkt në të ardhurat dhe në mirëqenien e familjeve shqiptare.

Mallrat e konsumit me çmime gjithmonë në rritje prekin ndjeshëm kuletën e çdo qytetari që kryesisht jeton me këto shpenzime të përditshme.

Meqenëse ne jemi përqendruar me tepër tek aspekti kulturor, mirëpo ne të njëjtën kohë jemi munduar të bëjmë gërshetimin mes kulturës dhe ndikuesit të ndryshimit të saj në çdo aspekt, fenomenit globalizim.

Kur jemi tek aspekti i ndikimit të globalizimit në kulturën shqiptare atëherë vlen të theksohet se: “Globalizimi lind nga dëshira që, nga inventari i elementeve kulturore dhe i elementeve të tjera që përbëjnë një identitet, të zgjedhën ato që konsiderohen karakteristika burimore dhe origjinale të një grupi të caktuar dhe /ose te një vendi/ hapësire e të cilat kombinohen me ato që konsiderohen globale.⁶

Përderisa, ushqimi në përgjithësi është i një rëndësie të veçantë ekzistenciale për njerëzimin, ne të njëjtën kohë si pjesë e përditshmërisë, përmes tij

⁴ Kval-Mellbye-Tranoy, Politika dhe Demokracia, Sh.botuese ”Rozafa”, Prishtinë, f-176.

⁵ http://www.gazetashqiptare.eu/bedri_selmani/index.html.

⁶ Lumnije Kadriu, “Glokalizimi, perceptime etnokulturore”, IAP, Prishtinë, 2009, fq-57.

kemi reflektim të elementeve shoqërore dhe kulturore. Prandaj, qasjet antropologjike të teoricienëve të ndryshëm dhanë dhe interpretime të ndryshme për ushqimin.

Mund të përmendim interpretimin e Bronislaw Malinowskit për funksionin e ushqimit si përgjigje kulturore ndaj metabolizmit si një nga nevojat bazë të njerëzve”. Gjithashtu mund të përmendet analiza strukturaliste e “trekëndëshit kulinar” të L. Strauss”. Funksionet e ndryshme të ushqimit në kuptim magjik pozitiv ose negativ si dhe në kuptimin të ushqimit si tabu ndeshen edhe në “Degën e artë” të Frazerit.⁷

Në disa nga punimet monografike në aspektin e etnologjisë, trajtohen tema rreth ushqimit, përmes të cilit synohet të paraqitet një reflektim identitar. Reflektim ky i cili me domosdo, ngërthen në vete edhe modernitetet dhe stile të ndryshme të jetesës.

Për ushqimin si element i kulturës regjionale, nacionale dhe lokale si dhe për vlerën e tij simbolike shkruan edhe Sara Delamont në librin e saj “Appetitis and Identities”, e cila ndër të tjera, thekson: “Ushqimi bart edhe historinë e shtetit, apo regjionit, pa marrë parasysh se a e kuptojnë këtë banorët e tyre modernë apo jo’, sikurse edhe porositë simbolike të ushqimeve evropiane jashtë Evropës, nëpërmjet pushtuesve kolonialë në të kaluarën dhe me anë të turistëve sot”. Jonas Frykman kishte deklaruar se “lokalja ashtu si paraqitet sot duket se e nxjerr forcën e saj jo vetëm nga procesi i globalizimit, por gjithashtu edhe nga ajo që mund të bëhet prej tërheqjes së saj, dhe se lokalja ofron një stil, një temë, një fije e cila lidh proceset, njerëzit dhe kujtimet se bashku, në atë që mund të quhet-me një fjalë të tejpërdorur kulturë, për me tepër ai shton se “nevoja që të krijohet një korse kulturore rreth diçkaje që kërcënohet me zhdukje është bërë më e lehtë për faktin se e kaluara më nuk komandon, ajo tërheq, fton”.⁸

Nga kjo mund të kuptohet se ushqimi shumë shpesh është përdorur si një mjet me anë të të cilit është krijuar në një far forme një identitet qoftë i një regjioni të caktuar, apo edhe në aspektin nacional.

Kemi disa raste si p.sh: ushqimin në Skanë, nga Suedia, mandej nëse fokusohemi tek identiteti kosovar përmes disa lloje të ushqimit, atëherë kemi “Sharrin”, që përveç që është i njohur si një krahinë e veçantë.

Për më tepër, duke qenë fakt që si territor gjeografik, shtrihet në tri shtetet fqinjë: osovë, Shqipëri dhe Maqedoni, koncepti i Sharrit, prandaj edhe i djathit të tij, e tejkalon jo vetëm Sharrin si krahinë, jo vetëm Kosovën si shtet, por ngritët edhe më lart si simbol e mjet identifikimi i lashtësisë dhe unitet të të gjithë kombit shqiptar. Është ky produkt dhe ky regjion me vlerat e saj të shumëfishta kulturore, tradicionale, historike që mundëson shkuarjen thellë në lashtësi, duke siguruar kontinuitet, autenticitet dhe identitet përkatës.⁹

⁷ Po aty, fq-61.

⁸ Po aty, fq-62.

⁹ Po aty, fq-63.

Tradita e ushqimit në kulturën shqiptare

Secili popull mundohet që ta ruaj traditën, kulturën, doket dhe zakonet e veta në mënyra të ndryshme. Nuk është kulturë vetëm veshja, shtëpia e banimit, ritualet e ndryshme. Por kulturë ishte dhe është edhe ushqimi, si njëri ndër elementet kulturorë më të rëndësishëm shqiptare, ngase sofrat shqiptare vërtet ka qenë dhe vazhdon me shumë rikthime tradicionale të ruhet, të kërkohen çdo ditë e më shumë ushqimet tradicionale dhe të konsumohen.

Një tjetër dukuri që vërehet më të madhe janë edhe restorantet të cilat çdo ditë ofrojnë këto ushqime, duke u munduar që pas ushqimeve edhe ambientin ta rikthejnë në një vend ku mund të shohësh një mori objektesh tradicionale. Objekte këto që në përputhje me ushqimin mund të përafërisht të kthejnë një tradicionalitet të së kaluarës.

Populli shqiptarë siç dihet tashmë, është popull i kulturës dhe traditave të shumta. Tradita të cilat janë ruajtur dhe kultivuar gjeneratë pas gjenerate. Kultura tradicionale është cilësim i një populli të cilin e bën të dallohet nga një popull tjetër. Duke e ruajtur dhe bartur, njëkohësisht duke u munduar që sa më shumë të ruhet origjinaliteti i kësaj kulture. Që nga lashtësia popujt janë dalluar në aspektin kulturor si për nga gjuha, veshja, ushqimi, ritet, religjioni, doke e zakone, prandaj kultura si fenomen shoqëror është e pambarim në të gjitha kohërat.

Sapo gjendemi pranë ushqimit, sidomos ushqimit tradicional-etnik, ne jemi të vetëdijshëm për konotimin e tij të thellë kulturor. Ne mundohemi të dallojmë ndryshimet, dallimet në ushqime dhe gjithmonë jemi në gjendje ta përcaktojmë ndonjë lloj identifikimi të lidhur me të.¹⁰

Mënyra e të ushqyerit përmban karakteristika specifika të mirëfillta të çdo popull. Secili sish ka diçka specifike. Shpeshherë hajet, gjellët ose pijet e caktuara janë veçori kombëtare.¹¹

Përveç se popujt janë dalluar nga mënyra e të ushqyerit, ekziston edhe ndarja krahinore që e bën këtë dallim në ushqime. Secila lami në aspektin kulturor ka rëndësinë e vet në atë që ajo paraqet si kulturë dhe traditë. Edhe ushqimi tradicional pos tjerash ka rolin dhe rëndësinë e vet kulturor të një populli, si në të kaluarën edhe në ditët e sotme. Dihet së në të kaluarën një ndikim të madh në përgatitjen dhe mënyrën e të ushqyerit ka pasur edhe sasia e pakët e produkteve që kanë ekzistuar në ato kohë për përdorim. Kryesisht janë përdorur produkte ushqimore nga natyra dhe bulmeti. Se sa ka qenë interesant ushqimi në vendin tonë, tregon edhe fakti se kjo pjesë e kulturës ka qenë objekt studimi i disa studiuesve vendor dhe të huaj si: Franc Nopca, Drita Statovci, Lumnije Kadriu etj. Këta autor ndër studimet e tyre shkencore, kanë sjellë krahasime të ndryshme rreth përdorimit të ushqimit në vendin tonë, dhe në të njëjtën kohë ndikimin dhe të ushqimeve të tjera.

¹⁰ Po aty, fq-60.

¹¹ Drita Statovci, "Skicë për studimin e ushqimit popullor", Gjurmime Albanologjike, XIII, IAP, Prishtinë, 1984, fq-131.

Ushqimi tradicional dikur me origjinalitetin e produkteve te përdorura vërtet ka treguar për një kulturë të pasur ushqimore në traditën apo më mirë të themi në sofrën shqiptare. Sot, mund te flitet për lloje të shumta të ushqimeve të ndryshme. Por, pak nga ato janë ruajtur pa ndikimin e kulturave të tjera, si ne çdo aspekt tjetër të jetës sociale.

Te shumë popuj janë shkruar studime të tëra rreth mjeshtrisë së përgatitjes së gjellëve dhe të gatesave të tjera, rreth të ushqyerit(fuqisë kalorike), të hajeve e pijeve të ndryshme. Duke ushtruar shekuj me radhë gatimin e ushqimit për njerëz e për raste të ndryshme, kjo mjeshtri është bërë art i kuzhinës.¹² Më të gjitha këto çështje janë marruar shumë nga studiuesit e kulturave të ndryshme, nga të cilët, ne gjenerata e ushqimit modern kemi pak njohuri për ushqimin e së kaluarës të popullit tonë. Ngase , shkrimet mbi ushqimin tradicional shqiptar nuk janë të shumta ne numër, ato janë të pranishme dhe ndeshen si “pjesë të monografive me karakter të ndryshëm, si të dhëna dhe raste marginale në shkrime të udhëtarëve ne kohë të ndryshme, dhe shumë pak si studime pikërisht për ushqimin”.¹³

Kur jemi tek llojet e ushqimeve, që dikur kanë qenë edhe ushqim përditshmërie në sofrën e familjes shqiptare, atëherë vlen të cekën disa nga këto ushqime .Ushqimet më të njohura nder shqiptar në Kosovë dhe qe konsiderohen si ushqime tipike tradicionale janë: flija,buka nore (pogaçja), mantijat, kryelana e kollomojt, specat me gjizë,ajroni, lëngu, buka misrit, dhe bakllava. Këto konsiderohen nder ushqimet më tradicionale të cilat edhe sot konsumohen në familjet shqiptare dhe mund te gjenden edhe nëpër restorantet e ndryshme. Një përshkrim duke u referuar nga të dhënat e marra nga autorja e librit “Glokalizimi, perceptime etnokulturore”, etnologja Lumnije Kadriu, për këto ushqime tradicionale po i paraqesim pika të shkurtra më poshtë:

-Bukë nore – (pogaçja) - është lloj i bukës, zakonisht i bërë me miell gruri,ujë,krup dhe sodë bikarbonate. Karakteristikë e saj nuk është në elementet përbërëse sa në teknikën gjatë procesit të gatimit, meqë atë nevojitet ngjeshur sa më shume.

-Flija- i takon ushqimit të gatuar nga brumi. Elementet përbërës janë:uji, mielli i grurit, kripa dhe ajo shkrihet në një tepsi të lyer me yndyrë në formë të rrezeve, duke lënë hapësirë simetrike për shtrirjen e rendit pasi që të jetë pjekur rendi paraprak me enën tradicionale të nxehur në zjarr-saçin. Secila shtresë lyhet me harxhin që përgatitet prej gjalpi ,dhallë e qumështi përzihet mirë.

-Kryelana- në Kosovë quhet ”Kërlana”ky lloj ushqimi përgatitet me miell misrit apo grurit.

-Leçeniku- në fakt bëhet fjalë për kryelanë të përgatitur nga mielli i misrit. Dikur ky lloj ushqimi është përgatitur vetëm me mazë(ajkë),ndërsa sot kryesisht përgatitet në mënyrë të njëjtë, por ka përmbajtje apo harxh (fill),edhe të tjera si p.sh: pinaq,kos, djathë ,dhe disa vende e gatuajnë edhe me kungull.

¹² Po aty, fq-131.

¹³ Lumnije Kadriu, “ Glokalizimi, perceptime etnokulturore”, IAP, Prishtinë, 2009, fq-63.



Foto vetjake, të realizuara gjatë përgatitjes së flisë në familje

-Leçeniku- në fakt bëhet fjalë për kryelanë të përgatitur nga mielli i misrit. Dikur ky lloj ushqimi është përgatitur vetëm me mazë(ajkë),ndërsa sot kryesisht përgatitet në mënyrë të njëjtë, por ka përmbajtje apo harxh (fill),edhe të tjera si p.sh:spinaq,kos, djathë ,dhe disa vende e gatuajnë edhe me kungull.

-Gjiza- është një lloj ushqimi qe fitohet nga prodhimet e qumështit, mjaft i përdorur dikur dhe sot gjendet më shumë i prodhuar nga fabrikat e ndryshme. Zakonisht konsumohet me speca të pjekur. Po ashtu edhe këtë lloj ushqimi,kohëve të fundit e hasim edhe nëpër restorantet tona.

-Longu- ky ushqim përgatitet nga përzierja e kosit dhe gjizës,ku mund të shtohet pak djathë , apo ky përfitohet vetëm nga uji në të cilin është ruajtur djathi. Në disa vende e quajnë kumsht.

-Ajroni- është një lloj jogurti i tretur në ujë ,apo ndryshe njihet edhe si kos i tëholluar me ujë dhe kripe me këtë term është përdorur derisa ka filluar qe nëpër restorante te quhet me emrin ayran.

Këto ushqime kanë pothuajse edhe mënyrë tradicionale të përgatitjes, por që sot ekzistojnë edhe mjete adekuate për përgatitjen e tyre. Ajo çka i bën të dallohen këto ushqime sot nga ushqimi i përgatitur dikur janë produktet që përdorën sot të cilat pak a shumë janë të përafërta me shijen e produkteve të dikurshme, por assesi nuk janë të njëjtat produkte, apo rrallë gjenden dhe atë vetëm nëpër fshatra. Kjo nga fakti që tashmë tregu të ofron mjaft zgjedhje për ushqimet.

Faktor tjetër është edhe zhdukja në vazhdim e sipër i mbajtjes së bagëtive në shtëpi, nga te cilat sigurohej një sasi e konsideruar e produkteve ushqimore. Bujqësia dhe blegtoia, si dy degë mjaft të rëndësishme, e që dikur nga to varej dhe zhvillohej ekonomia familjare, janë në zhdukje e sipër. Po ashtu koha dhe dinamika e jetës ka bërë që njerëzit te jenë më të dhënë pas ushqimeve të shpejta e veçmas mbas më të njohurës “Fast food”. Mu këtu shohim një shembull tjetër edhe më konsekuent të globalizimit që na paraqitet në përgatitjet e ushqimit.

S’ka dyshim se kudo në familjet shqiptare vazhdon ruajtja e traditës së të ushqyerit me ushqime tradicionale. Mirëpo, në familjet shqiptare hyjnë edhe ushqimet e kulturave të tjera, sidomos picat dhe makaronat dhe salcat italiane.¹⁴

Nga kjo mund të kuptohet që procesin e globalizimit si fenomen shoqëror, e shohim të manifestuar edhe në vendin tonë, përmes llojeve të ndryshme të ushqimit. Por në të njëjtën kohë duhet theksuar faktin që po ekziston nëpër familjet shqiptare në diasporë. Shumica nga këto familje, me mallin më te madh për vendin, kulturën dhe traditën qoftë në ushqim, veshje, apo çdo aspekt tjetër kulturor qe i takon botës shqiptare, me shumë xhelozi po tentojnë ti ruajnë dhe kultivojnë edhe atje këto tradita. Kjo vërehet edhe tek ushqimi. Flija, si një nder ushqimet më të preferuara, të cilën e përgatisin në ballkonet e banesave të tyre, apo edhe nëpër oborre të shtëpizave, me saçet e posaçëm. Në këtë mënyre ata mblidhen dhe konsumojnë flinë, me miq e familjarë, vetëm e vetëm për tu ndier si në vendin e vet Kosovën.

Janë këto disa nga ushqimet që konsiderohen më tradicionale,të cilat edhe sot konsumohen nëpër familjet shqiptare. Më lart kam cekur se ekziston edhe dallimi krahinor në përgatitjen e ushqimeve. Marrim shembull flinë, ku ne disa krahina ajo përgatitet apo gatuhet ne rende, ndërsa ne disa të tjera gatuhet me petulla dhe konsiderohet si më e vështir përgatitja e saj .Ushqimi dihet historikisht që në të gjitha kohërat është përgatitur në shtëpi. Por sot ushqimet e lartpërmendura

¹⁴ Po aty, fq-64.

mund ti konsumojmë edhe nëpër shumicën e restoranteve vendore, në të cilat ende punohet me mjeshtërinë moderne. Kjo nga fakti që, mbas luftës prania e shumë ndërkombëtarëve solli ndryshime të shumta.

Si një dukuri tjetër të globalizimit, të lidhura me ushqimet dhe mënyrën e të ushqyerit, mund ta konsiderojmë edhe prezencën e shumë restoranteve nacionale nga kulturat e tjera të botës, sikurse janë restorantet kineze, italiane, meksikane, franceze etj.

Këtu mund të shohim mjaft qartë tendencat në treg qoftë nga ana e ushqimit vendorë, qoftë atij që vije nga jashtë.

Kjo po ndodh me anë të përshtatjes së ofrimit tradicional në një mënyrë moderne. Me anë të pranisë së shumë furrave e restoranteve, në të cilat ofrohet ushqimi i llojllojshëm tradicional etnik. Në këto furra përkatëse, në të cilat ofrohen lloje të shumta të internacionales, na paraqitet edhe mbishkrimi dygjuhësor i tyre (shqip e anglisht). Aty shitën flija dhe mantoja, buka e misrit, e gatuar në mënyrë tradicionale, e shumë lloje të tjera, “mafinave e doughnats” amerikane, si dhe ëmbëlsirave të ndryshme nacionale e internacionale.¹⁵

Megjithatë, edhe përkundër të gjithave kushteve, jetës shoqërore të stërngarkuar me dinamikën e përditshmërisë, prapë se prapë dëshira për tradicionalen nuk mund të shuhet ashtu pa lënë gjurmë. Ngase tek familja shqiptare, e veçmas tek ajo rurale, akoma ka përgatitje të ushqimit tradicional në shtëpi dhe të cilin e konsiderojnë si shumë të shëndetshëm.

Si përfundim lidhur me këtë temë, po theksojmë edhe njëherë që : globalizimi ka sjellë risi të përmasave të mëdha si në çdo aspekt të jetës sociale dhe kulturore. Por duhet pasur parasysh se të gjitha dukuritë shoqërore të cilat e bëjnë një shoqëri të veçantë dhe të rëndësishme në identitetin e saj , duhet që doemos të çmohet, kultivohet të ruhet dhe të mbrohet nga ndryshimet e vullshme të kohës, të cilat dinë që shumë shpesh të marrin gjithçka të mirë për vete, dhe të humbin gjurmët e një kulture të veçantë siç konsiderohet dhe është kultura jonë unike. Prandaj çdoherë ekziston shpresa dhe besimi tek populli shqiptarë, sikurse tek popujt e tjerë, po dëshmojnë kreativitetin e tyre, shfrytëzimin e traditave dhe adaptimin e tyre sa më të mirë. Sepse çdo veprim i marrë nga ne për të ruajtur një diçka që na takon dhe është e jona, mund të ndikojë në fatin e traditës qoftë të vendit qoftë të një tradite te ndonjë vendi tjetër.

¹⁵ Po aty, fq-66.

LITERATURA

1. Daniele Archibugi dhe Simona Lammarino “ the policy implications of the globalisation of innovation”, Reserch Policy 28.1999 317-336, Institut for Studies on Scientific Research and Documentacion, National Research Council of Italy, Via C De Lollis, 12, 00185 Rome
2. http://www.danielearchibugi.org/downloads/papers/Globalisation_of_techn_and_science/Policy_implications.pdf
3. Bryane Michael “Theorising the Politics of Globalisation: A Critique of Held et al.’s “Transformationalism”, Journal of Economic and Social Research 4 (2), 3-17, fq. 1
(<http://jesr.journal.fatih.edu.tr/Globalisation.pdf>)
4. Kval-Mellbye-Tranoy, Politika dhe Demokracia, Sh.botuese ”Rozafa”, Prishtinë, f-176.
5. http://www.gazetashqiptare.eu/bedri_selmani/index.html.
6. Fadil Maloku, ”Refleksione Sociologjike mbi shtetësinë dhe raportet ndëretnike”, Zëri Ynë, Prishtinë, 2011.
7. Drita Statovci, “Skicë për studimin e ushqimit popullor”, Gjurmime Albanologjike, XIII, IAP, Prishtinë, 1984.
8. Lumnije Kadriu, “ Glokalizimi, perceptime etnokulturore”, IAP, Prishtinë, 2009
9. Anthony Giddens, “ Sociologjia”, Çabej, Tiranë, 2007.

*BUKURIE MUSTAFA***LESIKU I KULTURËS POPULLORE
TË PATISHKA REKËS**

Patishka është fshat malor edhe sot i banuar dhe gjendet nën majën a lartë të malit Karaxhicë. Gjeografikisht i takon rajonit të Karshiakës, por nga pikëpamja gjuhësore e etnografike, është e veçantë. Lidhjet e saj burimore kanë më shumë të bëjnë me fshatrat e Rekës së Epërme, e cila dëshmohet e vërtetohet nga dimensionet e shumta të kulturës e të trashëgimisë, që e gjejmë ende të gjallë në të folme, veshje, rite e zakone etj. Duke u dalluar nga veçoritë e përgjithshme etnografike, ajo ka arritur ta ruajë mëvetësinë e saj edhe krahas rrethimit nga fshatra që ndryshojnë në të folmet e tyre. Hulumtimet për këtë rajon janë më të shumta në aspekt të etnografisë, por hulumtime gjuhësore për fshatrat e Karshiakës, përfshirë këtu edhe Patishkën, datojnë nga viti 1929 kur gjuhëtari Petar Skok bën një vizitë këtyre fshatrave dhe është njëri nga ata i cili përpiket që përmes analizave gjuhësore dhe të toponimisë të nxjerrë përfundime për të folmet e këtij rajoni. Skoku e dallon Patishkën për nga e folmja nga ky rreth gjuhësor: “E folmja shqipe e Patishkës jo vetëm leksikalisht, por edhe fonetikisht dallon nga të folmet e tjera të shqiptarëve të Luginës së Shkupit. Derisa këta të fundit thonë *cauc*, ata të Patishkës thonë *vasha*”¹. Por duhet vërejtur se përdorin edhe leksemën *cuc*; ... *i ka dy cuca*. Për nga veçantitë gjuhësore, duhet të pranojmë se e folmja e Patishkës është e një tipi me atë të Cërnivorit, Jabollcës-Jabollçishtes, Nerezit, Krushopekut, Stapetkës dhe Gërçecit².

Skoku merret me analizën etimologjike të leksemave të veçanta, duke përfshirë leksemat e veshmbathjes, për të cilat thotë se ato iliro-trakase janë më pak dhe se të tjerat janë latine e sllave³. Josllave i jep edhe shprehjet e dasmës (*dars(z)ma*, *kraushk*), si edhe shprehjet e farefnisnës, që janë kryesisht josllave dhe me këtë rast dallon fjalën *strojnik* në Jabollcë, që në shqipe e përdorin *shkus*⁴. Në të folme të Patishkës, vërejmë përdorime të formave sinonime, *strojnik*, por edhe *petkar* e *petkallar* nga *petkat*⁵.

¹ P. Skok, 1978, f. 100.

² Haki Ymeri, E folmja shqipe e Karshiakës, 1998, f. 31.

³ P. Skok, 1978, f. 100.

⁴ Po aty, f. 101.

⁵ “Nga shprehjet e veshëmbathjes, ku gati s’kemi elemente iliro-trakase përveç *petka* dhe *brez*”. Po aty, f. 100.

Haki Ymeri, po ashtu ka trajtuar aspektet gjuhësore të të folmeve të kësaj ane, por në një mënyrë të përgjithshme dhe thotë se libri i tij “E folmja shqipe e Karshiakës” është përpjekja e parë, ngase deri atëherë nuk kishte ndonjë studim i veçantë për këto të folme⁶.

Leksiku i kulturës popullore të Patishkës është i begatshëm dhe regjistrimi i plotë i saj është i vështirë të mblidhet.

Në një lartësi mbidetare prej 1920 m, Patishka është një kopsht botanik dhe Skoku vëren elementin trako-ilir dhe latin, për të cilën thotë se është ruajtur mrekullisht në terminologjinë malore dhe në fushat e lidhura me të⁷. Këtu ende janë të gjalla emërtimet autentike të florës, e që paraqesin një fushë leksikore popullore:

bajshite e idhun f. bot. lloj lule balsami.

bajshitshpërdit f. bot. lule balsami.

bazhurk-a f. bot. bozhure.

çkolk-a f. bot. luleborë

frasha/druni i frashes bot. f. dru mali i lartë 10 metra, veç dru edhe gjethe; prej saj përfitohet bojë e zezë, i ngjyrosnin tirqit, xhamadanët, mitanët e lurkat me *frash*.

grun biberi ferkallke m. bot. lloj biberi, që përzihet me *ferkallken*.

kokram-a f. bot. rrush arushe.

kukurek-u m. bot. shpendra.

kurpin-a/kurpinj-a f. bot. kulpër (... e kapërcenin, e përshkonjin fmiht akolla kurpinjës, për t'qonon shëndosh: - *Lei t'ligat ktu*; fëmijët i sillnin rreth kulprave për shëndet në ditë të Shëngjergjit).

lula e verdh f. bot. ... *kur i binte sarilleku i lanjim me lula t'verdha* ...

lulkakaçke f. bot. lulja e verdh, lule nga e cila përfitohet ngjyra e verdhë dhe është përdorur për ngjyrosjen e veshjes.

lulashyngjergji m. bot. lule e verdhë, që u jepej lopëve si ushqim.

lula bgjeshke f. bot. lule mali; *çaj bgjeshke*.

lule zogë f. bot. gjuhënuse.

milc-a f. bot. lulebletë; *çaj milce* bar i bletës; erë limoni që i mbledh bletët, çaj për qetësim.

nagjas-i m. bot. mentë.

patlipesk-a f. bot. aguliçe.

Fjalë nga sfera të tjera të leksikut:

agal ndaj. vetëm.

akraba-ja f. familja, farefisi.

amçanik-u m. lidhëse opingash.

anteri-a f. pjesë e veshjesh së grave, e veshur mbi këmishë të bardhë dhe e gjatë, kryesisht e punuar dhe e zbukuruar.

⁶ Haki Ymeri, “E folmja shqipe e Karshiakës”, Shkup, 1998, f. 29.

⁷ P. Skok, Hulumente gjuhësore te popullsitë josllave të luginës së Shkupit, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 1978, f. 97.

ashik-u m. eshtë i vogël i këmbës së deles, është përdorur si top/*topk* në lojën *ducka*.

baç-i m. babë.

baba i ri f. babai, por mund të përdoret edhe për vëlla të babait, axhë⁸.

babapqak-u m. gjyshi.

baçqark-a f. përparëse.

bash-i m. bakshish.

cafk-a f. tas.

Çafkarnik-u m. *Çafkarniku i Madh dhe Çafkarniku i Vogël*; toponime⁹.

çamak-u m. shkop i gjatë prej një metër gjatësi, që përdoret në lojën *çelik*.

çapraz-i m. pafhtë, kopsë e metaltë e kollanit (ari, argjendi a bakri), si pjesë zbukurimi në veshje grash.

çaush-i m. njeri i caktuar për të mbajtur rendin gjatë dasmës.

çazhnj-e f. lesh i përdorur për përpunimin e tirqve.

çelik e çamak ndajf. lojë djemsh; luhet me *çamak* dhe *çelik*; *çeliku* është shkop prej njëzet centimetra. *Edhe muhabeti osht "mos i luj çeliket shum"*: mos u tall.

çerep-i m. saç bote.

çifutk-a f. shami burrash në kostume dhëndërie, e vendosur mbi krah.

çpatit/çpatititet fol. shpotit.

çoban-i m. ai që ruan dhen.

çukit fol. *pelivanët bëjnë salltanat ... n'kom e n'krje i çukitnin durt për t'i tregu kundërshtarit se s'ën e rzojne*.

çupesh ndajf. lojë vajzash me gurë; guralecash; "*ajde lujna çupesh*".

dad-a f. nënë.

daull-i m. vegël muzikore, tupan.

daullexh-i m. ai që i bie daulles.

dock-a f. *ato grat mblidhen dockat* - grua llafazane, flet shumë.

drag-a f. ortek i borës, ekziston edhe toponim *Lugu i Drages*.

druar-i (ët) m. druvarët; ... *druarët i çonin dru me kval dasmorit*.

duck- a f. top i vogël; *asaj topkës i thon duck, ajo prej druni boret*.

ducka ndajf. lojë *duckash*, lojë djemsh.

dujç/dujsh – m. torbë, trastë; *i vinin n'dujç petkat ; ... shkonjin me petkat me dujçit*.

dysk-a f. gur, përdoren në lojën *çupesh*.

ferkallk-a f. biber i shtypur.

⁸ Emrat *baç* e *baba i ri*, por edhe emri *bab*, në kuptim të gjyshit janë emra respekti, të krijuara në rrethana të një hierarkie familjare dhe të respektit të gjeneratave. Më shumë shih: Bukuriye Mustafa - Vëzhgime mbi leksikon e të folmeve shqipe të Maqedonisë, "Studime albanologjike", nr. 5, Shkup, 2012, f. 99-105,.

⁹ *Çafkarnik*, fshatarët e përshkruajnë si gropë e thellë dhe e errët. Emërtimin e lidhin me shpendë që mblidhen në këtë vend; ... *mblidhen çafkat; ... n'Çafkarnik do t'shkojm do zom pllumba*.

gaçk-a f. përrallë, tregim; *gaçka t'diftojmë* – fjalë pa vend, flet gjëra të kota a të pavërteta.

gazmend-i m. gëzim.

gost-i m. mysafir, *shkaj n'gosti*.

gostit fol. e *gostiti*, e priti mikun a mysafirin mirë, me ushqime e pije.

govedar-i m. ai që ruan lopë.

grill-i m. rërë.

grish fol. ftoj; *i grishnin n'shpi n'shpi; grishnin dasmori me daull; shkonin e grishnin bajrakët*.

grulit mb. i rrjepur, i gërvishtur, ... /q/sheni *grulit*¹⁰.

gur kone m. gur prej të cilit përfitohet këna.

gunj-a f. veshje barinjsh, pallto e gjatë leshi, me jakë të gjerë, e cila sipas nevojës mund të kthehet në kësulë.

gjeleshiten fol. zihen.

haxhavell-a f. gjellë vere me perime; (këtu *r-ja* ka rënë, *harxhavell*).

hoka-f. shaka.

kakill-a f. pjesë zbukurimi te veshja e nuseve, shami shumëngjyrëshe, të vendosura mbi *terthorkën*.

kalepk-a f. djep.

kallçi-n m. sh. çorape leshi për gra e për burra.

kallnuer-i m. janar.

kavall-i m. fyell.

kazar-i m. ai që ruan dhi.

keç-i m. plis.

kek-a f. tezja e halla, emër respekti për një grua më të vjetër.

kerluk-u m. kërrabë.

kiç-e f. kec¹¹.

kok-a f. bonbone.

komakalës ndajf. këmbadoras; *ec komakalës*.

korpavic-a f. shportë¹².

corp-a f. shami grash.

kozhuf-i m. gozhup.

kub-e f. bar i mbledhur në trajtë të një kubi.

kuk-a f. qyqe.

kup-a f. enë, tas.

ledh-i m. mur guri.

¹⁰ Ndër banorët qarkullon legjenda se është hedhur një qen në Çafkarnik dhe pas një kohe është shfaqur në shpellë, mirëpo ka dalë i gërvishtur, pa qime, ... *sheni grulit*.

¹¹ Shprehje e Ditës së Verës, që fëmijët duke shkuar shtëpi për shtëpi thërrasin: *Ku i keni kiçet e poçet?*, derisa e zonja e shtëpisë i përgjigjet: *Nër verniket, nër çerepet*.

¹² *Korpavica*, e gjejmë në një këngë që këndohet gjatë festës së Vasilicës: *Cekr, cekr Vasilica, dajni, baba, korpavica! Me një moll, me një dardh t'dale ftyra e bardh! Istref Beqiri* (intervistuar nga Ibe Mustafa më 31.12.2014).

lese f. kryes. sh. gërshetat e hollë e të thurur nga flokët e rënë e të mbledhur, duke i ngjitur në flokët natyrale për të zgjatur e për dendësi të flokëve, që njëherësh është edhe shenjë e të martuarave, nuseve, të cilat në momentin e vdekjes së burrit, ato hiqen.

Lenisht-e f. livadh, toponim.

ligat-a f. moçalishte.

lla pj. ja, qe (këtu), *lla ktu.*

majnak-u m. pjesa e rrjetës me rruaza që bie në pjesën e pasme të kokës, e përngjitur *ksulës me pare* në kostume të nuseve.

majzhenic-a f. gjellëbërësja.

mindilk-a f. pecetë.

mixh-a f. xhaxhai apo emër respekti ndaj më të vjetrit.

mat/mot –i m. vit; ... *kemi qon njizet e një mat syfırxhi.*

matmot/motmot-i m. një vit, *nji matmot.*

mullar-i m. strumbullari i lëmës, shtylla në mes të lëmit ku lidhet kali kur shijnë.

natver-e f. etnogr. nata para Ditës së verës; *nata e ditveres, ditvere.*

nom-a f. mallkime.

nonalluk-e f. njerka.

nonapqāk-a f. gjyshja.

nun-i m. etnogr. kumbarë (... *fjalë e moçme, kur martoheshin mirte një shak/shok i thoshin nun).*

nxitoj fol. shpejtoj.

panazhyrk-a f. përparëse nusesh.

pastat fol. lodh.

përcjellsh kryes. sh. etnogr. burra të familjes e të fisit që përcjellin vajzën nuse.

petk-a f. rroba.

petkar kryes. sh. njerëzit nga ana e dhëndrit, të cilët i çojnë petkat nuses, por edhe *strojnik a petkallar.*

poç-e f. vorbë.

postaq-i m. lëkura e kafshës, *athere kishte postaqi, dhen sa t' duesh.*

pustit fol. shkret.

pushtu fol. u kan pushtue pelivan.

regzina kryes. sh. shirit i vejtur leshi, të mbathura mbi opingat.

sandok-u m. arka, *sandoket i mbushnin me petka.*

stolk-a f. shkëmb.

syfırxhi –a f. ai që i zgjon njerëzit për syfyr, duke i rënë daulles.

sharit, sharitun mb. laraman, *brez t' sharitun.*

shtomb-a f. shtambë.

terlik-u m. mantel i zi, i hollë.

terllok-u m. kapuç i beztë.

terthork-a f. shami e palosur në formë trekëndëshi e tëra e zbukuruar me stringla, pjesë e kostumit të nuses.

tishk-a f. ashkël.

torll-e f. stan, kasolle.

katar -i m. vathë, vendi ku mbahen dhentë.

vajz/vash-a f. ... *nji vajz, si t'kesh shum vajza, (sh.) vasha.*

vernik-u saç hekuri.

vdor fol. i *vdora*, i humba.

vic-a f. nusja e dajës, nusja e axhës, *mixhavica, dajxhavica.*

vonçk-a f. vrimë.

Verzhilla f. një ditë para Shëngjergjit.

xërnxcalla-t f.vet. sh. syze.

xhuli-e f. lurkë, veshje burrash, e zezë, më e shkurtër se guna, me krahë të shkurtër.

Bojat: *e bardh, e verdh, e zez, e kushe e çilt, e bgjer (e gjelbërt), e çilt (tirkiz, teget), e pllavt (e kaltër), pembe, argavan.*

Thirrje për të mbledhur bletët:

Mat, mato

bij bijo

Eja te shpija

Eja te koshi mato.

Shprehjet urimi e përgëzime:

Urim: *Për hajr!* dhe forma e përgjigjes: *Ua kthefshim huan!*

O mall, o gjalë, o gazmend i nonës.

Malli i gzuët.

Sa i bukur. M'erdhën mushknit! Mushkni ju kam! – gëzim shumë i madh.

T'kam një gjal si hulli (yill). E kam një gjal si hulli!

Për vajzë:

E kam një cuc si honëz!

E kam një cuc si zog!

T'kam si drita sabahit!

Lele kuk e vogël (pasthirmë); Lele e gzuët mbetsh!

Mallkimet- *nomat, siç u thonë këta:*

Ma ngjefsh!

Mos e mbriqsh!

Ku shkan a haberi t'shkaft!

Shkafsh e mos kthefsh!

Oxhaku t'u shynt!

Kuk mbetsh! – Qyqe mbetsh!

Një numër i mallkimeve lidhen me lumin Radika: *T'mart Radika! T'laft Radika! T'laft rona e Radikës!*

Fjalë të urta popullore

Ditshkurti s'bohët ditshat - ka të bëjë me jetën, përkatësish vdekjen.

Banjin dazmë, pa daulla.

Peshku n'det, tiganji n'zjarm.

Kan mbetun pa pare si peshku nd'uj.

Ku s'ka pula, mos bo ish.

I frynti nuk i ze bes t'untit.

Ratin malet u ngriten halet.

Kashta e kalit, buka e Fetait – shprehje gjatë shirjes; kali e shin lëmin, ndërsa dobinë e përfiton njeriu.

Shprehjet frazeologjike

... *mos e përzine brumin me qert* (nuk janë përzier me të tjerët)¹³.

Lese, ... kur mbartohen i mbajn, kur i vdes buri e shiten (d.m.th. i largojnë, i heqin).

... *menjerë ja ngjesin bishtin*; muhabetit, bisedës i japin tjetër kuptim.

Kur t'folish ndoni send, përtype pak; i matur në të folur.

... *mjalta t'u boft zhak* ...

Do foli ama një fjalë pes denar; flet rrallë; që thotë diçka të rëndësishme.

Dikush qi i ka motet edhe mend mundet t'i folen kto pun; dikush që është në moshë dhe ende mban në mend.

... *ta fryne prushin e t'punojm*, të nxit ndonjë punë; shtie vrullin për t'u krye ndonjë punë.

Ka pushue ... Ka vdekur.

Të intervistuarit:

Istref Beqiri, 1928

Nebi Adili, 1929

Bilall Xhemaili Shaqiri, 1951

Zeqir Zeqiri, 1953

Avdyl Halili, 1955

Qerime Zeqiri, 1958

Rushit Zeqiri, 1964

Kadime Zeqiri, 1964

Hanife Ymeri, 1972

Ibe Mustafa, 1961

¹³ Një konstruksion e kuptim të ngjashëm me shprehjen:” “*E kemi pasë bukën e përzieme ndërmjet veti*“: kemi qenë të përziem me shtëpi, kemi qenë të lidhur me krushqi, me miqësi të ngushtë, kemi dhënë e kemi marrë te njëri tjetri”. Mehmet Gjevori, Frazeologjizma të gjuhës shqipe, Prishtinë, 1972.

Bibliografi:

Gjevari, Mehmet. Frazologjizma të gjuhës shqipe, Prishtinë, 1972.

Миленко, Филипović. Патишка, Јужни преглед, бр.4, 163-174, Скопје, 1931.

Skok, Petar. Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të luginës së Shkupit, Studime gjuhësore I, 81-13, Prishtinë, 1978.

Ymeri, Haki. E folmja shqipe e Karshiakës, Shkup, 1998.

BAJRAM MEHMETAJ

MBI DISA TOPONIME PERIFRASTIKE TË TREVËS SË DEÇANIT

Duke hulumtuar onomastikën e trevës së Deçanit tani e shumë vjet më parë, hasa edhe në disa toponime të tipit perifrastik që, kujtoj, janë me interes gjuhësor për t'u trajtuar. Tipin e toponimeve perifrastike e trajtoi gjuhëtari ynë Mehmet Halimi shumë vjet më parë.¹ Kjo temë studimore si e tillë, me sa kam hulumtuar në literaturën përkatëse, është fare pak e trajtuar.

Toponimet që i përdor përditë popullata e një vendi kanë karakter praktik, sepse, para së gjithash, ato janë shenja gjuhësore që përdoren për të veçuar objektet në natyrë si dhe morfologjinë e një vendi që mund të jetë breg, lug, kodër, rrazhgë, gërrellë, qafë, maje, shpat, shpellë etj. Banorëve të një vendi, siç e thonë edhe ata vetë, u intereson më tepër morfologjia e një terreni të caktuar dhe orientimi toponimik në të, sesa konceptet etimologjike të toponimeve, prandaj, në rrjedhën e moteve ndodhin shtrembërime, evoluime kuptimesh e ndërrime të ndryshme nga kuptimet parësore të tyre.

Në këtë punim nuk do të hyj në detaje etimologjike të toponimeve në shqyrtim, por do të përmend këtu edhe disa toponime perifrastike të trevave të tjera gjuhësore të Kosovës që i kam hasur në shkrime të ndryshme profesionale dhe që kanë disa karakteristika të veçanta.

Toponimet e mirëfillta të tipit perifrastik në gjuhën shqipe janë të pakta dhe të pastudiuara sa duhet. Këto toponime janë të formuara kryesisht me material leksikor të shqipes dhe për nga struktura e tyre gramatikore janë të formuara në trajtë të një fjalie përshtuesore të shprehur me perifrazë që, në pjesën më të madhe, kjo fjali tregon vendin se ku është zhvilluar një ngjarje.

Banori i këtyre anëve (veçmas bujku e bariu) është përpjekur të emërtojë gjithë terrenin e fshatit dhe të bjeshkës së vet, sipas cilësisë e karakteristikave të çdo vendi, si: arë, livadh, kopsht, rrugë, vijë uji, përrua, mriç, grykë, vargmal etj. Këto emërtime shërbejnë si orientime për t'u gjetur banori i këtushëm sa më mirë e më saktë në terrenin e tij të përditshëm.

Ashtu si toponimet perifrastike të trevave të tjera të shqipes, edhe ato të trevës së Deçanit janë histori e shkurtër ngjarjesh e përshtuesorësh objektsh e vendesh në trajtë të rrudhur gramatikore, por semantikisht (kuptimisht) janë mjaft të qarta. Hasen në këto anë (si rrallë gjetiu) një tip i veçantë toponimesh perifrastike figurative që kanë rëndësi për leksikun e toponiminë e kësaj ane për shtresat

¹ Mehmet Halimi, Mbi disa toponime të tipit perifrastik, në «Onomastika e Kosovës», Prishtinë, 1979, f. 243.

kuptimore (semantike) që kanë e që do të trajtohen në vazhden e këtij shkrimi. Toponimet perifrastike kanë rëndësi edhe për mënyrat e fjalëform. të tyre.

Në toponimet e tipit perifrastik që hasen në fshatrat tona vërehen dy lloj procesesh: a) Toponime që tregojnë një veprim të kryer (statik), si p.sh.: TEK KAN LIFTUE TRIMAT² dhe b) Toponime perifrastike dinamike, që tregojnë procese dinamike që rrjedhin, që përsëriten edhe në të ardhmen,³ si p.sh.: KU KCEJN DRANGOJT (Voksh-Deçan).⁴

* Disa nga toponimet perifrastike të vjela në terrenet e trevës gjuhësore të Deçanit janë: TE (KU) DEL UJT (i thonë edhe Tedeli; toponim në Pllaçicë, Voksh)⁵

TE (KU) THEN QAFEN UJT (Voksh, Junik)⁶

TE (KU) DAHEN DRUMET (toponim ndërmjet fshatrave Lybeniq e Raushiq, në rrugën e asfaltuar Pejë-Deçan)⁷

KERRSHI QI QET UJ (Bjeshka e Lloçanit)⁸

TU DEL VRELLA (Bjeshkë e Gjocaj - te Juniku)⁹

KU HUP UJT (Pllaçicë-Voksh)¹⁰

GRYKA E DELUJT (Pllaçicë-Voksh)¹¹

KU DAHEN U:DHT (Pllaçicë-Voksh)¹²

PRRONI I TEDELIT (TE DEL UJ) (Pllaçicë-Voksh)¹³

² M. Halimi, pun. i cit. f. 245

³ Terminet e shënuara nën a) dhe b) këtu më lartë janë dhënë nga M. Halimi, pun. i cit. f. 246.

⁴ Shënuar nga Selim Delia, plak 80 vjeç nga Pobergja, më dt. 20.04.2002.

⁵ Shumë toponime perifrastike të fshatrave të komunës së Deçanit i shënoi dr. Jusuf Osmani, në librin «Vendbanimet e Kosovës, Peja dhe Deçani, nr. 11», Prishtinë, 2004, f. 287, 304, 333.

⁶ Shënoi M. Halimi, pun. i cit. f. 246

⁷ Shënoi autori (B.M.) më 27.04.2002 nga 2 pleqtë e Lybeniqit: Haxhi Shabani, Shaban Avdullahaj, Januz Ozmanaj.

⁸ Toponimet në fusnotat (8,9,10,11,12,13,15), janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

⁹ Toponimet janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

¹⁰ Toponimet janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

¹¹ Toponimet janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

¹² Toponimet janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

TE (KU) I KAPSHIN TAREÇT (Ratish i Poshtëm)¹⁴

TE (KU) PERPIQEN PRROJET (TE URAT E KOZNERIT, ndërmjet Bjeshkës së Deçanit, Bjeshkës së Baballoçit dhe Pleçes së Isniqit-Bellesë së Balaj; Te Centrali elektrik)¹⁵

KU (TEK) PERPIQEN DRINI E BISTRICA (fshati Grobonicë-Klinë)¹⁶

KU PERZIHEN LUGJET (fshati Bec-Gjakovë)¹⁷

TEK FLËN ÛJT (P.Plluzhinë)¹⁸ etj.

Në katundet e të folmes së Deçanit (ku duhet të përfshihen të gjitha katundet e Rekës – Reka e Gjakovës) përdorshin dendur disa toponime perifrastike figurative, që paraqesin vend të imagjinuar, të largët e të pacaktuar, por koncepti figurativ dhe semantik i tyre është i qartë dhe i kuptueshëm, sado që në shtresat kuptimore të tyre, gjuha figurative «gjuha e fshehtë» ka shprehjen kryesore në këtë tip toponimik perifrastik. Toponime të tilla në këto anë janë hasur edhe këto:

TE (KU) HA UKU MZO:R (Pozhar-Deçan),

KU (TE) FTOFEN KUALT (Pozhar-Deçan) dhe

TE (KU) BREN MIZA HEKUR (Pozhar-Deçan)¹⁹

Toponimi perifrastik figurativ «TE (KU) HA UKU MZO:R»²⁰, paraqet një vend të pacaktuar qartë, por të rrezikshëm. Paraqet një vendbetejë gjatë luftës, ku mund të vriten shumë ushtarë, ndaj është shprehur figurativisht vendi i rrezikshëm-fronti; uku (ujku)- armiku, që «HA MZOR» «që vret ushtarë, djem të rinj në vijën e parë të frontit».

«KU (TE) FTOFEN KUALT» është toponim perifrastik figurativ që emërton po ashtu një vend të pacaktuar, por etimologjikisht të kapshëm e të qartë, me kuptimin figurativ: «vendi ku mblidhen burrshtetasit e shteteve pas luftëtarëve për bashkëbisedime e marrëveshje, për t'i vënë kufijtë e një qyteti, krahine a shteti» ose, ka edhe kuptimin tjetër: «I forti, ai që ka krahë, ka miq, ka para e imunitet, ka përkrahje dhe është i mençur, vendos gjithmonë në dobi të tijën dhe nuk merr vesh për të ligun, për atë që ka pak forca ushtarake»... etj.

¹³ Toponimet janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

¹⁴ Shënoi autori (B.M.) nga Asllan Rexhepi - Hasanaj, 65 vjeç, në Ratish të Poshtëm, më 21.04.2008.

¹⁵ Toponimet janë shënuar në fshatin Pobergjë, më 20.04.2002, nga informatorët: Selim Delia, 83 vjeç, Abaz Hadërgjonaj, 84 vjeç, Bilall Hadërgjonaj, agronom, 57 vjeç; të gjithë banorë të fshatit Pobergjë (Voksh i Ri) të Deçanit.

¹⁶ Shënoi autori nga Skënder Sejdiqaj, në Grobonicë, më 12.03.2007.

¹⁷ Skënder Hoxha, **Beci i Dushkajës** (monografi), Pejë, 2013, f. 28.

¹⁸ Hasan Kelmendi, Rreth emërimit dhe përbërjes strukturore të toponimisë së lokalitetit të Turiçevcit dhe të fshatrave përreth, «Onomastika e Kosovës», Prishtinë, 1979, f. 297.

¹⁹ Këto të tri toponime perifrastike figurative i kam shënuar në muajin maj të vitit 1978, nga pleqtë e fshatit Pozhar: Musli Berisha, 63 vjeç; Shefqet Riza, 62 vjeç; Ramë Kadria, 75 vjeç.

²⁰ Zanoret e gjata në këtë punim i kam shënuar me dy pika (:).

Toponimi perifrastik «TE (KU) BREN MIZA HEKUR» paraqet figurativisht një vend shumë të largët, të panjohur; një vend të frikshëm e të rrezikshëm që kuptohet fare pak edhe etimologjikisht. Ky vend paraqet ferrin e vërtetë.

Toponime të tilla perifrastike figurative, si këto që u paraqitën më sipër, janë shumë të rralla dhe mund të përdoren në mjedise të caktuara shoqërore bashkë me ndonjë «mesele» a «fjalë të urtë» popullore me kuptime figurative si «gjuhë e fshehtë». «Meseletë - Rrotllat» janë tregime popullore alegorike të moçme ose të formuara që, pas paraqitjes së drejtpërdrejtë, shprehin kuptim domethënës. Por në këtë punimth nuk do të trajtohet gjuha e fshehtë e «Meseleve»-«Rrotllave» të përdorura dikur aq dendur në odat e njohura të këtij terreni, por këtu u fol për këto tri toponime perifrastike që janë të rralla e që paraqesin vërtetë, në mënyrë të fshehur, mençurinë e popullit të kësaj treve. Këto toponime perifrastike kanë formën e fjalëve të urta popullore që dalin nga “rrotllat” - «meselet», duke emërtuar kështu një vend të pacaktuar, që nënkuptohet se ai vend mund të gjendet kudo, por të folurit është bërë i figurshëm dhe kthehet nga një mjet i drejtpërdrejtë kumtimi në një mjet arti me fuqi të madhe shprehëse, ku dallohet shkoqur ngjyresa artistike emocionale.

Sipas strukturës gramatikore pjesa më e madhe e emërtimeve të llojit perifrastik kanë radhitjen parafjalë + folje + emër.

Parafjalët më të shpeshta vendore të këto toponime janë: te, tek, tuk, ku, në, kah, që kryesisht janë në funksion të plotësve të vendit, ndaj tregojnë vendin, kahen apo orientimin, ku kryhet një veprim apo ndodh një ngjarje. Në raste të rralla hasim përdorimin e dy parafjalëve njëra pas tjetrës, p.sh.: TE (KU) HA UKU MZO:R, që në këtë rast, edhe nëse heqim njëren parafjalë nuk dëmtohet aspak tërësia semantike e toponimit perifrastik në shqyrtim.

Folja në këto toponime përdoret kryesisht në kohën e tashme dhe në të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore. Kjo do të thotë se këto toponime nuk janë të vjetra. Foljet e këtij tipi toponimesh janë në numrin njëjës të vetës së parë dhe të tretë, por hasen toponime edhe me folje në numrin shumës. Te disa nga këto toponime mund të dallohen qartë diatezat foljore veprore dhe pësore.

E tashmja (prezenti) dhe e kryera e thjeshtë (aoristi) të këto toponime kanë për qëllim të tregojnë veprimet e kryera brenda një periudhe kohore të shkurtër ose për të treguar veprimet e përsëritura në të tashmen dhe në të ardhmen.

Emrin, si pjesë përbërëse të strukturës gramatikore të toponimeve perifrastike, në shumë raste e hasim në numrin njëjës, në trajtën e shquar të emrave, p.sh.: TU (KU) DEL VRELLA etj., por në këto toponime emri del edhe në numrin shumës, si p.sh.: KU FTOFEN KUALT, KU KCEJN DRANGOJT, TE DAHEN DRUMET etj.

Vlen si rregull i përgjithshëm i këtyre toponimeve ndërtimi me parafjalë + folje + emër, por te toponimet perifrastike të zgjeruara apo të përbëra, haset renditja strukturore: emër + lidhëz vendore (ku ose tek) + folje + emër në emërore + emër,

që mund të shërbejë si atribut i gjinore për të treguar përkatësinë e tyre, p.sh.: LIVADHI KU I LADROJSHIN KUALT E SHAL'S,²¹ etj.

Haset edhe një tip tjetër i toponimeve perifrastike që janë toponimet e njëfjalësuar: TEDOKETMULLINI,²² që sipas të dhënave, është njëfjalësuar plotësisht në gojën e banorëve të katundit Gmicë të Gollakut dhe që është i formuar nga parafjala te + folja doket (duket) dhe emri mullini. Ngajshëm me këtë është edhe toponimi KUVRADULI²³ (Vendi ku është vrarë Duli), i njëfjalësuar në një fjalë, pra në një toponim të vetëm perifrastik që është i përbërë nga parafjala vendore ku + folja vra dhe emri vetjak Duli.

Toponimet perifrastike të zgjeruara dhe të përbëra u paraprijnë toponimeve të tipit sintagmatik që tregojnë gjendje statike të toponimeve në fjalë. Këto toponime mund të hasen në formën dygjymtyrëshe: LIVADHI GA:T, LUGI BUTAJ (Pozhar-Deçan),²⁴ trigjymtyrëshe: TU VERRAT BINEQ (Llukë e Epërme-Deçan)²⁵ dhe shumëgjymtyrëshe: TE KERRSHI ME BÖTH N UJ (Deçan).²⁶

Toponimet perifrastike, siç shihet nga shembujt e sipërhënuar, kanë mundësi thjeshtimi, sepse krahas tyre hasen edhe toponime sintagmatike ku mungon folja, si p.sh.: TE VORRI KOL'S (Llukë e Poshtme - Deçan), TU KRONI ZEK ADEMIT (Deçan)²⁷ etj.

Toponimet sintagmatike janë emërtime më të reja që përdoren nga një numër i caktuar banorësh të një vendi. Për këtë arsye ato nuk janë toponime stabile, nuk kanë «vizën» e toponimit, prandaj disa sosh mund të thjeshtohen e të detoponimizohen, të zhduken apo të aglutinohen, siç konstaton gjuhëtari ynë Mehmet Halimi.²⁸

Toponimet perifrastike janë ndër emërtimet më të reja të një vendi që kanë një rëndësi të madhe për studimin e dukurive fonetike, morfologjike, sintaktike e leksikore të trevave të ndryshme, ku flitet gjuha shqipe. Përpos peshës së tyre dialektore, këto toponime janë me interes të veçantë edhe për onomastikën, sepse e pasurojnë toponiminë e një vendi me emërtime të reja. Për këtë arsye, kujtoj, është e nevojshme vjelja e këtyre toponimeve në terrenet e të folmeve të shqipes si dhe studimi më i thelluar i tyre.

²¹ Shënoi autori më 21.04.2008 në Ratish të Poshtëm nga Asllan Rexhepi, banor i këtij fshati, i moshës 65 vjeç.

²² Zijadin Munishi, Mbi tipet dhe mbi disa veçori të strukturës leksiko-gramatikore, në «Onomastika e Kosovës», Prishtinë, 1979, f. 323.

²³ Hasan Kelmendi, Rreth emërimit dhe përbërjes strukturore të toponimisë, në «Onomastika e Kosovës», Prishtinë, 1979, f. 293.

²⁴ Toponimet nën fusnotën 24,25 dhe 26 i shënoi autori në muajin tetor të vitit 2005, në fshatrat Pozhar, Llukë e Deçan.

²⁵ Toponimet i shënoi autori në muajin tetor të vitit 2005, në fshatrat Pozhar, Llukë e Deçan.

²⁶ Toponimet i shënoi autori në muajin tetor të vitit 2005, në fshatrat Pozhar, Llukë e Deçan.

²⁷ Shënoi autori në muajin tetor të vitit 2005, në fshatrat Llukë e Poshtme e Deçan nga pleqtë e këtyre katundeve.

²⁸ M. Halimi, pun. i cit. f. 249.

HAJRIP KOÇINAJ**TOPONIMIA E FSHTATIT BLAÇ TË OPOJËS**

Blaçi është një nga tetëmbëdhjetë fshatrat e Rrethinës së Opojës, të komunës së Dragashit. Ka shtrirje gjeografike sipas tipit të mëhallëve: Mahalla Eporme, Mahalla Poshtor (Poshtme) dhe Priftja. Priftja ka qenë një lagje më vete, ose më mirë të thuhet ka qenë fshat më vete, por, më vonë, u bashkua me dy lagjet tjera të Blaçit. Kjo gjë vërehet lehtë nga mënyra e ndarjes territoriale të fshatit të sotëm. Dy lagjet e emërtuara si mahallë edhe sot e kësaj dite e kanë Bjeshkën dhe Fushën të pandarë dhe i kullosin bagëtitë bashkë, kurse Priftja ka territor të caktuar në bjeshkë, fushë e deri vonë edhe në ujëra e burime të tjera. Sot fshati funksionon si tërësi administrative. Blaçi ka 9.68 kilometra katrorë dhe është i treti për nga madhësia në gjithë rrethinën e Opojës. Ai, për nga territori, vjen menjëherë pas fshatrave Bresanë (Brodosanë) e Zaplluxhe. Ka një numër të madh të toponimeve dhe ne do të përpiqemi ta japim atë sa më besnikërisht sipas rendit alfabetik. Dhe sipas mënyrës si i shqiptojnë vendësit.

TOPONIMET

AHISHTA BJESHKOS – vend me dru ahu në bjeshkë.

ARA HYSOS – pronë toke e blerë nga Hysa.

ARA SHEHIT – një nga pjesët e shumta të arave të Shehit të Blaçit.

ARA TE LITHIA – arë afër një pllaje të mbushur me dru lajthie. Sot e lënë livadh.

ARAT E BJESHKOS – pjesë e veçantë në Bjeshkën e Blaçit ku shtriheshin ara që mbilleshin kryesisht me prodhime që e përballojnë lartësinë mbidetare (tërshërë e thekër). Sot këto ara janë djerrina ose të mbjella me jonxhë a bar për blegtorinë.

ARAT E GATA – ara të holla e të gjata rreth rrugës.

ARGAÇI DHENVE – vend i veçantë te Guri Grihos ku kanë fjetur dhentë. Edhe sot gjenden gjurmët e mureve të tij.

ARRA SHEHIT – një nga të paktat arra në fshat. Është emërtuar sipas klerikut fetar sepse ka qenë e njohur për frutat e saj dhe për vjetërsinë. Ka qenë rrëzë lëmit të shehit.

BAZËNI – vendi ku grumbullohet uji para se të shpërndahet në familjet e fshatit Blaç.

BENDI – vend ku bujqit e kanë zënë xholin për të ujitur tokat. (Xholi është pendë e thjeshtë me anë të së cilës mblidhet uji i cili pastaj përcillet përmes një vije deri te tokat e mbjella për t'i ujitur).

BOTZA KUÇE – ara me dhe të kuq mbi rrugën kryesore në të dalë të fshatit Blaç në rrugën për Bresanë (Brodosanë).

BREGI – bregore e veshur me dru. Në pjesën me të madhe mbizotëron druri i lajthisë, por ka edhe dru verri, rakite e ahu.

BREGI KOÇINAJVE – një pjesë e Bregit pronë e fisit të Koçinajve të fshatit.

BRESHNJA – vend në shpati me kaçuba.

BRESHNOST – vende kaçubash me dru ahu e shkurre.

BRIJA – bregore që i rri anash Priftos (lagje në fshatin Blaç).

BRIZA – bregore që është prapa shtëpive të fisit të Koçinajve dhe Dautajve nga ana e veriut. Është si mburojë.

BUNARI LIKËNIT – pus në Likë. Likëni është një lëndinë në Shtav' të Blaçit. Aty është një pus që shërben për të pirë ujë bujqit që punojnë tokat në atë pjesë. Këtë pus e përdornin dhe blegtorët për bagëtitë e tyre. Sot pusi nuk ekziston, po vendi ku ka qenë identifikohet lehtë në bazë të gjurmëve dhe murit të rrethojës së tij.

BUXHAKI – një vend në drejtim të Lisit të Madh mbi Livadhet e Shpatllës ku ka disa prona të fshatarëve. Vendi është një luginë (lugshtajë, - sipas të folmes së vendasve) në të hyrë të pjesës me dru lajthie. Te Buxhaki është edhe një rrugë e ngushtë që të çon në drejtim të Lisit të Madh.

BUZATICA – livadhe afër Luginë Vathit.

ÇALIJAT – arë e mbjellë me dru bredhi të bardhë. Në Opojë druri i bredhit të bardhë emërtohet si çali.

ÇUSHIZA – vend që ka pasur dru qershie.

DARDHA DAUTIT – dardhë.

DULLIJAT E SHPESHA – vend me dëllinja në një shpat të Shtavos.

DUSHKI RRÂ°ZAVE – vend në pjesën e Blaçit në kufi me Zgatarin.

FËRRAT E TEZOS MIR' – ferra të njohura për frutat e kaçës afër arës së një bije (vajze) të Priftës.

GARDHI – vend përtej Pazhikit nën Xhollzat nga ana e territorit të Priftos.

GAVRA GAÇOS – zgafelle në pjesën e Gurit të Blaçit e hapur sa një dhomë. Është një e çarë shkëmbi e gurëve gëlqeror në formë të harkore si një kube në shpatin e Gurit. Në Opojë gavër i thonë birës a vrimës.

GAVRA UKIT – edhe **GAVRA ZEZ'** (anash Gavros Gaços) - gavor (birë) e zezë e hapur në formë të rrumbullakët në shkëmbin gëlqeror anash Gavrës së Gaços.

GROPA – gropë te Luginë Vathit.

GROPA KILIKEROS – gropë në një shpati mali. Emërtimi Kilikere nuk dihet se nga ka ardhur. Pleqtë nuk japin ndonjë sqarim dhe kuptimisht është i paqartë.

GROPA KINDLAVE - edhe **GROPA KINXHAVE** – gropë që e ka marrë emrin nga disa barishte të buta, të gjata e të varura si tuba të vogla që në Opojë quhen kindla. E njëjta gropë quhet edhe *Gropa e Kinxhave* pasi shpeshherë qengjat e blegtorëve kur janë lodhur nga terreni i ashpër i kullotave kanë mbetur aty.

GROPA SINANIT (i thonë Zaplluxhja); Gopa Kasâ°mit (-i thonë Blaçi) –gropë e madhe.

GROPA UJIT – gropë e madhe në Likë (pjesë e Shtavos së Blaçit) në të cilën mblidhen ujërat e pranverës a vjeshtës së vonë.

GROPA XHOLLZOS – te Gropa Esatit. Gropë në Shtav' në pjesën e Mahallos Poshtor.

GROPAT E KIKIT – një vend afër Kikit (Kik në Blaç i thuhet një vendi në formë çuke) që ka një rrafshinë e cila i ka dy gropa të mëdha me gjasë të formuara nga shpërthimet vullkanike.

GROPAT E LIKËNIT EPORM – gropa në pjesën e Likënit të Eporm të mbushura me shkurre dhe me fierishte. Disa prej tyre kanë edhe kullota në të cilat kullosin bagëtitë.

GRYKA – vend te Dushki i Grykos Shehit. Grykë me një dushk të vjetër dhe shumë të madh.

GRYKA SHEHIT – grykë në të dalë të Shtavos së fshatit Blaç. Në të dy anët e saj ka bregore kurse mes tyre është rruga.

GURI DASHIT – gur i madh afër *Prrojti Dashit*, në pjesën e bjeshkës dhe në kufij me Bresanën.

GURI DUDUMIT – gur (shkëmb) në faqen e Gurit të Mahallos Poshtor.

GURI DHELPNOS – gur (shkëmb) në të cilin janë parë dhelpra.

GURI I GRIHOS – gur në Bjeshkën e Blaçit që ka shërbyer për të bërë griha për mprehjen e kosoreve.

GURI KAKARAJE – gur (shkëmb) rreth një hektarë që është i shtrirë në arat e pronat e fisit të Kakarajve (Kakarajt janë fis në fshatin Blaç). Sot këto prona janë ara që mbillen me thekërishte.

GURI I KORBIT – gur në Bjeshkën e Blaçit me shtrirje të madhe në të cilin rrinë korbmat dhe zogjtë tjerë.

GURI MAHALLOS POSHTOR – shkëmb me gurë gëlqeror i veshur me dru dëllinje që Mahallos Poshtor i rri prapa nga ana e Veriut si mburojë. Ka lartësi rreth 150 m. mbi sipërfaqen e rrafshët të lagjes. Maja e shkëmbit është Kiki.

GURI MATH – gur i thepisur rreth dy metra i gjatë që gjendet në udhën Mahalla Poshtër - Shtav'. Këtu fëmijët e lagjes luajnë lojëra të ndryshme për të shfaqur shkathësitë e tyre të shënjzimit. Në majë të Gurit të Math vihet një gur tjetër dhe fëmijët e qëllonjë atë deri sa fituesi i garës e rrëzon nga vendi.

GURI MAXHYPIT – gur nën Gurin e Dhelprës nga Livadhi i Shpatllos. Emrin e ka marrë nga prona e “maxhypit” afër gurit. Maxhup ka pasur në fshatin Blaç deri në vitet 1960. Pas kësaj kohe ata i kanë shitur pronat e tyre dhe janë vendosur, kryesisht, në qytetin e Prizrenit. Ato prona i kanë ruajtur emrat e tyre deri në ditët e sotme. Edhe Guri Maxhypit tregon pronën afër këtij guri që ka pasur pronari rom (maxhypi).

GURI MEMOS – gur (shkëmb) afër Aros Memos. Ky gur e ka marrë emrin nga pronari i parcelës së tokës sipas pronarit. Sot Arën e Memos e ka një pronar tjetër, por ara e ka ruajtur emrin e vjetër dhe si të tillë e njohin të gjithë fshatarët e Blaçit.

GURI MINOS – gur që gjendet ndërmjet Lugit Vathit dhe Kujzave. Guri nuk është shumë i madh, por shërben si shenjë dalluese e vendit në të cilin ndodhet. Emrin e ka marrë nga pronari që e ka pasur arën aty afër.

GURI MISINIT - te ky vend fshatarët kanë nxjerrë gur për ndërtimtari. Ishte një tip miniere që u shërbente atyre që ndërtonin shtëpi për ta nxjerrë lëndën e parë.

GURI PRIFTOS (Guri Rados) – pjesa e shkëmbit gëlqeror (Guri) që i rri prapa Priftos.

GURI SKEÑERIT – gur i madh dhe i dallueshëm mbi Mahallâ°n Epor. Të rinjtë e lagjes ritet e festave të motmotit që lidhen me paganizmin i kryejnë te Guri i Skeñerit. Aty i thyejnë vezët e Verzës, ndezin zjarret për Verzë e Shëngjergj etj.

Vërejtje: Në vitet 1950-1960 kur në këtë pjesë të Kosovës kishte shumë struktura serbe të pushtetit të atëhershëm të Rankoviçit, njëri prej tyre, Zhivki, shpesh i ka provokuar fshatarët për autoktoninë e tyre. Ai i paskësh pyetur pleqtë e fshatit se kur kanë ardhur nga Shqipëria në Opojë dhe të gjitha përgjigjet e tyre i paskësh mbajtur shënim. Kur e kishte pyetur Rakip Dautin, te Oborri i Xhamisë së fshatit në prani të xhematit për këtë gjë, ky i kishte thënë:

- A po shohish çat gurin e math mi Mahallâ°n Epor?
- Gurin e Skeñerit a? –pe sho, -kishte thënë Zhivki.
- Kur kemi ardh na, çaj Guri Skeñerit s’o kâ°n hiç! –ia kishte kthyer plaku.
- Plak i mençâ°m axha Rakip, -i paskësh shpëtuar fjala Zhivkit.

(Tregoi Mehmet Koçinaj, -plak 80 vjeç në vitin 1994)

GURI STEPOS – shkëmb ndërmjet PONIKIT e RRIHNAVE (Për Ponikin dhe Rrihnat shih te sqarimet për toponimet përkatëse.). Që nga këtu shihet një pjesë e Fushës së Prizrenit. Kur fshatarët e Blaçit shkojnë për dru, ndalen dhe pushojnë te ky gur dhe kënaqen me pamjet të cilat shihen nga këtu.

GURI VOGOL – gur i dalë dhe i veçantë në rrugën Mahalla Poshtor-Shullâ°. Te ky gur fëmijët luajnë (shih te Guri i Math) me lojëra popullore të ndryshme me gur e me rrasa. Sot ky gur nuk ekziston pasi më 2013 është zgjeruar rruga dhe me këtë rast i njëjti është mbuluar nga zhavori.

GURI XHËMAUJIT (kufiri me Zgatarin) – gur i rrafshët dhe me një gropë që mban ujë. Kur gropa mbushet uji rrjedh nëpër të çarat e tij dhe duket se po gjëmon.

GURTHI – pjesë e arave te Shtava. Arat në këtë vend janë në një bregore të vogël që nuk kanë tokë të bollshme dhe janë me gurth të vegjël gëlqeror. Nga gurët që kanë këto ara, fshatarët, krejt pjesën e kanë quajtur Gurthi. Në këtë pjesë janë rreth 20 ara. Ato sot janë djerrina ose disa mbillen me prodhime bujqësore si gruri, thekra, tërshëra a elbi. Po mbajti pranverë e lagësht këto ara japin prodhime të bollshme bujqësore, në të kundërt, nuk japin bereqet të bollshëm ose prodhimi dështon plotësisht nga thatësia.

GURRA MADHE (te Guri mbi Prifte) - burim uji që gjendet rrëzë Gurit mbi Prifte. Këtu fshatarët, para se të instalohej rrjeti i ujësjellësit, mbushnin ujë për nevojat e familjeve.

GURRA MIFTARIT – burim uji te Livadhet e Bjeshkës së Blaçit. Emrin e ka marrë ngaqë gurra që gjendet anash pronës së Miftarit. Sot është kyçur në rrjetin e ujësjellësit të fshatit dhe prej saj ka mbetur vetëm një gyp që e përcjellë tepricën e ujit. Gurra është futur në ujësjellës në vitin 1970/1975

GURRA RRIHNOS – burim uji në Rrihna. Burimi gjendet në territorin e Blaçit kurse krojet në territorin e Libeçevës. Burimin e kanë shfrytëzuar gjithmonë fshatarët e Blaçit për bagëtitë e tyre gjatë kohës së drekës, kur në këtë kohë flenë bagëtitë.

GURRA SHEFKIS' – burim uji te Arat e Bjeshkos. Emrin e ka marrë se është pranë arës që ka qenë pronë e Shefkis'. Sot është kyçur në rrjetin e ujësjellësit të fshatit.

GURRA SHEHIT – burim uji mbi Livadhet e Shpatllos. Është burimi më i madh i ujit në fshatin Blaç. Emrin e ka marrë sipas pronarit të arës ku buronte uji. Shehi i Blaçit e ka pasur arën dhe në mes të saj ka qenë gurra. Sot Gurra e Shehit është futur në rrjetin e ujësjellësit të fshatit.

GURRA VOGOL (te Livadhot mbi Prifte) – burim uji te livadhet e Priftos. Është quajtur Gurra e Vogël për ta dalluar nga Gurra e Madhe që ka e njëjta lagje përtej lumit. Dy gurrat ndahen nga njëra tjetra nga lumi aty.

JAZI MULLINIT AJETIT E DAUTIT – vija e ujit për mullinjtë e Priftos. Gjurmët e tij ende janë rreth Lumit të Blaçit dhe ato shkojnë deri te rrënojat e mullinjve.

JAZI MULLINIT SHEHIT – vijë që e çon ujin në mulli. Jazi është i gjatë rreth 300 metra dhe gjurmët e tij janë të dukshme edhe sot.

JAZI MULLINIT ZYBERIT – një nga vijat e ujit të mullinjve të Priftos. E ka marrë emrin nga pronari i tij.

KAÇZA – në të dalë të Mahallos Poshtor, vend me kaçubat me ferra dhe që jepnin shumë fruta të kaçave.

KAJNAKI LUXHZOS – burim uji në një lugshajtë.

KAJNAKI MI MAHALL – burim uji mbi Prifte.

KIKI – maja e një shkëmbi gëlqeror që i rri anash si mburojë nga Veriu Mahallos Poshtor. Nga këtu shihet pjesa më e madhe e Opojës dhe fshatrave të saj. Kik në Opojë i thonë majës së bjeshkës; çukës. Kjo pjesë ka qenë e zhveshur nga bimësia por më vonë aty kanë mbirë dru dëllinje, shkurre, dru murrizi e thane. Kiki është pikë e bukur e Mahallos Poshtor. Ai është edhe kufiri që ndanë Blaçin me Zgatarin.

KODRA (te Lugi Vathit) – pjesë e dalë si kodër që fillon pasi të kryhet bregorja që e formon një rën anë të Lugit të Vathit. Kjo pjesë përbën një pjesë të mirë të arave të asa ane. Këto ara kanë qenë të njohura për prodhimet bujqësore që i kultivonin vendasit: të patates, misrit, fasules, elbit, tërëshërës, thekrës e grurit.

KODRA POLAKIT – kodër në Shtavë më e theksuar se sa kodrat tjera të kësaj pjese në të cilën qëndronte roja e arave dhe pronave të fshatarëve. Polaki qëndronte këtu dhe me sy ose, më vonë, me dylbi vëzhgonte ata barinj bagëtitë e të cilëve bënin dëme në arat e fshatit.

KODRA SHERIT – kodër në Shtavë nga e cila shihet një pjesë e qytetit të Prizrenit. Këtu njerëzit kur kanë shkuar në Prizren ose kur janë kthyer kanë pushuar dhe kanë ngrënë pak bukë e kanë pirë ujë. Nga që shihet qyteti i Prizrenit e ka marrë emrin Kodra e Shehrit.

KOSHARISHTA – ara e livadhe në formë bregoreje, nëpër medzhët e të cilave ka thupra lajthie dhe nga të cilat fshatarët kanë bërë kosha për t'i mbushur me tutla bari. (Tutla e barit është një racion lope, kau a viçi.).

KREVI UDHOS SHTAVOS – udhë që të çon për në Shtavë'.

KROI – Gjendet në rrugën Blaç-Bresanë nën udhë dhe mbi Varrezat e Halitajve. Sipas besëtytnive banorët e Blaçit dhe ata që janë ndalur për të pirë ujë këtu kanë besuar se për të pasur udhë të mbarë, shëndet dhe jetë të gjatë “kush pi ujë në këtë

krua duhet ta ñuk (ta këpus) një pe nga rrobat e veta dhe ta lë në një vend në formë dritare a frenxhie mbi lëfytin e kroit. Peri i këputur nga rroba e atij që pi ujë duhet të jetë mundësisht i kuq, por në mungesë të tij mund të jetë edhe i gjelbër, i kaftë, i kaltërt a i bardhë. Po u këputën dhe u lanë tre penj me ngjyra të ndryshme dobia është më e plotë. Me këtë rast është thënë edhe një lutje e thjeshtë: *Pe lâ° çet pë por udh' t'mar, por shñet e por jet'!*

KROI I DHELPNOS –burim uji mbi Livadhet e Shtatllas.

KROI FIRIÇIT – burim uji mbi Mahallâ°n Epor, te pjesa përballë lithishtës së fshatit. Uji i tij njihet për freskinë dhe shijen e mirë.

KROI HALILIT – burim uji te Gryka. Ky ujë është i yndyrshëm dhe e përdorin për pije vetëm bagëtitë. Nuk ka shumë ujë, por rrjedh edhe në kohën e pikut të vapës dhe të stinës së verës. Xhevdet Koçinaj e ka bërë krua por brenda një sezoni të dimrit e ka shkrirë pjesën metalike të lëfytit. Për këtë arsye tash lëfyti është zëvendësuar me gyp plastike. Ky fenomen ka ndodhur me gjasë nga prania e reaksioneve kimike që kanë ndodhur mes lëfytit të metalit dhe ujit që përmban ndonjë element kimik gërryes a shkrirës.

KROI HYSOS – burim uji nën Likënin e Eporm te Shtava. Sot është krua dhe bagëtitë e Mahallos Poshtor pinë ujë kur kthehen pasdite nga kullotat për në shtëpi.

KROI MAHALLOS – krua në mes të Priftos. Uji i tij vjen nga Kajnaki Mi Mahall' dhe nga Bazëni Blaçit. Kroi përdoret për pije nga bagëtitë e Priftos.

KROI MALIT – gjendet te Lithishta e Blaçit në anën nga Zaplluxhja. Sipas besimit të plakave të vjetra, uji i këtij kroi, e rrit “tuñmon e tlynit” kur e tund flinin me të. Për këtë arsye ato shpeshherë kanë marrë ujë për ta përdorur ujin e Kroit të Malit kur kanë tundur. Rruga nga fshati deri te Kroi i Malit ka zgatur rreth një orë në këmbë. Më 2013 ky krua është ndërtuar nga Xhevdet Koçinaj me material të fortë dhe funksionon si krua me një lëfyti të mbushur plot me ujë.

KROI ME RRASA – burim uji në Bjeshkë.

KROI MISINIT – krua te Mahalla Epor mbi oborrin e shkollës. Në këtë krua pinë ujë bagëtitë e kësaj mëhale kur lëshohen në kullotë.

KROI RAKIPIT – burim uji te Livadhet e Priftos.

KROI SHKUPIT – burim uji në Bjeshkë 400-500 metra më lart se Kroi me Rrasa. Burimi është mes ahishtave prandaj pëlqehet nga fshatarët se ka shije të mirë dhe është shumë i ftohtë në sezonin e verës.

KROI SHLLAKIT – burim uji në anën e Blaçit në drejtimin nga Bresana. Shllakët janë fis i Bresanës.

KUJZA – vend mbi pjesën e Lugit Vathit në të cilin shtrihen ara e livadhe. Anës arave e livadheve ka dru lajthie, rakite e ahu që fshatarët i shfrytëzonin për të bërë kunja për vegla pune bujqësore. Këta kunja i bënin ose në vjeshtë ose në pranverën e hershme.

KUMLLA HAJRATIT – kumbull te Udha e Shtavos.

KURTI I TEÇOS – pjesë are para Tyrbos Blaçit të cilën e shfrytëzonte familja e Shehit.

LAKI – vend ku udha e lumi kanë një lakesë në të njëjtin vend në kufi me Zgatarin. Është pika e kufirit mes dy fshatrave Blaç e Zgatar. Ka dhe një bestytini të përhapur nga banorët e këtyre anëve se pikërisht te Laki, sidomos natën e vonë, rri

“qoftëlargu me të vetët”. Nga kjo gjë banorët e dy fshatrave sa të jetë e mundur u ikin udhëtimeve në orë të vona në këtë pjesë, -sidomos udhëtimeve në këmbë.

LAKNAT E BARDHA - vend nën Vanë e Mullinit Ajetit.

LÂ°MA IBISHIT – lëmë të cilën e shfrytëzonin fshatarët për të shirë dhe për ta nxjerrë drithin nga kallinjë.

LÂ°MAT E PRIFTOS (PAZHIKI) – lëmenj ku kanë shirë të lashtat.

LIKËNI – parcelë e madhe lëndine e rrethuar nga arat e fshatarëve. Ka kullota që i shfrytëzojnë bagëtitë e Mahallos Poshtor. Në mes të Likënit ka qenë një pus gjurmët e të cilit shihen edhe sot. Emrin e ka marrë se në afërsi të tij është një gropë e cila thuhet të ketë qenë liqen. Kjo gropë (Xhollza) në pranverën e hershme mbledh shumë ujë dhe shpesh pronarëve të arave aty u duhet të mbjellin më vonë se të tjerët sepse janë të detyruar të presin shterrjen e ujërave.

LIKËNI EPORM – lëndinë larg rreth dyqind metra nga Likëni. Anës ka gropa, po njëra është më e madhe dhe thuhet të ketë qenë liqen.

LIKËNI GARIPIT – gropë në Shtavon e Priftos. Sot është pronë e Garipit. Nga këtu e ka marrë edhe emrin. Thuhet të ketë qenë një nga liqenet e shumta të Shtavos së Blaçit.

LINISHTA KOÇINAJVE – vend mbi shtëpitë e fisit të Koçinajve në drejtim të Mahallos Epor.

LINISHTAT – vende të mbjella dikur me li.

LISAT E RRIHNAVE – lisa shumë të mëdhenj.

LISI MADH – lis shumë i madh ahu te lithishtat e Blaçit mbi Mahallâ°n Epor. Krejt ajo pjesë është me dru lajthie ndërsa lisi është i vetmi dru i madh që mbizotëron mbi pyllin; bresanast që e kanë afër kufirit të tyre i thonë LISI SHIPOS. Është nja 150 metra mbi Kroin e Firiqit.

LISI MATH – ka qenë në dalje të Rrihnave nga ana e Priftos. Ky lis ka qenë shumë i madh dhe është përdorur si shenjë dalluese në Shtavâ°n e Blaçit.

LITHIA PRIFTOS – pjesë me dru lajthie nga Priftja në kufij me Zaplluxhën. Parcelë që i ndan varrezat e Zaplluxhës me pronat e priftjanve.

LITHISHTA – pjesë e fshatit Blaç me dru lajthie në drejtim nga Bresana. Në këtë pjesë ka shumë pak prona private.

LIVADHI BEGIT – nën udhën prej Priftos deri në kufij të Zaplluxhës. Ky livadh sot është ndarë në shumë pjesë, por më herët pleqtë e mbajnë mend si një tërësi dhe thonë se Kukli Begi ua paska dhënë priftjanëve si dhuratë për bindjen dhe besnikërinë e treguar në raport me të.

LIVADHI BULLIT – livadh afër Lugit Vathit.

LIVADHI CENOS (përtej Xhollzave) – livadh.

LIVADHI DUROS (te Bazëni Medos) – livadh.

LIVADHI HUPOS – livadh në krye të Mahallos Epor.

LIVADHI KASOS (kufiri me Bresanën) – livadh në rrugën kryesore që lidh fshatrat Blaç e Bresanë. Kjo pikë e shënon ndarjen e kufirit kadastral mes këtyre dy fshatrave.

LIVADHI MAMUTIT – livadh mbi udhë në dalje të Priftos për Zaplluxhe. Emrin e ka marrë nga pronari i tij.

LIVADHI MATH – emërtimi i një pjese livadhesh që shtrihet në mes të fshatit Blaç dhe kufizohet me tri mahallët e tij.

LIVADHI MI MAHALL – livadh mbi Mahallâ°n Epor.

LIVADHI NXHÂ°M – livadhe në dalje të Mahallos Poshtor. Emrin e ka marrë nga njomësia e tij. (në Opojë *nXHâ°m* do të thotë njomë).

LIVADHI SYLOS – livadh mbi Mahallon Epor, i rrethuar me dru verri.

LIVADHI I SHPATLLOS (Bregi) – livadhe mbi Mahallâ°n Epor që shtrihen në një hapësirë bregore në formë shpatulle.

LIVADHOT E BJESHKOS – tërësi livadhesh në Bjeshkën e Blaçit. Shumë prona thirren me këtë emër për t’i dalluar nga parcelat e arave a ahishtave të Bjeshkos. Këto livadhe janë pjesë e veçantë e tokave të punuara në bjeshkë. Janë prona të rëndësishme të bujqve të cilët sigurojnë prej tyre sanën e bagëtive për sezonin e dimrit.

LUGI ISUFIT – luginë që shtrihet nga Kiki (Maja e Kikit) deri në Rrâ°za (pjesa e poshtme e shkëmbit që i rri prapa Mahallos Poshtor).

LUGI MATH – luginë që ndanë Mahallâ°n Poshtor me Priftâ°n në drejtim të Shtavos.

LUGI MEMOS – luginë te Likêni Eporm.

LUGI VATHIT – luginë në dalje të Mahallos Epor. Është shumë e theksuar, me dy shpate në të cilat ka prona arash e parcela lajthishteje.

LUXHZAT – livadhe nën Rrozhanat. Emrin e kanë marrë nga shtrirja e tyre mes tri lugjesh jo shumë të theksuara në të cilat ka livadhe e ara.

LLASKARTI – ara brenda parcelave me dru lajthie, mbi Lugin e Vathit në kufi mes Blaçit e Bresanës.

MAHALLA EPOR – mëhallë e Blaçit.

MAHALLA POSHTOR – një nga mëhallët e Blaçit.

MALI DYT – mal.

MALI PAR – mal.

MALI SHEHIT – mal në pjesën e Shtavos. Është shumë i pasur me dru dhe, edhe sot e kësaj dite, pinjollët e Shehit të Blaçit e shfrytëzojnë për të marrë dru. Ka dhe një pjesë tjetër të këtij mali që është tjetërsuar dhe e kanë në pronësi të tjerë pronarë.

MASKUJZA – pjesa prapa Kujzave. Ara e livadhe në këtë vend.

MASHNOST – livadhe me ujë e lagështi.

MEJTEPI – vend në mes të Mahallos Epor. Aty pranë ka qenë një shtëpi ku hoxha i fshatit ka organizuar mësimet fetare. Në këtë lagje ka qenë veç Mejtepi kurse xhamia ka qenë te Mahalla Poshtor. Sot vendi i quajtur Mejtep është sheshi kryesor i Mahallës Epor.

MEXHA MADHE – vend te Lugi i Vathit. Është një mezhde që është më e madhe se tjerat. Është shenjë e një vendi me të cilën njihet për dallim nga zonat tjera përreth.

MIJAZOT – ara mbi Jazin e Mullinit Shehit. Këto ara janë mbjellë kryesisht me misër, fasule a patate. Sot, një pjesë e tyre, janë të mbjella me bar, jonxhë e tërfojë.

MIVIJA – livadheve të fisit të Koçinajve që gjenden nën Vijën e Ujit që vjen nga Lumi i Blaçit dhe që shërben për ujitje.

MIZIDZA – livadhe të Koçinajve që gjenden mbi një muranë me gurë. (Në Opojë përdoret fjala *zid* për *mur*, nga këtu del edhe *mizidza* për *mbimur*.).

MLLAKA DÂ°NOS – livadh që mban llum e ujë bashkë, sidomos në kohë pranvere e vjeshte.

MOLLZA – ara nën rrugën që shkon për Zgatar. Më herët kanë qenë djerrina dhe në këto pjesë ka pasur mollë të egra që vendasit i kanë quajtur mollza, mulleza ose edhe molla t'egra. Sot aty janë ndërtuar shtëpi dhe lokale përcjellëse për to.

MORRIZE – një pjesë e hollë dizgë në dalje të Priftos për në Zaplluxhe. Vendi ka qenë i njohur për shkurre e murriza dhe nga ky shkak është quajtur Murrize.

MULLINI AJETIT – një nga mullinjtë e Priftos i emërtuar dhe i njohur, edhe sot me këtë emër, sipas pronarit të parë të tij. Sot mund të shihen vetëm pjesët e rrënojave të tij dhe themelet.

MULLINI DAUTIT – sot nuk ekziston dhe dihet vetëm vendi ku ka qenë.

MULLINI HALITIT – ky mulli ka qenë i tipit të vogël dhe u ka shërbyer vetëm Halitajve.

MULLINI KOÇINAJVE – mulli i ndërtuar nga të parët e këtij fisi pasi janë vendosur prej Vërmicës së Prizrenit në fshatin Blaç të Opojës.

MULLINI ZYBERIT – një nga mullinjtë e Priftos. Ka qenë mulli i tipit të vogël dhe u ka shërbyer vetëm familjarëve të Zyberit. Këta kanë qenë në miqësi me Koçinajt dhe këta të fundit kanë ndikuar për ndërtimin e këtij mulliri. Emrin e ka marrë sipas pronarit të tij.

MUSHTEKNA – vend mbi Mahallâ°n Epor me dru mështekne.

MUSHTEKNA (mbi Livadhin e Mamutit) – vend mbi Livadhin e Mamutit. Ka dru mështekne. Është pjesë tjetër nga vendi ku është Mushtekna si më lart. Kjo pjesë është te Priftja në drejtim të Zaplluxhës.

NORARZAT (përtej **GARDHIT**) – vend me pjesë të vogla livadhesh që gjenden nën pjesën me ara të punueshme. Nga pozita gjeografike që kanë në raport me arat e kanë marrë emrin e tyre. Në Norarza kultivohen edhe patatet, fasulet etj.

NORGARDHZA – ara e livadhe që shtrihen nën pjesën e rrethuar me gardh.

NORJAZOT – ara nën Jazin e Mullirit të Koçinajve. Arat gjenden nën jaz dhe mbi lumë në një rrip toke të gjatë e të ngushtë. Këto ara janë shumë pjellore pasi kanë ujë për ujitje dhe janë të mbushura me lym që ka sjellë herë pas herë lumi. Këto toka mbillen me misër, elb, patate, fasule, lakra, domate etj.

NORMJET DY MALOSH – vend mes Malit të Parë dhe Malit të Dytë te Shtava.

NOR-RRUGZA – ara nën rrugën e ngushtë që lidh Mahallâ°n e Poshtor me rrugën kryesore që shkon për Bresanë.

NORVIJA (në pjesën e sipërme të Mahallos Poshtor) – ara e livadhe që shtrihen nën vijën e ujitjes. Këto toka janë rreth Lumit të Blaçit ndërmjet Urës së Haxhisë (Bendit) dhe fisit të Koçinajve. Vija e ujit arrinte deri te Lëmet e Koçinajve dhe ujiste edhe bahçet e tyre.

NORVIJA - vend nën vijë, mbi Kroin e Blaçit.

OGRADJA – livadh i rrethuar me gardh (gjerdhe).

OGRADOT – ara e livadhe të rrethuara me gardhe te Mahalla Epor.

OGRADOT E PRIFTOS – livadhet e Priftos të rrethuara me gardh. Pjesë livadhesh të veçanta afër kësaj mëhale.

ORNICAT – vende të pambjella dhe që pastaj kositen me kosore për t'ua marrë barin që del vetë. Sot janë livadhe të gjitha.

OSTRIKA – ara e livadhe.

OTRINA – vende të cilat janë në pronë të fshatit ose prona të shtetëzuara.

PAZHIKI – pjesë e lëndinës (kullotë) anash Mahallos Epor ku mblidhen bagëtitë e fshatit para se të nisen për në kullota.

PLAKRUSHTA - është në krye të Llivadhit Shpatllos. Kanë qenë parcela të arave të mbjella me thekër e tërshërë kurse tash janë të mbjella me jonxhë e bar për kafshë.

PONIKI – një nga parcelat e mëdha të Malit të Blaçit. Ky vend gjendet në pjesën e Priftos dhe kufizohet me fshatrat Lybeçevë e Lez të komunës së Prizrenit. Është i njohur me rritjen e drurit të ahut. Një pjesë e tij është lëndinë e madhe e cila shihet edhe nga Shtava e Blaçit, nga Lezi, Lybeçeva e nga Prizreni. Është pjesa e vetme në të cilën kanë hise të tri lagjet e Blaçit.

POTOKI – pjesë mbi Xhaminë e Blaçit në rrugën që hyn nga fisi i Koçinajve në të cilën ka pasur ujëra që kanë rrjedhur nga Livadhi i Madh. Aty afër ka qenë edhe Topilla për të cilën kemi folur në emërtimin përkatës.

PRIFTJA – një nga lagjet e sotme të Blaçit. Nuk emërtohet si mëhallë pasi më herët ka pasur territor të ndarë nga dy lagjet tjera të Blaçit dhe është konsideruar si fshat më vete. Kjo lagje ka territor të ndarë nga dy lagjet tjera. Pleqtë i tregojnë kufijtë e kullotave, të maleve, të ujërave e të të drejtës së shfrytëzimit të tyre në raport me dy lagjet tjera që nuk kanë kufij të tillë mes vete.

PRROI – përrua që lidh vija e burime ujërash nga Bjeshka e kalon nëpër Mahallâ'n Epor. Nuk ka shumë ujë, por në vjeshtë e në pranverë ujërat e tij shtohen. Ujit bahçet e mëhallës nga kalon.

PRROI DASHIT – përrua në bjeshkën midis territorit të Bresanës dhe të Blaçit. Emërtimi i tij vjen sipas një legjende e cila thotë se aty ka ndodhur një vërshim i madh dhe si pasojë gjithë tufa e deleve është mbytur përveç Dashit të Këmborës. Vendi ku ka arritur të mbijetoj dashi ka marrë emrin e tillë. Sot është përrua e tharë që mund të ketë ujë vetëm herë pas here kur bie shi ose kur ka të reshura tjera në periudha të ndryshme kohore.

PRROI GARDHIT (e ndan Pazhikin e Priftos dhe Gardhin) – përrua që mbledh vijat e ujit të Bjeshkës në anën e Priftos. Ky përrua ndan dy tërësi të mëdha të kësaj lagje siç janë Pazhiki Priftos dhe Gardhi.

PRROI GURROS SHEHIT- përrua që mbledh ujërat e Gurrës së Shehit dhe i derdh ato te përroi i Mahallos Epor. Ngaqë Gurra e Shehit është kyçur në instalimin e ujit të fshatit Blaç sot janë veç gjurmët e këtij përroi. Gurra ka pasur shumë ujë dhe siç është thënë dhe më sipër ka buruar në njërin nga pronat e shumta të Shehit. Nga ky fakt e ka marrë edhe emrin Gurra e Shehit.

PRROI LUGIT VATHIT – përrua që ndan përmes Lugin e Vathit.

PRROI MI BRIZ' – përrua që vjen nga Udha e Shtavos mbi shtëpitë e fisit të Koçinajve dhe derdhet përreth rrugës deri sa arrinë te Lumi i Blaçit. Gjatë kohës më të madhe të vitit është i tharë ose ka pak ujë, por, kur bie shi dhe bëhen vërshime, e kalon Brizâ'n dhe futet nëpër shtëpitë e fshatarëve afër tij.

PRROI PRIFTOS – vazhdimësia e Përroit të Gardhit që kalon përmes Priftos. Në dy anët e tij ka pasur drunj shkurresh e kumbullash të egra. Sot është shtruar me gypa nëpër të cilët kalon uji dhe mbi të është bërë rruga që hyn për PRIFTE.

RAKITAT – vend te Lugi Vathit ku janë dy rakita që janë shenjë dalluese pasi gjenden në mes të gjithë pjesës ku mbizotëron druri i lajthisë. Drutë e rakitave janë edhe sot në pronat te Bregi i Koçinajve. Degët e tyre përdoren kryesisht për ndonjë bisht të grabujës a për hunj gardhi.

RAZOJZA – vend me ferra, shkurre e driza ngjitur me Mahallâ°n Poshtor. Më vonë është pastruar e është bërë livadh. Aty ka disa prona. Sot në këtë pjesë janë të ndërtuara disa nga shtëpitë e Mahallos Poshtor.

RRAFÇI NOR KIK – pjesë e rrafshët e pjesës shkëmbore mbi Mahallâ°n Poshtor. Rrafçi gjendet nën Kik që është pjesa më e lartë e Gurit të Blaçit. Aty kullosin bagëtitë dhe luajnë lojëra popullore barinjtë e fshatit.

RRAFSHINAT – pjesë e Bjeshkos Blaçit mbi Gurin e Korbit. Këtu ka shumë *çushia t'egra* (boronica). Gjithashtu Rrafshinat janë të pasura me kullota të shumta dhe gjatë sezonit së verës shfrytëzohen nga blegtorët e fshatit Blaç. Njerëzit

në nevojë në këtë pjesë mbledhin boronica të cilat pastaj, ose i shfrytëzojnë si fruta bjeshke, ose i shesin për shuma të caktuara të të hollave. Ka familje që një nga burimet e jetesës e ka këtë aktivitet të leverdishëm.

RRAFSHITA – RRAFSHA – RRAFSHINA – vend mbi Mahallâ°n Epor. Një nga pjesët e shumta të rrafshëta që janë ndërtuar nga gërryerjet e shumta që kanë ndodhur që në kohërat e hershme. Janë kullota por përreth saj gjenden dhe ara e livadhe. Sot pjesa më e madhe e arave janë të mbjella me jonxhë e bar për bagëtitë.

RRAHA – vend i pjerrët me dru ahu. Ka një shtrirje të madhe dhe aty kanë prona shumë fshatarë.

RRAHILIOS – rrah. Pronar i kësaj pjese të madhe ka qenë Lila dhe nga këtu është emërtuar si Rrahi i Lilos. Sot ka shumë prona të fshatarëve në këtë pjesë të madhe mali me dru ahu.

RRÂ°ZAT – vend i madh me ara përtej lumit në anën e Gurit të Mahallos Poshtor. Rrâ°zat janë rrëzë Gurit të Blaçit. Ato kanë cilësi të mirë toke dhe ngaqë u kalon lumi pranë, ujiten e japin prodhime të ndryshme bujqësore me bollëk. Aty mbillet misër, patate, fasule, kep, domate. Pleqtë tregojnë se në kohët më të hershme kanë mbjellë edhe duhan. Sot janë ndarë në shumë pjesë sipas pronarëve të ndryshëm dhe një pjesë e tyre është me jonxhë e tërfojë.

RRÂ°ZA NALT – pjesë e Rrâ°zave. Tregon njërin nga tërësitë e saj dhe është në pjesën e lartë afër Mahallos Poshtor.

RRÂ°ZA POSHT' – pjesë e Rrâ°zave. Tregon njërin nga tërësitë e saj dhe është në pjesën e poshtë të saj në drejtimin nga fshati Zgatar.

RRIHNAT – lëndinë e madhe e rrethuar me male. Vendi është në një shpat të Blaçit në kufi me Malin e Lybeçevos (Lybeçeva është fshat i Prizrenit).

RRIHNOROT (Malet) – malet rreth e përreth Rrihnavë. Pronat e maleve të fshatarëve shtrihen përreth Rrihnavë. Kjo pjesë është shumë e pasur me dru ahu dhe shumë e shfrytëzueshme për nxjerrjen e lëndëve djegëse për dimër.

RROMYMI – vend nën Mahallâ°n Poshtor te pjesa që ndan Lumin dhe një nga shkëmbinjtë e thepisur të Gurit Blaçit.

RROTLLAKI – vend në formë rrethi. Rrotull arave dhe livadheve në këtë pjesë ka drunj lajthie e kumbulle të egër në formë rrethi.

RRUGZA – ara nën Rugëzën e mbi Rugëzën. Prona që shtrihen anash një rruge të ngushtë që shkonte nga Mahalla e Epor në drejtim të fshatit Bresanë. Këto prona mbilleshin me elb, tërshërë e patate. Sot janë në të shumtën me jonxhë e bar. Rugëza është rrugë këmbësore.

SHATORRISHTA – nën Lisin e Mulos, anash Rrotllakit. Lëndinë me prona livadhesh në pjesën e Priftos në shumë pjesë me kaçuba të drurit të lajthisë që rrinin si shatorrë.

SHELÇOT E KAFEXHIS – vend me tri shelgje të mëdha nën hijet e të cilave kafexhinjtë e dasmave të Mahallos Poshtor bënë kafe për miqtë.

SHEVARTI – te Lugi i Vathit. Është vend shpati. Livadh rreth të cilit ka drunj lajthie e verri. Vendi mban ujë. Është një nga pjesët e Lugit Vathit.

SHEVARTOT – vend anash Mahallos Epor. Pjesë me bahçe e me vende me shkurre anash Mahallos Epor. Sot aty janë ndërtuar shtëpi dhe gjurmët e mëparshme nuk ekzistojnë.

SHPATLLA MADHE – vend në shpat mbi Mahallâⁿ Epor në drejtim të Bjeshkës së Blaçit. Njëra nga pjesët e Livadhit Shpatllos.

SHPATLLA VOGOL – një nga pjesët e Livadhit të Shpatllos.

SHPIA MAXHYPI – vendi ku e ka pasur shtëpinë maxhupi (romi) i Blaçit. Ishte pjesë e shkëputur nga Mahalla Poshtor. Shumë vonë ka qenë rrënoja e shtëpisë së tij. Ngaqë ka dalë të jetojë në Prizren, pronën me këtë emërtim e kanë blerë fisi i Dautajve dhe sot aty janë ndërtuar shtëpi të reja.

SHPIAT E TARALAJVE – rreth Gurit në dalje të Mahallos Prifte në drejtim të Zaplluxhës. Është vend që është emërtuar sipas një fisi. Ky fis është thirrë Taralaj nga fiset tjera. Edhe sot e kanë këtë emër.

SHTAVA – pllajë e cila shtrihet gjerë e gjatë duke prekur Shullâⁿin dhe Gurin e Mahallos Poshtme e të Priftos në njërën anë dhe Gjermanin e Zgatarit, Malet e Rrihnavë e Ponikin në anën tjetër. Ka lartësi mbidetare më të madhe se dy lagjet e Blaçit. Në Shtav’ shtrihen shumë prona të fshatarëve të cilat në të shkuarën mbilleshin me grurë, thekër, patate, elb, tërshërë etj. Ngaqë nuk ka burime uji dhe toka e saj nuk ka sistem ujitjeje, prodhimet bujqësore varen shumë nga lagështia që mund të ketë stina e verës. Po të jetë stina e verës e lagësht prodhimet e Shtavos janë të mëdha e të bollshme, po të jetë stina e verës pa të reshura të mbjellat dështojnë ose janë shumë të dobëta. Një pjesë e Shtavos është pronë e përgjithshme e Blaçit. Sot pjesa më e madhe e pronave janë me jonxhë, bar ose të lëna djerrë.

SHULLÂⁿNI – shpat i madh që ndan Shtavon me Mahallâⁿ e Poshtor e Priftâⁿ.

SHULLËJOT – shpat i madh që ndan Shtavon me Mahallâⁿ Poshtor e Priftâⁿ. Me këtë emërtim thirret nga priftjanët, përndryshe është i njëjti vend që emërtohet si Shullâⁿni nga blaçasit e tjerë.

TABOT – vend i veçantë në Prifte i rrethuar përmes një fortifikimi me gurë.

TOPILLA – gropë e madhe që mbushet me ujë dhe formon një pellg, moçal ishte.

TOPILLA THAT (te Kroj i Hysos: *Pranveros â^osht’ plot, veros thahot*) - vend që mbushet me ujë gjatë vjeshtës së vonë, dimrit dhe në pranverë. Është në mes të rrugës dhe për të kaluar qerret duhet të futen nëpër të.

TRË KROJNAT – vend në një rën nga pjesët mbi Verrishtâ°n e Mahallos Epor. Afër i kalon rruga kurse në të djathtë të rrugës për Bjeshkë janë tri burime uji. Dy prej tyre nuk kanë ujë në vjeshtë, dimër e pranverë kurse njëri është aktiv gjatë gjithë vitit. Poshtë burimeve të Trë Krojnave ka shumë bimë fieri dhe dru verri.

TRI LUXHE – vend mbi Prifte në pjesën nga Bjeshka e Blaçit. Tri Luxhe e ka pamjen e luginave prandaj e ka marrë edhe këtë emër.

TRI LUXHOST – gjendet nën Gurin e Kajkarave. Vendi dhe pozita kanë formën e tri lugjeve që kanë rrjedhë nga Bjeshka në drejtim të fshatit. Emërtohen si Tri Luxhe pasi janë të thara në të shumtën e kohës.

TRI UDHOT – udhë mbi Mahallâ° Poshtor në të dalë të Shtavos së Blaçit.

TRRAFÇZA – pjesë territori mbi Mahallâ°n Epor. Gjendet mbi Lithishtâ°n e Blaçit dhe është një pllajë e madhe para se të arrihet në Bjeshkë. Trrafçza është me ara e livadhe. Arat në të shumtën e herave mbillen me tërshërë e me thekër. Megjithatë, një pjesë e Trrafçzos është pasuri e përbashkët e fshatit (Mera).

TYRBJA – objekt kulturi bektashi, ndërtuar në vitet 1800 dhe ka qenë gjithmonë si një degëzim i Xhamisë së fshatit. Këto dy objekte kanë pasur të njëjtët besimtarë, kanë qenë në të njëjtin vend e me të njëjtin oborr. Sa ka qenë Tyrbja aktive e ka udhëhequr i njëjti njeri që ka qenë Imam i Xhamisë së Blaçit. Pas Luftës së Dytë Botërore Tyrbja ka një funksionim pasiv dhe imamët që zgjidhen pas kësaj kohe, nuk ishin nga familja e Shehit të Blaçit. Me këtë rast imamët e rinj nuk u morën me organizimin e jetës së Tyrbes dhe të rriteve të saj. Në vitin 1996 pas rënies së një dëbore të madhe në stinën e dimrit, Tyrbja rrënohet dhe më nuk është rindërtuar. Sot, në vendin ku ekzistuar ajo, janë vetëm themelet. Familja e Shehit të Blaçit ka filluar të largohet nga ritet e bektashizmit qysh pas Luftës së Parë Botërore, pasi si familje me ndikim në Opojë filloj të ndiqet dhe të terrorizohet nga pushtuesit serbë të Serbisë së Parë. Për një kohë në vitet 1913-1926 Shehi i Blaçit (Nuridin Avduti) bashkë me vëllanë e tij (Jakup Avdutin) kanë qenë të detyruar të migrojnë në Turqi. Ata janë kthyer në vendlindje vetëm pas amnistisë së përgjithshme që kishte bërë Mbretëria e SKS-së. Edhe kur u kthyen ishin vënë nën presionin shtetëror dhe e kishin të pamundur të merreshin me aktivitete fetare e atdhetare.

THEKNISHTA – vend me tokë të përshtatshme për kultivimin e thekrës.

UDHA – ky emërtim është shumë i përhapur në toponiminë shqipe, dhe, si i tillë, ka vend të veçantë edhe në emërtimet e fshatit Blaç. Secili toponim që gjendet afër një udhe (rruge) shoqërohet edhe me emërtim UDHA.

UDHA BJESHKOS – udha që shkon nga Blaçi për Bjeshkë.

UDHA BOTOS KUÇE – udhë që kalon nga pjesa e Lugit vathit përmes Lithishtës deri te Botza Kuçe dhe përmes kësaj deri te arat e Llaskartit.

UDHA BRESANOS – udha që kalon nga Blaçi dhe shkon deri në Bresanë.

UDHA BARDH – udhë në Bjeshkë që në të njëjtën kohë është dhe kufij mes Blaçit e Bresanës.

UDHA FUSHOS – udhë që çon për në fushë.

UDHA GOROS – udhë në Bjeshkë të Blaçit që është përdorur si lidhje mes fshatrave të Gorës së Dragashit me fshatrat e banuara me terbesh (mysliman) të Komunës së Prizrenit.

UDHA HOLL – udhë këmbësore që shkon nga Blaçi për Bresan'. Udhë bie përmes arave e livadheve dhe kur afrohet në Bresanë del në rrugën kryesore.

UDHA KEÇE – një nga udhët e shumta që prej Shtavos hyjnë në Rrihna. Emrin e ka marrë nga pozita e saj dhe nga gjendja e vështirë për të kaluar përmes saj. Kjo rrugë është shfrytëzuar për të kaluar me qe ose në këmbë.

UDHA LEZIT – e lidh Blaçin me Lezin. Kjo udhë kalon përmes Shtavos, hyn te Mali Azemit dhe përmes malesh arrin deri te Tyrbja e Lezit. Pas Luftës së Kosovës është zgjeruar dhe është shtruar me zhavor. Ajo pret që të asfaltohet dhe të krijoj kushte më të mira udhëtimi mes anës së Vrrinit të Prizrenit dhe Blaçit e Zaplluxhos të rrethit të Opojës.

UDHA LIVADHEVE – udhë që kalon anës Mullakos Xhaferit deri te livadhet dhe pronat posht, anash dhe mbi të.

UDHA LIVADHIT MATH – udhë që kalon si degëzim nga Udhë Blaçit te Livadhi Math. Kjo udhë e ndan edhe Mahallâ'n Epur e Mahllâ'n Poshtor me Priftâ'n e cila është pjesë e veçantë e Blaçit.

UDHA LIVADHIT NEXHOS – udhë që kalon afër Livadhut Nexhos.

UDHA LOPVE – udhë në të cilën kalonin lopët e Mahallo Poshtor kur ktheheshin nga kullotat e Shtavos në fshat.

UDHA PONIKIT – është degëzim i Udhës Shtavos. Për dallim nga Udhë Lezit që kthen në të djathtë, Udhë e Ponikit lakon në të majtë dhe futet maleve të Ponikit. Emrin e ka marrë nga vendi i emërtuar si Ponik.

UDHA RE E PONIKIT – futet maleve të Ponikit. Është ndërtuar pas Luftës së Kosovës (1999) dhe emrin e ka marrë për ta dalluar nga udhë e vjetër.

UDHA RRÂ°ZOS – udhë që kalon rrëzë Gurit Mahallo Poshtor dhe shkon deri në Zgatar. Udhë në fjalë është për kalim këmbësorësh dhe e përshkon krejt pjesën anash Rrâ°zave. Më shumë e shfrytëzojnë bujqit kur shkojnë t'i punojnë arat e tyre gjatë sezonës së prashitjes.

UDHA RRIHNOS (edhe Udhë Mir') – udhë mirë e Rrihnos. Njëra nga rrugët e shumta që hyjnë nga Shtava në Rrihna.

UDHA SHTAVOS – udhë që lidh Mahallâ'n Poshtor me Shtavâ'n. Kalon anash Gurit dhe ngjitet përmes Grykës për të dalë në Shtav'. Megjithëse me pjerrtësi të madhe dhe e rrezikshme, bujqit e përdorin për të kaluar me mjete bujqësore transportuese.

UDHA VJETOR E PONIKIT – udhë që hyn në Ponik. Është udhë e vjetër që sot nuk shfrytëzohet pasi përdoret Udhë Re e Ponikit.

UDHA ZABELEVE – udhë që nga Shtava hyn në Zabele. Zabelet janë male që shtrihen nga Shtava duke zbritur poshtë në drejtim të Rrihnavë.

UDHA ZAPLLUXHOS – udhë që lidh Blaçin me Zaplluxhën. Para Luftës së Kosovës (1999) ka qenë e shtruar vetëm me zhavor, kurse sot është e asfaltuar dhe shumë e përshtatshme për përdorim. Kjo udhë është një pjesë e udhës kryesore që e lidh Blaçin me Prizrenin e Dragashin.

UDHA ZGATARIT – e lidh Blaçin me Zgatarin. Kjo udhë, për herë të parë, është hapur gjatë Luftës së Parë Botërore nga Forcat Xheniere të Ushtrisë Austro-Hungareze. Deri më 2012 ka qenë vetëm fushore, kurse tash është e asfaltuar.

URA HAXHIS – një nga urat e shumta të Blaçit. Kjo urë gjendet në kufij mes Mahallos Poshtor dhe Priftos dhe bën lidhjen e këtyre mahallëve me Lugin e Priftos i cili të çon në drejtim të Shtavos. Ura lidh dy brigjet e Lumit. Atë e ka ndërtuar mjeshtri Destan Rakipi me kontributin e tij familjar.

VAJA E ÇOSIT – vend te Livadhot e Priftos. Vaja sipas të folmes së Opojës është vend i përshtatshëm për ta kaluar lumin qerret dhe mjetet tjera të punës. Edhe te Vaja e Qosit është vendi i përshtatshëm për të kaluar lumin nga ana e Blaçit për te pjesa e Zaplluxhës. Ka raste ku në pjesë të caktuara të lumit ka thellësi dhe për të kaluar në anën tjetër fshatarët e zënë një gjiri e mbushin atë me mjete inerte dhe e përshtatin për kalim.

VËNDI ÇENVE T'COFOT – vend në dalje të Mahallos Poshtor në drejtim të Kumllos Hajratit, më saktë nja 20 metra poshtë kumbullës së përmendur. Pjesa është nën Udhâ'n e Shtavos dhe mbi Projin Mi Briz'. Vendi është i pjerrët dhe i shkëputur nga fshati. Këtu futeshin qentë që cofnin për shkaqe nga më të ndryshmet. Edhe sot ata futen nën dhe në këtë vend.

VËNDI KALLAJXHIS – vend ku dikur ndonjë mjeshër kallajxhi rom kallaiste enët e kuzhinës së fshatarëve.

VËRRI VETÂ°M – te Fusha e Blaçit. Në këtë vend, më saktë te Ostrika gjendet një verri i vetmuar dhe nga të paktët në atë hapësirë. Ky është shkaku që vendi përreth tij e ka marrë emrin Vërrit Vetâ°m dhe është bërë shenjë identifikuese e kësaj pjese.

VËRRI VETÂ°M – vend te Kajnaki i Salihit. Aty gjendet një verri i veçuar dhe nga ky fakt e ka marrë emrin vendi rreth tij.

VËRRISHTA – një nga pjesët e shumta të pasurisë së përbashkët të Blaçit. Pjesa gjendet mbi Mahallâ'n Epor dhe është e mbushur me dru verri.

VËRRTHI (Verthi) BEGOS – vend mes Mahallos Epor dhe Lugit Vathit. Në këtë pjesë ka shumë dru verri dhe nga ky dru e pronari i tij e ka marrë emrin. Pleqtë thonë se këta verri kanë qenë një nga parcelat e shumta të pasurisë së Kukli Begut. Kuklia ka qenë njeri me pozita të larta shtetërore në kohën e Perandorisë Osmane aty nga shek. XVII Ai ua ka dhënë bujqëve të tij të përzgjedhur nga Blaçi këtë pjesë dhe ata e kanë trashëguar deri në ditët e sotme.

VIDHAST – vend mbi shtëpitë e Koçinajve me dru të vidhit. Prej kultivimit të këti druri është emërtuar edhe vendi. Prapashtesa *-as*, *-ast ose -os -ost* është karakteristikë e të folmeve të Opojës. Ajo ndeshet në shumësin e disa emrave të pashquar (*-as*) e të shquar (*-ast*). Ja disa prej tyre: *vidh-as/ast*, *vash(ë)-as/ast*, *vorr-as/ast* etj., dhe *gur-os/ost*, *murriz-os/ost* etj.

VIDHAST E LIKËNIT EPORM – vendi është në Shtav' të Blaçit.

VIDHI VETÂ°M – vend mbi Vidhast. Në këtë vend gjendet një dru vidhi i vetmuar në udhën për në Shtav'.

VIJA UJIT (Vija Por Me Ujt) – vijë uji për ujitje që zinte fill te Ura e Haxhisë dhe gjarpëronte parcelave të Koçinajve. Sipas shtrirjes së saj emërtoheshin dhe parcelat që gjendeshin mbi vijë: *Mivija*, -dhe parcelat që gjendeshin nën vijë: *Norvija*.

VORRAST E KOÇINAJVE - varreza të familjes së Koçinajve.

VORRAST E MAHALLOS – vendi ku varrosen njerëzit e Mahallos Poshtor.

VORRAST E XHAFERAJVE (te Rromymi) - vendi ku kanë qenë të varrosur njerëzit e fisit të Xhaferajve. Sot ky fis nuk ekziston pasi është “fik” në kohën e mortajës gjatë Luftës së Parë Botërore. Sot në këtë pjesë janë vetëm gjurmët e varrezave. Duhet thënë se ky fis ka qenë i ndarë nga pjesët tjera të Mahallos.

XHOLLOST – vend mbi Prifte në drejtim të Bjeshkos Blaçit. Është një shpat i pjerrët në të cilën ka disa livadhe dhe tufa ferrash e dru verri. Xhollost gjenden mbi Gardh (për më tepër shih edhe te toponimi Gardhi). Ky vend në brendinë e tij mban ujë që e bëjnë sipërfaqen e tij të lagësht. Nga prania e tepërt e ujit e ka marrë emrin Xhollost.

XHOLLZAT – në Mahallâ°n Poshtor, te Likêni n’Shtav’.

XHYBRA PASHOS – vend ku kanë veruar dhe fjetur bagëtitë.

ZABELOT – një nga pjesët e maleve në Shtavon e Mahallos Poshtor. Zabelët kanë shtrirje nga Shtava dhe përfundojnë në Rrihna. Janë të pasura me dru ahu. Në këtë pjesë ka shumë prona të fshatarëve të Blaçit, prej të cilave ata i bëjnë drutë e dimrit.

ZALLINA – vend me zall (rërë të kuqe) në pjesën e Mahallos Epor.

ZALLISHTA – vend me tokë ranore në pjesën e Priftos.

ZINOVA – vend në kufij me Bresanën e me Zgatarin.

RECENSIONE**NJË STUDIM AKTUAL PËR PROBLEME TË SHQIPES
STANDARDE**

(Prof. dr. Qemal Murati, *Gjuha shqipe në komunikimet publike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2013, f. 1-549).

Libri «*Gjuha shqipe në komunikimet publike - Ligjërimi mes zyrtares/jozyrtares dhe sendërgji për përmbysje standardi e kthim dialekti*», i autorit prof. dr. Qemal Murati, është ndër veprat kryesore që trajton kodet e gjuhës standarde dhe mesazhin për ruajtjen e kësaj gjuhe sot e në të ardhmen. Reagimi i autorit ndaj keqpërdorimeve të gjuhës shqipe në masmedia, në gazeta e shkrime të shumta si dhe shkarjet e rrëshqitjet e qëllimta nga gjuha shqipe e njësuar, mandej ndërhyrjet arbitrare të diletantëve në normat e gjuhës standarde, bëri jehonë të madhe te lexuesit e nderuar.

Ky libër gjuhësor ka vlera të shumëfishta dhe u nevojitet të gjithëve, gjuhëtarëve, letrarëve, mësuesve të gjuhës shqipe, lektorëve, redaktorëve letrarë, por edhe juristëve dhe ekonomistëve, avokatëve e gjyqtarëve, të cilët duhet ta mbajnë këtë libër në tavolinat e tyre të punës bashkë me librin e Kodit Penal e të Kushtetutës së shtetit tonë - Kosovës, nëse kanë për qëllim që vendimet e tyre, raportet e nenet ligjore të dalin të qarta e të kuptueshme.

Autori Q. Murati sjell risi të shumta në temët që trajton dhe në konceptimet si, bie fjala, gjuhë, të folur, dialekt, gjuhësi, gjuhët në kontakt, gjuha e plisit, gjuha e fluturave, ligjërimet e fshehta në të folmen e Rahovecit, sistemi i shqiptimit, sistemi i formave gramatikore dhe sistemi i fjalorit; mandej evolucioni i gjuhës, universalitet dhe të veçantat e gjuhëve, etj.

Në këtë vepër gjuhësore shtrohen probleme të rëndësishme që kanë të bëjnë me: Situatat në arealin linguistik në Maqedoni; Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972); Portrete të figurave të shquara në fushën e shqipes (Rami Memushaj, Viktor Fridman, Arbën Xhaferi, Atë Gjergj Fishta, Hasan Prishtina).

Kapitulli i tretë i kësaj vepre «*Sendërgji për përmbysje standardi e kthim dialekti*», që përfshin lëndën e shtjelluar në 204 faqe teksti (f. 141-345), është pothuajse ndër pjesët kryesore të librit. Në këtë kapitull trajtohen çështje të statutit të shqipes standarde dhe të kulturës së gjuhës në mediet e shkruara dhe të folura, shkeljet e normës fonetike, leksikore e gramatikore, ndikimet e gjuhëve fqinje në leksikon dhe në ndërtimet gramatikore të shqipes, shkarje gjuhësore të përditshme, që i përmirëson ato dhe i shpjegon ashtu siç duhet me premisën «si të flasim dhe të shkruajmë shqip». Janë vënë në dukje këtu gabime të shumta gramatikore që dalin sot në shtypin tonë, në radio-televizion e në masmedia të tjera, ku po përdoren edhe fjalë të paqena, gabime në përdorimin e gjinisë tek numërorët (te numri tre/tri); po përdoren gabimisht në gjuhën e folur dhe në shkrime trajtat e shkurtra të përemrave vetorë si dhe fjali të tëra të çoroditura. Të gjitha këto gabime Q. Murati i thotë troç dhe ia paraqet lexuesit formën e drejtë gramatikore të fjalës dhe të fjalisë në shqyrtim.

Në vazhdën e këtij kapitulli janë trajtuar edhe shumë çështje të tjera me rëndësi për statusin e shqipes standarde, si p.sh.: Gjuha shqipe në shkollë; Gjuha shqipe në Universitet; Gjuha shqipe në masmedia, ku bëhet fjalë për kulturën e gjuhës dhe për respektimin e standardit gjuhësor, duke sjellë një mori shembujsh të shkeljes drejtshkrimore dhe të gabimeve të shumta gjuhësore në ligjërimin e përditshëm në gjuhën e shtypit e të televizioneve, në përdorimin publik të gjuhës; në shkollë; në administratë etj. Të gjitha këto gabime e lëshime gjuhësore autori i sheh si rrjedhim i mungesës së formimit gjuhësor, si mungesë e disiplinës gjuhësore dhe snobizmit e mendjelehtësisë së njerëzve të ligjërimin publik.

Shkeljet e normës gjuhësore vërehen në një varg të gjatë shembujsh si në përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme, ashtu edhe në përdorimin e ndërtimeve sintaksore të gabuara, ose të marra nga gjuhët e huaja. Gabimet gjuhësore të çdo fushe të dijes ai i qorton rreptë. Mirëpo, në çdo rast, në vend të fjalës së gabuar, fjalës së huaj të pavend si dhe ndërtimeve të gabuara sintaksore, i jep formën e fjalës ose ndërtimin e duhur sintaksor, të korrigjuar e të përmirësuar në rrafshin leksiko-gramatikor.

Vënia në dukje e gabimeve leksikore, fonetike, morfologjike, sintaksore, semantike (kuptimore) që po ndodhin në masmedia, radio-televizion, në shtypin e përditshëm, në revista profesionale (edhe shkencore) dhe këshillimet këmbëngulëse të autorit për zhdukjen e këtyre gabimeve, që janë shtjelluar me kompetencë të plotë në librin në shqyrtim, përbëjnë një vlerë të madhe kulturore e shkencore, veçmas për ata që punojnë në fushën e ligjërimin publik të shkruar e të folur. Libri i zënë ngoje këtu është një manual praktik e i lehtë për t'u kuptuar. Është një libër shumë i nevojshëm, në radhë të parë, për mësuesit e gjuhës shqipe, për gazetarët, për studiuesit e fushave të ndryshme të gjuhës shqipe, për juristët tanë dhe për të gjithë ata që duan të flasin dhe ta shkruajnë pa gabime gjuhën shqipe, siç u tha edhe njëherë këtu më lart.

Një vërejtje qortuese në librin në shqyrtim i jepet edhe përdorimit të shqipes standarde në universitetet tona, në aktet administrative, në librat universitarë, në leksione, siç thotë autori, që është në shkallën më të ultë të mundshme, aq sa arsimit dhe edukimi i lartë nuk kanë ecur mbarë, pasi që «diploma e fakultetit merret edhe pa ditur asgjë, pa frekuentuar fare fakultetin, ndërsa kandidatët magjistrohen e doktorohen edhe pa kryer fare një fakultet; kurrë nuk kemi pasur më shumë punime magjistrature e doktorature më të pavlera e më jo shkencore. Në këtë livadhosje një dhunë e paparë i bëhet edhe shqipes standarde». (Vep. e cit. f. 273).

Prej gabimeve të shumta leksiko-gramatikore që e lëndojnë gjuhën standarde është edhe tautologjia, që «po përdoret shpesh në gjuhën e medieeve dhe në gjuhën e politikanëve tanë të paformuar sa duhet filologjikisht». Tautologjia në gjuhë është përsëritja dy herë e fjalëve të ndryshme me të njëjtin kuptim (p.sh.: aprovohet-miratohet, atraksione-atraktive etj.). Në këtë vepër gjuhësore dalin mëse 50 shembuj frazash e fjalish, ku është përdorur tautologjia pa nevojë. Këto përdorime, thotë autori, e artificializojnë gjuhën dhe gjithsesi duhen shmangur si në gjuhën e folur dhe në gjuhën e shkruar (Po aty, f. 403).

Në kapitullin e gjashtë dhe të shtatë janë shqyrtuar çështje të komunikimit në mjedise të ndryshme shoqërore dhe çështje të përgjithshme të gjuhës. Janë trajtuar këtu elemente semiologjike dhe sociolinguistike në fushë të shqipes që kanë karakter etnolinguistik, siç janë shprehjet e përsëritjes, në komunikimin formal dhe informal. Sipas këtyre termeve gjuha mund të përdoret në tri nivele: formale (zyrtare), informale (jozyrtare) dhe popullore (e përditshme). Varësisht nga situata në të cilën ndodhemi, shprehjet e përsëritjes mund të përdoren në forma të ndryshme. Kështu, bie fjala, kur i drejtohem dikujt me nderim e rrespekt, përdorim përemrin vetor «ju», që tregon edhe hierarkinë në shoqëri, ndërsa forma me «ti» tregon afërsinë, familjaritetin. Në gjuhën shqipe, thotë Qemali, tradicionalisht është përdorur veta e dytë njëjës edhe në rastet e të folurit me nderim, por janë shtuar fjalë nga bashkëfolësi që paraqitin idenë e dallimit social: Si je gdhirë, zotrote? (në Jug); A mujte, bacë? (në Veri); Si je bajraktari i Rugov's?; A je si je kreu i fisit? (në terrenet e Deçanit, etj.). (Vep. e cit. f. 431).

Shkrimi me karakter etnolinguistik «Gjuha e plisit» është me interes shkencor, me që bartja e plisit, përveç funksionit mbrojtës, ka pasur edhe semiotikën e veçantë të identifikimit të elementit shqiptar nga të tjerët; «Plisi ka qenë në funksion të ruajtjes e konservimit të elementit shqiptar nga rrëgjimi në elementin e huaj dhe ka pasur rëndësi sa edhe vetë gjuha» (Vep. e cit. f. 441). Me kësulën e bardhë/plisin janë të lidhura edhe shumë shprehje frazeologjike dhe rituale që përdoren në treva të ndryshme të shqipes. Është interesant leksiku i pasur që ruhet në shprehjet e shumta me fjalën «plis». Në terrenet e Drenicës, përkitazi me plisin, Qemali ka shënuar edhe disa shprehje alegorike, si p.sh.: «kapuçmadh», i pasur; «kapuçgat», mendjemadh etj., si dhe 18 frazeologjizma me elementin shënjues kapuç/plis, ku ruhen fjalë e shprehje të rralla që kanë edhe kuptime me vlerë, që i shënoi prof. Qemali, ky hulumtues i shkathtë i terrenit, që, pa përtesë, u bie kryq e tërthuer shpeshherë trevave shqiptare, duke zbuluar dukuri interesante që ruhen në të folmet shqipe, siç janë edhe gjuhët e fshehta në të folmen e Rahovecit, që janë përshkruar në temën «Gjuha e fluturave» në kapitullin e gjashtë të këtij Vëllimi. Janë interesante kodet e fshehta ligjërimore në të folmen e Rahovecit, ku paraqiten tri kode argotike: 1. Kodi i formuar me mjete fonetike që quhet edhe gjuha e fluturave nga përdoruesit. Ky kod përdoret nga të rinjtë në fshatin Ratkoc për t'i fshehur mesazhet nga të tjerët; 2. Kodi i realizuar me mjete morfologjike dhe 3. Kodi i ndërtuar me mjete sintaksore. Këto kode argotike janë quajtur «Dialekti misterioz i Kosovës». Ligjërimet e Rahovecit duhen gjurmuar sa më parë, thotë autori, sepse me zhvillimet e reja dinamike mund të humbet kjo pasuri e madhe gjuhësore. (Po ai, po aty, f. 442,449).

Kapitulli VII u kushtohet elementeve të përgjithshme linguistike, ku bëhet fjalë për gjuhën dhe evolucionin e saj; universalet dhe të veçantat e gjuhëve; tipat e gjuhëve; njeriu në gjuhë etj. Në këtë pjesë autori trajton nocionin «gjuhë», «gjuhësi» (linguistikë) «filologji», ku përmend edhe numrin e gjuhëve dhe klasifikimin e tyre. Me një njohje të thellë gjuhësore ai rishqyrton klasifikimin e gjuhëve. Si bazë për klasifikimin e gjuhëve merr kriterin gjenetik, tipologjik dhe kriterin areal. Te klasifikimi i gjuhëve autori përmend edhe termat gjuhë të gjalla (që fliten aktualisht) dhe gjuhë të vdekura (që janë folur dikur, por që nuk fliten sot,

p.sh.: pellazgjishtja, ilirishtja, greqishtja e vjetër, trakishtja, maqedonishtja, dakishtja, mizishtja etj.). Ndërkaq, sipas klasifikimit tradicional gjenealogjik, sipas strukturës morfologjike të fjalëve, ka gjuhë izoluese, aglutinative dhe gjuhë fleksive (p.sh. gjuha shqipe).

Përkritazi me evolucionin e gjuhëve, universaliet dhe të veçantat e gjuhëve, tipat e gjuhëve e varietetet gjuhësore të trajtuara në këtë kapitull të kësaj vepre, ka risi të shumta shkencore që ia rrisin vlerën këtij punimi me tematikë të larmishme, të pasur me studime, artikuj e intervista.

Në kapitullin e nëntë jepen vlerësime për fjalorë të shqipes standarde dhe fjalorë dialektorë, ku janë dhënë edhe kritika ndonjëherë edhe të rrepta për disa botime leksikografike, por edhe ato vlerësime kritike të këtij autori, janë gjithnjë të sakta e objektive.

Në shkrimin «Vlerësime rreth veprës Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe (2011) të bashkautorëve Ali Dhrimo – Rami Memushaj», prof. Q. Murati jep vërejtje, vlerësime e kritika të rrepta, por të nevojshme dhe objektive. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (1976), thotë ai, u ka vënë kufi formave të tjera variante dialektore e krahinore, prandaj nuk ka pse të hartohen fjalorë të rinj drejtshkrimorë dhe nuk ka nevojë të propozohet «normë mbi normë». Ndryshimet e bëra në kodin e ri të quajtur «*Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*» (Tiranë, 2011), nuk janë të mbështetura dhe të arsyeshme, por janë një prapaktim në një gjendje të mëparshme dialektore e sociolekti, shprehet Murati.


Për ta shtjelluar këtë lëndë të gjerë gjuhësore, Qemal Murati ka përdorur një aparaturë të rreptë shkencore përmes një mendimi të thellë e argumentimi konkret të fakteve. Përmes shpjegimit shkencor janë paraqitur dhe sqaruar faktet e konstatuara të lidhura gjithnjë me përkufizimin, klasifikimin, përfundimin, argumentimin, përgënjeshttrimin etj. E tërë lënda gjuhësore është përpunuar përmes metodave shkencore induktive, deduktive si dhe atyre krahasuese, historike etj. Hulumtimi gjuhësor i këtij gjuhëtari të rrallë në librin në shqyrtim si dhe në shumë studime të tjera të tij, është i mbështetur në fakte të caktuara materiale e historiko-shoqërore. Këto fakte janë me interes dhe me rëndësi për tematikën që është hulumtuar dhe që mund të verifikohen në mënyra të ndryshme.

Vëllimi «*Gjuha shqipe në komunikimet publike*» i autorit prof. Q. Murati është një ndihmesë për të gjithë ata që dëshirojnë dhe që kanë nevojë ta flasin e ta shkruajnë pa gabime gjuhën amtare, shqipen standarde. Libri është i lehtë për t'u kuptuar nga të gjithë, sepse problemet gjuhësore që janë shtjelluar aty i ka studiuar me kompetencë të rrallë e me përmasa të thella shkencore.

Bajram MEHMETAJ

NOMADËT E FUNDIT

(Sipas romanit të shkrimtarit Thanas Medi)



Disa vjet më parë, tek po shëtisja me një mikun tim muzikant në “Lëndinën e Lotëve” në Korçë, na erdhën në vesh tingujt e një muzike në tonë të larta dhe pastaj një këngë e Ermira Babaliut. Miku im stepi në vend, u kthye nga ana e një lokali që kishte trajtën e një kisha dhe u mvrajt. “Mos është më mirë, miku im, të shkojmë e ta dëgjojmë atje?”, – thashë unë. ”Jo, në asnjë mënyrë, – u përgjigj ai prerazi. Aty është bërë një mëkat dhe ata që këndojnë aty janë duke bere një sakrilegj të tmerrshëm! Është prishur një kishë, kisha jonë, e arumunëve, nga disa edepsëz, të cilët e kanë kthyer në DISKO një vend të shenjtë!”. Heshti një çast dhe pastaj u largua, duke me lënë vetëm, të shoqëruar në enigmën e një shkatërrimi të një objekt-kulti të një populli, i cili kishte nisur të lakohej shpesh, nëse ishin të racës rumunë, helene, latine apo shqiptare..

Thuajse e kisha harruar këtë episod, kur 15 vjet më pas, shkrimtari ynë Thanas Medi, më dha për të lexuar në Athinë romanin e tij “Fjala e fundit e Sokrat Bubës”. Në dorë kisha tani enigmën e tyre, në faqet e një romani, të shkruar bukur, në një gjuhe të pastër shqipe, që më tërhoqi qysh në faqet e para. Mu shpalos përpara jeta e vllëhëve, e këtyre njerëzve endacakë, me “shtëpinë mbi kurriz të mushkës”! Ishte fjala e një njohësi të thellë të këtij populli “rrënjëshkullor”, për ata njerëz që s’i mban dot vendi në një vend e që janë kurdoherë në ecje, si puna e

breshkës, e cila “vete nga vete dhe e merr shtëpinë me vete...”. Aty do të mësoja se, edhe këta endacakë kanë individualitetin e tyre, me tiparet, zakonet, psikologjinë, këngët, kishat, dashurinë dhe vdekjen, si të gjithë njerëzit që i vërtit GLOBI... Dhe do ti jepja të drejtë atij mikut tim që me braktisi të shushatur aty, në “Lëndinën e Lotëve”. Pas kaq e kaq vjetësh...

Ky libër me vlerë është pjese e kolanës se Shtëpisë Botuese prestigjioze “TOENA” dhe vjen menjëherë pas romanit të pare të Thanas Medit “Hije e mallkuar” që bën fjalë për jetën e vështirë të emigrantëve në ditët tona. Kushdo mund të habitej për këtë kapërcim, nga asgjëja në gjininë e madhe të letërsisë. Mirëpo romani i dytë “Fjala e fundit e Sokrat Budës“, do të na bindë për atë artikulum të përvojës letrare e të bagazhit jetësor që e benë çdo autor të “plugojë” tokën e begatë të artit të të shkruarit. Pa dyshim që, është talenti, i cili kryen këtë proces të një mrekullie ripërtëritëse të jetës, të njeriut e të gjithësisë. Dhe s’do të habitemi kur e shohim këtë roman të botuar nga Sh.B. “Arizona” në Amerikë dhe nga Sh.B. “Qedros” në Greqi...” Struktura e këtij romani interesant rrëfen dinamikën e një populli që lëviz gjithmonë, që kërkon e shpreh vitalitetin e tij, ndonëse shumëkush e ka përbuzur a e ka parë me “sy të shtrembër”! Subjekti, me ngjarje të tendosura, ndërthurja kompozicionale, veprimi e konflikti, si edhe personazhet lëvizëse, krijojnë njësinë e plotë të një romani, ku shprehet një e vërtetë e madhe për vllëhët, për endacakët e kasolleve me kashte, të cilët përshtaten aq natyrshëm me rrethanat, vuajtjet e vështirësitë e tjera që mbart jeta përreth tyre. Faza e ekspozicionit shpalos një lidhje martesore ende pa “çelur jeta” për të ruajtur kështu edhe miqësinë e hershme midis dy familjeve më të mëdha të një fisi. Nyja e mpleksjes se intrigës dhe e zhvillimit të ngjarjes, ka të beje me rrugët e ndryshme të rritjes së fëmijëve, të “sapomartuar(!), në largësi me njëra-tjetrën, duke prishur kështu ato marrëdhënie afërsie që do të ndihmonin krijimin e afinitetit e ndjesisë së dashurisë... Dhe, kur kjo do të ndodhë, atëherë do të kemi përplasjen e parë, me një pëllëmbë që vajza i jep Sokrat Bubës, të fejuarit të ligshëm, që ka jetuar larg saj për një kohë të gjatë, duke krijuar kështu hendekun e kontradiktës e të shpërbërjes. Është mjeshtëria e shkrimtarit që këtu gërsheton linjën e dytë të subjektit të romanit, duke sjellë antipodin e tij, Dhimitër Kerpini, që është ngjizur shtrembër e për të bërë keq, duke arritur të ngjitet si kulpra në jetën e në trupin e Katerinës, derisa ta bëjë të tijën, me një etje përbindëshi përdhunuese. Zgjidhja do të vijë paralelisht me prishjen e fejesës e të martesës, nga vetë vajza e nëpërkëmbur, duke shtuar këtu paralelizmin ideologjik të ndikimit po aq shtrembër në jetën e këtyre njerëzve të lirë të diktaturës së Enverit, që do të veprojnë verbërisht, midis kasolleve të vllëhëve. Duhet të mbaroje i gjithë romani, për të kuptuar mandej se këta njerëz bredharak, që ku mbillen s’korren, janë rropatur jo pak nga zgjedha e politikës, duke mos i pranuar midis vendasve, që i kanë konsideruar gjithmonë si të ardhur “nga Kozmosi”, apo duke i përfshirë, ashtu të shpërndare, në “kopenë popull”, për ti shtrydhur ca me keq akoma. Të mos harrojmë që këta njerëz jetonin me bagëtitë e tyre, me zejtarin, me artizanatin shëtitëse, ku bënin pjese teneqexhinjtë, bakërxhinjtë, kallaisjexhinjtë, samarxhinjtë, etj. Mirëpo, ata nuk dinin vetëm të kullosnin delet, por edhe të punonin me avlëmend e të sajonin vetë pëlhurën e të qepnin kostume nga me të bukurat që mahnitnin sallone mode edhe nëpër

kryeqytete të Europës. Në këtë mënyrë shkrimtari Medi ofron lëndë për njohjen e një realiteti që lakohet ende edhe sot si përkatësi, po edhe si vlerë njerëzore. Ana e kundërt e mosnjohjes, nga organet e pushtetit të asaj kohe të verbër, po kaq e njëjtë edhe me “përkujdesjen” e të ashtuquajtur “njohje”, sa për t’i futur në “shtrungën” e një shfrytëzimi të egër, shoqërohet me humor të këndshëm, deri në një satirë therëse.

E gjitha kjo realizohet në roman përmes personazheve vepronjës, që janë e mbetën karaktere të mëvetshëm. Shumica e tyre janë vllahë, të cilët rropatën në jetën e përditshme, personazhe të vërtetë, të paraqitur në trajtën me të thjeshtë, realisht e me emocione të forta. Në epiqendër është Sokrat Buba, endacaku i fortë, me një portret si të Taras Bulbës se Gogolit për nga karakteri i ashpër i fizionomisë, po njëherësh, në brendësi të tij, me një butësi shpirti, me sensibilitetin e një këngëtarit (atij i dridhet shpirti kur këndon për “syrin laraman” të Katerinës), i cili dashuron vetëm një herë për tërë jetën dhe që nuk arrin ta gëzojë dashurinë e tij të zjarrtë, përballë poshtërsisë, dinakërisë dhe të pabesisë njerëzore. E gjithë rrjedha e këtij vëshimi të fortë erotik do të jetë një vajze me emrin Katerinë, personazhi me i veçantë i romanit, e fejuara që në djep e Sokrat Bubës, e cila i shpëtoi vdekjes disa herë dha pastaj shpërtheu si një lule e egër, rrëzë gërxheve të shkëmbinjve malorë, me tërë bukurinë e aromën e saj dhe që do të bjerë viktime e krenarisë së vet në rrethin vicioz të së keqes. Dhe “e keqja” do të koncentrohet nga autori tek një personazh thujasë rakitik, i lig e me buzë të thara, që i është tharë edhe shpirti, Dhimitër Kerpi, i cili do të mbjellë këtu shkatërrimin përmes egocentrizmit vetjak, i dehur pas bukurisë marramendëse të Katerinës, duke arritur ta bëjë të tijën me dinakëri e incestet kafshërore të një monstre të vërtetë. Ky trinitet, që ngjan si nga ato trillime, të cilat nuk ti rrok dot as mendja, si të ishte vepër e vetë djallit, është edhe bërthama me energjike e romanit, e dhenë natyrshëm, besueshëm, me ngjyrimet, inverse e kontrapunktet. Dhe, përmes kësaj “bërthame” që duket sikur do të pëlcas nga çasti në çast, do të ndërthuren disa linja paralele, tok me disa personazhe të tjerë të skalitur si me daltë: Plaka e mençur Arhonda, me fjalën e vështrimin e saj profetik, historiankërkuesi Riza Kerpi, labi i përkushtuar në zbulimin e “rrënjëve” të vllahëve, gazetari stereotip, dogmatik e i fantaksur Thoma Thellimi, pushtetari vendor i ideologjizuar dhe konservator Stefan Mushka (me trurin e vet prej mushke!), një poet qesharak e impotent (në seks e në vjershat e tij), si edhe njëfarë “presidenti” që krekoset aty si “i pari” i vllahëve, plotësojnë karakteret, nën një “çati” të sigurt që hapin dritare plot diell.

Thanas Medi të befason, si në vlerat njohëse, po aq edhe në vlerat artistike, që kanë të bëjnë me tiparet e një populli krejt të veçantë, bijë të afërt të natyrës, mandej me kompozicionin dinamik, me gjuhën letrare, me skalitjen e kujdesshme të personazheve tipik, me mjetet shprehëse, imazhet dhe idetë, si edhe me të gjitha rrethana që i lidhin këta njerëz me të tjerët përreth tyre. Rrjedhin ngjarjet njëra pas tjetrës, ashtu si ecën vetë jeta e këtyre njerëzve “të parrënjë, që ku mbyllen s’korren!”, që nuk i mban vendi, po i mban jeta, dhe që dinë ta ndërtojnë jetën kudo e ngado. Dhe, kur afron fundi, do të na duket e gjitha kjo, si një këngë për një dashuri të pamundur, që mbaron me vdekjen e heroit, sa ngjan si akti i fundit i një tragjedie. Në të gjithë këtë shtrirje ndërthuren e përplasen të gjitha ndjenjat e veset

njerëzore, sikundër janë dashuria, mirësia, xhelozia në një jetë primitive, si në fiset e lashta paganë, që njohin vetëm perënditë e tyre paganë e janë zotër të vetvetes. Dhe, në mes tyre endet një shpirt i pastër, me vuajtje të pafundme, nën qiellin e hapur, me romantiken, lirizmin e erotiken dhe të sflitjeve që sjellin dramën njerëzore.

Fryma realiste e romanit është e mpleksur edhe me disa skena sureale, që kanë të bëjnë me praninë e të vdekurve e me një “bashkëbisedim” me ta, si të ishin njerëz të gjallë, në çaste kritike të rrugëdaljes, nga e keqja shtrënguese, për një zgjidhje të halleve e të problemeve që u dalin përpara. Natyrisht që kjo lidhet edhe me bestytnitë e brezit të vjetër, me përfytyrimet e tyre pagane, të cilat ende rrojnë bashkë me ta e “besohen”, por që këtu teprohen e dalin jashtë stilit të veprës së Medit, si njëfarë krisje. Në një prizëm tjetër të përafërt e me ngjyrim natyraliste jepet shkrimi i mërzisë “kozmiqe” të Sokratit Bubës, me rrahjen e tmerrshme që i bënë kafshës së gjorë (kalit të tij të dashur e të dhuruari) në një tjetërsim po aq kafshëror, aq sa i duhet të vjelle krimba nga stomaku!... Tejkalimi i sensit artistik, natyralizmi e surealizmi, cenojnë sadopak konceptimin e përgjithshëm, nga ku rrjedh një “përrua i pastër e i kthjellët”.

Gjithsesi, duke folur për vllahët e Shqipërisë, shkrimtari Thanasi Medi, jep një panoramë krejt të panjohur të shpirtit të tyre njerëzor, duke shpërndarë edhe mjegullën që qëndron mbi ta, për ata njerëz që krijuan Voskopojën nga një “grusht kasollesh me kashtë”, e cila u bë dikur një qytet i madh, me kisha e manastire, me shkollë, akademi e me një shtypshkronjë (100 vjet me përpara Athinës), me tregtarë, bankierë, arkitektë, poetë e shkrimtarë të zotë, që mbahen mend nga të gjithë ne, që përsëri i shohim vllahët se një ENIGMË E MADHE!

Miho GJINI

SIMON VIZENTAL - LUFTËTAR I MBAJTJES GJALLË TË KUJTESËS SË GJENOCIDIT NAZIST

Që të triumfojë e keqja, mjafton heshtja e njerëzve të mirë.

Edmund Burke

Simon Vizentali është figura qendrore e ndjekjes, gjetjes dhe dhënies drejtësisë të kriminelëve nazistë përnjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Ai u mor me këtë punë për rreth gjashtëdhjetë vjet, që nga koha kur shpëtoi nga kampet naziste e derisa vdiq. Idealizmi i tij që i plotë, ndjenja e detyrës e kthyer në mision, po ashtu.

Emrat “Simon Vizental” dhe “Gjahtari i nazistëve” kanë hyrë në historinë e pas-Holokaustit si sinonime. Megjithatë, Simon Vizentali është shumë më shumë se gjahtar i nazistëve: ai është njëkohësisht luftëtar për drejtësi; luftëtar i mbajtjes gjallë të kujtesës së gjenocidit nazist, me qëllim jo vetëm për të ditur se ç’ndodhi, por edhe për të bërë që ajo që ndodhi të mos përsëritet më; si dhe autor librash. Në një kohë kur njerëzit kërkonin ta harronin Holokaustin, ai i bëri ata ta kujtonin. Ai nderoi viktimat, u dha të mbijetuarve qetësi dhe shpresë, duke çuar para drejtësisë kriminelë nazistë të fshehur e të shpërndarë nëpër botë dhe bëri të jetonin çdo minutë me frikën e zbulimit, kapjes dhe dënimit ata që mbetën të fshehur.

Luftën kundër harresës dhe indiferencës Vizentali e konsideronte si një veprim me rëndësi të jashtëzakonshme. Në raste të ndryshme ai ka thënë: “Puna më e madhe që kam bërë ka qenë lufta kundër harresës, lufta për mbajtjen gjallë të kujtesës. Është shumë e rëndësishme ta bëjmë popullin të ndiejë se armiqtë e tij nuk janë harruar. Ky është një paralajmërim për vrasësit e nesërm. Në qoftë se nuk do të paralajmërojmë vrasësit e nesërm me veprime, miliona të tjerë do të vdesin prej tyre... Drejtësia për krime kundër njerëzimit nuk duhet të ketë kufizime kohore... Me siguri, monstra si Hitleri dhe Stalini lindin përditë... ata presin që ne të harrojmë. Kur historia të shohë pas, dua që populli të marrë vesh se nazistët nuk i shpëtuan ndëshkimit, edhe pse mundën të vrisnin miliona. Ky është një mesazh edhe për vrasësit e së nesërme: ata nuk do të gjejnë paqe... Në qoftë se injorojmë të shkuarën, në qoftë se deformatojmë apo mohojmë atë që ndodhi, e shkuara do të përsëritet. Vetëm duke kujtuar do të mundemi ne dhe fëmijët tanë, dhe fëmijët e fëmijëve tanë, të ndërtojmë një të ardhme të sigurt, një të ardhme në të cilën jeta e njeriut të mos humbë vlerat e veta... E bëj këtë punë, sepse duhet ta bëj. Nuk shtyhem nga ndjenja e hakmarrjes... por nga ajo e kujtesës dhe drejtësisë. Në qoftë se harrojmë të gjithë, mund të ndodhë e njëjta gjë pas njëzet, pesëdhjetë apo njëqind vjetësh...”

Për Vizentalin, të kujtuarit e viktimave dhe e mizorive të luftës do të ndihmonte edhe në rindërtimin e jetës së atyre që shpëtuan. Mijëra të mbijetuar kudo në botë do të qetësoheshin disi kur të mësonin se kriminelët do të qëndronin këtej e tutje ose para drejtësisë, ose nën frikën e përhershme të saj.

“Mbijetesa është një privilegj i cili përmban edhe detyrime, - thotë Vizentali. - Gjithnjë pyesja veten se çfarë mund të bënim për ata që nuk mbijetuan. Për vete, e kam gjetur përgjigjen... Do të bëhem folësi i tyre, do të mbaj gjallë

kujtesën e tyre, do të siguroj që të vdekurit të jetojnë në atë kujtesë. Por ne, të mbijetuarit, kemi një detyrim jo vetëm ndaj të vdekurve, por edhe ndaj gjeneratave të ardhshme: ne duhet t'u kalojmë atyre përvojat tona, në mënyrë që ato të mësojnë prej tyre. Ne kemi për detyrë të bëjmë që brezat e rinj të kuptojnë se sa e veçantë, se sa e pabesueshme, se sa e pazakontë ka qenë periudha e Holokaustit, ndonëse mund të jetë shumë e vështirë për ta t'i pranojnë tregimet tona si të vërteta. E pakapshmjia mbetet e pakapshme... Ne duhet t'u kalojmë gjeneratave të ardhshme përvojën tonë, në mënyrë që ata të përfitojnë prej saj. Informacioni është mbrojtje.

“Nuk mjafton që gjithçka të regjistrohet në libra. Një libri, ndryshe ndaj një personi, nuk mund t'i bëhen pyetje. Një dëshmitar është një dëshmitar i gjallë. Prandaj, në takime me të mbijetuar, kam thënë gjithnjë: ‘Ju keni fëmijë, ju keni nipër e mbesa, ju duhet të flisni me ta. Ju duhet t'u thoni atyre gjithçka keni provuar dhe t'i nxisni ata t'ju bëjnë pyetje’. Tregimet gojore ndihmojnë shumë që kujtesa të mbahet gjallë. Luftëtarët e rezistencës nuk duhet të kënaqen me përkujtime të rezistencës së asaj kohe, ata duhet të tregojnë rezistencë edhe sot. Ka edhe sot diktatura çnjerëzore që dhunojnë njerëz.

“Duhet t'i themi popullit se si gjenerata jonë e nënvlerësoi Hitlerin dhe nacionalsocializmin dhe se si besimi ynë në progres, në kulturë, në drejtësi dhe në miqësi u zhvlerësua shumë shpejt. Gjenerata jonë që shumë e pakujdesshme në fillim, ne ndiqnim në heshije daljen e partive naziste në vende të cilat Hitleri i kishte planifikuar t'i godiste, në vende ku shumica ndërsehej ndaj pakicave dhe populli hutohej dhe nuk shihte rrezikun kryesor”.

Filozofia e Vizentalit është e bazuar në traditën judaiste e cila pranon, vlerëson dhe ka parasysh lidhjen e fortë midis së shkuarës, së tashmes dhe së ardhshmes, sipas së cilës tek e tashmja ka elementë të së shkuarës dhe tek e ardhmja do të ketë elementë të së tashmes; se, as e tashmja dhe as e ardhmja nuk janë të sigurt, pa pasur parasysh të shkuarën. Botëkuptimi judaist e konsideron të shkuarën si shumë të rëndësishme dhe e ruan atë me fanatizëm. Hebrenjtë nuk janë nga ata që thonë: “Të shohim përpara, se po pamë mbrapa, ose mbetemi në vend, ose shkojmë mbrapa”. Jo, ata thonë: “Të ecim përpara, duke shikuar mbrapa, sepse ashtu shkojmë të sigurt përpara”. Kjo është ecja e kujdesshme, tjetra, ajo që sheh vetëm përpara, pa parë as anash, pa le më mbrapa, është ecje kuturu. Hebrenjtë kanë mbi dy mijë vjet që njohin një histori të tyre të kanonizuar mbi të cilën nuk guxon njeri të vërë dorë, ta rishikojë apo ta ndryshojë. Ata festojnë të njëjtat festa, festivale e përkujtime. Ata nderojnë të njëjtët persona e heronj; ata përkujtojnë paraardhësit e tyre, prindërit e tyre, më me kujdes nga ç'festojnë të tjerët të porsalindurit, apo ditëlindjet. Ndryshe nga shumë popuj të tjerë, për të mos folur për popuj pa baza, për popuj majmunë, hebrenjtë sot kanë të njëjtat emra që kanë pasur edhe dy mijë vjet më parë, kanë të njëjtën gjuhë, kanë të njëjtat shkronja, kanë të njëjtën fe, kanë të njëjtat zakone. Kjo i ka bërë ata të kenë identitet plotësisht të përcaktuar, të kenë lidhshmëri në qenien e tyre, lidhshmëri midis brezave. Kjo i ka bërë ata të dallueshëm prej të tjerëve. Historia e tyre, për nga kohëzgjatja, është e krahasueshme vetëm me atë të indianëve. Shumë kultura që kanë lulëzuar në kohë të shkuara, sot nuk kanë trashëgimtarë. Judaizmi, sikurse

hinduizmi indian, jeton dhe jeton në të njëjtin popull, paçka se shumë prej e atij populli është pa atdhe.

Parim kryesor i judaizmit është drejtësia, ndryshe nga ai i krishterimit që është mëshira. Ligjet e drejtësisë së judaizmit janë të përcaktuara me përpikëri dhe konsiderohen të shenjta. Bazat e tyre janë dhënë mbi dy mijë vjet më parë në librin e tyre të shenjtë “Tora”, libër që mund të konsiderohet si Kushtetuta e tyre. Ato baza janë zgjeruar më tej nga dijetarët e tyre për të përfshirë çdo fushë të jetës, duke marrë formën e kodeve civile a penale që nuk mund të lëvizin, apo të ndryshohen prej askujt.

I nisur nga dy parimet apo karakteristikat e judaizmit: nga kujtesa dhe nga drejtësia, ndofta edhe pa vetëdije, Vizentali hebre, por jo fetar, punoi dhe kërkoi që Holokausti të mos harrohej dhe mbi kriminelët që e kryen atë të veprohej dhe të veprohej me drejtësi. “Kujtimi i së keqes bëhet mburojë ndaj vetë së keqes”, thotë Eli Vizel (Elie Wiesel).

Drejtësia judaiste i kërkonte fajtorit më shumë se pranimin e fajit, apo kërkesën e ndjesës, ajo i kërkonte atij ndëshkim në përputhje me shkallën e fajit apo të kimit, në përputhje me shkallën e dëmit që ka bërë. Për Vizentalin, drejtësia e kriminelëve nazistë do të realizohej përmes gjykatave. Ai thoshte: “Kuptimi i jetës sime do të realizohet atëherë, kur vrasësit e nesërm, ata që ndofta nuk kanë lindur ende, të kuptojnë se nuk do të gjejnë qetësi. Ky paralajmërim është me shumë rëndësi për gjeneratat e ardhshme”. Ai përsëriste se asnjë vrasës nazist, sado i moshuar që të ishte, nuk duhej lejuar që të vdiste në paqe, nuk duhej lejuar që të vdiste pa u gjykuar dhe pa dhënë llogari, nuk duhej të vdiste duke marrë me vete sekretet e krimeve të tij, nuk duhej të vdiste pa marrë vesh të tjerët se ç’ mizori kishte kryer.

Në shtatëdhjetepesëvjetorin e ditëlindjes, gruaja iu lut Vizentalit që t’i linte punët, të cilave u qe përkushtuar deri atëherë dhe të fillonte një jetë normale si gjithë të tjerët për vitet që i kishin mbetur. Por, për të, ai “normalitet” konsiderohej tradhti. Ai ishte i vendosur që të ecte përpara drejt asaj që kishte nisur: drejt gjetjes dhe dhënien drejtësisë së kriminelëve nazistë, bërjes së qartë të brezave të rinj se ato që harroheshin, përsëriteshin. “Që nga çlirimi nuk ka pasur asnjë ditë që të kem harruar se kam qenë një i mbijetuar, - thotë Vizentali. - ...Unë i shpëtova Holokaustit dhe jam munduar të ruaj kujtesën e të vdekurve... E shoh atë që po bëj si një paralajmërim për vrasësit e nesërm, si një paralajmërim që ata të mos gjejnë paqe.”

Për Vizentalin, gjykimi dhe ndëshkimi i kriminelëve duhej të ishte individual dhe jo kolektiv. Edhe pse ndëshkimi nuk do të mundte kurrë të shlyente veprat monstruoze të nazistëve, dalja e së vërtetës, ndërgjegjësimi i botës për ato që ishin kryer, do të vlente si një masë mbrojtëse që ato të mos përsëriteshin më. Edhe pse kërkonte ndëshkim për kriminelët nazistë, dënimin kapital nuk e ka pranuar.

Vizentali nuk pati ndonjë shkollë, specializim a përvojë për punën që do të kryente. Puna që nisi, e specializoi. Ai nuk punoi për ndonjë forcë policore, për ndonjë qeveri apo agjenci private. Ai punoi në një zyrë të varfër dhe me kontribute vullnetare mbante veten dhe punën. Ndhimësit e tij punonin gati falas, por besonin në punën që kryenin. Kur njerëz të ndryshëm shkonin në zyrën e tij për të treguar

historitë e tyre, vinin re se ai i dëgjonte me shumë emocione. Ai qante bashkë me ta, ai nuk i përpunonte historitë e tyre, ai i jetonte ato. Ai mund të rrinte kohë të gjatë me një person që tregonte ngjarje nga jeta e tij edhe kur ato ngjarje nuk paraqitnin ndonjë rëndësi të përgjithshme, apo rëndësi për hetim. Ai krijoi një arkiv të dëshmimeve të ish-të burgosurve të kampeve të përqendrimit. Informacioni i mbledhur dhe i sistemuar aty do të vihej në dispozicion të gjyqeve që do të zhvilloheshin më pas ndaj kriminelëve nazistë. Përveç dëshmimeve që mundi të grumbullonte nga shumë persona, ai pati dhe përvojën e tij të kampeve, ku kaloi gati të gjithë periudhën e luftës. Ndonëse në kampet naziste iu shuan afro 90 pjesëtarë të familjes së tij dhe të gruas, ai nuk foli kurrë për hakmarrje personale dhe nuk u mor kurrë me të. Çdo fakt e çdo dëshmi që mblidhte, ai ia kalonte gjyqeve.

Vizentali mbajti lidhje me shumë luftëtarë të rezistencës të cilët i sillnin informacion për ata që kërkoheshin. Kur ata i kërkonin që, po t'i lejonte, të mund t'i vrisnin drejtpërsëdrejti nazistët e gjetur, Vizentali nuk pranonte. Ai u thoshte se drejtësia ishte më e rëndësishme se hakmarrja: “Ne duhet të tregojmë se nuk jemi si nazistët. Ligji dhe drejtësia duhet të jenë baza e ndëshkimit dhe jo hakmarrja”. Vizentali ndoqi dhe paditi jo vetëm ata kriminelë që kishin kryer krime ndaj hebrenjve, por edhe ata që kishin kryer krime ndaj të tjerëve. Në vitin 1993, pas një pune të gjatë të ndjekjes së kriminelëve nazistë, Vizentali i tha botës: “Për të mirën tuaj, mësoni nga tragjedia jonë. Nuk ka ndonjë ligj të shkruar se viktimat e ardhshme do të jenë përsëri hebrenj. Mund të jenë edhe të tjerë. Ne pamë se tragjedia filloi në Gjermani me hebrenjtë, por nuk shpëtuan edhe popuj nga afro njëzet kombe. Kur e fillova këtë punë, thashë: ‘Do të kërkoj vrasësit e të gjitha viktimave, jo vetëm të hebrenjve. Do të luftoj për drejtësi pa pushim, detyrimi moral nuk ka cak’”.

Vizentali kërkonte që çdo gjë që kishte ndodhur në të shkuarën të shpallej, pa marrë parasysh se disave mund të mos u pëlqente. Për të, nuk duhej mbajtur asnjë e fshehtë, në qoftë se do të kërkoheshin që të këqijat të mos përsëriteshin. “Nuk ka zgjidhje tjetër, përveçse t'i hidhemi së shkuarës dhe të mësojmë prej saj. Nuk ka kuptim të zvogëlojmë fajin, në mënyrë që të jetë më e lehtë për bijtë dhe bijat e kriminelëve që të pranojnë punët e ndyra të nënave, baballarëve, gjyshërve, gjysheve të tyre...”

“Historia e njerëzimit, - thotë Vizentali, - është historia e krimeve të përsëritura. Kështu, informacioni merr rëndësinë e mbrojtjes. Me anë të tij ne mund të ndërtojmë dhe duhet të ndërtojmë sigurinë ndaj përsëritjes”. Dhe, më pas, shton: “Shkolla mund të dështojë përmes heshtjes së saj, kisha përmes mëshirës së saj dhe shtëpia përmes mohimit dhe heshtjes së prindërve. Gjenerata e re duhet të dëgjojë dhe të dijë atë që gjenerata e vjetër refuzon ta tregojë”. Për Vizentalin e keqja nuk ishte mundur përfundimisht. Ai paralajmëronte: “Urrejtja mund të ushqehet kudo, idealizmi mund të kalojë në sadizëm kudo... Kombinimi i urrejtjes me teknologjinë është rreziku më i madh që kërcënon njerëzimin... Dhuna është si bari i keq që nuk thahet edhe në thatësinë më të madhe”.

Vjetari biografik i vitit 1975 e karakterizonte Vizentalin në këtë mënyrë:

“Me mprehtësi inxhinieri, me seriozitet talmudisti, me talent të jashtëzakonshëm për mendim investigativ, ai bashkon pjesë të errëta, të mangëta e, në dukje, të parëndësishme e pa lidhje, dhe me to ndërton padi të forta për t’u bërë ballë kërkesave të gjyqeve. Dosjet e përpiluara në këtë mënyrë, u paraqiteshin autoriteteve përkatëse. Kur, ashtu siç ndodhte shpesh, gjyqet nuk vepronin, qoftë nga indiferenca, qoftë nga ndjenjat ende naziste, apo për arsye të tjera, ai i drejtohej opinionit publik përmes gazetave dhe mjeteve të tjera të komunikimit. Ai e dinte se publiciteti dhe opinionit publik ishin armë të fuqishme”.

Pas Gjyqit të Nurembergut nga fundi i viteve 1940, Vizentali mbeti zëri i vetëm dhe këmbëngulës për gjykimin e të gjithë atyre që kishin kryer krime, sidomos kur fuqitë botërore filluan të mendonin më shumë për Luftën e Ftohtë, sesa për përfundimin e punës me nazistët. Ato fuqi në këtë kohë, u munduan të shfrytëzonin më shumë e më mirë specialistët nazistë për qëllimet e tyre.

Martin Mendelson, një jurist amerikan që ndihmoi në krijimin e Zyrës së Hetimeve të Posaçme për Nazistët brenda Departamentit të Drejtësisë së qeverisë amerikane, ka thënë: “Vizentali mbajti të gjallë kujtesën e Holokaustit kur secili donte të largohej. Kjo është arritja e tij më e madhe”.

Kur fillon, dëgjon, apo studion mbi atë që kryen nazistët gjermanë, pyetja e parë që do të bësh është: a ka lidhje natyra e gjermanit, personaliteti i tij, me krimin? A është populli gjerman më i predispozuar se popujt e tjerë për t’u bërë kriminel? Nuk është e lehtë për t’u përgjigjur. Dhe, pastaj, kur mendon se ato mizori u kryen nga një popull që kishte arritur majat më të larta të kulturës, që i kishte dhënë botës shembuj të shkëlqyer arritjesh në të gjitha fushat, nga një popull që ishte tejet i edukuar e tejet i mësuar, përgjigjja bëhet edhe më e vështirë. Dhe, kur, përsëri mendon e pyet se si ishte e mundur që një popull si ai të adhuronte, të hyjnizonte e të ndiqte deri në vdekje teoritë dhe përpjekjet e një njeriu të paekuilibruar e kriminel, të Hitlerit, për të krijuar një rend të ri botëror “shumë të avancuar”, në qendër të të cilit do të ishte raca gjermane, gjaku gjerman, dhe të tjerët ose do të shfaroseshin, ose do të ishin skllëvërit modernë të tyre, mbetesh krejt pa gojë.

Për shkak të natyrës së punës që bënte, shumë herë Vizentalit i është kërcënuar jeta dhe është udhëzuar nga miqtë ta linte punën që kishte nisur. Ai nuk u tërhoq. Ai thoshte: “Kur shoh nipërit e mbesat, më vijnë ndër mend shumë të tjerë si ata, por që u vranë. Dhe pastaj mendoj se si do të mund t’i shpëtoj ata nga një kohë e ngjashme... I them gruas: ‘Shihi këta fëmijë, a nuk është detyra jonë të bëjmë ç’është e mundur që ajo që ndodhi të mos përsëritet?’... dhe, pastaj, gruaja më thotë: ‘Përse vetëm ti, përse jo të tjerët?’”.

Një hebre, një ish-të burgosuri të Mathauzenit, i cili, duke u marrë me argjendari, ishte pasuruar mjaft, që qortoi Vizentalin, pasi, sipas tij, kishte bërë gabim që nuk vazhdoi të punonte si arkitekt, të ndërtonte pallate e të ishte bërë milioner, Vizentali iu përgjigj: “Ti je fetar. Ti beson te Zoti dhe te jeta pas vdekjes. Edhe unë besoj. Kur të shkojmë në atë botë e të takojmë miliona hebrej që vdiqën nëpër kampe, të gjithë do të na pyesin se ç’kishte bërë secili prej nesh në këtë botë. Në do t’u tregojmë: ti do t’u thuash se u bërë argjendar i suksesshëm dhe u pasurove mjaft, një tjetër do t’u thotë se ishte pasuruar duke marrë kafe dhe cigare

kontrabandë nga Amerika, një i tretë do t'u thotë se kishte ndërtuar shtëpi e pallate. Unë do t'u them se nuk i harrova”.

Mendohet se pa aktivitetin e Vizentalit në ndjekje të kriminelëve, pavarësisht nga koha dhe nga vendi, nuk do të kishte as gjyqe për kriminelët e luftës për ish-Jugosllavinë, as për Ruandën. Krijimi i gjyqit të përhershëm ndërkombëtar për kriminelët e luftës në Hagë në vitin 2002, është i lidhur drejtpërdrejt me punën e Vizentalit, që ai e filloi që në vitin 1946. Ai gjyq do të bëjë që, edhe pse nuk do të çohen dot para drejtësisë të gjithë kriminelët, frika e dënimit do t'u rrijë e varur mbi kokë, ajo frikë do të jetë njëfarë ndëshkimi për ta dhe në njëfarë mënyre do të shkurajojë krime të tjera para se të ndodhin. Vizentali demonstroi se si një person i vetëm mund të ndikojë në ndryshimin e gjërave të rëndësishme për botën.

Mendoj se vlera kryesore e Vizentalit, përveç punës që bëri për gjurmimin e kriminelëve dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë, është dhe paanësia e tij. Ndryshe nga shumë hebrenj të tjerë, edhe nga ata më të shquarit, për Vizentalin viktima të nazizmit nuk ishin vetëm hebrenjtë, por edhe shumë të tjerë nga etni, fe e raca të tjera. Për Vizentalin, ashtu sikundër kishte gjermanë të këqij, kishte edhe gjermanë të mirë dhe, siç kishte hebrenj të mirë, kishte edhe hebrenj të këqij. Kjo paanësi e futi atë edhe në konflikt me fanatikë hebrenj e judaistë, por ajo paanësi e bëri atë edhe më të besueshëm.

Ilir HASHORVA

KRONIKA SHKENCORE**OLIVERA JASHAR-NASTEVA - NJË INSTITUT MË VETE
BALLKANOLOGJIE****Në 15-vjetorin e vdekjes**

Olivera Jashar-Nasteva (1922, Beograd – 2000, Shkup), dijetare me formim të përfillshëm ballkanologjik, e diplomuar në romanistikë, njohëse e shkëlqyer e sllavishteve, e shqipes, e turqishtes dhe e disa gjuhëve të tjera, pa dyshim zë një vend të merituar edhe në albanologjinë shkencore. Ajo ka prekur dhe ka hulumtuar me kompetencë edhe probleme dhe mistere të gjuhës shqipe dhe ka arritur rezultate të përfillshme në kërkimet filologjike shqiptare, që e bëjnë atë të jetë një figurë e nderuar në albanologji.

Akad. Olivera Jashar-Nasteva ishte bijë e Emin Beut, pjesëmarrësit në Kongresin e Manastirit (1908). Shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Shkup, maturi në Beograd më 1941. Studimet i filloi pas Luftës në Beograd, kurse i mbaroi në Shkup, kur më 1945 diplomoi në Grupin e Gjuhës dhe të Letërsisë Frënge në Fakultetin Filozofik.

Gjatë kohës së studimeve dhe pasi ishte diplomuar punoi si profesoreshë e gjuhës frënge dhe e gjuhës maqedonase në disa shkolla të mesme të Shkupit. Në vitin 1959 zgjidhet asistente në Katedrën e gjuhëve sllavojugore dhe ballkanike. Në qershor të vitit 1962 mbron disertacionin e doktoratës më temë *Turski leksički elementi vo makedonskiot jazik (Elementet leksikore turke në gjuhën maqedonase)*. Dy vjet më vonë, më 1964, zgjidhet docent për lëndën e Historisë së gjuhës maqedonase, Profesor inordinar më 1959, Profesor ordinar më 1975. Për shumë vjet ligjëroi edhe kursin e gjuhësisë së përgjithshme për studentët e shkallës së dytë dhe të tretë. Në vitin 1979 zgjidhet anëtare me korrespondencë e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, kurse më 1983 anëtare e rregullt e kësaj Akademie (MANU).

Interesimi shkencor i akademikes Nasteva përqendrohet në disa fusha: ndikimi i turqishtes dhe i gjuhëve të tjera ballkanike në leksikun dhe idiomatikën e maqedonishtes dhe teoria e gjuhësisë kontrastive në rrafsh më të gjerë, historia e gjuhës maqedonase dhe nivelet sociolinguistike të zhvillimit të saj dhe historia kulturore e maqedonishtes në shek. 19, organizimi i fondit leksikor të maqedonishtes, kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike etj. Bibliografia e punimeve të saj studimore arrin fondin prej 150 zërash bibliografikë, studime të përfillshme që rrokin një spektër të gjerë tematik, shumica syresh me reflektime edhe për shqipen dhe për problematikën shqiptare. Në këtë fushë studimore vlen të përmendim kontributet me vlerë për albanologjinë të akad.. Nasteva: *Razvojot na dijalektната leksika vo uslovi na jazično mešanje (vrz osnova na turski-makedonski i tursko-albanski kontakti vo Gostivarsko)*, Makedonski jazik, Skopje, 1980; *Razvojot na dijalektната leksika vo uslovi na jazična interferencija (Bogatenjeto na albanskite, romanskite i turskite govori vo SR Makedonija)*, Makedonski jazik, Skopje, 1983; *Vlijanieto na makedonskiot jazik vrz albanskite i turskite govori vo*

Makedonija, Makedonski jazik XIII, 2, str. L47-l64; *La phraseologie macedonienne dans le contexte balcanique* (Frazeologjia maqedonase në kontekstin ballkanik) – në bashkautorësi me B. Koneskin dhe B. Vidoeskin, ku shembujt frazeologjikë jepen edhe në përqasje me shqipen, te *Prilozi (Contributions)*, MANU, 1981; *Za rečnicite na Gjorgji Pulevski i albanskata paralela vo niv*, Prilozi IX, MANU, Skopje, 1984; *Za Skenderbeg kaj Grigor Prličev*, te Simpoziumi për Skënderbeun, 9-12 maj 1968, Prishtinë, 1969. Në lëmin e dialektologjisë sociale akad. Olivera Jashar-Nasteva e bën objekt të vetin kërkimor elementin e shqipes në gjuhët e fshehta të maqedonishtes: *Albanski zborovi vo makedonskite tajni jazici*, Makedonski jazik IV, 1953, nr. 3, nr. 4, 5-6. Argotë e maqedonishtes, siç ka vënë re Nasteva, “vlojnë” me fjalë shqipe, sikurse dhe argotë e gjuhëve të tjera ballkanike.

Punimet studimore të akad. Olivera Jashar-Nasteva, si për metodologjinë shkencore dhe si për thellësinë mendimore dhe objektivitetin, mund të thuhet se janë drejtimdhënëse për të gjithë filologët që do t'i referohen problematikës ballkanike. Ajo hedh dritë të re edhe në albanologji.

E përgatitur mirë me njohjen teorike dhe me përdorjen praktike të shqipes dhe të gjuhëve të tjera ballkanike, njohuritë dhe erudicionin e saj që zotëronte në albanologji dhe në ballkanologji kjo dijetare e rryer ua shpërndau edhe studentëve të Degës së Albanologjisë në Fakultetin Filologjik të Shkupit, ku prej shumë vjetësh ligjëroi kursin e dialektologjisë shqiptare dhe gjuhësinë e përgjithshme.

Kontribut të veçantë Nasteva ka dhënë sidomos në lëmin e studimeve të elementit të huazuar nga turqishtja në gjuhën dhe në letërsinë popullore të maqedonishtes. Në këtë fushë ajo kishte mbrojtur temën e disertacionit të doktoratës *Turski leksički elementi vo makedonskiot jazik, 1962*. Ky punim i thelluar studimor botohet si monografi më vete në vitin 2002 (ah sikur të kishim një monografi të tillë edhe për elementin leksikor të turqishtes në gjuhën shqipe!). Në këtë vazhdë boton edhe një radhë studimesh me vlerë dhe të vëllimshme për kalket: *Makedonski kalki od turskiot jazik*, Makedonski jazik, Skopje, 1962/63, f. 109-172; *Turski elementi vo jazikot i stilot na makedonskata poezija*, MANU, Skopje, 1987. Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë (MANU) akad. Nasteva ishte udhëheqëse e projektit *Rečnik na turcizmi vo makedonskiot jazik (Fjalor i turqizmeve në gjuhën maqedonase)*, ku me dorën e saj të sigurt ky fjalor, kur të botohet, do të jetë pa dyshim një vepër themelore jo vetëm për këto dy gjuhë, por edhe për ballkanologjinë.

Për kontributin e madh që kishte dhënë në fushën e kërkimeve turkologjike në truallin e Maqedonisë dhe të Ballkanit, akademikja Olivera Jashar-Nasteva në vitin 1991 zgjidhet anëtare e Akademisë Turke të Shkencave (Turk Dil Kurumu).

Akad. Olivera Jashar-Nasteva ishte shkencëtare dhe pedagoge model, që reflektoi gjithë urtësinë dhe objektivitetin prej dijetareje. Ajo ishte një Institut më vete Ballkanologjie. Kjo jo vetëm për atë, siç ma ka thënë edhe vetë gojarisht: se ishte me rrënjë atësie shqiptare, amësie sllave dhe burrërie vllëhe, por edhe për profilin e saj dhe për kontributin e çmuar në ballkanologji. Akad. Olivera pata pata fatin ta kisha anëtare të Komisionit për mbrojtjen e disertacionit tim të doktoratës në Prishtinë (1989), ku nga qëndrimi dhe elokuenca e saj e shkëlqyer kishim mundësinë të mësonim të gjithë se si bëhet një mbrojtje dinjitoze doktorate. Dhe

për paraqitjen e fjalës së saj, më kujtohen si sot edhe fjalët e anëtarit tjetër të Komisionit, prof. Besim Bokshit, që thoshte për të: “Ajo Zonjë na mbuloi të gjithëve!”. Në kontaktet disahovesh që kam pasur me akademikën Olivera Jashar-Nasteva, patëm diskutuar edhe nevojën dhe mundësinë e botimit të veprës së saj të përzgjedhur në gjuhën shqipe dhe mora pëlqimin se do të ishte në nderin e saj që vepra madhore të botohej edhe në këtë gjuhë. Albanologjia ia ka borxh shkencëtares së mirënjohur ta ketë në objektivat dhe në sirtarët e vet. Ajo shumë herë e ka mbrojtur albanologjinë nga sulmet meskine të politikës pseudoshkencore sllave, sidomos në fushatën e tërbuar kundërshqiptare pas vitit 1981, kur edhe qarqet filologjike akademike maqedonase u vunë në shërbim të ideologjisë etatiste maqedonase dhe me një patologji të pashembullt histerike dekretinin që toponimet shqipe të përdorshin me forma sllavomaqedonase! Akademikja Olivera diti ta ndajë mirë linguistikën nga politika, një gjë që pakkush e bën në këto hapësira tonat ballkanike, përveç shkencëtarëve të rrallë të racës.

Ndonëse akad. Olivera Jashar-Nasteva pati botuar nëpër revista prestigjioze, ballkanike e ndërkombëtare, qindra artikuj studimorë të vëllimshëm dhe substancialë, me standard linguistik intelektual të rrallë, ajo nuk botoi për të gjallë të saj asnjë vepër a vëllim të veçantë, nuk u rrëmbye pas titujve dhe numrit të veprave – të cilat sigurisht se do të ishin të shumëvëllimshme.

Disa punime studimore të kësaj lingvisteje të rendit të parë u përkthyen dhe u botuan edhe në gjuhën shqipe, si të *Gjurmime albanologjike*, *Gjuha shqipe*, *Shqyrtime albanologjike* etj. Shtëpia botuese Logos-A e Shkupit ndërmori të botojë një pëmbledhje punimesh studimore të kësaj lingvisteje të shquar *Kontaktet linguistike në hapësirat ballkanike* (1998), të përkthyer në gjuhën shqipe, e cila u mirëprit në rrethet shkencore dhe studentore. Kjo vepër gjuhësie është nga ato të rrallat në të cilën çështjet komplekse ballkanologjike shtjellohen ashtu thjesht, ashtu qartë dhe përgjithësisht ashtu në mënyrë shkencore, sa e bën atë burim referencial të dorës së parë.

Qemal MURATI

AKTIVITETET DHE BOTIMET SHKENCORE TË ITSHKSH NË VITIN 2014

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup (ITSHKSH) në vitin 2014 ka dëshmuar se tashmë është institucion i konsoliduar dhe i etabluar në kuadër të sistemit shkencor dhe arsimor të Maqedonisë, ka dhënë prova të shumta se është një institucion i hapur për bashkëpunim me institucionet shkencore të vendit dhe rajonit si dhe ka përmbushur me përpikëri planin e punës, të parashikuar në fillim të vitit që lamë pas. Që në fillim nënvizojmë faktin që të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara janë bërë realitet falë energjisë së palodhur të punonjësve shkencorë të ITSHKSH-së dhe ndihmës së pamohueshme të Komunës së Çairit, por edhe disa organizatave të tjera siç është organizata e respektuar ZFD nga Gjermania, dhe Shtëpia Botuese “Logos A”, pasi pa ndihmën e tyre ne nuk do të mund të lëvizim nga pika zero. Nuk ka munguar edhe mbështetja konkrete e projekteve nga Ministria e Kulturës, megjithatë meqë ITSHKSH-ja është themeluar dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, presim që gjatë vitit 2015, por edhe në të ardhmen ky dikaster të ndihmojë më fuqishëm realizimin e projekteve të shumta, të cilat i janë dorëzuar në formë zyrtare.

Në vazhdim do të referojmë lidhur me aktivitetet e realizuara. Vitin 2014, Instituti e nisi me një udhëtim të disa studiuesve, sikur për të paralajmëruar se e pret një rrugëtim i gjatë, por jo edhe pa sfida dhe vështirësi, meqë ato na kanë përcjellë gjatë punës sonë vazhdimisht. Prej 11 deri më 22 janar të vitit 2014 tre punonjës shkencorë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, ish-drejtori Shefqet Zekolli, drejtori aktual Skender Asani dhe asistenti hulumtues Ardian Limani ishin pjesë e grupit prej dhjetë anëtarësh nga Maqedonia që qëndruan në vizitë studimore në SHBA, në kuadër të programit ndërkombëtar për vizitorë dhe udhëheqës: “Ballafaqimi me të kaluarën – historia dhe politika”. Vizita studimore është zhvilluar në disa qytete amerikane, me sponsorizim të Departamentit të Shtetit Amerikan, përkatësisht Zyrës për çështje edukative e kulturore. Ndoshta për shkak të simbolikës që ka godina e ITSHKSH, edhe aktiviteti i dytë lidhet me miqtë amerikanë. Gjatë qëndrimit të tij në Shkup, ish-diplomati amerikan në Maqedoni, Xhejms Pardju, realizoi një vizitë në Institut. Pardju, i cili ishte është edhe njëri nga ndërmjetësuesit kryesor ndërkombëtar për arritjen e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, u takua me drejtuesit dhe të punësuarit e ITSHKSH-së, dhe më pas edhe para një numri të mysafirëve të ftuar, mbajti një ligjëratë lidhur me Marrëveshjen e Ohrit dhe proceset politike në Maqedoni dhe rajon. Nuk ka asnjë dyshim se Instituti ynë është mbështetës i vazhdueshëm i Muzeut të Manastirit. Në bashkëpunim me Institucionin Nacional “Muzeu i Alfabetit Shqip” në Manastir, me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, u organizua tribuna shkencore, në të cilën u përkujtua 120- vjetori i vdekjes së mësuesit Gjerajim Qiriazhi. Drejtori i mëparshëm i Institutit, Dr. Shefqet Zekolli, i shoqëruar nga disa bashkëpunëtorë shkencorë, foli për rëndësinë e kësaj date të rëndësishme për historinë tonë kombëtare, duke theksuar kontributin e madh të familjes Qiriazhi në ngritjen e arsimit shqip. Përveç projekteve hulumtuese

shkencore, Instituti synon promovimin e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve para të rinjve, me qëllim që të ruhet tradita jonë kombëtare, e kultivuar shekuj me radhë. Pikërisht për këtë qëllim në maj të vitit të kaluar në ambientet e Gjimnazit “Zef Lush Marku” në Shkup u realizua projekti “*Vlerat e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve dhe identiteti kombëtar*”. Me këtë rast, para nxënësve dhe profesorëve të shumtë, studiuesit e ITSHKSH-së paraqitën tema të ndryshme dhe interesante, të cilat kryesisht kishin të bënin me kultivimin e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve në Maqedoni. Ky projekt synon promovimin dhe afirmimin e trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve para gjeneratave të reja, sepse vetëm duke e njohur vetveten, në kushtet e globalizimit, mund t’i njohim vlerat dhe identitetin e të tjerëve. Me mjaft interesim u përcoll edhe filmi dokumentar “*Një jetë në ikje – zejet në Maqedoni*”, me narrator Mr. Besnik Eminin. Në korrik Instituti ynë në bashkëpunim me Muzeun e Manastirit dhe Institutin Albanologjik në Prishtinë, në Qendrën e Kulturës në Manastir, organizuan tribunën shkencore “*Rëndësia e Sami Frashërit në zhvillimin e alfabetit shqip, gjuhës dhe letërsisë shqiptare si dhe zhvillimin e vetëdijesimit të shqiptarëve*”, në të cilën u trajtuan tema lidhur me kontributin historik, gjuhësor dhe letrar të këtij rilindasi. Kjo tribunë u realizua në kuadër të bashkëpunimit midis ITSHKSH-së dhe Muzeut të Manastirit, ndërsa u vendos që në të ardhmen dy institucionet të bashkëpunojnë lidhur me botimin e një reviste të Muzeut. Në 11 shtator të vitit të kaluar, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, me rastin e 100-vjetorit, organizoi konferencën shkencore me temë: “*Lufta e Parë Botërore 1914-1918*”. Organizimi i kësaj konference dhe zgjedhja e kësaj date jo pa simbolikën e saj, janë dëshmi se ne si studiues, veçmas të historisë, e kemi patjetër të jemi më vigjilentë me veprimet tona, më të ndërjegjshëm me deklaratimet tona dhe më të guximshëm në ndërmarrjet tona, që të mos lejojmë të na përsëritet e kaluara. Maksima jonë duhet të jetë se ai që lejon t’i përsëritet e kaluara, thjesht nuk ka marrë mësim prej saj. Në hapjen e konference morën pjesë ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilaqim Ademi, ambasadori i SHBA-ve, Poll Uolers, dhe ambasadorja e Gjermanisë, Kristine Althausen. Në dy sesione të konferencës shkencore punimet e tyre i lexuan studiuesit: Nebi Dervishi, Sabit Syla, Qerim Lita, Rudina Mita & Besnik Bajrami, Haki Kasumi, Memli Krasniqi, Mehmet Prishtina & Sylë Zhitia, Isak Sherifi & Skender Asani, Aleksandar Stojçev, Ylber Sela, Naim Halimi, Isamedin Azizi, Sevdail Demiri, Besnik Emini & Ardian Limani. Shtatori i vitit 2014 ka qenë mjaft produktiv për Institutin tonë. Në datën 30 shtator u organizua konferenca shkencore “*Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni*”. Ne konsiderojmë se përmes këtyre tubimeve shkencore, po dëshmohet se studiuesit tanë dhe vetë ky institucion, është etabluar si institucion i mirëfilltë shkencor, i cili edhe në të ardhmen do të vazhdojë të realizojë projekte të tilla. Në dy sesionet e konferencës, u paraqitën 19 kumtesa edhe atë nga Fatmir Sulejmani, Naim Halimi, Mixhait Pollozhani, Skender Asani, Qemal Murati, Zeqirja Neziri, Hamit Xhaferi, Nebi Dervishi, Sevdail Demiri, Bukuriye Mustafa, Izaim Murtezani, Bexhet Asani, Afrim Rexhepi, Hidajete Azizi, Rini Useini, Afet Jashari, Arlind Farizi dhe Sefer Tahiri.

Në vitin 2014 ka ndodhur ndryshim edhe në strukturën drejtuese të Institutit tonë. Bazuar në kompetencat ligjore, Këshilli i Institutit zgjodhi Dr. Skender Asanin për drejtor të ITSHKSH-së, i cili prej datës 30.06.2014, ishte ushtrues i detyrës së drejtorit. Zgjedhja e Asanit u bë njëzëri nga të gjithë anëtarët e Këshillit, përkatësisht me 6 votat e anëtarëve të brendshëm dhe 3 votat e anëtarëve të jashtëm të deleguar nga Qeveria e Maqedonisë. Nga aktivitetet e tjera veçojmë edhe atë që u mbajt me rastin e shënimit të *“Ditës ndërkombëtare të luftës kundër fashizmit dhe antisemitizmit”*. Në fakt Instituti në Qendrën Përkujtimore të Holokaustit në Shkup, me partnerët e vet më 10 nëntor nënshkroi Marrëveshjen për mirëkuptim dhe realizim të projektit *“Ballafaqimi me të kaluarën – guximi qytetar në kohë të vështira”*. Memorandumi u nënshkrua edhe nga drejtuesit e Institutit të Historisë Nacionale në Shkup, Komunitetit Hebre në Republikën e Maqedonisë dhe Qendrës Përkujtimore të Holokaustit të Hebrenjve të Maqedonisë. Projekti parasheh thellimin e bashkëpunimit në mes katër institucioneve, njëkohësisht të shërbejë edhe si shembull i respektimit dhe i mirëkuptimit ndëretnik dhe ndërjetar. Nënshkrimi i këtij memorandumi paraqet shprehje të dëshirës së përbashkët për parandalimin dhe ballafaqimin me urrejtjen dhe dhunën ndaj cilitdo grupi etnik apo fetar. Në Institut nuk janë realizuar vetëm projekte nga fusha e historisë apo trashëgimisë kulturore, por edhe nga fusha e gjuhësisë. Më 21 nëntor i zhvilloi punimet konferenca shkencore me temë *“Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë”*, ku punimet e tyre shkencore në konferencë i paraqitën studiuesit nga Shkupi, Prishtina e Tirana: Qemal Murati, Xhevat Lloshi, Emil Lafe, Dimitar Pandev, Ludmill Spasov, djali i profesorit të ndjerë, Bardhyl Demiraj, Haki Ymeri, Nexhip Merkuri, Bardhosh Gaçe, Naile Mala Imami, Myrvete Dreshaj – Baliu & Begzad Baliu, Kujtim Kapllani, Hysen Matoshi, Zeqirja Neziri, Agim Poloska, Asllan Hamiti, Mirushe Hoxha, Valbona Toska Ismet Osmani, Mustafa Ibrahimimi, Berton Sulejmani, Bukurije Mustafa, Hidajete Azizi dhe Zeqirija Ibrahimimi. Gjatë kësaj konference ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilaqim Ademi kumtoi edhe lajmin e shumëpritur nga Instituti. Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendosi të lejojë hapjen e tri programeve studimore të shkallës së magjistraturës, përkatësisht në Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe dhe Histori me marrëdhënie ndërkombëtare. Në bazë të këtij vendimi të Ministrisë në janar u shpall konkurs për regjistrimin e studentëve dhe tashmë studimet e magjistraturës kanë filluar dhe procesi arsimor po vijon normalisht dhe sipas dinamikës së parashikuar.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup ishte ndërmjetës në arritjen e marrëveshjes mes Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Qendrës Përkujtimore të Holokaustit të Hebrenjve në Maqedoni, e cila u nënshkrua më 15 dhjetor në Shkup. Me këtë rast, u hap edhe ekspozita me dokumente dhe fotografi me temë *“Nderi i njeriut”*, në të cilën u prezantuan dokumente dhe fotografi për sakrificën e popullit hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore. Më 12 dhjetor Instituti, i përkrahur nga Qendra Informativ Kulturore dhe Komuna e Çairit, shënoi 35- vjetorin e ndarjes së Çmimit Nobel të Paqes për shkupjanen shqiptare Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza. Ne po mundohemi me të gjitha mundësitë që t'i dalim borxhit Nënë Terezës për

aktivitetin e saj human, por edhe kombëtar, sepse ajo doli nga Shkupi dhe përmes saj ne dëshmojmë për autoktoninë tonë iliro-shqiptare.

Gjatë dhjetorit të vitit të kaluar Institutin e vizitoi një delegacion i arbëreshëve të Italisë, i udhëhequr nga dekani i Fakultetit Albanologjik të Universitetit të Kalabrisë dhe studiues i njohur i albanologjisë, Prof. dr. Françesko Altimari. Delegacioni u prit nga stafi shkencor i Institutit dhe drejtori Dr. Skender Asani, i cili theksoi se një nga qëllimet e këtij takimi është vënia e bazave të bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve të rëndësishme nga fusha e shkencave albanologjike.

Segment i veçantë i punës sonë është botimi i veprave shkencore dhe revistave në kuadër të institutit. Për herë të parë në historinë e shkencës, dy institute që trajtojnë historinë e dy popujve të ndryshëm, atij shqiptar dhe maqedonas, realizuan një projekt të përbashkët. Bëhet fjalë për botimin e përmbledhjes së kumtesave shkencore, në shqip dhe maqedonisht, në të cilën autorë shqiptarë dhe maqedonas shfaqën pikëpamjet dhe hulumtimet e tyre shkencore-historike mbi njëri nga ngjarjet e rëndësishme në historinë e vendit Kryengritjen e shtatorit. Po ashtu me ndihmën e organizatës ZFD botohet edhe përmbledhja “Identitete”, në të cilën studiues shqiptarë dhe maqedonas shfaqin mendimet e tyre mbi identitetin, historinë dhe kulturën e vendit.

Instituti me ndihmën e Ministrisë së Kulturës ka botuar veprën shkencore *”Probleme aktuale të gjuhës së sotme shqipe - E nesërmja e gjuhës shqipe përcaktohet sot”*, të studiuesit të mirënjohur Prof.dr. Qemal Murati. Kjo vepër si bosht të saj ka çështjet e kujdesit për gjuhën amtare, çka përbën një shqetësim të përhershëm të këtij autori. Vepra është ndërtuar si një mozaik katërpjesësh. Pjesa e parë titullohet “Gjuha si kod komunikimi dhe si kod emocional”, pjesa e dytë: “Biseda për shqipen standarde”, e treta “Mendime e meditime për gjuhën” dhe e katërta “Referenca filologjike”. Sipas profesorit Rami Memushaj kjo vepër përbën një prurje tjetër me vlerë të prof. dr. Qemal Muratit, e cila ka për qëllim që të vetëdijesojë folësit e shqipes, por edhe shtetet shqiptare, për nevojën e mbrojtjes së gjuhës shqipe nga ndërhyrjet në kodet e saj si dhe nga shkeljet e normave të këtyre kodeve në ligjërimin e shkruar e të folur. Instituti ka botuar edhe veprën shkencore të punonjësit shkencor të ITSHKSH-së, Dr. Zeqirija Ibrahimimi *“Interlinearis”*, që përkthehet si ndërmjet rreshtave - në kuptim të titullit të kësaj vepre nënkupton një libër që ka shtruar disa çështje (të ndërmjetme) të filologjisë, por jo vetëm. Në kapitullin e parë gjenden tekstet që kanë të bëjnë me gjuhën standarde në Maqedoni, pastaj vijnë disa tekste që, duke ndjekur modelin e studimeve që i ka realizuar në kuadër të gjurmimeve të tij- analizën e konektorëve të tekstit, përkatësisht të mjeteve të lidhjes së një teksti, nga qasja forenzike. Pjesa tjetër e librit të Ibrahimit ka të bëjë me disa interferime gjuhësore, stilistikën e gjuhës dhe transkriptimin e teksteve shqipe me alfabet arab.

Janë botuar dy numra, 9 dhe 10 të revistës “Studime Albanologjike”, me kryeredaktor Prof. dr. Qemal Muratin, në të cilën studiues të ndryshëm nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, historisë, folklorit, kulturës kanë sjellë para lexuesve tema të reja dhe interesante për opinionin shkencor. Si rrjedhojë e aktiviteteve të vitit 2014 u botuan numrat 7, 8 dhe 9 të revistës SCUPI, në të cilën botohen punimet

shkencore të prezantuara në konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta, tribuna apo simpoziume të organizuara nga Instituti. Në numrin 7 u botuan punimet e konferencës shkencore mbi 100- vjetorin e Luftës së Parë Botërore, në numrin 8 punimet e konferencës mbi figurën e albanologut të madh Shaban Demiraj, ndërsa në numrin 9 u botuan punimet e konferencës shkencore me titull “*Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni*”.

Gjatë vitit të kaluar është bërë edhe avancimi profesional-shkencor i punonjësve tanë shkencorë. Rini Useini mori titullin magjistër në fushën e folklorit, ndërsa Hidajete Azizi mori titullin doktor në fushën e gjuhësisë. Para Institutit, menaxhmentit, punonjësve shkencorë dhe administratës së tij gjenden shumë sfida dhe projekte, të cilat do të shtrihen në planin hulumtues-shkencor, arsimor dhe në atë të organizimit të konferencave shkencore. Synojmë që këtë vit të rrisim numrin e veprave shkencore, që do të botohen nga punonjësit shkencorë të Institutit. Konsiderojmë se në këtë mënyrë, duke vendosur nga një gur do të ndërtojmë kalanë e botimeve shqiptare, të domosdoshme për njohjen e vetvetes dhe më pas edhe të tjerëve.

(Referim i paraqitur në promovimin e punës njëvjeçare të ITSHKSH-së që u organizua më 24 mars të vitit 2015).

Sefer TAHIRI

MANIFEST PËR MBROJTJEN E SHQIPES

(*Preng Cub Lleshi, Mos e vritni fjalën shqipe, Tiranë, 2014*)

Gati tre vjet më parë “Shqiptarja.com” zbuloi se në rrethin e akademikëve do të bëhej një mbledhje e fshehtë e Këshillit Ndërakademik të Gjuhës Shqipe, ku do të projektoheshin ndryshime drastike në Gjuhën Letrare Shqipe dhe të Drejtshkrimit të 1972-shit. Debati zgjati me argumente pro dhe kundër, ndërsa projektet që ngriheshin në tryeza të ngushta, nuk po bëheshin transparente më media.

Të mbështetur edhe nga politika e kohës, ndryshimet ishin gati të merrnin aprovimet në formën ligjore. Anëtarë të Këshillit Ndërakademik si Emil Lafe, Gjovalin Shkurtaç, Rami Memushaj e të tjerë dhanë dorëheqjen nga kryesia e KNGJSH, por kjo vetëm sa u hapi rrugën disave prej vendimeve të gabuara në dëm të gjuhës shqipe. Nuk mbeti zgjidhje tjetër, dhe të dorëhequrit e ngritën zërin në media.

Çështja u kthye në një protestë publike dhe akademike mbarëkombëtare. Studiues të shquar të diasporave shqiptare në Itali, si Matteo Mandala, Francesco Altimari, akademikë e gjuhëtarë të njohur në Kosovë, si akademiku Rexhep Qosja, Shefkije Islamaj, Qemal Murati, e në Shqipëri gjuhëtarët Memhmet Çeliku, Rami Memushaj, Gjovalin Shkurtaç e të tjerë krijuan terrenin për një debat të madh publik e intelektual për mbrojtjen e gjuhës shqipe, duke ua prerë vrullin këtyre ndërmarrjeve absurde.

Preng Cub Lleshi, një nga delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në vitin 1972, pjesëmarrës në komisionin e hartimit të rregullave drejtshkrimore, ngriti zërin kundër ndryshimit të gjuhës së njësuar dhe në intervistat e tij në media solli me argumente shkencore arsyet se pse duhej mbrojtur Drejtshkrimi i '72-shit. Gjatë periudhës ku dolën këto probleme, nisi sensibilizimi i gjuhëtarëve për krijimin e një shoqate kombëtare për mbrojtjen e gjuhës shqipe. Pas dy vjetësh përpjekje, Shoqata Kombëtare për Mbrojtjen e Gjuhës Shqipe ka fituar të drejtat ligjore të veprimtarisë së saj. Dje, kjo shoqatë e nisi aktivitetin e parë me promovimin e librit të Preng Cub Lleshit “*Mos e vritni fjalën shqipe*”. Promovimi i librit të Preng Cub Lleshit u mbajt në Fakultetin Filologjik në Tiranë, në praninë e dhjetëra gjuhëtarëve e studiuesve të shquar nga Shqipëria e Kosova. Libri i Preng Cub Lleshit u çmua nga akademikët dhe gjuhëtarët për misionin që përmbush në një situatë të tillë. Profesor Rami Memushaj e quajti situatë krize të gjuhës shqipe.

Gjuhëtari i njohur Memushaj vlerësoi edhe faktin që gazeta “Shqiptarja.com”, “ka qenë një nga gazetat e para që ka hapur faqet e saj për të sensibilizuar opinionin mbarë për rrezikun që po i vinte gjuhës shqipe”. Studiues dhe gjuhëtarë të shquar si Shpëtim Çuçka, Qemal Murati, Gjovalin Shkurtaç, Mark Tirka, Jorgji Gjinari, Emil Lafe dhe shkrimtarë të njohur të pranishëm në këtë promovim e kanë konsideruar librin e Preng Cub Lleshit si një “manifest” të Shoqatës Kombëtare për mbrojtjen e gjuhës shqipe.

Shpëtim Çuçka: Shqipja e njësuar, monument që duhet ruajtur

Gjuhëtar dhe përkthyes i shquar, profesor Shpëtim Çuçka ka folur për vlerat e librit të Preng Cub Lleshit “*Mos e vritni fjalën shqipe*”, duke i argumentuar ato hap pas hapi.

“Ky libër të mos humbasë në lëmin e librave të rëndomtë. Promovimi duhet të ishte bërë, jo vetëm në një mjedis akademikësh, por edhe në një mjedis me studentë”, tha profesor Çuçka, duke arsyetuar se libri i Preng Cub Lleshit meritonte më shumë vëmendje për temën madhore të gjuhës së njësuar që trajton e që duhet të ruhet si një monument. “Ka ardhur koha ta përmirësojmë Drejtshkrimin, thonë kundërshtarët e standartit, “Po prit more zotëri, si do ta përmirësojmë!”.

Është si të thuash do ta përmirësojmë ne Kalanë e Rozafës. Por ne duhet ta ruajmë njëherë, që të mos shkatërrohet”.

Çuçka tha ndër të tjera se vlerat e librit të P.C. Lleshit duken nga mënyra sesi e mbron Drejtshkrimin “pa patos, pa zjarr, por me një karakter luftarak dhe të qytetëruar. Nuk fyen dikë. Ndryshe ka qenë sjellja nga kundërshtarët të standartit, që e quajtën “pjellë në epruvetë”.

Preng Cub Lleshi në këtë libër përdor argumentet. Dija bëhet e argumentuar. Ai ka dhënë me qëndrimin e tij dhe me këtë libër një shembull qytetarie në një epokë degradimi”. “Prenga nuk e sheh gjuhën si njeri klanesh, që për fat të keq është përhapur rëndshëm sot edukata e klanizmit e momenti kur shkruan Prenga për mbrojtjen e shqipes është në kohën e krizës dhe paditurisë.

Gjovalin Shkurtaj: Jo, dorëheqjes nga mbrojtja e gjuhës së njësuar

Gjovalin Shkurtaj foli për deformimet që po i vijnë gjuhës shqipe në media dhe shtypin e shkruar nga shkujdesja për normat e Drejtshkrimit. “Këto janë problemet me të cilat akademikët duhet të merren zyrtarisht”, tha ndër të tjera gjuhëtari i njohur, duke u shprehur se ndihet i penduar që është larguar nga Këshilli Ndërakademik i Gjuhës Shqipe me anëtarët e tjerë që ishin kundër ndryshimeve në Drejtshkrim.

Shkurtaj argumentoi se ishte më mirë të qëndronim e të debatonim. “Lumi ka shumë gurë, e ka edhe gurë me thepa, që duhen përplasur me njëri-tjetrin sa të bëhen të rrumbullakët”, tha ai, ndërsa theksoi se “gjuha shqipe standarde është një gjë shumë e vlefshme. Është ajo që na bashkon dhe që duhet ta mbrojmë”.

Qemal Murati: Akademikët në Prishtinë donin t’i bënin dy gjuhë

Gjuhëtari i njohur kosovar, Qemal Murati, pasi vlerësoi argumentet e librit të Preng Cub Lleshit dhe ngritjen e shoqatës kombëtare në mbrojtje të gjuhës, rrëfeu se “Idelogjia e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe është krijimi i dy shqipeve standarde.

Një akademik në Prishtinë më ka thënë “ose do t’i bëjmë dy gjuhë, ose nuk bëhet ndryshe”. Nuk e ka tagrin një Këshill i tillë për të vendosur për platforma

gjuhësore”, tha Murati duke shtuar se “nuk do t’i mistifikojmë kulmet, unë të mbroj kulmin tim e dikush të Prizrenit. Kulmet janë shumë të bukura, por janë dialekte. Ne do të mbrojmë gjuhën e njësuar”.

Emil Lafe: Prapaskenat e kundështarëve të dialektit

“Unë nuk dola vetë, unë e ndjej veten të përjashtuar nga kryesia e Akademisë dhe KNGJSH. Në konferencën që u mbajt me rastin e përvjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit në vitin 2002, kemi formuluar thirrjen për të krijuar një Këshill Kombëtar për Gjuhën Shqipe, por në vend të një Këshilli Kombëtar, dy akademikë sesi u morën vesh dhe nga zyrat e Akademisë së Arteve e të Shkencave të Prishtinës, sesi ua prishën mendjen dy zyrtarëve të Akademisë sonë dhe në vend të Këshillit Kombëtar doli një Këshill Ndërademik.

Çështja e gjuhës është një çështje kombëtare, nuk është ndërademike, dhe aq më tepër ajo akademi nuk ka asnjë kontribut në këtë çështje. Nuk ka bërë asgjë për gjuhën letrare ndërkombëtare ose asgjë të madhe, për të mos thënë që ka futur shkopinj në rrota”. Kështu e përmbloodhi historinë e problemeve që u hapën për gjuhën shqipe gjatë këtyre vjetëve gjuhëtari i njohur Emil Lafe, duke kujtuar historinë e debateve të nisura për ndryshimet në gjuhën shqipe në marsin e vitit 2012.

Dhurata HAMZAI

IN MEMORIAM

IKJA E ILIROLOGUT QË DINTE MË SË SHUMTI PËR ILIRËT

Aleksandar Stipçeviq (1930-2015)



Më 30 gusht 2015 në Zagreb ndërroi jetë arkeologu, historiani, ilirologu, bibliologu dhe mbi të gjitha patrioti dhe njeriu i madh Akademiku Aleksandar Stipçeviq. Ai merrej me kulturën ilire (posaçërisht me besime religjioze dhe mitologji), histori, bibliografi, enciklopedistikë dhe sociologji të librit, por ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e ilirologjisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Aleksandar Stipçeviq lindi në fshatin Arbanasi të Zarës në Kroaci më 10 tetor të vitit 1930.

Është njëri nga pasardhësit e arbëneshëve të rrethit të Shkodrës, të cilët 300 vjet më parë u shpërngulën në rrethin e Zarës. Ka studiuar arkeologjinë dhe ka drejtuar një varg institucionesh e projektesh që lidhen me bibliotekat, historinë e librit, botimet enciklopedike etj. në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Jugosllavisë (JAZU) e më vonë të Kroacisë (HAZU) në Zagreb.

Në vitin 1954 ishte diplomuar në Fakultetin Filozofik të Zagrebit në Degën e Arkeologjisë, ndërsa në vitin 1977 e kishte mbrojtur tezën e doktoratës me titull “Simbolizmi religjioz tek ilirët” në Fakultetin Filozofik të Zarës. Një kohë të caktuar kishte punuar në Muzeun Arkeologjik të Zarës, kurse nga viti 1957 ishte shpërngulur në Zagreb dhe kishte filluar punën në Bibliotekën Kombëtare e Universitare të Zagrebit. Në vitin 1974 kishte marrë postin e drejtorit në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Jugosllavisë (JAZU) në Zagreb, ndërsa prej vitit 1983 kishte kaluar me punë në Entin Leksikografik Jugosllav (JLZ) “Miroslav Krležha” (Miroslav Krleža) po ashtu në Zagreb.

Që nga viti 1987 e deri në vitin 1997 ishte profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, Dega e Bibliotekarisë, të Universitetit të Zagrebit ku mbante kursin e historisë së librit, sociologjisë së librit dhe bibliografisë për ilirët, censurën në biblioteka etj. Për më shumë së 50 vjet emri i tij identifikohet me rezultatet me të reja të studimeve ilire.

Veprimtaria shkencore e Aleksandër Stipçeviqit zhvillohet në disa drejtime, ndërsa dy prej tyre mbesin kryesore: arkeologjia dhe bibliologjia, kurse gjatë karrierës së vet shkencore kujdes të veçantë i kishte kushtuar studimeve në fushën e iliologjisë.

Veprimtaria e tij shkencore-hulumtuese është e pasur me vlera edhe e gjerë për nga vëllimi meqë prof. Stipçeviq kishte publikuar disa qindra punime shkencore e profesionale në gjuhën kroate, italiane, angleze, shqipe dhe një varg monografish shkencore e bibliografike siç ishin: ”Arte degli Illiri“ (Arti ilir) Milano 1963. (përkthyer në gjuhën angleze në vitin 1963), “Gli Illiri” (Ilirët), Milano 1966 (përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 1967), “Bibliographia Illyrica”, Sarajevo 1967, “Iliri - povijest, kultura, život“ (Ilirët-historia, kultura, jeta), Zagreb 1974, 1989 dhe 1991 (përkthyer në gjuhën angleze në vitin 1977 dhe në gjuhën shqipe në vitet 1980, 1990 dhe 2002), “Bibliografija antičke arheologije u Jugoslaviji 1-2“ (Bibliografia e arkeologjisë antike në Jugosllavi), Sarajevo 1977, “Kultni simboli kod Ilira“ (Simbolet e kultit të ilirët), Sarajevo 1981 (përkthyer në gjuhën shqipe në vitet 1983, 1990 dhe 2002), “Povijest knjige“ (Historia e librit), Zagreb 1985 (përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 1988 e 2000, në gjuhën arabe në vitin 1993 në Kuvajt, në persishte në vitin 1994, dhe i ribotuar në gjuhën arabe në vitin 2013 në Aman), “Cenzura u knjižnicama“ (Censura nëpër biblioteka), Zagreb 1992, “O savršenom cenzoru“ (Mbi censorin e përkryer), Zagreb 1994 (përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 2002), “Interpretime albanologjike”, Shkup 1994, “Kulturno povijesni spomenici u Arbanasima“ (Monumentet kulturo historike në Arbanasi), Zadar 1977, “Tradicijska kultura zadarskih Arbanasa“ (Kultura tradicionale e arbneshëve të Zarës), Zagreb 2011 (i përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 2012).

Veprat e tij u përkthyen në shumë gjuhë botërore, ndërsa disa nga këto së fundi u përkthyen edhe në gjuhën shqipe, atë arabe dhe persishte.

Në vitin 1983 profesori Stipçeviq ishte zgjedhur anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës (ASHAK), kurse prej vitit 2001 ishte anëtar i huaj (Socio straniero) i akademisë prestigjioze Accademia Marchigiana di Scienze, Lettere ed Arti në Ankona të Italisë.

Deri në qershor të vitit 2014 profesori Stipçeviq ishte aktiv në jetë e shkencë, ndërkaq në qershor 2014 i kishte pësuar disa sulme të njëpasnjëshme në tru dhe disa muaj pas kësaj gjendja e tij shëndetësore shkonte duke iu përkeqësuar dhe për diç më shumë se një vit ai gjendej i vendosur në institucione përkatëse nën mbikqyrjen e mjekëve.

Për shkaqe të problemeve shëndetësore që nga fundi i vitit 2014 ishte thuajse i palëvizshëm.

Në shenjë respekti dhe falënderimi për punën e tij shkencore, në vitin 2001 ishte dekoruar nga ana e Presidentit të atëhershëm të Shqipërisë z. Rexhep Mejdani me dekoratën e artë “Naim Frashëri” për kontributin në “ndriçimin e historisë së ilirëve”, ndërsa në fillim të vitit 2015, respektivisht më 3 shkurt, profesori Stipçeviq ishte nderuar edhe me dekoratën “Skënderbeu” nga presidenti i Republikës së Shqipërisë. Ceremonia solemne e ndarjes së kësaj dekorate ishte organizuar në Ambasadën Shqiptare në Zagreb.

Mirënjohjen "Skënderbeu" kryetari i Shqipërisë e jep për shqiptarët më të njohur dhe për miqtë shqiptarë për kontribut të madh në promovimin e kulturës shqiptare dhe në përparimin e shtetit shqiptar në botë.

Për fat të keq, mirënjohja dhe i medalja “Skënderbeu” e kryetarit z. Bujar Nishani nuk i është dorëzuar personalisht profesorit Aleksandar Stipçeviq, për shkak të gjendjes tejet të rëndë të tij shëndetësore por bashkëshortes së tij prof. Angjelka Stipçeviq, në prani të tre djemve: Ennio, profesor i muzikologjisë, Mario, profesor i fizikës dhe Branimir Stipçeviqit, udhëheqës i përpunimit kompjuterik në Bibliotekën Universitare në Zagreb.

Nderimi i jetës dhe i veprës së profesorit Stipçeviq nga ana e Kryetarit Nishani dhe nga ana e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë sado i vonuar ishte një satisfikacion moral për familjen Stipçeviq, ndërsa mosbërja të asgjëje nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës për një shkencëtar të kalibrit të tij, i cili kishte kontribuar shumë në lëmin e arkeologjisë, ilirologjisë dhe kulturës shqiptare është e pakuptueshme, aq më tepër kur dihet se prof. Stipçeviq për dekada të tëra ishte promovues dhe ambasador i kulturës shqiptare jo vetëm në Kroaci dhe rajon, por edhe në tërë botën.

Profesorin Stipçeviq e pata nderin ta njoftoj në vitin 1974, kur isha student në Zagreb, dhe edhe pse nuk e pata profesor kurrë, prej asaj kohe e kisha koleg e mik të shtrenjtë.

Akademiku Aleksandar Stipçeviq ka qenë dhe ka mbetur një personazh i madh si shkencëtar, por mbi të gjitha si njeri i cili i kishte nderuar rrënjët e veta arbëreshe, kishte ruajtur gjuhën amë-arbëreshe, ishte mburrur me origjinën e tij dhe me punën e vete e ka nderuar mbarë kombin shqiptar. Akademiku Aleksandar Stipçeviq ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e ilirologjisë (librat e tij “Arti ilir” dhe “Ilirët” nuk kanë qenë të parët në këtë fushë, por ishin të parët të cilët i kishin promovuar ilirologjinë dhe ilirët jashtë botës shqiptare dhe ballkanike). Gjatë shumë viteve prof. Stipçeviq kishte punuar në sajimin e bibliografisë ilire (Bibliographia Illyrica) në të cilën është përmbledhur çdo gjë që ishte shkruar për ilirët deri në momentin e botimit të këtij libri. Po ashtu është

marrë edhe me traditën e të parëve të vet-arbëreshve të Zarës dhe me shumë çështje të tjera me interes për ilirologjinë dhe për kombin shqiptar.

Vdekja e profesorit Stipçeviq është humbje e madhe jo vetëm për shqiptarët por për shkencën në përgjithësi, e posaçërisht për ilirologjinë. Një shkencëtar i kalibrit të Stipçeviqit lind një herë dhe nuk përsëritet. Ajo që është e dhimbshme është se ne, shqiptarët e kemi çmuar pak, ose më mirë të themi nuk e kemi vlerësuar sa duhet. Për të gjitha çka ka bërë Stipçeviqi për kulturën shqiptare ne i kemi mbetur borxh. Ç'është e vërteta profesori për një kohë ka ligjruar në UP (1970-1973), pastaj në vitin 2002 redaksia e revistës "Dardania Sacra" (prof. Engjell Sedaj, kryeredaktor dhe autori i këtyre rreshtave, Sekretar i redaksisë) e ka ftuar në Prishtinë ku i ka mbajtur dy ligjërata: në Fakultet Filozofik dhe në Institut Albanologjik dhe po ashtu, me rastin e 70 vjetorit të jetës, atij iu ishte kushtuar një numër tematik i revistës "Dardania Sacra" (nr.2/2002). Disa vite më vonë, respektivisht më 2009, ishte ftuar në Prishtinë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "Iliria dhe Ilirët" të cilën e kishte organizuar Kolegji "Iliria" me ç'rast ishte nderuar me çmimin e veçantë: "Anëtar Nderi i Bordit të Kolegjit ILIRIA". Në vitin 2012 Instituti Albanologjik ia kishte përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe librin "Kultura tradicionale e arbëreshëve të Zarës". Këto, së bashku me përkthimin e disa veprave të tjera të tij në gjuhën shqipe (Ilirët, Simbolet e kultit të ilirët, Historia e librit) disa recensione të shkruara për veprat e tij (Ilirët, Simbolet e kultit të ilirët) nga autori i këtyre rreshtave dhe një emision dokumentar mbi jetën e veprën e tij të përgatitur dhe emituar në mars të vitit 2015 nga TV Dukagjini të Pejës, ishin të tëra çka kishin bërë Kosova dhe kosovarët për profesorin Stipçeviq. Në nëntor të vitit 2014 e pata vizituar Profesorin në shtëpi të pleqve në Zagreb, dhe ia solla nga Doha e Katarit veprën e tij "Historia e librit" që ishte ribotuar në gjuhën arabe në Aman në vitin 2013 e përkthyer nga Prof. Muhamet Mufaku Arnauti. Ky ishte edhe takimi ynë i fundit. Duhet theksuar arritjet njerëzore të profesorit Stipçeviq: ai ishte lindur dhe jetonte në Kroaci, për një kohë të gjatë i përndjekur nga regjimi komunist, por asnjëherë nuk e kishte harruar gjuhën arbëreshe dhe origjinën e vet shqiptare. Aq sa ka bërë me pendë, profesori Stipçeviq ka bërë duke u ndihmuar profesionalisht dhe në çdo aspekt tjetër shumë shqiptarëve kur ata kishin nevojë, dhe ky është një nga gurët në monumentin që ai ia ngriti vetës për së gjalli.

Akademiku Stipçeviq ishte edhe ambasador dhe promotor i kulturës kombëtare shqiptare meqë i tubonte te gjitha botimet dhe të gjitha të dhënat (audio, video, materiale të shkruara e tjera) lidhur me arkeologjinë, historinë, etnologjinë, folklorin dhe kulturën shqiptare në përgjithësi dhe çdo shkencëtar që interesohej për çështje të ndryshme të kulturës ilire e shqiptare i referohej profesorit Stipçeviq, i cili pos njohjes së madhe të arkeologjisë dhe të kulturës ilire e shqiptare në përgjithësi, kishte grumbulluar në banesën e tij edhe një fond tejet të pasur të literaturës përkatëse lidhur me kulturën ilire dhe shqiptare në përgjithësi për çka për shumë vite edhe ishte persekutuar nga regjimi monist sllav dhe për një kohë të gjatë nuk i ishte lejuar puna në Universitet. Për këtë arsye edhe të gjithë shkencëtarët e huaj, gazetaret apo kushdo tjetër që interesohej për të kaluarën dhe kulturën shqiptare i referohej profesorit Stipçeviq.

E çka kanë bërë institucionet shtetërore të Kosovës për te?Asgjë!

Pjesa më tragjike e jetës së tij ishin vitet 2014 dhe 2015, kur Profesori është sëmurë dhe ishte detyruar të qëndronte në shtëpi të pleqve (fillimisht në fshatin Odra afër Zagrebit e së fundi në Zagreb), ndërsa për shkak të shpenzimeve të larta rreth qëndrimit në këto institucione dhe të shërimit bashkëshortja e tij ishte detyruar ta shiste bibliotekën e tij të vlefshme (të cilën ai e kishte tubuar tërë jetën) për ti siguruar mjetet e nevojshme për varrimin e të ndjerit.

E asnjë Qeveri shtetërore (as ajo shqiptare e as ajo kosovare) nuk e bënë as gjënë më të vogël për t'i ndihmuar këtij njeriu dhe miku të madh sa ishte i sëmurë, madje nuk e organizuan asnjë mbledhje komemorative me rastin e vdekjes së tij !!!

Prof. dr. Naser FERRI

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

11

2015

*Kopertina
Imer Bajrami*

*Përpunimi kompjuterik
Besnik Emini*

*Shtypi
Shtypshkronja
“Focus Print” – Shkup*

*Revista botohet me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës të
Republikës së Maqedonisë*

